

# TË VËRTETË NDAJ BESIMIT



NJË REFERIM PËR UNGJILLIN

# TË VËRTETË NDAJ BESIMIT

NJË REFERIM PËR UNGJILLIN

Botuar nga  
Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme  
Salt Lake City, Utah

Kapaku i librit: *Light and Truth (Drita dhe e Vërteta)*, nga Simon Dewey  
© nga Simon Dewey

© 2005 nga Intellectual Reserve, Inc.  
I rezervohen të gjitha të drejtat  
Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Miratimi për gjuhën angleze: 7/04  
Miratimi për përkthim: 7/04  
Përkthim i *True to the Faith*  
Albanian

## MESAZH NGA PRESIDENCIA E PARË

Ky libër është hartuar për t'u përdorur si bashkudhëtar gjatë studimit tuaj të shkrimeve të shenjta dhe të mësimave të profetëve të ditëve të mëvonshme. Ne ju nxisim t'i referoheni atij kur të studioni dhe të vini në zbatim parimet e ungjillit. Përdoreni si material burimor kur përgatisni bisedat, kur u jepni mësim klasave dhe kur u përgjigjeni pyetjeve në lidhje me Kishën.

Ndërsa mësoni të vërtetat e ungjillit, ju do të rrisni kuptimin për planin e përjetshëm të Atit Qiellor. Duke e pasur këtë kuptim si themel për jetën tuaj, ju do të jeni në gjendje të bëni zgjedhje të urta, të jetoni në harmoni me vullnetin e Perëndisë dhe të gjeni gëzim jete. Dëshmia juaj do të bëhet më e fortë. Do të mbeteni të vërtetë ndaj besimit.

Jemi veçanërisht të kujdesshëm për të rinjtë, të rriturit e rinj beqarë dhe të kthyerit e rinj. Ne ju premtojmë se nëpërmjet lutjes së rregullt personale dhe studimit të shkrimeve të shenjta e të doktrinaeve të ungjillit, ju do të jeni të përgatitur për t'i bërë ballë ndikimeve të liga të cilat do t'ju mashtronin dhe do t'ju dëmtonin.

Ky libër ju forcoftë në përpjekjet tuaja për t'iu afruar Shpëtimtarit pranë dhe për ta ndjekur shembullin e Tij.

Presidencia e Parë



## TEMA TË UNGJILLIT RENDITUR ALFABETIKISHT

### Abort

Në shoqërinë e sotme, aborti është bërë një praktikë e zakonshme, mbrojtur nga argumente mashtruese. Në rast se përballeni me dyshime mbi këtë çështje, mund të jeni të sigurtë me ndjekjen e vullnetit të zbuluar të Zotit. Profetët e ditëve të mëvonshme e kanë denoncuar abortin, duke iu referuar urdhërimit të Zotit: “Mos vrit, as mos bëj diçka të ngjashme” (DeB 59:6). Këshilla e tyre mbi këtë çështje është e qartë: Anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme nuk duhet t’i nënshtrohen, të kryejnë, të inkurajojnë, të paguajnë ose të bien në ujdi për një abort. Në rast se e inkurajoni një abort, në çfarëdolloj mënyre, mund t’i nënshtroheni disiplinimit të Kishës.

Udhëheqësit e Kishës kanë thënë se disa rrethana të jashtëzakonshme mund të justifikojnë një abort, të tilla si: kur shtatëzania është rezultat i incestit ose përdhunimit, kur jeta ose shëndeti i nënës gjykohet prej autoritetit mjekësor kompetent se është seriozisht në rrezik ose kur njihet nga autoriteti mjekësor kompetent se fetusi ka defekte të rënda të cilat nuk lejojnë që foshnja të mbijetojë mbas lindjes. Por madje edhe këto rrethana nuk e justifikojnë vetvetiu një abort. Ata të cilët përballen me rrethana të tilla, duhet ta marrin abortin në konsideratë vetëm pasi të konsultohen me udhëheqësit e tyre lokalë të Kishës dhe pasi të marrin një pohim nëpërmjet lutjes së zellshme.

Kur një fëmijë ngjizet jashtë lidhjes martesore, zgjedhja më e mirë është që nëna dhe babai i fëmijës të martohen dhe të punojnë në drejtim të krijimit të një marrëdhënieje familjare të përjetshme. Nëse nuk ka të ngjarë për martesë të suksesshme, ata duhet ta çojnë fëmijën për birësim,

e parapëlqyeshme të bëhet nëpërmjet LDS Family Services [Shërbimet Familjare të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme] (shih “Birësim”, faqe 24).

## Abuzim

Abuzimi është trajtimi i të tjerëve ose i vetvetes në një mënyrë që shkakton dëmtim ose fyerje. Ai lëndon mendjen dhe shpirtin dhe shpesh po ashtu dëmton trupin. Mund të shkaktojë pështjellim, pasiguri, mosbesim dhe frikë. Ai është dhunim i ligjeve të shoqërisë dhe është në kundërshtim të plotë të mësimave të Shpëtimtarit. Zoti e dënon sjelljen abuzuese të çdo forme—fizike, seksuale, gojore ose emocionale. Sjellja abuzuese mund të çojë në disiplinim nga ana e Kishës.

### Këshillë për Personin Abuzues

Në qoftë se keni qenë abuzues në ndonjë marrëdhënie, duhet të pendoheni për mëkatin tuaj. Lutjuni Zotit fuqimisht që t’ju falë. U kërkoni falje atyre që i keni lënduar. Flisni me peshkopin ose presidentin tuaj të degës, që ai të mund t’ju ndihmojë gjatë procesit të pendimit dhe, nëse nevojitet, t’ju ndihmojë që të merrni këshillim shtesë ose ndihmë tjetër.

Në rast se sjellja juaj abuzuese është ushqyer prej ndjenjave të zemërimit, mësoni si ta kontrolloni temperamentin tuaj. Shkojini Zotit me lutje dhe kërkoni Atij t’ju ndihmojë. Me pamjen e përjetshme përpara, do të shihni se zemërimi juaj pothuajse gjithnjë ka ardhur si reagim për gjëra që nuk janë shumë të rëndësishme.

Nëse keni qenë fajtor për abuzim seksual, përpiquni ta disiplinoni mendjen. Kujtoni që mendimet tuaja kanë efekt të fuqishëm në jetën tuaj—“ashtu si [një njeri] mendon në zemër të tij, ashtu është ai” (Fjalët e Urta 23:7). Qëndroni larg pornografisë dhe çfarëdo gjëje tjetër që mund të nxiste dëshirë seksuale të pamoralshme. Lutuni për të pasur aftësinë që “virtyti . . . t’i stolisë mendimet e tua pa pushim” (DeB 121:45).

## Ndihmë për Viktimat e Abuzimit

Në rast se jeni viktimë e abuzimit, kërkoni menjëherë ndihmë. Flisni me udhëheqësin tuaj të priftërisë, normalisht peshkopi ose presidenti i degës suaj, por nganjëherë një anëtar i presidencisë së kunjit ose distriktit. Ai mund t'ju ndihmojë që të dini se ç'të bëni.

Jini të sigurtë se nuk fajësoheni ju për sjelljen lënduese të tjerëve. Nuk ju duhet të ndiheni fajtor. Në qoftë se keni qenë viktimë e përdhunimit ose e një abuzimi tjetër seksual, nëse jeni abuzuar nga një i njohur, një i panjohur ose madje një anëtar i familjes, ju nuk jeni fajtor për mëkat seksual. Djeni se jeni i pafajshëm dhe se Ati juaj Qiellor ju do.

Lutuni për paqen që vjen vetëm nëpërmjet Jezu Krishtit dhe Shlyerjes së Tij (shih Gjoni 14:27; 16:33). Shpëtimtari ka përjetuar të gjitha dhembjet dhe pikëllimet tuaja, madje ato që shkaktohen prej të tjerëve, dhe Ai di si t'ju ndihmojë (shih Alma 7:11-12). Më mirë se të kërkoni shpazim, përqendrohuni mbi çështje që mund t'i kontrolloni, të tilla si pikëpamja vetjake për jetën. Lutuni për forcën që të falni ata që ju kanë lënduar.

Vazhdoni të kërkoni ndihmë nga udhëheqësi juaj i priftërisë, që kështu ai të mund t'ju udhëzojë gjatë procesit të shërimit emocional. Nëpërmjet bekimeve të ungjillit ju mund ta ndaloni ciklin e abuzimit dhe të çlirohni nga vuajtja që keni përjetuar.

Referime shtesë: Mateu 18:1-6; DeB 121:34-46

*Shih gjithashtu Falje; Pendim*

## **Administrim i Kishës**

Jezu Krishti qëndron në krye të Kishës. Misioni i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është të ndihmojë të gjithë njerëzit të vijnë tek Ai (shih Moroni 10:32). Për të përmbushur këtë mision, Kisha është organizuar sipas modelit të zbuluar nga Zoti "për përsosjen e shenjtorëve, . . . derisa të arrijmë të gjithë te uniteti i besimit dhe të njohjes



së Birit të Perëndisë” (Efesianëve 4:12-13; shih gjithashtu vargun 11). Përshkrimi që vijon jep shkurtimisht organizimin e Kishës.

## Shtëpia dhe Familja

Familja është njësia themelore në Kishë dhe shtëpia është vendi më i rëndësishëm për mësimin e ungjillit. Asnjë organizim tjetër nuk mund të zërë vendin e familjes. Madje, ndërkohë që Kisha vazhdon të rritet, qëllimi i saj do të jetë përherë të mbështesë dhe të forcojë familjet dhe individët në përpjekjet e tyre për të jetuar ungjillin.

## Administrimi i Përgjithshëm

Zoti e udhëzon sot popullin e besëlidhjes së Tij nëpërmjet Presidentit të Kishës, të cilin ne e mbështesim si profet, shikues dhe zbulues. Presidenti i Kishës kryeson mbi të gjithë Kishën. Ai dhe këshilltarët e tij, të cilët gjithashtu janë profetë, shikues dhe zbulues, formojnë Kuorumin e Presidencisë së Parë.

Anëtarët e Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve janë gjithashtu profetë, shikues dhe zbulues. Ata, së bashku me Presidencinë e Parë, janë “dëshmitarët e veçantë të emrit të Krishtit në gjithë botën” (DeB 107:23). Ata veprojnë nën drejtimin e Presidencisë së Parë “për të ngritur kishën dhe për të rregulluar të gjitha punët e saj në të gjitha kombet” (DeB 107:33). Ata “[u hapin] derën [kombeve] me anë të shpalljes së ungjillit të Jezu Krishtit” (DeB 107:35).

Anëtarët e Kuorunit të të Shtatëdhjetëve thirren që të shpallin ungjillin dhe të ngrenë Kishën. Ata punojnë nën drejtimin e Dymbëdhjetë Apostujve. Anëtarët e Kuorunit të Parë dhe të Dytë të të Shtatëdhjetëve paracaktohen Autoritete të Përgjithshme dhe mund të thirren që të shërbejnë kudo në botë.

Këshilli Kryesues i Peshkopit është presidencia e Priftërisë Aarone në të gjithë Kishën. Peshkopi Kryesues dhe këshilltarët e tij shërbejnë nën drejtimin e Presidencisë së Parë për të administruar çështje të jetës tokësore për Kishën.

Organizatat Të Rinjtë, Shoqata e Ndihmës, Të Rejat, Fillorja dhe Shkolla e së Dielës të gjitha kanë presidenci në nivel të përgjithshëm për të siguruar udhëzim dhe drejtim.

### Administrimi i Zonës

Një zonë është ndarja më e madhe gjeografike e Kishës. Nën Drejtimin e Presidencisë së Parë dhe të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, një Presidenci e Zonës kryeson mbi secilën zonë. Presidentët e Zonave dhe këshilltarët e tyre caktohen nga Kuorumi i të Dymbëdhjetëve dhe nga Kuoromet e të Shtatëdhjetëve.

Disa vëllezër shugurohen në detyrën e të Shtatëdhjetëve, por nuk shërbejnë si Autoritete të Përgjithshme. Ata quhen të Shtatëdhjetë Autoritete Zone dhe caktohen në kuorume veç Kuorumit të Parë dhe të Dytë të të Shtatëdhjetëve, sipas vendndodhjes gjeografike. Autoriteti i tyre kufizohet në rajonin e përgjithshëm në të cilin jetojnë. Disa të Shtatëdhjetë Autoritete Zone shërbejnë si Presidenci të Zonave.

### Administrimi Lokal

*Lagjet dhe Degët.* Anëtarët e Kishës organizohen në grumbullime, të cilat takohen shpesh së bashku për pasurim shpirtëror dhe shoqëror. Grumbullimet e mëdha quhen lagje. Secila lagje kryesohet nga një peshkop, i ndihmuar nga dy këshilltarë.

Grumbullimet e vogla quhen degë. Secila degë kryesohet nga një president i degës, i ndihmuar nga dy këshilltarë. Një degë mund të organizohet atëherë kur të paktën dy familje anëtarësh jetojnë në një zonë dhe një nga anëtarët është mbajtës i denjë i Priftërisë Melkizedeke ose një prift i denjë në Priftërinë Aarone. Një presidenci e kunjtit, e misionit ose e distriktit organizon dhe mbikqyr degën. Një degë mund të rritet deri në lagje, nëse ndodhet brenda një kunji.

Secila lagje ose degë mbulon një zonë gjeografike të caktuar. Organizime të ndryshme në lagje ose në degë kontribuojnë për

punën e Zotit: grupet e priftërinjve të lartë; kuorumet e pleqve; Shoqata e Ndihmës, për gratë nga 18 vjeç e sipër; kuorumet e Priftërisë Aarone, për djemtë nga 12 deri 17 vjeç; programi i të Rejave, për vajzat nga 12 deri 17 vjeç; Fillorja, për fëmijët nga 18 muaj deri 11 vjeç; dhe Shkolla e së Dielës, për të gjithë anëtarët e Kishës nga 12 vjeç e sipër. Secili prej këtyre organizimeve plotëson role të rëndësishme në mësimdhënien e ungjillit, dhënien e shërbimit dhe mbështetjen e prindërve në detyrat e tyre të shenjta për të ndihmuar fëmijët e tyre të kthehen sipas ungjillit të Jezu Krishtit. Këto organizime punojnë gjithashtu së bashku për të ndihmuar anëtarët t'ua japin ungjillin të tjerëve.

*Kunjet, Misionet dhe Distriktet.* Shumica e zonave gjeografike ku është organizuar Kisha, ndahen në kunjje. Termi *kunj* vjen nga profeti Isaia, që profetizoi se Kisha e ditëve të mëvonshme do të ishte si një tendë, e fiksuar mirë me kunjja (shih Isaia 33:20; 54:2). Zakonisht në një kunj ka 5 deri 12 lagje dhe degë. Secili kunj kryesohet nga një president, i ndihmuar nga dy këshilltarë. Presidentët e kunjjeve i raportojnë dhe marrin drejtim nga Presidencia e Zonës.

Një mision është një njësi e Kishës që normalisht mbulon një zonë shumë më të gjerë nga ajo që mbulohet nga një kunj. Secili mision kryesohet nga një president misioni, i ndihmuar nga dy këshilltarë. Presidentët e misioneve përgjigjen drejtpërdrejtë para Autoriteteve të Përgjithshme.

Pikërisht ashtu si dega është një variant më i vogël i një lagjeje, distrikti është variant më i vogël i një kunji. Distrikti organizohet kur ka një numër të mjaftueshëm degësh në një zonë, që lejon komunikimin e lehtë dhe udhëtime të favorshme për mbledhjet e distriktit. Një president distrikti thirret për të kryesuar mbi të, me ndihmën e dy këshilltarëve. Presidenti i distriktit i raporton presidencisë së misionit. Një distrikt mund të rritet deri në kunj.

*Programet për Anëtarët Beqarë.* Shumë anëtarë të Kishës nuk janë martuar më parë ose janë të divorcuar apo kanë mbetur të ve. Këta anëtarë përbëjnë dy grupe: të rriturit e hershëm

beqarë (nga 18 deri 30 vjeç) dhe të rriturit beqarë (nga 31 vjeç e sipër).

Nuk ka një program të mbarë Kishës për të rriturit e hershëm beqarë dhe të rriturit beqarë. Në vend të tij, kur mjaft anëtarë beqarë jetojnë në një zonë, udhëheqësit lokalë të priftërisë nxiten të thërrasin përfaqësues të anëtarëve beqarë, të cilët punojnë nën drejtimin e tyre. Përfaqësuesit e anëtarëve beqarë planifikojnë veprimtari të tilla, si vallëzime, projekte shërbimi dhe mbremje shpirtërore. Këto veprimtari u japin anëtarëve beqarë mundësi të takohen dhe të forcojnë njëri-tjetrin. Anëtarët beqarë nxiten gjithashtu që të takohen rregullisht me udhëheqësit e tyre të priftërisë për të diskutuar nevojat dhe mundësitë e tyre për rritje shpirtërore dhe shërbim.

Referime shtesë: DeB 107

*Shih gjithashtu Priftëri; Shoqatë e Ndhimës*

## **Adhurim**

Të adhurosh Perëndinë do të thotë t'i japësh Atij dashurinë, nderimin, shërbimin dhe përkushtimin tënd. Zoti e urdhëroi Moisiun: "Adhuro Perëndinë, sepse vetëm atij do t'i shërbesh" (Moisiu 1:15). Në këtë periudhë ungjillore Ai ka urdhëruar: "Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë fuqinë, mendjen dhe forcën tënde; dhe në emër të Jezu Krishtit duhet t'i shërbesh atij" (DeB 59:5). Nëse vendosni ndonjë njeri ose tjetër gjë mbi dashurinë për Perëndisë, ju po praktikoni adhurim të rremë ose idhujtari (shih Eksodi 20:3-6).

Lutja është një mënyrë që ne mund ta adhurojmë Atin. Alma i mësoi djalit të tij Helamani: "Përgjëroju Perëndisë, për gjithë mbështetjen tënde; po, le të jenë të gjitha veprimet e tua në Zotin dhe kudo që të shkosh, le të jetë në Zotin; po, le të jenë të gjitha mendimet e tua të drejtuara te Zoti; po, le të jetë dashuria e zemrës sate e vendosur përgjithnjë te Zoti" (Alma 37:36).

## Agjërim dhe Oferta Agjërimi

Ju duhet të frekuentoni mbledhjet e Kishës me një shpirt adhurimi. Zoti ka urdhëruar: “Që të mund ta ruash veten më tepër të panjollë nga bota, duhet të shkosh në shtëpinë e lutjes dhe t’i ofrosh sakramentet e tua në ditën time të shenjtë; sepse në të vërtetë kjo është një ditë e caktuar për ty që të prehesh nga punët e tua dhe t’i drejtosh lutje Më të Lartit” (DeB 59:9-10).

Pjesëmarrja në ordinancat e priftërisë është gjithashtu pjesë e adhurimit tuaj. Kur merrni sakramentin me nderim dhe frekuentoni tempullin, ju kujtoni dhe adhuroni Atin tuaj Qiellor dhe shprehni mirënjohje për Birin e Tij, Jezu Krishtin.

Përveç shfaqjes së adhurimit nëpërmjet shprehjes së jashtme, duhet të keni një qëndrim adhurues kudo që të shkoni dhe në çfarëdo gjë që të bëni. Alma ia mësoi këtë parim një grupi njerëzish që ishin përjashtuar nga vendi i tyre i adhurimit. Ai i ndihmoi ata të kuptonin që adhurimi i vërtetë nuk kufizohet në një ditë të javës (shih Alma 32:11). Duke i folur po atij grupi njerëzish, shoku i Almës, Amuleku, i nxiti: “Adhuroni Perëndinë, në çfarëdo vendi që të jeni, në shpirt dhe në vërtetësi” (Alma 34:38).

Referime shtesë: Psalmeve 95:6-7; Mosia 18:25; Alma 33:2-11; DeB 20:17-19, 29; Nenet e Besimit 1:11

*Shih gjithashtu* Agjërim dhe Oferta Agjërimi; Dashuri; Lutje; Perëndia Atë; Shabat

## Agjërim dhe Oferta Agjërimi

Të agjërosh do të thotë të kalosh vullnetarisht një periudhë të caktuar kohe pa ushqim dhe pa pije. Agjërimi, i bashkuar me lutje të singertë, mund t’ju ndihmojë të përgatitni vetveten e të tjerët për të marrë bekimet e Perëndisë.

### Qëllimet e Agjërit

Në një rrethanë, Shpëtimtari dëboi një djall prej një fëmije dhe e përdori këtë përvojë që t’u mësonte dishepujve

të Tij mbi fuqinë e lutjes dhe të agjërimit. Dishepujt e Tij e pyetën: “Përse ne nuk ishim në gjendje ta dëbonim?” Jezusi u përgjigj: “Prej mosbesimit tuaj; sepse në të vërtetë, unë po ju them, se po të keni besim sa një kokërr sinapi, do t’i thoni këtij mali: ‘Zhvendosuni nga këtu atje’, dhe ai do të zhvendoset; dhe asgjë nuk do të jetë e pamundshme për ju. Por ky lloji demoni nuk del veçse me anë të lutjes dhe të agjërimit” (Shih Mateu 17:14-21.)

Ky rrëfim mëson se lutja dhe agjërimit mund t’u japin forcë shtesë atyre që japin dhe marrin bekime priftërie. Ky rrëfim gjithashtu mund të gjejë zbatim në përpjekjet tuaja vetjake për të jetuar ungjillin. Në rast se keni një dobësi ose mëkat të cilin jeni munduar ta mposhtni, mund t’ju nevojitet të agjëroni dhe të luteni për të marrë ndihmën ose faljen që dëshironi. Ashtu si djalli që Krishti e dëboi, telashi juaj mund të jetë i atij lloji që ikën vetëm nëpërmjet lutjes dhe agjërimit.

Mund të agjëroni për shumë qëllime. Agjërimit është një nga mënyrat për të adhuruar Perëndinë dhe për t’i shprehur Atij mirënjohje (shih Lluca 2:37; Alma 45:1). Mund të agjëroni ndërsa kërkoni nga Ati Qiellor të bekojë të sëmuret ose të pikëlluarit (shih Mateu 17:14-21). Agjërimit mund t’ju ndihmojë ju dhe ata që i doni, për të marrë zbulesë vetjake dhe për t’u bërë të kthyer tek e vërteta (shih Alma 5:46; 6:6). Me anën e agjërimit mund të fitoni forcën për t’i bërë ballë tundimit (shih Isaia 58:6). Mund të agjëroni kur përpiqeni të përulemi përpara Perëndisë dhe të ushtroni besimin tek Jezu Krishti (shih Omni 1:26; Helamani 3:35). Mund të agjëroni që të merrni udhëzime gjatë shpërndarjes së ungjillit dhe në lartësimin e thirrjeve në Kishë (shih Veprat e Apostujve 13:2-3; Alma 17:3, 9; 3 Nefi 27:1-2). Agjërimit mund të shoqërojë tri-shtimin ose vajtimin e të drejtëve (shih Alma 28:4-6; 30:1-2).

## E Diela e Agjërimit

Kisha përcakton një të dielë në çdo muaj, zakonisht të dielën e parë, si ditë për agjërime. Zbatimi i së dielës së agjërimit ashtu siç duhet përfshin qëndrimin pa ushqim dhe pije

për dy vakte të njëpasnjëshme, frekuentimin e mbledhjes së agjërimit e të dëshmimeve dhe dhënien e ofertës së agjërimit për të ndihmuar përkujdesjen ndaj atyre që kanë nevojë.

Oferta e agjërimit tuaj duhet të jetë të paktën sa vlera e dy vakteve të pangrëna. Kur është e mundur, jini bujar dhe jepni shumë më tepër se kjo shumë.

Përveç respektimit të ditëve të agjërimit të fiksuara nga udhëheqësit e Kishës, ju mund të agjëroni në çdo ditë tjetër, në përputhje me nevojat tuaja dhe nevojat e të tjerëve. Sidoqoftë, nuk duhet të agjëroni tepër shpesh ose për periudha kohe të tepruara.

### Agjërimit i Vërtetë

Në Predikimin në Mal Jezusi mësoi llojin e vërtetë të agjërimit. Ai foli kundër hipokritëve të cilët, kur agjërojnë, “shfityrohen për t’u treguar njerëzve se agjërojnë”. Më mirë se të vishesh me një pamje të jashtme drejtësie, duhet të agjërosh para “Atit tënd në fshehtësi; dhe Ati yt, i cili shikon në fshehtësi, do ta japë shpërblimin publikisht” (Mateu 6:16-18).

Profeti Isaia gjithashtu mësoi mbi shpirtin e vërtetë të agjërimit: “Agjërimit që më pëlqen a nuk është vallë ky: të thyesh zinxhirët e ligësisë, të zgjidhësh verigat e zgjedhës, t’i lësh të lirë të shtypurit, të dërrmosh çdo zgjedhë? A nuk konsiston vallë në ndarjen e bukës sate me atë që ka uri, në sjelljen në shtëpinë tënde të të varfërit pa strehë, në të veshurit e atij që është lakuriq, pa lënë pas dore ata që janë nga gjaku yt?” (Isaia 58:6-7).

Isaia gjithashtu dëshmoi për bekimet që vijnë kur i bindemi ligjit të agjërimit: “Atëherë drita jote do të shpërthejë si agimi dhe shërimi yt do të mbijë menjëherë, drejtësia jote do të të pararendë dhe lavdia e Zotit do të jetë praparoja jote. Atëherë do të thërrasësh dhe Zoti do të të përgjigjet, do të bërtasësh dhe ai do të thotë: ‘Ja ku jam!’ . . . Në rast se plotëson nevojat e të uriturit dhe ngop shpirtin e pikëlluar, atëherë drita jote do të lindë nga terri dhe terri yt do të jetë si mesdita. Zoti do të të udhëheqë vazhdimisht, do të ngopë

shpirtin tënd në vendet e thata dhe do t’u japë forcë kockave të tua; ti do të jesh si një kopsht i vaditur dhe si një burim uji, ujërat e të cilit nuk shterojnë” (Isaia 58:8-11).

Referime shitesë: 3 Nefi 13:16-18; DeB 59:12-14; 88:76, 119

*Shih gjithashtu* Lutje

**Alkool** (*Shih* Fjala e Urtësisë)

**Apostull** (*Shih* Administrim i Kishës; Profetë)

## **Ardhja e Dytë e Jezu Krishtit**

Mbasi Jezu Krishti u ngjit në qiell në mbarim të shërbesës së tij të vdekshme, dy engjëj u shpallën Apostujve të tij: “Ky Jezus, që u është marrë në qiell nga mesi juaj, do të kthehet në të njëjtën mënyrë, me të cilën e keni parë të shkojë në qiell” (Veprat e Apostujve 1:11). Kur Shpëtimtari të vijë përsëri, Ai do të vijë me fuqi dhe lavdi për ta marrë tokën si mbretërinë e Tij. Ardhja e Tij e Dytë do të shënojë fillimin e Mijëvjeçarit.

Ardhja e Dytë e Jezu Krishtit do të jetë një kohë e frikshme dhe vajtimi për të ligjtë, por do të jetë një ditë paqeje dhe triumfi për të drejtët. Zoti shpalli:

“Ata që janë të urtë dhe e kanë pranuar të vërtetën, dhe kanë marrë Shpirtin e Shenjtë si udhëzuesin e tyre, dhe nuk janë mashtruar—në të vërtetë unë ju them, ata nuk do të priten e nuk do të hidhen në zjarr, por do t’i qëndrojnë ditës.

Dhe toka do t’u jepet atyre për trashëgim; dhe ata do të shumëzohen e do të bëhen të fuqishëm dhe fëmijët e tyre do të rriten pa mëkat deri në shpëtim.

Sepse Zoti do të jetë mes të tyre e lavdia e tij do të jetë mbi ta dhe ai do të jetë mbreti e ligdhënësi i tyre” (DeB 45:57-59).

Zoti nuk e ka zbuluar me saktësi se kur do të vijë përsëri: “Orën dhe ditën askush s’e di, as engjëjt në qiell, as nuk do ta dinë derisa ai të vijë” (DeB 49:7). Por Ai u ka zbuluar profetëve



të Tij ngjarjet dhe shenjat që do të paraprijnë Ardhjen e Tij të Dytë. Ndër ngjarjet dhe shenjat e profetizuara janë:

- Braktisja e së vërtetës së ungjillit (shih Mateu 24:9-12; 2 Thesalonikasve 2:1-3).
- Rivendosja e ungjillit, duke përfshirë rivendosjen e Kishës së Jezu Krishtit (shih Veprat e Apostujve 3:19-21; Zbulesa 14:6-7; DeB 45:28; 133:36).
- Rivendosja e çelësave të priftërisë (shih Malakia 4:5-6; DeB 110:11-16).
- Dalja e Librit të Mormonit (shih Isaia 29:4-18; 3 Nefi 21:1-11).
- Predikimi i ungjillit kudo në botë (shih Mateu 24:14).
- Kohë ligësie, lufte dhe trazirash (shih Mateu 24:6-7; 2 Timoteu 3:1-7; DeB 29:17; 45:26-33; 88:91).
- Shenja në qiell dhe në tokë (shih Joeli 2:30-31; Mateu 24:29-30; DeB 29:14-16; 45:39-42; 49:23; 88:87-90).

Mos u shqetësoni për kohën e saktë të Ardhjes së Dytë të Shpëtimtarit. Në vend të kësaj, jetoni në një mënyrë të tillë që të jeni të përgatitur kurdo që Ai të vijë. Ndërsa vëzhgoni fatkeqësitë e këtyre ditëve të fundit, kujtohuni që të drejtët nuk kanë pse ta kenë frikë Ardhjen e Dytë ose shenjat që e paraprijnë atë. Fjalët e Shpëtimtarit për Apostujt e Tij ju përshtaten juve: “Mos u shqetësoni, sepse, kur të gjitha këto gjëra të ndodhin, ju mund të dini se premtimet që ju janë bërë do të përmbushen” (DeB 45:35).

Referime shtesë: Lluca 21:34-36; 2 Pjetri 3:10-14; DeB 133:42-52; Joseph Smith—Mateu

*Shih gjithashtu* Mijëvjeçar; Plani i Shpëtimit; Shenja

## **Arsim**

Zoti na ka urdhëruar: “Kërkoni të mësoni, madje me anë të studimit dhe gjithashtu me anë të besimit” (DeB 88:118).

Ai na ka këshilluar të mësojmë ungjillin e të fitojmë kuptim “për gjërat si në qiell, edhe në tokë dhe nën tokë; gjërat që kanë qenë, gjërat që janë, gjërat që duhet të ndodhin së shpejti; gjërat që janë në vendin tuaj, gjërat që janë jashtë; luftërat dhe ngatërresat e kombeve dhe gjykimet që janë mbi tokën; dhe një dije gjithashtu për vendet dhe për mbretëritë—me qëllim që [ne] të mund të [përgatitemi] në gjithçka” (DeB 88:78-80).

### Shkollimi dhe Formimi Profesional

Duhet të punoni gjithnjë për të mësuar mendjen dhe duart, që kështu t’ia dilni mbanë në fushën tuaj të zgjedhur. Përdoreni arsimin tuaj për të ndikuar për mirë. Kur e bëni këtë, do të bëheni i njohur si person me integritet. Do të jeni i përgatitur kur të vijë mundësitë dhe do të jeni një pasuri e vërtetë për familjen tuaj, Kishën dhe komunitetin.

Kërkoni shkollimin më të mirë të disponueshëm. Disa mundësi janë kolegjet dhe universitetet, shkollat teknike, kurset me korrespondencë, arsimi komunitar dhe kualifikimi privat.

### Seminari dhe Instituti

Nëpër botë shenjtorët e ditëve të mëvonshme nga moshja 14 deri 18 vjeç marrin pjesë në seminar, i cili siguron çdo ditë jave udhëzim nga shkrimet e shenjta. Institutet e besimit fetar sigurojnë çdo ditë jave kurse mbi një varg temash nga ungjilli për shenjtorët e ditëve të mëvonshme nga moshja 18 deri 30 vjeç.

Këto programe sigurojnë një mjedis shpirtëror dhe shoqëror, ku studentët mund të shoqërohen me njëri-tjetrin ndërsa mësojnë më tepër për ungjillin.

Për informacion mbi seminarin dhe institutin lidhuni me udhëheqësin lokal të priftërisë.

## Mësim Gjatë Gjithë Jetës

Vazhdoni të kërkonti mundësi arsimimi gjatë gjithë jetës suaj. Kjo do t'ju ndihmojë të jeni i kohës në profesionin e zgjedhur dhe në zotësitë e gjërat e tjera që ju interesojnë. Në këtë botë që ndryshon shpejt, ju duhet të caktoni kohë të arsimoheni për të tashmen dhe të ardhmen.

Veç shtytjes përpara të arsimimit tuaj me anë të shkollimit formal, ju mund të vazhdoni të mësoni duke lexuar, duke ndjekur ngjarje kulturore të shëndetshme, duke vizituar muzeume dhe vendndodhje historike dhe duke e vëzhguar botën përreth jush.

Referime shtesë: Fjalët e Urta 1:5; DeB 130:18-19

## Atë Qiellor (Shih Perëndia Atë)

## Autoritete të Përgjithshme (Shih Administrim i Kishës)

## Bekime Patriarkale

Bekimet patriarkale u jepen anëtarëve të denjë të Kishës nëpërmjet patriarkëve të shuguruar. Bekimi juaj patriarkal ju njofton prejardhjen familjare në shtëpinë e Izraelit dhe përmban këshillë private për ju nga Zoti.

Kur e studioni bekimin tuaj patriarkal dhe e ndiqni këshillën që përmban, ai do t'ju sigurojë udhëheqje, ngushëllim dhe mbrojtje. Për të mësuar se si ta merrni bekimin patriarkal, flisni me peshkopin ose presidentin e degës suaj.

## Njoftimi i Prejardhjes Familjare

Bekimi juaj patriarkal përfshin njoftimin e prejardhjes suaj familjare, duke bërë të ditur se jeni nga shtëpia e Izraelit—jeni pasardhës i Abrahamit, që i përkisni një fisi të caktuar të Jakobit. Shumë shenjtorë të ditëve të mëvonshme janë nga fisi i Efraimit, fis të cilit i jepet përgjegjësia parësore për udhëheqjen e punës së Zotit në ditët e mëvonshme.

Për shkak se secili nga ne ka përbërje gjaku shumë të përzier, dy anëtarë të së njëjtës familje mund të shpallen se janë nga fise të ndryshme të Izraelit.

Nuk ka rëndësi nëse prejardhja juaj nga shtëpia e Izraelit është përmes linjës së gjakut apo të birësimit. Duke qenë anëtar i Kishës, ju llogariteni si pasardhës i Abrahamit dhe si trashëgimtar i të gjitha premtimeve dhe bekimeve që përmban besëlidhja e Abrahamit (shih "Besëlidhje e Abrahamit", faqe 19-20).

### Mësoni nga Bekimi Juaj Patriarkal

Pasi të keni marrë bekimin patriarkal, duhet ta lexoni me përvullje, me lutje dhe shpesh. Ai është zbulesë private nga Ati juaj Qiellor, i cili i njej fuqitë, dobësitë dhe mundësitë tuaja të përjetshme. Me anë të bekimit patriarkal Ai do t'ju ndihmojë të mësoni se çfarë pret Ai nga ju. Bekimi juaj mund të përmbajë premtime, këshillime dhe paralajmërime. Ndërsa koha ecën, do të njihni fuqinë e zbulesës që gjendet atje.

Kur e ndiqni këshillën në bekimin tuaj, më pak mundësi do të ketë që ju të pengoheni ose të shkoni në gabim. Nëse nuk e ndiqni këshillën, nuk do të jeni të zotë të merrni bekimet që u premtuan.

Ndërkohë që bekimi patriarkal përmban këshillë dhe premtime të frymëzuara, ju nuk duhet të prisni që ai t'iu përgjigjet të gjitha pyetjeve që keni ose që të japë hollësi për atë që do të ndodhë në jetën tuaj. Nëse bekimi juaj nuk përmend një ngjarje me rëndësi, si p.sh., një mision kohëplotë ose martesën, nuk duhet të mendoni që s'do ta keni atë mundësi.

Në mënyrë të ngjashme, nuk duhet ta quani të mbaruar që çdo gjë që përmendet në bekimin tuaj patriarkal, do të plotësohet në këtë jetë. Bekimi patriarkal është i përjetshëm dhe premtimet e tij mund të arrijnë deri në përjetësi. Të jini i sigurt se, po të jeni i denjë, të gjitha premtimet do të plotësohen në kohën e përshtatshme para Zotit. Ato që nuk realizohen në këtë jetë, do të plotësohen në tjetrën.

Bekimi juaj patriarkal është i shenjtë dhe privat. Ju mund t'ua tregoni anëtarëve të afërt të familjes, por nuk duhet ta lexoni me zë të lartë në publik ose të lejoni që ta lexojnë apo ta shpjegojnë të tjerët. Madje as patriarku ose peshkopi apo presidenti i degës suaj nuk duhet ta shpjegojnë atë.

Mbajini fjalët e çmuara të bekimit patriarkal si thesar në zemër. Mendojini ato thellë dhe jetoni në mënyrën që të jeni i denjë t'i merrni bekimet e premtuara në këtë jetë dhe në jetën që vjen.

## Besëlidhje

Një besëlidhje është një kontratë e shenjtë midis Perëndisë dhe një personi ose grupi njerëzish. Perëndia cakton kushtet dhe Ai premtun të na bekojë kur u bindemi atyre kushteve. Kur ne zgjedhim të mos i mbajmë besëlidhjet, nuk mund të marrim bekimet dhe në disa raste vuajmë ndëshkimin si pasojë e mosbindjes sonë.

Të gjitha ordinancat shpëtuese të priftërisë shoqërohen nga besëlidhje. Për shembull, ju bëtë një besëlidhje kur u pagëzuat dhe ju e ripërtëriti atë besëlidhje çdo herë që merrni sakramentin (shih Mosia 18:8-10; DeB 20:37, 77, 79). Nëse keni marrë Priftërinë Melkizedeke, ju keni hyrë në betimin dhe besëlidhjen e priftërisë (shih DeB 84:33-34). Indaumenti i tempullit dhe ordinanca vulosëse gjithashtu përmbajnë besëlidhje të shenjta.

Gjithnjë kujtojeni dhe nderojini besëlidhjet që bëni me Zotin. Atëherë nuk do t'ju duhet të urdhëroheni në gjithçka që bëni (shih DeB 58:26-28). Ju do të frymëzoheni nga Fryma e Shenjtë dhe sjellja si e Krishtit do të jetë pjesë e natyrës suaj. Ashtu siç ka premtuar Zoti, ju “do të [merrni] zbulesë pas zbulesë, dituri pas diturie, që të mund të [dini] misteret dhe gjërat paqësore—ato që sjellin gëzim, ato që sjellin jetë të përjetshme” (DeB 42:61). Shpresa juaj më e madhe duhet të jetë shenjtërimi që vjen nga ky drejtim hyjnor; frika juaj më e madhe duhet të jetë humbja e këtyre bekimeve.

Referime shitesë: Jeremia 31:31-34; Mosia 5; Moroni 10:33; DeB 82:10; 97:8; 98:13-15

*Shih gjithashtu* Besëlidhje e Abrahamit; Martesë; Ordinanca; Pagëzim; Priftëri; Sakrament; Tempuj

## **Besëlidhje e Abrahamit**

Abrahami pranoi ungjillin dhe u shugurua prift i lartë (shih DeB 84:14; Abrahami 1:2). Më vonë hyri në martesë celestiale, që është besëlidhja e ekzaltimit (shih DeB 131:1-4; 132:19, 29). Ai në lidhje me besëlidhjen që bëri mori premtime të mëdha nga Zoti përsa i përket familjes së tij. Ndërmjet këtyre premtimeve ishin sa vijon:

- Pasardhësit e tij do të ishin të shumtë (shih Zanafilla 17:5-6; Abrahami 2:9; 3:14).
- Fara e tij, ose pasardhësit, do të merrnin ungjillin dhe do të mbanin priftërinë (shih Abrahami 2:9).
- Nëpërmjet shërbesës së farës së tij “të gjitha familjet e tokës do të [bekoheshin], madje me bekimet e Ungjillit, të cilat janë bekimet e shpëtimit, madje të jetës së përjetshme” (Abrahami 2:11).

Së bashku, të gjitha besëlidhjet dhe premtimet që mori Abrahami nga Zoti, quhen besëlidhja e Abrahamit. Ajo është një besëlidhje e përjetshme që shtrihet tek të gjithë ata të farës së Abrahamit (shih Zanafilla 17:7). Që të numërohet si farë e Abrahamit, një person duhet t’u bindet ligjeve dhe ordinarave të ungjillit. Atëherë ai person mund të marrë të gjitha bekimet e besëlidhjes së Abrahamit, madje edhe kur ai ose ajo nuk është pasardhës i drejtpërdrejtë i Abrahamit (shih Galatasve 3:26-29; 4:1-7; DeB 84:33-40).

Ju, si anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, jeni një fëmijë i besëlidhjes (shih 3 Nefi 20:25-26). Ju keni pranuar ungjillin e përjetshëm dhe keni trashëguar të njëjtat premtime dhënë Abrahamit, Isakut dhe Jakobit. Ju keni të drejtën ndaj bekimeve të priftërisë dhe

ndaj jetës së përjetshme, sipas besnikërisë në marrjen e ordinancave të shpëtimit dhe mbajtjen e besëlidhjeve shoqëruese. Kombet e tokës do të bekohen nga përpjekjet tuaja dhe nga punët e pasardhësve tuaj.

*Shih gjithashtu* Bekime Patriarkale; Besëlidhje; Jetë e Përjetshme; Ordinanca; Priftëri

## Besim

Apostulli Pali mësoi se “besimi është siguria e gjërave që shpresohen, tregim i gjërave që nuk shihen” (Hebrenjve 11:1). Alma bëri një formulim të ngjashëm: “Në qoftë se keni besim, ju shpresoni për gjëra që nuk shihen, të cilat janë të vërteta” (Alma 32:21).

Besimi është parim veprimi dhe fuqie. Kurdoherë që punoni për një qëllim të vlefshëm, ju ushtroni besim. Ju po shfaqni shpresën tuaj për diçka që ende nuk mund ta shihni.

### Besimi tek Zoti Jezu Krishti

Në mënyrë që besimi juaj t’ju çojë në shpëtim, ai duhet të përqendrohet tek Zoti Jezu Krishti (shih Veprat e Apostujve 4:10-12; Mosia 3:17; Moroni 7:24-26; Nenet e Besimit 1:4). Mund të ushtroni besim tek Krishti atëherë kur keni sigurinë që Ai jeton, ide të saktë për karakterin e Tij dhe dijeninë që po mundoheni të jetoni sipas vullnetit të Tij.

Të kesh besim tek Jezu Krishti, do të thotë të mbështetesh tërësisht tek Ai—t’i besosh fuqisë, inteligjencës dhe dashurisë së Tij të pafundme. Përfshin besimin te mësimet e Tij. Do të thotë të besosh që, megjithëse ju nuk kuptoni gjithçka, Ai i kupton. Mbani mend se, ngaqë Ai ka përjetuar të gjitha dhe mbjet, pikëllimet dhe dobësitë tuaja, e di si t’ju ndihmojë që të ngriheni përmbi vështirësitë tuaja të përditshme (shih Alma 7:11-12; DeB 122:8). Ai e “[ka mundur] botën” (Gjoni 16:33) dhe ka përgatitur udhën që ju të merrni jetë të përjetshme. Ai është gjithmonë i gatshëm t’ju ndihmojë kur e

mbani në mendje kërkesën e Tij: “Shihni tek unë në çdo mendim; mos dyshoni, mos kini frikë” (DeB 6:36).

### Të Jetosh përmes Besimit

Besimi është shumë më tepër se të besosh në mënyrë pasive. Ju e shprehni besimin përmes veprimit—me mënyrën si jetoni.

Shpëtimtari premtoi: “Në qoftë se ju do të keni besim në mua, ju do të keni fuqi të bëni çfarëdolloj gjëje që unë ta shoh të përshtatshme” (Moroni 7:33). Besimi tek Jezu Krishti mund t’ju nxisë të ndiqni shembullin e Tij të përsosur (shih Gjoni 14:12). Besimi juaj mund t’ju udhëheqë për të bërë vepra të mira, për t’iu bindur urdhërimeve dhe për t’u penduar për mëkatet tuaja (shih Jakobi 2:18; 1 Nefi 3:7; Alma 34:17). Besimi juaj mund t’ju ndihmojë ta kapërceni tundimin. Alma e këshilloi birin e tij, Helamanin: “Mësoju t’i bëjnë ballë çdo tundimi të djallit, me besimin e tyre në Zotin Jezu Krisht” (Alma 37:33).

Zoti do të kryejë mrekulli të fuqishme në jetën tuaj, sipas besimit tuaj (shih 2 Nefi 26:13). Besimi tek Jezu Krishti ju ndihmon të merrni shërimin shpirtëror dhe fizik nëpërmjet Shlyerjes së Tij (shih 3 Nefi 9:13-14). Kur të vij në kohë provash, besimi mund t’ju japë forcë për të ngulmuar përpara dhe përballuar me guxim vështirësitë tuaja. Madje edhe kur e ardhmja duket e pasigurtë, besimi juaj tek Shpëtimtari mund t’ju japë paqe (shih Romakëve 5:1; Helamani 5:47).

### Rritja e Besimit Tuaj

Besimi është dhuratë nga Perëndia, por ju duhet ta ushqeni që ta mbani të fortë. Besimi është si muskuli i krahut tuaj. Në qoftë se e ushtroni, forcohet. Nëse e vini në qafore fashoje dhe e lini aty, bëhet i dobët.

Ju mund ta ushqeni dhuratën e besimit nëpërmjet lutjes tek Ati Qiellor në emrin e Jezu Krishtit. Ndërsa i shprehni mirënjohjen Atit tuaj dhe ndërsa i luteni fuqimisht për bekimet që ju nevojiten juve dhe të tjerëve, ju do t’i afroheni pranë. Do t’i afroheni pranë Shpëtimtarit, Shlyerja e të cilit bën të mundur që



ju të luteni fort për mëshirë (shih Alma 33:11). Gjithashtu do të jeni i aftë të kapni udhëzimin e pandier të Frymës së Shenjtë.

Ju mund ta forconi besimin nëpërmjet mbajtjes së urdhërimeve. Si të gjitha bekimet nga Perëndia, besimi fitohet dhe rritet nëpërmjet bindjes dhe veprave të drejta vetjake. Në qoftë se dëshironi ta zgjeroni besimin tuaj në shkallën më të lartë të mundshme, duhet të mbani besëlidhjet që keni bërë.

Mund ta zhvilloni besimin gjithashtu me anë të studimit të shkrimeve të shenjta dhe të fjalëve të profetëve të ditëve të mëvonshme. Profeti Alma mësoi se fjala e Perëndisë e ndihmon besimin të forcohet. Duke e krahasuar fjalën me një farë, ai tha se dëshira për të besuar mund t'ju çojë që "të bëni vend" që fjala "të mbillet në zemrën tuaj". Atëherë do të ndjeni që fjala është e mirë, pasi do të fillojë të zmadhojë shpirtin tuaj dhe të ndriçojë kuptimin tuaj. Kjo do ta forcojë besimin tuaj. Kur e ushqeni vazhdimisht fjalën në zemrën tuaj, "me zell të madh dhe me durim, duke pritur frutin e saj, do të lëshojë rrënjë; dhe vini re, do të jetë një pemë që do të rritet, deri në jetën e përjetshme". (Shih Alma 32:26-43.)

Referime shtesë: Hebrenjve 11; Jakobi 1:5-6; 2:14-26; Ethëri 12:4-27; Moroni 7:20-48; DeB 63:7-11; 90:24

*Shih gjithashtu* Jezu Krishti; Pagëzim; Pendim; Perëndia Atë

**Betim** (*Shih* Blasfemi)

**Bibla** (*Shih* Shkrime të Shenjta)

## **Bindje**

Në ekzistencën para lindjes, Ati Qiellor kryesoi një Këshill të madh në Qiell. Atje ne mësuam për planin e Tij për të na shpëtuar, i cili përbante një kohë prove mbi tokë: "Ne do të bëjmë një tokë në të cilën këta të mund të banojnë; dhe ne do t'i provojmë me këtë, për të parë nëse ata do t'i bëjnë të gjitha që Zoti, Perëndia i tyre, do t'i urdhërojë" (Abrahami

3:24-25). Një nga arsyet pse jeni këtu në tokë, është që të tregoni gatishmërinë për t'iu bindur urdhërimeve të Atit Qiellor.

Shumë njerëzve u duket se urdhërimet janë të rënda dhe se kufizojnë lirinë dhe rritjen vetjake. Por Shpëtimtari mësoi se liria e vërtetë vjen vetëm kur ndjekim Atë: “Nëse do të qëndroni në fjalën time, jeni me të vërtetë dishepujt e mi; do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do t’ju bëjë të lirë” (Gjoni 8:31-32). Perëndia jep urdhërime për përfitimin tuaj. Ato janë udhëzime të përzemërta për lumturinë dhe mirëqenien tuaj fizike e shpirtërore.

Profeti Jozef Smith mësoi se bindja ndaj urdhërimeve çon në marrjen e bekimeve nga Perëndia. Ai tha: “Ka një ligj, të shpallur në mënyrë të pakthyeshme në qiell, përpara krijimit të kësaj bote, mbi të cilin të gjitha bekimet bazohen—dhe kur ne fitojmë ndonjë bekim nga Perëndia, është me anë të bindjes ndaj atij ligji mbi të cilin ai bazohet” (DeB 130:20-21). Mbreti Benjamin mësoi këtë parim po ashtu: “Unë do të doja që ju të keni parasysh gjendjen e bekuar dhe të lumtur të atyre që zbatojnë urdhërimet e Perëndisë”, këshillonte ai. “Pasi vini re, ata janë të bekuar në të gjitha gjërat, qoftë tokësore ashtu edhe shpirtërore; dhe nëse qëndrojnë besnikë deri në fund, ata janë marrë në qiell, që si rrjedhim të jetojnë me Perëndinë, në një gjendje lumturie të pafund. O, kujtoni, kujtoni se këto gjëra janë të vërteta; pasi Zoti Perëndi i ka folur” (Mosia 2:41).

Bindja ndaj urdhërimeve është shprehje e dashurisë sonë për Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin. Shpëtimtari tha: “Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia” (Gjoni 14:15). Më vonë Ai shpalli: “Po të zbatoni urdhërimet e mia, do të qëndroni në dashurinë time, sikurse unë i zbatova urdhërimet e Atit tim dhe qëndroj në dashurinë e tij” (Gjoni 15:10).

Referime shtesë: Jozueu 24:14-15; Predikuesi 12:13; Mateu 7:21; Gjoni 7:17; 1 Nefi 3:7; DeB 58:21-22; 82:8-10

*Shih gjithashtu Liri e Zgjedhjes; Plani i Shpëtimit*

## **Birësim**

Fëmijët kanë të drejtën të rriten nga prindër që nderojnë zotimet martesore dhe që sigurojnë dashuri dhe përkrahje. Birësimi mund të jetë një bekim i madh për shumë fëmijë që lindin pa këtë mundësi.

Kur një fëmijë ngjizet jashtë lidhjes martesore, zgjedhja më e mirë është që nëna dhe babai i fëmijës të martohen dhe të punojnë në drejtim të krijimit të një marrëdhënieje familjare të përjetshme. Nëse nuk ka të ngjarë për martesë të suksesshme, ata duhet ta çojnë fëmijën për birësim, e parapëlqyeshme të bëhet nëpërmjet LDS Family Services [Shërbimet Familjare të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme]. Vënia e foshnjës për birësim nëpërmjet Shërbimeve Familjare të ShDM i ndihmon prindërit e pamartuar të bëjnë për fëmijën atë që është më e mira. Ajo garanton që fëmija do të vulozet tek një nënë dhe baba në tempull dhe e shton shpresën për bekimet e ungjillit në jetën e të gjithë atyre që lidhen me këtë gjë. Birësimi është një vendim bujar, i përzemërt që bekon prindërit e lindjes, fëmijën dhe familjen birësuese.

Nëse jeni i martuar dhe dëshironi si bashkëshortë të birësoni një fëmijë, sigurohuni që t'i njihni të gjitha kërkesat ligjore të shteteve dhe agjencive qeveritare të përfshira. Këshillohuni me udhëheqësit tuaj të priftërisë dhe, nëse është e mundur, me anëtarë të organikës së Shërbimeve Familjare të ShDM. Nëse Shërbimet Familjare të ShDM nuk mundësohen në zonën tuaj, punoni me udhëheqësit tuaj të priftërisë për të gjetur agjenci të licensuara e të autorizuara që mbrojnë edhe fëmijët, edhe prindërit birësues.

## **Blasfemi**

Blasfemia është mungesa e respektit ose përbuzja për gjërat e shenjta. Ajo përfshin përdorimin e shkujdesur ose pa respekt të emrit të cilitdo anëtar të Kreut-Perëndi. Po ashtu përfshin çdo lloj mënyre të foluri ose sjelljeje të papastër ose të rëndomtë.

Përdorini emrat e Atit Qiellor, të Jezu Krishtit dhe të Frymës së Shenjtë përherë me nderim dhe respekt. Shpërdorimi i emrave të tyre është mëkat. Gjuha ose gjestet blasfemuese, të rëndomta ose të pahijshme, si dhe shakatë e pamoralshme janë fyese para Zotit dhe të tjerëve.

Gjuha e ndyrë ju dëmton shpirtin dhe ju prish. Mos i lejoni të tjerët t’ju ndikojnë që të përdorni një gjuhë të ndyrë. Në vend të kësaj gjëje, përdorni ju një gjuhë që të tjerët i lartëson e i ngre moralisht. Zgjidhni shokë që përdorin gjuhë të mirë. Jepni shembullin që do t’i nxishte të tjerët përreth që të përdorin gjuhë të pastër. Po qe se miqtë dhe të njohurit përdorin gjuhë blasfemuese, nxitini me dashamirësi që të zgjedhin fjalë të tjera. Në rast se vazhdojnë ende, duke përdorur finesën largohuni ose ndërroni temën.

Në rast se e keni bërë zakon të betoheni, ju mund ta ndërprisni. Filloni nga marrja e vendimit për të ndryshuar. Lutuni për ndihmë. Nëse tundoheni për të përdorur gjuhën blasfemuese, heshtni ose zgjidhni një mënyrë tjetër për të thënë atë që duhet të thoni.

Referime shtesë: Levitiku 19:12; DeB 63:60-64

*Shih gjithashtu Tundim; Thjeshtësi*

## Borxh

Nëpërmjet Profetit Jozef Smith, Zoti i tregoi njëherë një grupi shenjtorësh: “Është vullneti im që ju duhet t’i paguani të gjitha borxhet tuaja” (DeB 104:78). Që nga ditët e para të Kishës, profetët e Zotit na kanë paralajmëruar në mënyrë të përsëritur të shmangim skllavërinë e borxhit.

Një nga rreziqet e mëdha të borxhit është interesi që e shoqëron atë. Disa forma të kredisë, si kartat e kreditit, kanë veçanërisht norma interesi të larta. Sapo hyni në borxh, ju konstatooni se interesi nuk ka asnjë mëshirë. Ai vazhdon të mbliidhet, pavarësisht se si është gjendja juaj—nëse jeni i punësuar apo pa punë, me shëndet apo i sëmurë. Ai nuk shqitet derisa borxhi të paguhet. Mos u mashtroni nga ofertat

e kredisë, madje edhe nëse ato e paraqesin borxhin joshës, duke premtuar norma interesi të ulta apo pa asnjë interes për një periudhë kohe.

Kujdesuni për gjendjen tuaj financiare. Disiplinoheni veten në blerjet që bëni, duke shmangur aq sa të mundeni hyrjen në borxh. Në shumicën e rasteve, mund ta shmangni borxhin me përdorimin e mençur të burimeve tuaja. Në qoftë se merrni përsipër një borxh si, për shembull, një shumë të arsyeshme për të blerë një shtëpi të thjeshtë ose për të përfunduar arsimimin tuaj, punoni që ta paguani sa më parë e ta çlironi veten nga varësia. Kur t'i keni paguar borxhet tuaja dhe të keni mbledhur disa kursime, do të jeni të përgatitur për furtunat financiare që mund t'ju vijnë. Do të keni strehim për familjen tuaj dhe paqe në zemër.

Referime shtesë: Lluca 16:10-11; DeB 19:35

## **Braktisje**

Kur individë ose grupe njerëzish u largohen parimeve të ungjillit, ata janë në gjendje braktisjeje.

Periudha të braktisjes së përgjithshme kanë ndodhur gjatë gjithë historisë së botës. Pas kohëve të drejtësisë, shpesh njerëzit i janë kthyer ligësisë. Një shembull është Braktisja e Madhe, e cila ndodhi mbasi Shpëtimtari themeloi Kishën e Tij. Pas vdekjes së Shpëtimtarit dhe Apostujve të Tij, njerëzit i prishën parimet e ungjillit dhe bënë ndryshime të paautorizuara në organizimin e Kishës dhe ordinancat e priftërisë. Për shkak të kësaj ligësie gjerësisht të përhapur, Zoti e tërhoqi autoritetin e priftërisë nga toka.

Gjatë Braktisjes së Madhe njerëzit ishin pa drejtim hyjnor nga profetë të gjallë. Shumë kisha u krijuan, por ato nuk kishin fuqinë e priftërisë për t'i udhëhequr njerëzit tek njohuria e vërtetë e Perëndisë Atë dhe Jezu Krishtit. Pjesë nga shkrimet e shenjta u degraduan ose humbën dhe asnjëri nuk kishte autoritetin për të dhënë dhuratën e Frymës së Shenjtë ose për të kryer ordinanca të tjera priftërie. Kjo braktisje zgjati

derisa Ati Qiellor dhe Biri i Tij i Dashur iu shfaqën Jozef Smithit më 1820 dhe ndërmorën rivendosjen e plotësisë së ungjillit.

Tani ne jetojmë në një kohë kur ungjilli i Jezu Krishtit është i rivendosur. Por ndryshe nga Kisha në kohët e kaluara, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme nuk do të mbulohet nga një braktisje e përgjithshme. Shkrimet e shenja mësojnë se Kisha kurrë nuk do të shkatërronet përsëri (shih DeB 138:44; shih gjithashtu Danieli 2:44).

Megjithëse nuk do të ketë një braktisje tjetër të përgjithshme nga e vërteta, duhet që secili nga ne të mbrohet kundrejt braktisjes vetjake. Ju mund ta ruani veten nga braktisja vetjake nëpërmjet mbajtjes së besëlidhjeve tuaja, bindjes ndaj urdhërimeve, ndjekjes së udhëheqësve të Kishës, marrjes së sakramentit dhe forcimit të dëshmisë suaj vazhdimisht përmes studimit të përditshëm të shkrimeve të shenja, lutjes dhe shërbimit.

Referime shitesë: Isaia 24:5; Amosi 8:11-12; Mateu 24:4-14; Veprat e Apostujve 20:28-30; 2 Timoteut 3:1-5, 14-15; 4:3-4; 1 Nefi 13:24-29; Mormoni 1:13-14; DeB 1:15-17; Joseph Smith—Historia 1:17-19

*Shih gjithashtu Administrim i Kishës; Priftëri; Rivendosje e Ungjillit*

**Burg Shpirtëror** (*Shih Ferr; Parajsë; Vdekje Fizike*)

**Çaj** (*Shih Fjala e Urtësisë*)

**Çelësa të Priftërisë** (*Shih Priftëri*)

## Dashuri

Dashuria është një ndjenjë e thellë besnikërie, interesimi dhe dhembshurie. Dashuria për Perëndinë dhe për gjininë njerëzore është tipar dallues i dishepujve të Jezu Krishtit (shih Mateu 22:35-40; Gjoni 13:34-35; 2 Nefi 31:20). Ne e shfaqim dashurinë tonë për Atin Qiellor duke i mbajtur urdhërimet e

Tij e duke u shërbyer fëmijëve të Tij. Si shprehje të dashurisë sonë për të tjerët mund të përfshihen: t'u jesh dashamirës, t'i dëgjosh me vëmendje, të vajtosh me ta, t'i ngushëllosh, t'u shërbesh, të lutesh për ta, t'u flasësh për ungjillin dhe t'u bëhesh mik.

Dashuria jonë për ata që janë përreth nesh, rritet kur sjellim ndër mend që ata të gjithë janë fëmijë të Perëndisë—që ne jemi vëllezër e motra shpirtërore. Dashuria që rrjedh kur kuptohet kjo gjë, ka fuqi të kapërcejë të gjitha kufijtë kombëtarë, besimorë dhe racorë.

Referime shtesë: Levitiku 19:18, 34; Ligji i Përtërirë 6:5; Lluca 6:31-36; Gjoni 15:9-15; 1 Gjoni 4:7-21; Mosia 4:14-15; DeB 4:5; 12:8; 112:11; 121:41-45

*Shih gjithashtu* Bindje; Dashuri Hyjnore; Mëshirë; Shërbim

## **Dashuri Hyjnore**

Dashuria hyjnore është “dashuria e pastër e Krishtit” ose “dashuri e pafundme” (Moroni 7:47; 8:17). Profeti Mormoni mësoi: “Dashuria hyjnore është e duruar dhe është e mirë dhe nuk ka smirë, dhe nuk krekoset, nuk kërkon të mirën e vet, nuk nxitet lehtë në zemërim, nuk mendon keq dhe nuk gëzohet në paudhësi, por gëzohet në të vërtetën, mban të gjitha gjërat, beson të gjitha gjërat, shpreson të gjitha gjërat, duron të gjitha gjërat” (Moroni 7:45; shih gjithashtu 1 Korintasve 13:4-7).

Jezu Krishti është shembulli i përsosur i dashurisë hyjnore. Në shërbesën e Tij të vdekshmërisë Ai gjithnjë “e përshkoi vendin duke bërë mirë”, duke mësuar ungjillin dhe duke shfaqur dhembshuri të ndjerë për të varfërit, të pikëlluarit dhe të dëshpëruarit (shih Mateu 4:23; Marku 6:6; Veprat e Apostujve 10:38). Shprehja kurorëzuese e dashurisë së Tij hyjnore ishte Shlyerja e Tij e pafundme. Ai tha: “Askush s’ka dashuri më të madhe nga kjo: të japë jetën e vet për miqtë e tij” (Gjoni 15:13). Ky ishte akti më i madh i durimit, i dashamirësisë dhe i vetëmohimit që do të njohim ne ndonjëherë. Me kuptimin për dashurinë e qëndrueshme të

Shpëtimtarit, ju mund të ushtroni besim dhe pendim për mëkatet tuaja, i bindur që Ai do t'ju falë dhe do t'ju forcojë në përpjekjet tuaja për ta jetuar ungjillin.

Shpëtimtari dëshiron që ta pranoni dashurinë e Tij dhe dëshiron gjithashtu që ju t'ua tregoni atë të tjerëve. Ai u shpalli dishepujve të Tij: “Po ju jap një urdhërim të ri: ta doni njëri-tjetrin; sikurse unë ju kam dashur, ashtu edhe ju ta doni njëri-tjetrin. Prej kësaj do t'ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin” (Gjoni 13:34-35). Në marrëdhëniet tuaja me anëtarët e familjes dhe të tjerët, shihni Shpëtimtarin si shembull për ju. Përpiquni të doni siç do Ai, me dhembshuri, durim e mëshirë të pandryshuar.

Kur vazhdoni të merrni dashurinë e përsosur të Shpëtimtarit dhe kur shfaqni për të tjerët dashuri si të Krishtit, do të konstatooni se dashuria juaj rritet. Do të provoni gëzimin që gjendeni në shërbim të Zotit. Fryma e Shenjtë do të jetë bashkudhëtari juaj i përhershëm, duke ju udhëzuar në shërbimin tuaj dhe në marrëdhëniet me të tjerët. Do të përgatiteni të takoni Zotin tek Gjykimi, kur Ai do t'ju shpërblejë sipas përkushtimit në punën e Tij. Mormoni mësoi:

“Në qoftë se nuk keni dashuri hyjnore, ju s'jeni asgjë, pasi dashuria hyjnore nuk dështon kurrë. Prandaj, kapuni pas dashurisë hyjnore që është më e madhja e të gjithave, pasi të gjitha gjërat duhet të dështojnë—

Por, dashuria hyjnore është dashuria e pastër e Krishtit dhe nuk ka mbarim; dhe kushdo që gjendet i zotëruar prej saj në ditën e fundit, do të jetë mirë me të.

Prandaj, vëllezër të mi të dashur, lutjuni Atit me gjithë fuqinë e zemrës suaj, që të mbusheni me këtë dashuri që ai ua jep të gjithë atyre që janë pasues të vërtetë të Birit të tij Jezu Krisht; që ju të mund të bëheni bijtë e Perëndisë, që kur ai të shfaqet, ne të jemi si ai, pasi ne do ta shohim atë ashtu sikurse është; që të mund të kemi këtë shpresë; që ne të mund të pas-trohemi, madje ashtu si ai është i pastër” (Moroni 7:46-48).

Referime shitesë: Mateu 25:31-46; 1 Gjoni 4:18; Ethëri 12:33-34; DeB 12:8; 34:3; 121:45



## **Dëlirësi**

Dëlirësia është pastërti seksuale, një gjendje që është “e këndshme ndaj Perëndisë” (Jakobi 2:7 [LiM]). Të jesh i dëlirë, duhet të jesh i pastër moralisht në mendime, në fjalë dhe në veprimet tuaja. Ju nuk duhet të keni asnjë marrëdhënie seksuale para se të martoheni ligjërisht. Kur të martoheni, duhet të jeni krejtësisht besnik ndaj bashkëshortit ose bashkëshortes suaj.

Afrimi fizik ndërmjet bashkëshortit dhe bashkëshortes është i bukur dhe i shenjtë. Ai shugurohet nga Perëndia për krijimin e fëmijëve dhe për shprehjen e dashurisë brenda martesës.

Sot në botë Satani i ka çuar njerëzit të besojnë që afrimi seksual jashtë martesës është i pranueshëm. Por, në shikimin e Perëndisë, ai është një mëkat i rëndë. Është një abuzim me fuqinë që Ai na e ka dhënë të krijojmë jetë. Profeti Alma mësoi që mëkatet seksuale janë më të rënda se çdo mëkat tjetër, përveç vrasjes dhe mohimit të Frymës së Shenjtë (shih Alma 39:3-5).

Nganjëherë njerëzit provojnë të bindin veten se marrëdhëniet seksuale jashtë martesës janë të pranueshme, nëse pjesëmarrësit e duan njëri-tjetrin. Kjo nuk është e vërtetë. Të thyesh ligjin e dëlirësisë dhe të nxisësh një tjetër të veprojnë kështu, nuk është shprehje dashurie. Njerëzit që duhen me njëri-tjetrin, nuk do ta rrezikojnë kurrë lumturinë dhe sigurinë e njëri-tjetrit si shkëmbim për kënaqësi vetjake të përkohshme.

Kur njerëzit përkujdesen për njëri-tjetrin aq shumë sa të mbajnë ligjin e dëlirësisë, dashuria, mirëbesimi dhe zotimi i tyre rriten, duke rezultuar në një lumturi dhe unitet më të madh. Në kontrast me këtë, marrëdhëniet e ndërtuara mbi imoralitetin seksual bëhen shpejt të athta. Ata që angazhohen në imoralitetin seksual, shpesh ndiejnë frikë, faj dhe turp. Acarimi, xhelozia dhe urrejtja shpejt zëvendësojnë çdo

ndjenjë pozitive që ekzistonte njëherë në marrëdhënien e tyre.

Ati ynë Qiellor na e ka dhënë ligjin e dëlirësisë për të na mbrojtur. Bindja ndaj këtij ligji është në thelb të paqes vetjake dhe forcës së karakterit e lumturisë në shtëpi. Kur e mbani veten të pastër seksualisht, ju do të shmangni dëmtimet shpirtërore dhe emocionale që vijnë përherë nga përdorimi i afrimeve fizike me dikë jashtë martesës. Ju do të jeni të ndjeshëm ndaj udhëzimit, fuqisë, qetësisë dhe mbrojtjes së Frymës së Shenjtë dhe do të plotësoni një kërkesë të rëndësishme për marrjen e një rekomandimi për tempull dhe pjesëmarrjen në ordinancat e tempullit.

### Mëkatet Seksuale

Zoti dhe profetët e Tij e dënojnë imoralitetin seksual. Të gjitha lidhjet seksuale jashtë martesës dhunojnë ligjin e dëlirësisë dhe janë fizikisht dhe shpirtërisht të rrezikshme për ata që angazhohen në to.

Dhjetë Urdhërimet përfshijnë urdhërin që të mos kryejmë kurorëshkelje, që është komunikimi seksual ndërmjet një burri të martuar dhe një tjetër gruaje veç bashkëshortes ose ndërmjet një gruaje të martuar dhe një tjetër burri veç bashkëshortit (shih Eksodi 20:14). Apostulli Pali tha se është “vullneti i Perëndisë” që ne “të [heqim] dorë nga kurvëria,” që është komunikimi seksual ndërmjet një personi të pamartuar dhe kujtdo tjetër (1 Thesalonikasve 4:3). Profetët e ditëve të mëvonshme në mënyrë të përsëritur shprehen kundër këtyre mëkateve dhe kundër praktikës së ligë të abuzimit seksual.

Ashtu si dhunimet e tjera të ligjit të dëlirësisë, veprimtaria homoseksuale është një mëkat i rëndë. Ajo është në kundërshtim me qëllimet e tërheqjes seksuale njerëzore (shih Romakëve 1:24-32). Ajo i shtrembëron marrëdhëniet dashurore dhe i pengon njerëzit të marrin bekimet që mund të gjenden në jetën familjare dhe në ordinancat shpëtuese të ungjillit.

Në standardin e Zotit, thjesht shmangia nga komunikimi seksual jashtë martesës nuk mjafton për pastërtinë vetjake. Zoti kërkon një standard të lartë moral nga dishepujt e Tij, që përfshin besnikërinë e plotë të bashkëshortëve në mendime dhe në sjellje. Në Predikimin në Mal Ai tha: “Ju keni dëgjuar se të lashtëve u qe thënë: ‘Mos shkel kurorën’. Por unë po ju them se kushdo që shikon një grua për ta dëshiruar, ka shkelur kurorën me të në zemrën e vet” (Mateu 5:27-28). Në ditët e mëvonshme Ai ka thënë: “Mos bëj shkelje kurore, . . . as mos bëj diçka të ngjashme” (DeB 59:6). Dhe Ai ka ritheksuar parimin që mësoi në Predikimin në Mal: “Ai që e sheh një grua për ta dëshiruar ose, nëse ndonjë do të shkelë besnikërinë bashkëshortore në zemrën e tij, ata nuk do ta kenë Shpirtin, por do ta mohojnë besimin dhe do të kenë frikë” (DeB 63:16). Këto paralajmërime vlejné për të gjithë njerëzit, të martuar apo beqarë.

Në rast se ju keni kryer mëkat seksual, flisni me peshkopin ose presidentin e degës tuaj, që kështu ai t’ju ndihmojë nëpër procesin e pendimit (shih “Pendim”, faqe 115-119).

Nëse e gjeni veten duke luftuar me tundime seksuale, përfshirë ndjenjat e tërheqjes ndaj së njëjtës gjini, mos iu jepni atyre tundimeve. Të jeni të sigurt se e keni mundësinë që të zgjidhni shmangien e sjelljeve të tilla. Ju mund ta merrni ndihmën e Zotit kur luteni për fuqi dhe punoni për të kapërcyer problemin. Si pjesë të këtij procesi duhet të kërkonti këshillë nga peshkopi ose nga presidenti i degës tuaj. Ai do t’ju ndihmojë.

### Mbajtja e Ligjit të Dëlirësisë

Pavarësisht se sa të forta duken tundimet, Zoti do t’ju ndihmojë t’u rezistoni, nëse vendosni të ndiqni Atë. Apostulli Pali shpalli: “Asnjë tundim nuk ju ka gjetur juve, përveç se tundimi njerëzor; por Perëndia është besnik dhe nuk do të lejojë që t’ju tundojnë përtej fuqive tuaja, por me tundimin do t’ju japë dhe rrugë dalje, që ju të mund ta përballoni” (1 Korintasve 10:13). Këshilla që vijon mund t’ju ndihmojë të kapërceni tundimet e shpeshta dhe të paturpshme në botën e sotme:

*Vendosni tani të jeni të dëlirë.* Duhet ta merrni këtë vendim vetëm një herë. Merreni tani vendimin, para se të vijnë tundimet, dhe vendimi juaj le të jetë aq i fortë dhe me një zotim të tillë, saqë kurrë të mos arrijë të lëkundet. Përcaktojeni tani se kurrë nuk do të bëni përjashta martesës diçka që të zgjojë emocione të fuqishme që duhen shprehur vetëm në martesë. Mos i nxisni ato emocione në trupin e një personi tjetër ose në trupin tuaj. Përcaktojeni tani se do të jeni krejtësisht të vërtetë ndaj bashkëshortit ose bashkëshortes.

*Kontrolloni mendimet tuaja.* Askush nuk kryen mëkat seksual në çast. Veprimet e pamoralshme fillojnë me mendime të papastra. Nëse i lejoni mendimet të rrinë në gjëra të turpshme ose të pamoralshme, ju tashmë e keni hedhur hapin e parë drejt imoralitetit. Mbathjani menjëherë nga ato rrethana që mund t'ju bëjnë të mëkatoni. Lutuni për forcë të qëndrueshme për t'i rezistuar tundimit dhe për t'i kontrolluar mendimet. Bëjeni këtë pjesë të lutjeve tuaja të përditshme.

*Qëndroni larg pornografisë.* Mos shihni, mos lexoni a dëgjoni çfarëdoqoftë që paraqet ose përshkruan trupin njerëzor apo sjellje seksuale në një mënyrë që mund të zgjojë ndjesi seksuale. Materialet pornografike janë zakonformuese dhe shkatërruese. Ato mund t'ju zhvatën respektin për veten dhe ndjesinë e bukurive të jetës. Ato mund t'ju shkallmojnë vetëkontrollin dhe t'ju çojnë në mendime të liga dhe sjellje abuzuese.

*Nëse jeni beqar dhe po takoheni, trajtojeni gjithnjë me respekt atë që keni njohur.* Kurrë mos e trajtoni atë si objekt për t'u përdorur për dëshira epushore. Planifikoni me maturi veprimtari pozitive dhe të dobishme, me qëllim që ju dhe personi që takoni të mos mbeteni të vetëm pa asgjë për të bërë. Qëndroni në zona të sigurta, ku ju mund ta kontrolloni veten me lehtësi. Mos merrni pjesë në bashkëbisedime ose veprimtari që zgjojnë ndjesi seksuale. Mos u përfshini në puthje me pasion, në shtrirje së bashku apo mbi personin tjetër ose prekjen e pjesëve të shenjta vetjake të trupit të personit tjetër,

të veshur ose jo. Mos lejoni asnjëri që të bëjë me ju gjëra të tilla.

*Nëse jeni martuar, qëndrojeni besnik bashkëshortes apo bashkëshortit tuaj në mendime, fjalë dhe veprime.* Zoti ka thënë: “Duaje bashkëshorten tënde me gjithë zemër dhe do të kapesh pas saj e pas askujt tjetër. Dhe ai që e sheh një grua për ta dëshiruar atë, do të mohojë besimin dhe nuk do ta ketë Shpirtin; dhe nëse nuk pendohet, ai duhet të dëbohet” (DeB 42:22-23). Mos flirtoni kurrë në çfarëdo mënyre. Aq sa të jetë e mundur, shmangni qëndrimin vetëm për vetëm me cilindo të gjinisë tjetër. Pyeteni veten në do të kënaqej bashkëshorti ose bashkëshortja juaj, po të dinin fjalët dhe veprimet tuaja. Mbani mend këshillën e Apostullit Pali për të “[hequr] dorë nga çdo dukje e ligë” (1 Thesalonikasve 5:22). Kur u qëndroni larg rasteve të tilla, tundimet nuk e kanë mundësinë e rritjes.

### Falje për të Penduarin

Rruga më e mirë është pastërtia e plotë morale. Është gabim të kryhen mëkate seksuale thjesht me mendimin që do të pendoheni më vonë. Ky lloj qëndrimi është vetë një mëkat, duke treguar mungesë respekti për Zotin dhe besëlidhjet që bëni me Të. Megjithatë, nëse keni kryer mëkate seksuale, Zoti ofron falje, në qoftë se pendoheni.

Pendimi është i vështirë, por është i mundur. Ju mund të jeni të pastër përsëri (shih Isaia 1:18). Dëshpërimi për mëkatën mund të zëvendësohet me paqen e ëmbël të faljes. Për të mësuar se ç’duhet të bëni që të pendoheni, shihni “Pendim”, faqe 115-119.

Punoni në drejtim të ditës kur do të jeni i denjë të hyni në tempull, nën udhëzimin e fjalëve të Psalmistit:

“Kush do t’i ngjitet malit të Zotit? Kush do të qëndrojë në vendin e tij të shenjtë?

Njeriu i pafajshëm nga duart dhe i pastër nga zemra” (Psalmet 24:3-4).

Referime shitesë: Eksodi 20:14; 1 Korintasve 6:18-20; Alma 38:12; 3 Nefi 12:27-30

*Shih gjithashtu* Martesë; Pornografi

## Dëshmi

Dëshmi është një vërtetim shpirtëror i dhënë nga Fryma e Shenjtë. Themeli i dëshmisë është njohuria që Ati Qiellor jeton dhe na do; që Jezu Krishti jeton, që Ai është Biri i Perëndisë dhe që Ai kreu Shlyerjen e pafundme; që Jozef Smithi është profeti i Perëndisë, i cili u thirr të rivendosë ungjillin; që ne udhëhiqemi sot nga një profet i gjallë; dhe që Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është Kisha e vërtetë e Shpëtimtarit mbi tokë. Me këtë themel, një dëshmi shtohet duke i përfshirë të gjitha parimet e ungjillit.

Marrja dhe Forcimi i Dëshmisë.

Duke qenë anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, ju keni mundësinë dhe përgjegjësinë e shenjtë të fitoni dëshminë tuaj. Mbase e fitoni një dëshmi, ju keni detyrën që ta ushqeni gjatë gjithë jetës suaj. Lumturia juaj në këtë jetë dhe gjatë gjithë përjetësisë varet shumë nga fakti nëse jeni i "guximshëm në dëshminë e Jezusit" (DeB 76:79; shih gjithashtu vargjet 51, 74, 101). Ndërsa përpiqeni në këtë proces, kujtoni parimet e mëposhtme:

*Kërkimi për dëshmi fillon me dëshirën e drejtë dhe të sinqertë.* Ati juaj Qiellor do t'ju bekojë sipas dëshirave të drejta të zemrës suaj dhe përpjekjes për të bërë vullnetin e Tij. Duke i folur një grupi njerëzish të cilët akoma nuk kishin dëshmi për ungjillin, Alma mësoi: "Në qoftë se ju do të zgjoheni dhe do të vini në veprim aftësitë tuaja, madje deri në një provë mbi fjalët e mia dhe të ushtroni një pjesëz të besimit, po, edhe në qoftë se ju nuk mund të bëni më shumë sesa të dëshironi të besoni, lëreni këtë dëshirë të veprojnë në ju, madje derisa të

besoni në mënyrë që të bëni vend për një pjesë të fjalëve të mia” (Alma 32:27).

*Dëshmia vjen nëpërmjet ndikimit të qetë të Frymës së Shenjtë.* Rezultatet e një dëshmie mund të jenë të mrekullueshme dhe jetëndryshuese, por dhurata e dëshmisë zakonisht vjen si një siguri e qetë, pa shfaqje mahnitëse të fuqisë së Perëndisë. Madje edhe Alma, i cili u vizitua nga një engjëll dhe kishte parë Perëndinë të ulur në fronin e Tij, kishte nevojë të agjëronte dhe të lutej, me qëllim që të merrte një dëshmi nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë (shih Alma 5:45-46; 36:8, 22).

*Dëshmia juaj do të rritet dalëngadalë me anë të përvojave tuaja.* Asnjë njeri nuk merr menjëherë një dëshmi të plotë. Dëshmia juaj do të bëhet më e fortë nëpërmjet përvojave tuaja. Ajo do të zgjerohet ndërsa shfaqni gatishmëri për të shërbyer në Kishë, kudo që të thirreni. Do të rritet ndërsa merrni vendime për të mbajtur urdhërimet. Kur ngrini të tjerët lart dhe i forconi, ju do të shikoni që dëshmia juaj do të vazhdojë të zhvillohet. Kur luteni dhe agjëroni, kur studioni shkrimet e shenjta, frekuenti mbledhjet e Kishës dhe dëgjoni të tjerët që thonë dëshmitë e tyre, ju do të bekoheni me çaste frymëzimi të cilat do të përforcojnë dëshminë tuaj. Momente të tilla do t’ju vijnë gjatë gjithë jetës, kur mundoheni të jetoni ungjillin.

*Dëshmia juaj do të rritet kur ua tregoni të tjerëve.* Mos prisni që dëshmia juaj të zhvillohet plotësisht para se t’ua tregoni të tjerëve. Një pjesë e zhvillimit të dëshmisë vjen kur ajo u thuhet të tjerëve. Në fakt, ju do të zbuloni se, kur jepni atë që keni nga dëshmia juaj, ajo do t’ju kthehet—me rritje.

## Dhënia e Dëshmisë

Në mbledhjet e agjërimin e të dëshmisë dhe në bisedat që keni me anëtarë të familjes dhe me miq, ju mund të ndjeheni i nxitur të tregoni dëshminë tuaj. Në raste të tilla, mbani mend se nuk ju nevojitet të jepni një fjalim të gjatë dhe madhështor. Dëshmia juaj do të jetë më e fuqishme kur shprehet shkurt si bindje e çiltër mbi Shpëtimtarin, mbi mësimet e Tij dhe Rivendosjen. Lutu për drejtim dhe Shpirti

do t'ju ndihmojë që të dini si t'i shprehni ndjenjat e zemrës. Ju do të gjeni gëzim të madh ndërsa i ndihmoni të tjerët të përfitojnë nga shpresa dhe bindja që Zoti ju ka dhënë.

Referime shtesë: Gjoni 7:17; 1 Korintasve 2:9-14; Jakobi 1:5-6 [Bibla]); Moroni 10:3-5; DeB 6:22-23; 62:3; 88:81

*Shih gjithashtu* Agjërim dhe Oferta Agjërimi; Dhurata Shpirtërore; Fryma e Shenjtë; Lutje; Perëndia Atë; Shlyerja e Jezu Krishtit; Zbulesë

**Diel (e)** (*Shih* Adhurim; Shabat)

## Divorc

Në “Familja: Një Proklamatë Drejtuar Botës” Presidencia e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve “solemnisht [shpallin] se martesë midis një burri dhe një gruaje shugurohet nga Perëndia dhe se familja është thelbësore në planin e Krijuesit për destinacionin e përrjetshëm të fëmijëve të Tij” (shih faqe 47-48 në këtë libër). Pavarësisht nga këto të vërteta, divorci është bërë i rëndomtë në shumë shoqëri dhe është rritur madje edhe ndërmjet anëtarëve të Kishës. Kjo plagë në rritje nuk është nga Perëndia, por më saktë, është puna e kundërshtarit.

Çdo çift i martuar duhet të punojë bashkë që të jetë i denjë për bekimet e jetës së përrjetshme. Nëse jeni i martuar dhe po përjetoni vështirësi si bashkëshortë, mbani mend që ilaçi për pjesën më të madhe të tensionit martesor nuk është tek divorci apo shkëputja. Ilaçi gjendet tek ungjilli i Jezu Krishtit—tek pendimi, falja, ndershmëria dhe dashuria. Ai gjendet në trajtimin e bashkëshortes ose bashkëshortit tuaj ashtu siç doni të trajtoheni për vete (shih Mateu 7:12). Ndërsa punoni për zgjidhjen e vështirësive, mund t'ju lindë nevoja të shkoni së bashku për të kërkuar këshillë nga peshkopi ose presidenti juaj i degës.

*Shih gjithashtu* Dashuri; Dashuri Hyjnore; Familje; Martesë; Tempuj

**Djall** (*Shih* Satani)



## **Doktrina e Besëlidhje** (Shih Shkrime të Shenjta)

### **Drejtësi**

Drejtësia është ligji i pandryshueshëm i cili sjell pasojat për veprimet. Për shkak të ligjit të drejtësisë ju merrni bekime kur i bindeni urdhërimeve të Perëndisë (shih DeB 130:21-22). Gjithashtu ligji i drejtësisë e kërkon që të paguhet një ndëshkim për çdo mëkat që kryeni. Ai kërkon që të mos lejohet asgjë e papastër të jetojë me Perëndinë (shih 1 Nefi 10:21).

Kur Shpëtimtari zbatoi Shlyerjen, Ai i mori mbi Vetën mëkatet tona. Ai ishte në gjendje “për t’iu përgjigjur kërkesave të ligjit” (2 Nefi 2:7) për arsye se ia nënshtroi Vetveten ndëshkimit që kërkonte ligji për mëkatet tona. Duke vepruar kështu, Ai “[plotësoi] kërkesat e drejtësisë” dhe i tregoi mëshirë gjithkujt që pendohet dhe e ndjek Atë (shih Mosia 15:9; Alma 34:14-16). Ngaqë Ai ka paguar çmimin për mëkatet tuaja, juve nuk ju duhet ta vuani atë ndëshkim, në rast se pendoheni (shih DeB 19:15-20).

Referime shtesë: 2 Nefi 9:26; Alma 42

*Shih gjithashtu Mëshirë; Pendim; Shlyerja e Jezu Krishtit*

### **Drita e Krishtit**

Drita e Krishtit “vjen nga prania e Perëndisë për të mbushur pafundësinë e hapësirës”. Ajo është “dritë e cila është në gjithçka, që i jep jetë gjithçkaje, që është ligji me anë të të cilit gjithë gjërat qeverisen” (DeB 88:12-13; shih gjithashtu vargjet 6-11.) Kjo fuqi është një ndikim për mirë në jetën e të gjithë njerëzve (shih Gjoni 1:9; DeB 93:2). Në shkrimet e shenjta Drita e Krishtit quhet nganjëherë Shpirti i Zotit, Shpirti i Perëndisë, Shpirti i Krishtit ose Drita e Jetës.

Drita e Krishtit nuk duhet të ngatërrohet me Frymën e Shenjtë. Ajo nuk është person, siç është Fryma e Shenjtë. Ndikimi i saj i çon njerëzit të gjejnë ungjillin e vërtetë,

të pagëzohen dhe të marrin dhuratën e Frymës së Shenjtë (shih Gjoni 12:46; Alma 26:14-15).

Ndërgjegjja është shfaqje e Dritës së Krishtit, ajo na bën të aftë të gjykojmë të mirën nga e keqja. Profeti Mormoni na mësoi: “Shpirti i Krishtit i jepet çdo njeriu, që ai të dallojë të mirën nga e keqja; prandaj, unë do t’ju tregoj mënyrën se si të gjykoni; pasi çdo gjë që ju fton të bëni mirë dhe t’ju bindë të besoni në Krisht, është dërguar nëpërmjet fuqisë dhe dhuratës së Krishtit; prandaj ju mund të dini me një njohuri të përsosur se është nga Perëndia . . . Dhe tani, vëllezër të mi, meqë ju e njihni dritën nëpërmjet së cilës mund të gjykoni, dritë e cila është drita e Krishtit, shikoni të mos gjykoni gabim; pasi me të njëjtin gjykim që gjykoni ashtu do të gjyko-heni” (Moroni 7:16, 18).

Referime shtesë: Gjoni 8:12; Alma 28:14

*Shih gjithashtu Fryma e Shenjtë; Ndërgjegje*

**Duhan** (*Shih Fjala e Urtësisë*)

**Dhjak** (*Shih Priftëri; Priftëri Aarone*)

## **Dhjetë (e)**

Një nga bekimet e anëtarësisë në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është privilegji për të paguar të dhjetën. Nëpërmjet zbatimit të ligjit të së dhjetës ju merrni pjesë në ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë mbi tokë.

Përkufizimi dhe Qëllimi i së Dhjetës

Të paguash të dhjetën e plotë, do të thotë t’i japësh Zotit një të dhjetën e të ardhurave tuaja nëpërmjet Kishës së Tij. Ju ia jepni të dhjetën një anëtar i të keshillit të peshkopit ose të presidencisë së degës.

Udhëheqësit lokalë ia kalojnë fondet e së dhjetës drejt-përdrejt selive qendrore të Kishës, ku një keshill përcakton

mënyra të veçanta për të përdorur fondet e shenjta. Ky këshill përbëhet nga Presidencia e Parë, Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve dhe Këshilli Kryesues i Peshkopëve. Duke vepruar në varësi të zbulësës, ata marrin vendime ashtu siç drejtohen nga Zoti. (Shih DeB 120:1.)

Fondet e së dhjetës përdoren gjithmonë për qëllimet e Zotit—për të ndërtuar dhe mirëmbajtur tempuj dhe shtëpitë e mbledhjeve, për të mbështetur punën misionare dhe për të drejtuar punën e Kishës anembanë botës.

Bekimet e Pagimit të së Dhjetës së Plotë.

Ligji i së dhjetës kërkon sakrificë, por bindja juaj ndaj ligjit sjell bekime të cilat janë shumë më të mëdha nga çdo gjë që ju hiqni dorë. Profeti Malakia mësoi:

“Sillni gjithë të dhjetat në shtëpinë e thesarit, që të ketë ushqim në shtëpinë time dhe pastaj më vini në provë për këtë gjë”, thotë Zoti i ushtrive, ‘nëse unë nuk do t’i hap pragjet e qiellit dhe nuk do të derdh mbi ju aq shumë bekim, sa nuk do të keni vend të mjaftueshëm ku ta shtini’” (Malakia 3:10).

Këto bekime vijnë tek të gjithë ata që paguajnë plot dhjetë përqind të të ardhurave të tyre, edhe nëse ajo sasi është shumë e vogël. Kur i bindeni këtij ligji, Zoti do t’ju bekojë juve edhe shpirtërisht, edhe me gjërat e jetës.

Në Zotim për të Paguar të Dhjetën.

Nëse nuk e keni bërë zakon ta paguani rregullisht të dhjetën, mund ta keni të vështirë të besoni që jeni në gjendje të hiqni dorë nga një e dhjeta e të ardhurave tuaja. Por paguesit besnikë të së dhjetës mësojnë se ata nuk janë në gjendje të *mos* e paguajnë të dhjetën. Në një mënyrë shumë të vërtetë dhe të mrekullueshme, dritaret e qiellit hapen dhe bekime derdhen mbi ta.

Sillni ndër mend se, të paguash të dhjetën, nuk është edhe aq çështje parash, sa është çështje besimi. Kini besim tek Zoti. Ai dha urdhërimin për përfitimin tonë dhe Ai bëri

premtimin shoqërues. Kërkoni të gjeni forcë tek besimi i Nefit, i cili tha: “Le të jemi besnikë në zbatimin e urdhërimeve të Zotit; sepse, vini re, ai është më i fuqishëm se e gjithë toka” (1 Nefi 4:1).

*Shih gjithashtu Agjërim dhe Oferta Agjërimi*

## **Dhjetë Urdhërimet**

Dhjetë Urdhërimet janë parime të përhjetshme të ungjillit që janë të nevojshme për ekzaltimin tonë. Zoti ia zbuloi ato Moisiut në kohërat e lashta (shih Eksodi 20:1-17) dhe Ai i ka ritheksuar ato në zbulesat e ditëve të mëvonshme (shih DeB 42:18-29; 59:5-13; 63:61-62). Dhjetë Urdhërimet janë pjesë jetësore e ungjillit. Bindja ndaj këtyre urdhërimeve na hap rrugën për bindje ndaj parimeve të tjera të ungjillit.

Rishikimi i mëposhtëm i Dhjetë Urdhërimeve, përfshin shpjegime të shkurtra se si ato vazhdojnë të gjejnë zbatim në jetën tonë sot.

1. “Nuk do të kesh perëndi të tjerë para meje” (Eksodi 20:3). Ne duhet të bëjmë “gjithçka me syrin drejtuar te lavdia e Perëndisë” (DeB 82:19). Ne duhet ta duam dhe t’i shërbejmë Zotit me gjithë zemrën, forcën, mendjen dhe fuqinë tonë (shih Ligji i Përtërirë 6:5; DeB 59:5).
2. “Nuk do të bësh skulpturë” (Eksodi 20:4). Në këtë urdhërim, Zoti e dënon adhurimin e idhujve. Idhujtaria mund të ketë forma të ndryshme. Disa njerëz nuk përuken para shëmbëlltyrave të gdhendura ose statujave, por në vend të kësaj zëvendësojnë Perëndinë e gjallë me idhuj të tjerë, si paraja, zotërime materiale, ide, ose prestigj. Në jetën e tyre, “thesari i tyre është perëndia i tyre”— një perëndi që “do të mbarojë me ta” (2 Nefi 9:30).
3. “Nuk do ta përdorësh emrin e Zotit, të Perëndisë tënd, kot” (Eksodi 20:7). Për shpjegim të këtij urdhërimi shih “Blasfemi”, faqe 24-25.

4. “Mbaje mend ditën e shtunë për ta shenjtëruar” (Eksodi 20:8). Për shpjegim të këtij urdhërimi shih “Shabat”, faqe 156-157.
5. “Do të nderosh atin tënd dhe nënën tënde” (Eksodi 20:12). Ky është një urdhërim detyrues, që qëndron në fuqi edhe kur jemi të rritur. Ne gjithmonë duhet të gjejmë mënyra për t’i nderuar prindërit tanë.
6. “Nuk do të vrasësh” (Eksodi 20:13). Për shpjegimin se si ky urdhërim gjen zbatim tek ata që iu është kërkuar të shkojnë në luftë, shih “Luftë”, faqe 77-78.
7. “Nuk do të shkelësh besnikërinë bashkëshortore” (Eksodi 20:14). Në një zbulesë të ditëve të mëvonshme, Zoti dënoi jo vetëm tradhëtinë bashkëshortore, por edhe “diçka të ngjashme” (DeB 59:6). Kurvëria, homoseksualiteti dhe mëkate të tjera seksuale janë shkelje të urdhërimit të shtatë. Për më shumë shpjegime shih “Dëlirësi”, faqe 30-35.
8. “Nuk do të vjedhësh” (Eksodi 20:15). Vjedhja është një formë pandershmërie. Për shpjegimin e ndershmërisë shih faqen 104.
9. “Nuk do të bësh dëshmi të rreme kundër të afërmit tënd” (Eksodi 20:16). Bërja e dëshmisë së rreme është një formë tjetër pandershmërie. Për shpjegim të ndershmërisë shih faqen 104.
10. “Nuk do të dëshirosh . . . asgjë . . . që është e të afërmit tënd” (Eksodi 20:17). Të lakmosh ose të kesh smirë për diçka që i përket një tjetri, është e dëmshme për shpirtin. Mund të na pushtojë mendimet dhe të na mjerojë me një brengë e pakënaqësi të vazhdueshme. Shpesh të çon në mëkate të tjera dhe në borxhe financiare.

Megjithëse shumica e Dhjetë Urdhërimeve rendit gjëra që *nuk duhet* t’i bëjmë, ato gjithashtu përfaqësojnë gjëra që ne

*duhet të bëjmë. Shpëtimtari i përmbloodhi Dhjetë Urdhërimet në dy parime—dashuria për Zotin dhe dashuria për njerëzit:*

“‘Duaje Zotin, Perëndinë tënde me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde’.

Ky është urdhërimi i parë dhe i madhi.

Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: ‘Duaje të afërmin tënd porsì vetveten’” (Mateu 22:37-39).

Referime shtesë: Mosia 12:33-36; 13:11-24

*Shih gjithashtu* Adhurim; Bindje; Blasfemi; Dëlirësi; Liri e Zgjedhjes; Luftë; Nderim; Ndershmëri; Shabat

## **Dhurata e Frymës së Shenjtë** (*Shih* Fryma e Shenjtë)

### **Dhurata Shpirtërore**

Dhuratat shpirtërore janë bekime ose aftësi që jepen nga fuqia e Frymës së Shenjtë. Perëndia i jep të paktën një dhuratë të tillë çdo anëtarì besnik të Kishës. Kur i merrni këto dhurata, ato do t’ju forcojnë e do t’ju bekojnë për vete dhe do t’ju ndihmojnë t’u shërbeni të tjerëve. (Shih DeB 46:8-12.) Shkrimet e shenjta na mësojnë mbi dhurata të shumta të Shpirtit:

- Njohjen “se Jezu Krishti është Biri i Perëndisë dhe se ai u kryqëzua për mëkatet e botës” (DeB 46:13).
- Aftësinë për të besuar fjalët e atyre që dëshmojnë për Jezu Krishtin (shih DeB 46:14).
- Njohjen për “mënyrat e ndryshme të administrimit” (DeB 46:15; shih gjithashtu 1 Korintasve 12:5). Kjo dhuratë përdoret në administrimin dhe udhëheqjen e Kishës.
- Njohjen për “larmitë e veprimeve”, e cila na ndihmon të dallojmë nëse një mësim ose ndikim vjen nga Perëndia apo nga ndonjë burim tjetër (DeB 46:16; shih gjithashtu 1 Korintasve 12:6-7).

- Dhurata për “fjalë diturie” (1 Korintasve 12:8; DeB 46:17). Kjo nuk i referohet ligjit që ne e njohim si Fjala e Urtësisë. Në fakt, kjo është dhurata e urtësisë—aftësia për të përdorur diturinë në mënyra të drejta.
- Dhurata për “fjalë njohurie” (1 Korintasve 12:8; DeB 46:18).
- Aftësia për të mësuar të tjerët me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë (shih Moroni 10:9-10; shih gjithashtu DeB 46:18).
- Dhurata e besimit (shih 1 Korintasve 12:9; Moroni 10:11).
- Dhurata “[për të pasur] besim për t’u shëruar” (DeB 46:19).
- Dhurata “[për të pasur] besim të shërojnë” (DeB 46:20; shih gjithashtu 1 Korintasve 12:9; Moroni 10:11).
- “Pushtet për të kryer veprime të fuqishme” (1 Korintasve 12:9; DeB 46:21; shih gjithashtu Moroni 10:12).
- Dhurata e profetizimit (shih 1 Korintasve 12:10; Moroni 10:13; DeB 46:22). Gjon i Dashuri na mësoi që “dëshmia e Jezusit është frymë e profecisë” (Zbulesa 19:10).
- Shikimi i engjëjve dhe i shpirtëve shërbyes (shih Moroni 10:14).
- Dallimi i frymërave (shih 1 Korintasve 12:9; DeB 46:23).
- Dhurata për të folur në gjuhë të ndryshme ose për mënyrën e të folurit (shih 1 Korintasve 12:10; Moroni 10:15; DeB 46:24).
- Dhurata e “[interpretimit të] gjuhëve” (1 Korintasve 12:10; DeB 46:25; shih gjithashtu Moroni 10:16).

Këto dhurata shpirtërore dhe të tjera që renditen në shkrimet e shenjta, janë vetëm disa shembuj të dhuratave të shumta të Shpirtit. Zoti mund t’ju bekojë në mënyra të tjera,

në varësi të besnikërisë suaj dhe të nevojave tuaja e të atyre që u shërbeni. Ai na ka urdhëruar të punojmë me zell, me qëllim që të mund të marrim dhurata shpirtërore:

“Ruhuni që të mos mashtroheni; dhe që të mos mashtroheni, kërkon me zell dhuratat më të mira, gjithmonë duke kujtuar përse jepen ato;

Sepse në të vërtetë unë ju them, ato jepen për përfitimin e atyre që më duan e që i zbatojnë të gjitha urdhërimet e mia, dhe të atij që kërkon të bëjë kështu; që të mund të përfitojnë të gjithë ata që kërkojnë ose që lypin prej meje” (DeB 46:8-9; shih gjithashtu vargun 26).

Referime shtesë: 1 Korintasve 13; 14:1-33; Moroni 10:17-25; DeB 46:27-33; Nenet e Besimit 1:7

*Shih gjithashtu Fryma e Shenjtë; Zbulesë*

## **Dhurata të Shpirtit** (*Shih Dhurata Shpirtërore*)

## **Ekzaltim** (*Shih Jetë e Përjetshme*)

## **Ekzistenca Para Lindjes** (*Shih Plani i Shpëtimit*)

## **Falje**

Shkrimet e Shenjta e përmendin faljen në dy mënyra. Zoti na urdhëron të pendohemi për mëkatet tona dhe të kërkojmë faljen e Tij. Ai gjithashtu na urdhëron të falim ata që na cenojnë ose na lëndojnë. Në lutjen e Zotit, Jezusi na këshillon t’i kërkojmë Atit Qiellor të “na i [falë] fajet tona, ashtu siç ua falim ne fajtorëve tanë” (Mateu 6:12).

### **Në Kërkim të Faljes nga Zoti**

Mëkati është barrë e rëndë. Ai sjell tendosje nervore faji dhe ankthin e dijenisë që kemi vepruar kundër vullnetit të Atit tonë në Qiell. Sjell brejtje të pandërprerë të ndërgjegjes ndërsa bëhemi të vetëdijshëm se, për shkak të veprimeve



tona, mund t'i kemi lënduar të tjerët dhe t'ia kemi ndaluar vetes marrjen e bekimeve që Ati ynë që i gatshëm të na jepte.

Për arsye të Shlyerjes së Jezu Krishtit ne mund të marrim falje për mëkatet tona përmes pendimit të sinqertë dhe të plotë. Gjendja me mëkat sjell vuajtje dhe dhembje, veç falja e Zotit sjell lehtësim, ngushëllim dhe gëzim. Zoti ka premtuar se, kur ne jemi penduar për mëkatet tona, jemi të falur dhe Ai nuk i kujton më mëkatet tona (shih DeB 58:42).

“Edhe sikur mëkatet tuaja të ishin të kuqe flakë, do të bëhen të bardha si bora, edhe sikur të ishin të kuqe të purpur, do të bëhen si leshi” (Isaia 1:18).

Ju mund ta përjetoni këtë mrekulli, qoftë kur nevojitet të pendoheni për mëkate serioze, qoftë për të metat e përditshme. Ashtu siç iu lut Shpëtimtari njerëzve kohë më parë, ju lutet juve sot:

“Ejani tek unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t'ju jap çlodhje.

Merrni mbi vete zgjedhën time dhe mësoni nga unë, sepse unë jam zemërbutë dhe i përulur nga zemra; dhe ju do të gjeni prehje për shpirtrat tuaj.

Sepse zgjedha ime është e ëmbël dhe barra ime është e lehtë!” (Mateu 11:28-30).

“A nuk do të ktheheni tani tek unë dhe të pendoheni për mëkatet tuaja dhe të ktheheni në besim, që të mund t'ju shëroj?

Po, në të vërtetë unë ju them juve, në qoftë se do të vini tek unë, ju do të keni jetën e përjetshme. Vini re, krahu im i mëshirës është shtrirë drejt jush dhe kushdo që do të vijë, unë do ta pranoj; dhe të bekuar qofshin ata që vijnë tek unë” (3 Nefi 9:13-14).

Për sqarimin e pendimit shih “Pendim”, faqe 115-119.

## Falja e të Tjerëve

Përveç kërkimit të faljes për mëkatet tona, ne duhet të jemi të gatshëm të falim të tjerët. Zoti tha: “Ju duhet ta falni njëri-tjetrin; sepse ai që nuk ia fal shkeljet vëllait të tij, mbetet i dënuar përpara Zotit; sepse atij i ngelet mëkati më i madh.

Unë, Zoti, do të fal kë do të fal, por nga ju kërkohet t'i falni të gjithë njerëzit" (DeB 64:9-10).

Në rrethanat e jetës së përditshme me siguri që do t'ju bëhen padrejtësi nga të tjerët, ndonjëherë me patëkeq dhe nganjëherë me qëllim. Është e thjeshtë të hidhërohesh ose të inatosesh apo të hakmerresh në situata të tilla, por kjo nuk është mënyra e Zotit. Shpëtimtari këshilloi: "Duani armiqtë tuaj, bekoni ata që ju mallkojnë, u bëni të mirë atyre që ju urrejnë, dhe lutuni për ata që ju keqtrajtojnë dhe ju përndjekin" (Mateu 5:44). Ai dha shembullin e përkryer të faljes atëherë kur ishte në kryq. Në lidhje me ushtarët romakë që e kishin kryqëzuar, Ai u lut: "O Atë, fali ata sepse nuk dinë ç'bëjnë" (Lluka 23:34).

Lutuni për forcën që të falni ata që ju kanë bërë padrejtësi. Hiqni dorë nga ndjenja e inatit, e zemërimit ose e hakmarrjes. Kërkoni të gjeni të mirën tek të tjerët, sesa të përqendroheni tek të metat e të zmadhoni dobësitë e tyre. Lejoni që Perëndia të jetë gjykatësi i veprimeve dëmtuese të të tjerëve. Mund të jetë e vështirë t'i lëshoni ndjenjat e lëndimit, por këtë mund ta bëni me ndihmën e Zotit. Ju do të zbuloni se falja mund të shërojë plagë të tmerrshme, duke e zëvendësuar helmin e grindjes me paqen dhe dashurinë që vetëm Perëndia mund t'i japë.

Referime shitesë: Mateu 6:14-15; 18:21-22; 1 Nefi 7:16-21

*Shih gjithashtu* Gjykim i të Tjerëve; Pendim; Shlyerja e Jezu Krishtit

## Familje

Më 23 shtator 1995 President Gordon B. Hinklli, Presidenti i 15-të i Kishës, lexoi në një mbledhje të përgjithshme të Shoqatës së Ndhmës proklamatin e mëposhtme. Kjo proklamata e frymëzuar, e titulluar "Familja: Një Proklamata Drejtuar Botës", është bërë deklarimi përfundimtar i Kishës për familjen:

"Ne, Presidencia e Parë dhe Këshilli i të Dymbëdhjetë Apostujve të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, solemnisht shpallim se martesë midis një burri dhe një gruaje shugurohet nga Perëndia dhe se familja

është thelbësore në planin e Krijuesit për destinacionin e përjetshëm të fëmijëve të Tij.

Të gjitha qeniet njerëzore, meshkuj dhe femra, janë krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë. Secili është një bir ose bijë shpirtërore e dashur e prindërve qiellorë dhe, si i tillë, secili ka një natyrë dhe destinacion hyjnor. Gjinia është një karakteristikë thelbësore e identitetit dhe qëllimit individual të jetës para lindjes, të jetës së vdekshme dhe asaj të përjetshme.

Në mbretërinë paratokësore, bijtë dhe bijat shpirtërore e njihnin dhe e adhuronin Perëndinë si Atin e tyre të Amshuar dhe e pranuan planin e Tij, me anë të të cilit fëmijët e Tij mund të merrnin një trup fizik, mund të fitonin përvojë tokësore për të përparuar drejt përsosjes dhe së fundi, mund të arrinin destinacionin e tij ose të saj si një trashëgimtar i jetës së përjetshme. Plani hyjnor i lumturisë bën të mundur që marrëdhëniet familjare të vazhdojnë përtej varrit. Ordinancat dhe besëlidhjet e shenjta që janë në dispozicion në tempujt e shenjtë, bëjnë të mundur që individët të kthehen në praninë e Perëndisë dhe që familjet të bashkohen përjetësisht.

Urdhërimi i parë që Perëndia i dha Adamit dhe Evës ishte rreth potencialit të tyre si burrë e grua për të qenë prindër. Ne deklarojmë se urdhërimi i Perëndisë për fëmijët e Tij që të shumohen dhe të mbushin tokën, mbetet i vlefshëm. Ne më tej deklarojmë se Perëndia ka urdhëruar që fuqitë e shenjta të krijimit të jetës duhet të përdoren vetëm midis burrit dhe gruas, ligjërisht të martuar si bashkëshort e bashkëshorte.

Ne deklarojmë se mënyra me anë të së cilës krijohet jeta e vdekshme është caktuar dhe drejtuar nga Perëndia. Ne pohojmë shenjtërinë e jetës dhe rëndësinë e saj në planin e përjetshëm të Perëndisë.

Bashkëshorti dhe bashkëshortja kanë një përgjegjësi solemne të duan dhe të kujdesen për njëri-tjetrin dhe për fëmijët e tyre. 'Bijtë janë një trashëgimi që vjen nga Zoti' (Psalmet 127:3). Prindërit kanë një detyrë të shenjtë për të

rritur fëmijët e tyre me dashuri dhe drejtësi, për të plotësuar nevojat e tyre fizike dhe shpirtërore, për t'i mësuar ata ta duan dhe t'i shërbejnë njëri-tjetrit, për të zbatuar urdhërimet e Perëndisë dhe për të qenë qytetarë që u binden ligjeve kudo që jetojnë. Bashkëshortët dhe bashkëshortet, nënat dhe etërit, do të mbahen përgjegjës përpara Perëndisë për plotësimin e këtyre detyrimeve.

Familja shugurohet nga Perëndia. Martesa midis burrit dhe gruas është thelbësore në planin e Tij të përjetshëm. Fëmijët kanë të drejtën të linden nga prindër brenda lidhjeve të martesës dhe të rriten nga një atë dhe një nënë të cilët i nderojnë me besnikëri të plotë besëlidhjet e martesës. Lumturia në jetën familjare është e mundur të arrihet më mirë kur bazohet në mësimet e Zotit Jezu Krishti. Martesat dhe familjet e suksesshme ngrihen dhe ruhen me parimet e besimit, lutjes, pendimit, faljes, respektit, dashurisë, dhembshurisë, punës dhe aktiviteteve të shëndosha argëtuese. Nëpërmjet planit hyjnor, etërit duhet të kryesojnë familjet e tyre me dashuri e drejtësi dhe janë përgjegjës për të siguruar gjërat e nevojshme për jetën dhe mbrojtjen për familjet e tyre. Nënëat janë kryesisht përgjegjëse për edukimin e fëmijëve të tyre. Në këto përgjegjësi të shenjta, etërit dhe nënat kanë detyrim të ndihmojnë njëri-tjetrin si partnerë të barabartë. Paaftësia, vdekja ose rrethana të tjera mund të bëjnë të nevojshme përshtatjen ose ndryshimin e këtyre roleve. Të afërm të tjerë duhet të ndihmojnë kur është e nevojshme.

Ne paralajmërojmë se individët që shkelin besëlidhjet e dëlirësisë, që abuzojnë me bashkëshorten ose fëmijët, apo që dështojnë në përmbushjen e përgjegjësive të tyre familjare, do të qëndrojnë një ditë përgjegjës përpara Perëndisë. Për më tepër, ne paralajmërojmë se shpërbërja e familjes do të sjellë mbi individët, komunitetet dhe kombet fatkeqësitë e parashikuara nga profetët e lashtë dhe modernë.

Ne u bëjmë thirrje qytetarëve dhe zyrtarëve të përgjegjshëm të qeverive kudo që janë të nxisin ato masa të krijuara për të ruajtur dhe forcuar familjen si njësi themelore e

shoqërisë” (*Familja: Një Proklamatë Drejtuar Botës*, numri i artikullit 35602).

*Shih gjithashtu Martesë; Mbrëmje Familjare në Shtëpi; Tempuj*

## **Fatkeqësi**

Si një pjesë e planit të shëlbimit të Atit Qiellor, ju përjetoni fatkeqësi gjatë vdekshmërisë. Provat, zhgënjimet, hidhërimi, sëmundja dhe dëshpërimi janë pjesë e vështirë e jetës, por ato mund të udhëheqin drejt rritjes shpirtërore, përpunimit dhe përparimit, kur i drejtoheni Zotit.

Fatkeqësia vjen nga burime të ndryshme. Ju nganjëherë mund të përballeni me prova si pasojë e vetë krenarisë dhe mosbindjes suaj. Këto prova mund të shmangen nëpërmjet një jete të drejtë. Prova të tjera janë thjesht pjesë e natyrshme e jetës dhe mund të vijnë hera-herës kur po jetoni drejt. Për shembull, ju mund t’i përjetoni provat në kohë sëmundjeje ose të pasigurisë apo gjatë vdekjeve të njerëzve të dashur. Fatkeqësia mund të vijë nganjëherë për shkak të zgjedhjeve të dobëta dhe fjalëve e veprimeve lënduese të të tjerëve.

T’i përgjigjemi Fatkeqësisë me Besim

Suksesi dhe lumturia juaj edhe tani, edhe në përjetësi varet shumë nga reagimi juaj ndaj vështirësive të jetës.

Një përmbledhje në Librin e Mormonit sjell shembuj të regjimeve të ndryshme ndaj fatkeqësisë. Profeti Lehi dhe familja e tij kishin udhëtuar në shkretëtirë për disa ditë, duke përdorur harqe dhe shigjeta për të gjuajtur për ushqim. Familja hasi në vështirësi kur djemtë e Lehit i nxorën jashtë përdorimit harqet e tyre. Harqet e Lamanit dhe Lemuelit humbën elasticitetin e tyre dhe harku i Nefit u thye. Të uritur dhe të lodhur, Lamani dhe Lemueli filluan të shfaqnin pakënaqësi kundrejt Zotit. Madje Lehi filloi të mërmëriste. Nga ana tjetër, Nefi nuk pranoi të shkurajohej. Ai shkoi të punonte. Ai rrëfeu: “Unë, Nefi, bëra nga një dru një hark dhe

nga një shufër e drejtë, një shigjetë; prandaj unë e armatosa veten me një hark dhe një shigjetë, me një hobe dhe me gurë. Dhe unë i thashë atit tim: Ku duhet të shkoj unë që të siguroj ushqim?" I përlur për shkak të fjalëve të Nefit, Lehi e pyeti Zotin se ku duhet të shkonin për ushqim. Zoti iu përgjigj lutjeve të tij dhe e drejtoi Nefin tek një vend ku ai mund të siguronte ushqim. (Shih 1 Nefi 16:15-31.)

Kur disa njerëz përballesh me fatkeqësi, janë si Lamani dhe Lemueli. Ata shfaqin pakënaqësi dhe acarohen. Ata bëjnë pyetje si këto: "Përse duhet të më ndodhte kjo mua? Përse duhet ta vuaj këtë tani? Çfarë kam bërë që ta meritoj këtë?" Por këto pyetje kanë fuqi t'i zotërojnë mendimet e tyre. Pyetje të tilla mund ta errësojnë vizionin e tyre, të gëlltisnin energjinë e tyre dhe t'i privojnë nga përvojat që Zoti dëshiron që t'i pranojnë. Më mirë se të reagoni në këtë mënyrë, ju duhet të ndiqni shembullin e Nefit. Konsideroni pyetje të tilla, si: "Çfarë më duhet të bëj? Çfarë kam për të mësuar nga kjo përvojë? Çfarë më duhet të ndryshoj? Kë kam për të ndihmuar? Si të mund t'i kujtoj bekimet e mia të shumta në kohë provash?"

Lloje të ndryshme fatkeqësie kërkojnë reagime të ndryshme. Për shembull, nëse prekeni nga sëmundja, thjesht mund t'ju duhet të jeni i duruar dhe besnik. Nëse vuani për shkak të fjalëve ose veprimeve të tjerëve, duhet të punoni në drejtim të faljes së atyre që ju cenojnë. Nëse jeni viktimë e abuzimit, duhet të kërkonit menjëherë ndihmë. Nëse vijnë prova për shkak të mosbindjes suaj, duhet të ndreqni sjelljen dhe të kërkonit falje me përlulësi.

Ndonëse disa prej reagimeve tuaja ndaj fatkeqësisë do të jenë të ndryshme, njëri duhet të jetë i pandryshueshëm—vënien e besimit tuaj tek Ati Qiellor dhe Jezu Krishti. Profeti Alma mësoi: "Kushdo që vë besimin e tij në Perëndi, do të përkrahet në sprovat e tij dhe në vështirësitë e tij dhe në mjerrimet e tij dhe do të ngrihet në ditën e fundit" (Alma 36:3).

## T'i Besosh Atit Qiellor dhe Jezu Krishtit

Kur i besoni Atit Qiellor dhe Birit, ju jeni i bindur se Ata ju duan në mënyrë të përsosur—se Ata dëshirojnë që të jeni i lumtur dhe se Ata do t'ju ndihmojnë të rriteni shpirtërisht. Ju i mbani urdhërimet. Ju kërkoni ta dini vullnetin e Tyre dhe ju bëni atë që Ata e kërkojnë, madje atëherë kur ju dëshironi diçka tjetër. Lutjet tuaja për lehtësim shoqërohen prej mirëkuptimit se Ati Qiellor nuk do t'i zgjidhë të gjitha çështjet menjëherë—që Ai mundet t'ju lejojë të prisni, që kështu të mund të vazhdoni të mësoni dhe të rriteni. Përmes gjithë kësaj do të gjeni ngushëllimin në sigurinë se Shpëtimtari i kupton në mënyrë të përsosur provat tuaja. Si pjesë e Shlyerjes së Tij të pafundme Ai mori mbi Vete “dhembjet dhe sëmundjet e popullit të tij”. Ai mori mbi Vete “dobësitë e tyre, që zemra e tij të mund të mbushet me mëshirë, sipas mishit, që ai të mund të dijë, sipas mishit, se si të ndihmojë popullin e tij sipas dobësive të tyre” (Alma 7:11-12). Ngaqë Ai e ka përjetuar dhembjen tuaj, Ai di si t'ju ndihmojë. Nëse shikoni nga Ai me besim, Ai do t'ju fuqizojë për t'i qëndruar çdo sprove që përjetoni.

Ndërsa përpiqeni t'i besoni Zotit gjatë kohës të sprovave, mbani mend këshillën e mëposhtme të dhënë nëpërmjet Profetit Jozef Smith:

“Ai që është besnik në mundime, shpërblimi i po atij është më i madh në mbretërinë e qiellit.

Ju nuk mund të shihni me sytë tuaj natyrorë, në këtë botë, planin e Perëndisë tuaj lidhur me ato gjëra që do të vijnë më pas dhe me lavdinë që do të pasojë pas shumë mundimesh.

Sepse pas shumë mundimesh vijnë bekimet” (DeB 58:2-4).

## Gjetja e Paqes dhe e Gëzimit gjatë Fatkeqësisë

Ju mund të gjeni paqe dhe gëzim, madje edhe kur ndesheni me sfidat dhe trishtimin. Libri i Mormonit përfshin një rrëfim për një popull të drejtë që e mësoi këtë të vërtetë. Duke vuajtur në robëri nën një sundimtar mizor, ata ia derdhën zemrat e tyre Perëndisë (shih Mosia 24:8-12). Zoti u përgjigj:

“Ngrini kokat tuaja dhe ngushëlohuni, pasi unë e di besëlidhjen që ju keni bërë me mua; dhe unë do të bëj besëlidhje me popullin tim dhe do ta çliroj nga robëria.

Dhe unë do t’ju lehtësoj gjithashtu barrat që ju janë vënë mbi shpatulla, që ju të mos i ndjeni në shpinat tuaja, madje ndërsa jeni në robëri; dhe këtë do ta bëj që ju të qëndroni si dëshmitarë për mua në të ardhmen dhe që ju të dini me siguri se unë, Zoti Perëndi, i vizitohet njerëzit e mi në pikëllimet e tyre” (Mosia 24:13-14).

Populli u përgjigj me besim dhe “barrat që iu vunë [atyre] u lehtësuan; po, Zoti i forcoi ata që të mund të duronin barrat e tyre me lehtësi dhe ata iu nënshtroan me gëzim dhe me durim gjithë vullnetit të Zotit” (Mosia 24:15).

Ashtu si këta njerëz të drejtë, ju mund “[t’i nënshtroheni] me gëzim dhe me durim gjithë vullnetit të Zotit”, duke e ditur që Ai do t’ju fuqizojë në sprovat tuaja. Ai ka premtuar: “Të gjitha gjërat me të cilat jeni munduar, do të veprojnë së bashku për të mirën tuaj dhe për lavdinë e emrit tim” (DeB 98:3).

Referime shitesë: Hebrejve 4:15-16; 2 Nefi 2:11-24; Mosia 23:21-22; DeB 105:6; 121:7-9; 122

*Shih gjithashtu Falje; Paqe; Pendim; Plani i Shpëtimit; Shpresë*

## Ferr

Zbulesat e ditëve të mëvonshme flasin për ferrin në të paktën dy mënyra. Së pari, ai është një tjetër emër për burgun shpirtëror, një vend në botën shpirtërore të pasvdekjes për ata që kanë “vdekur në mëkatet e tyre, pa një dituri të së vërtetës ose të shkeljes, duke i mohuar profetët” (DeB 138:32). Kjo është një gjendje e përkohshme ku shpirttrave do t’u mësohet ungjilli dhe do të kenë mundësinë të pendohen e të pranojnë ordinancat e shpëtimit që janë kryer për ta në tempuj (shih DeB 138:30-35). Ata të cilët pranojnë ungjillin mund të banojnë në parajsë deri në Ringjallje. Pasi të ringja-



Ilen dhe të gjykohen, ata do të marrin atë nivel lavdie për të cilin janë të denjë. Ata që vendosin të mos pendohen, por që nuk janë bij të mallkimit, do të mbeten në burgun shpirtëror deri në fund Mijëvjeçarit, atëherë kur ata do të lirohen nga ferri e ndëshkimi dhe do të ringjallen për një lavdi telestiale (shih DeB 76:81-85).

Së dyti, fjala *ferr* përdoret në lidhje me errësirën e jashtme, që është vendbanimi i djallit, i engjëjve të tij dhe i bijve të mallkimit (shih DeB 29:36-38; 76:28-33). Bijtë e mallkimit janë ata të cilët “nuk [marrin] falje në këtë botë, as në botën që vjen—sepse mohuan Shpirtin e Shenjtë pasi e kishin marrë atë dhe sepse mohuan Birin e Vetëmlindur të Atit, duke e kryqëzuar vetë dhe duke e poshtëruar hapur atë” (DeB 76:34-35; shih gjithashtu vargjet 31-33, 36-37). Persona të tillë nuk do të trashëgojnë vend në ndonjë mbretëri lavdie; për ta vazhdojnë të jenë kushtet e ferrit (shih DeB 76:38; 88:24, 32).

*Shih gjithashtu Mbretëri të Lavdisë; Satani*

## **Fjala e Urtësisë**

Fjala e Urtësisë është një ligj i shëndetit i zbuluar nga Zoti për dobinë tonë fizike dhe shpirtërore. Në këtë zbulesë, e cila është regjistruar në seksionin e 89-të në Doktrina e Besëlidhje, Zoti na tregon se cilat ushqime na bëjnë mirë për të ngrënë dhe cilat substanca nuk janë të mira për trupat tanë. Ai premtion bekime shpirtërore dhe fizike me bindjen ndaj Fjalës së Urtësisë.

Në Fjalën e Urtësisë, Zoti na urdhëron të mos fusim këto substanca në trupat tanë:

- Pije alkoolike (shih DeB 89:5-7).
- Duhan (shih DeB 89:8).
- Çaj dhe kafe (shih DeB 89:9; profetët e ditëve të mëvonshme kanë thënë që termi “pije të nxehta” i referohet çajit dhe kafes).

Çdo gjë e dëmshme që njerëzit fusin me qëllim në trupat e tyre, nuk është në harmoni me Fjalën e Urtësisë. Kjo është veçanërisht e vërtetë për drogat e paligjshme, të cilat mund t'i shkatërrojnë ata që bien në varësinë e tyre. Qëndroni plotësisht larg tyre. Mos bëni prova me to. Abuzimi me ilaçet e recetës çon gjithashtu drejt një varësie shkatërrimtare.

Zoti deklaron që ushqimet e mëposhtme u bëjnë mirë trupave tanë:

- Zarzavatet dhe frutat, të cilat duhen përdorur “me maturi dhe falënderim” (shih DeB 89:10-11).
- Mishi “[i kafshëve dhe i] shpendëve të ajrit”, i cili “duhet të [përdoret] me pakicë” (shih DeB 89:12-13).
- Drithërat, si gruri, orizi dhe tërshëra, të cilat janë “burim jete” (shih DeB 89:14-17).

Bekimet nga mbajtja e Fjalës së Urtësisë

Atyre që e mbajnë Fjalën e Urtësisë, Zoti u premton:

“Gjithë shenjtorët të cilët kujtohen t'i zbatojnë dhe t'i bëjnë këto thënie, duke ecur me bindje ndaj urdhërimeve, do të marrin shëndet në kërthizën e tyre dhe palcë në kockat e tyre;

Dhe do të gjejnë urtësi dhe thesare të mëdha diturie, madje thesare të fshehura;

Dhe do të vrapojnë e nuk do të lodhen, dhe do të ecin e nuk do të këputen.

Dhe unë, Zoti, u jap atyre një premtim se engjëlli shkatërrues do të kalojë pranë tyre, sikurse me fëmijët e Izraelit, dhe nuk do t'i vrasë” (DeB 89:18-21).

Mposhtja e Varësisë

Mënyra më e mirë është t'i shmangim plotësisht substancat që Zoti i ndalon në Fjalën e Urtësisë. Por, në qoftë se jeni i dhënë pas ndonjëres nga këto substanca, ju mund të çlirohëni nga varësia juaj. Mund ta mposhtni varësinë, përmes

përpjekjeve vetjake, fuqisë mundësuese të hirit të Zotit, ndihmës prej anëtarëve të familjes e miqve dhe udhëzimit nga udhëheqësit e kishës.

Lutuni për ndihmë dhe bëni gjithçka të mundur që t'i qëndroni tundimeve që vijnë për shkak të varësisë. Ati juaj Qiellor dëshiron që ju të merrni bekimet që vijnë nga mbajtja e Fjalës së Urtësisë dhe Ai do t'ju forcojë në përpjekjet tuaja të sinqerta për këtë gjë.

Referime shtesë: DeB 49:19-21; 59:15-20; 88:124; 89:1-4

*Shih gjithashtu* Bindje; Tundim

## **Fryma e Shenjtë**

Fryma e Shenjtë është anëtari i tretë i Kreut-Perëndi. Ai është person shpirtëror, pa një trup mishi e kocke (shih DeB 130:22). Shpesh përmendet si Shpirti, Shpirti i Shenjtë, Shpirti i Perëndisë, Shpirti i Zotit ose Ngushëlluesi.

### Funksionet e Frymës së Shenjtë

Fryma e Shenjtë punon në unitet të përkryer me Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin, duke përmbushur disa funksione për t'ju ndihmuar të jetoni me drejtësi e të merrni bekimet e ungjillit.

Ai “dëshmon për Atin dhe Birin” (2 Nefi 31:18) dhe zbulon e mëson “të vërtetën e të gjitha gjërave” (Moroni 10:5). Ju mund të merrni një dëshmi të sigurt për Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin vetëm nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë. Ajo që Ai i bën të ditur shpirtit tuaj, mbart shumë më tepër siguri se çdo informacion i shkëmbyer nëpërmjet ndjesive natyrore.

Kur përpiqeni të qëndroni në shtegun që të çon në jetë të përjetshme, Fryma e Shenjtë “do t'ju tregojë të gjitha gjërat që duhet të bëni” (shih 2 Nefi 32:1-5). Ai mund t'ju udhëzojë në vendime dhe t'ju mbrojë nga rreziku fizik e shpirtëror.

Nëpërmjet Tij mund të merrni dhuratat e Shpirtit për dobinë tuaj dhe në dobi të atyre që i doni dhe u shërbeni (shih DeB 46:9-11).

Ai është Ngushëlluesi (Gjoni 14:26). Sikurse zëri qetësues i një babai të dashur arrin të reshtë të qarën e fëmijës, ashtu edhe pëshpëritjet e Shpirtit mund t'ju qetësojnë frikën, të urtësojnë shqetësimet ngacmuese të jetës dhe t'ju lehtësojnë brengosjen. Fryma e Shenjtë mund t'ju mbushë "me shpresë dhe dashuri të pastër" e t'ju "mësojë gjërat paqësore të mbretërisë" (Moroni 8:26; DeB 36:2).

Nëpërmjet fuqisë së Tij shenjtëroheni, atëherë kur pendoheni, pranoni ordinancën e pagëzimit e të konfirmimit dhe mbeteni i vërtetë në besëlidhjet tuaja (shih Mosia 5:1-6; 3 Nefi 27:20; Moisiu 6:64-68).

Ai është Shpirti i Shenjtë i Premtimit (shih Efesianëve 1:13; DeB 132:7, 18-19, 26). Në këtë pozitë, Ai pohon se ordinancat e priftërisë që keni marrë dhe besëlidhjet që keni bërë janë të pranueshme tek Perëndia. Ky miratim varet nga vazhdimësia në besnikëri.

## Dhurata e Frymës së Shenjtë

Të gjithë kërkuesit e ndershëm të së vërtetës mund ta ndjejnë ndikimin e Frymës së Shenjtë, i cili i udhëheq drejt Jezu Krishtit dhe ungjillit të Tij. Megjithatë, plotësia e beki-meve që jepen nëpërmjet Frymës së Shenjtë, u mundësohet vetëm atyre që marrin dhuratën e Frymës së Shenjtë dhe vazhdojnë të jenë të denjë.

Pasi u pagëzuar në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, një ose disa mbajtës të Priftërisë Melkizedeke vendosën duart mbi kokën tuaj dhe, me një ordinancë të shenjtë priftërie, ju konfirmuan si anëtar të Kishës. Si një pjesë në këtë ordinancë, të quajtur konfirmim, juve ju dha dhurata e Frymës së Shenjtë.

Dhurata e Frymës së Shenjtë është e ndryshme nga ndikimi i Frymës së Shenjtë. Para pagëzimit, hera-herës ju mund

ta ndjenit ndikimin e Frymës së Shenjtë e nëpërmjet atij ndikimi ju mund të merrnit dëshmi për të vërtetën. Tani që e keni dhuratën e Frymës së Shenjtë, keni të drejtën për shoqërimin e vazhdueshëm të atij anëtarit të Kreut-Perëndi, në qoftë se i mbani urdhërimet.

Shijimi i plotë i dhuratës së Frymës së Shenjtë përmbledh marrjen e zbulesës dhe të ngushëllimit, shërbimin e bekimin e të tjerëve përmes dhuratave shpirtërore, shenjtërimit me largim nga mëkati dhe të bëhesh i përshtatshëm për ekzaltim në mbretërinë çelestiale. Këto bekime varen nga denjësia juaj; ato vijnë ca nga ca atëherë kur jeni gati për to. Kur e vini jetën në harmoni me vullnetin e Perëndisë, hap pas hapi e merrni Frymën e Shenjtë në masë të madhe. Profeti Jozef Smith bëri të njohur se të fshehtat e Mbretërisë së Perëndisë “duhet vetëm të shihen dhe të kuptohen nëpërmjet fuqisë së Shpirtit të Shenjtë, që Perëndia e jep mbi ata që e duan atë dhe pas-trohen përpara Tij” (shih DeB 76:114-116).

Kujtoni që “Shpirti i Zotit nuk banon në tempuj jo të shenjtë” (Helamani 4:24). Megjithëse keni marrë dhuratën e Frymës së Shenjtë, Shpirti do të banojë tek ju vetëm kur mbani urdhërimet. Ai do të tërhiqet në rast se Atë e fyeni nëpërmjet blasfemisë, papastërtisë, mosbindjes, rebelimit ose mëkateve të tjera. Mbahuni i pastër. Mbusheni jetën me mirësi, që të jeni i denjë për shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë.

Referime shtesë: Mateu 3:11; Gjoni 15:26; 16:13; Veprat e Apostujve 2:38; 8:12-17; 19:1-6; 1 Korintasve 2:9-14; 12:3; Galatasve 5:22-23; 1 Nefi 10:17-19; 2 Nefi 31:17; DeB 8:2-3; 39:20-24; 68:25-28; 121:46; Nenet e Besimit 1:4

*Shih gjithashtu* Dhurata Shpirtërore; Kreu-Perëndi; Pagëzim; Vënie e Duarve; Zbulesë

## **Gjykim i të Tjerëve**

Nganjëherë njerëzve u duket se është gabim të gjykosësh të tjerët, sido që të jetë. Ndërsa është e vërtetë që nuk duhet t'i dënoni të tjerët ose t'i gjykoni me pa të drejtë, juve do t'ju

duhet të bëni gjykime mbi ide, rrethana e njerëz gjatë gjithë jetës. Zoti ka dhënë shumë urdhërime të cilat ju nuk mund t'i mbani pa arritur të gjykoni. Për shembull, Ai ka thënë: "Ruhuni nga profetët e rremë . . . Ju do t'i njihni nga frytet e tyre" (Mateu 7:15-16) dhe "largohuni nga të ligjtë" (DeB 38:42). Juve ju nevojitet të ndërmerrni gjykim në shumë vendime të rëndësishme, si p.sh., zgjedhja e shokëve, votimi për udhëheqësit qeveritarë dhe zgjedhja e shokut të përjetshëm.

Gjykimi është i rëndësishëm në përdorimin e lirisë suaj për të zgjedhur dhe kërkon kujdes të madh, sidomos kur duhet të gjykoni mbi njerëz të tjerë. Të gjitha gjykimet tuaja duhet të udhëhiqen nga kritere të drejta. Mbani mend që vetëm Perëndia, i cili njeh zemrën e secilit, mund të gjykojë përfundimisht një njeri (shih Zbulesa 20:12; 3 Nefi 27:14; DeB 137:9).

Zoti dha një paralajmërim që të na prijë ne në gjykimin e të tjerëve: "Me çfarë gjykimi ju gjykoni, po me atë do të gjykoheni; dhe me çfarë mase ju matni, po me atë ju do të mateni përsëri. Dhe pse shikon qimen që është në sy të vëllait tënd, por nuk merr parasysh trarin që është në syrin tënd? Ose, si mund t'i thuash vëllait tënd: Lermë të nxjerr qimen nga syri yt—dhe vër re, një tra është në syrin tënd? Ti hipokrit, nxirr së pari trarin nga syri yt; dhe atëherë do të shohësh qartas, që të nxjerrësh qimen nga syri i vëllait tënd" (3 Nefi 14:2-5).

Në këtë pjesë të shkrimit të shenjtë Zoti na mëson se gabimi që shohim tek një tjetër, është shpesh një pikël në syrin e atij njeriu në krahasim me fajet tona, të cilat janë si një tra i pamasë në sytë tanë. Herë pas here ne përqendrohemi tek gabimet e të tjerëve kur, në vend të kësaj, duhet të punonim për t'u përmirësuar vetë.

Gjykimet tuaja të drejta mbi të tjerët mund t'u sigurojnë atyre udhëzimin e nevojshëm dhe, në disa raste, mbrojtje për ju e për familjen tuaj. Gjykime të tilla trajtojnë me kujdes e me dhembshuri. Sa më shumë që të mundeni, gjykoni

## Hir

rrethanat e njerëzve, më tepër sesa vetë njerëzit. Kurdoherë që ka mundësi, përmbahuni para gjykimit, derisa të keni njo-hurinë e mjaftueshme të fakteve. Jini gjithmonë i ndjeshëm ndaj Shpirtit të Shenjtë, i cili mund t'ju prijë në vendime. Kujtoni këshillën e Almës për birin e tij Koriantoni: “Shiko të jesh i mëshirshëm ndaj vëllezërve të tu; vepro me drejtësi, gjyko drejt dhe bëj të mira vazhdimisht” (Alma 41:14).

Referime shtesë: 1 Samueli 16:7; Moroni 7:14-19; DeB 11:12

*Shih gjithashtu* Dashuri; Dashuri Hyjnore; Falje; Mëshirë

## Hir

Fjala *hir*, siç përdoret në shkrime të shenjta, kryesisht lidhet me ndihmën dhe forcën hyjnore që marrim me anë të Shlyerjes së Zotit Jezu Krishti. Apostull Pjetri na mësoi se duhet “[të rri-temi] në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht” (2 Pjetri 3:18).

### Shpëtim nëpërmjet Hirit

Për arsye të Rënies gjithkush do të përjetojë vdekjen e për-kohshme. Nëpërmjet hirit, që u bë i mundshëm prej sakrificës shlyese të Shpëtimtarit, të gjithë njerëzit do të ringjallen e do të marrin pavdekësi (shih 2 Nefi 9:6-13). Por vetëm ringjallja nuk na jep cilësinë për jetën e përjetshme në prani të Perëndisë. Mëkatet tona na bëjnë të papastër e të papërshtatshëm që të banojmë në prani të Perëndisë dhe na nevojitet hiri i Tij për të na pastruar e përkryer “pas gjithçkaje që ne mund të bëjmë” (2 Nefi 25:23).

Shprehja “pas gjithçkaje që ne mund të bëjmë” të mëson se nga ana jonë kërkohet përpjekje për të marrë pjesën e plotë të hirit të Zotit e për t'u bërë të denjë të rrojmë me Të. Zoti na ka urdhëruar t'i bindemi ungjillit të Tij, gjë e cila përfshin besimin tek Ai, pendimin për mëkatet tona, pagëzimin, marrjen e dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe durimin deri në fund (shih Gjoni 3:3-5; 3 Nefi 27:16-20; Nenet e Besimit 1:3-4).

Profeti Moroni shkroi për hirin që marrim kur vijmë tek Shpëtimtari e i bindemi mësimëve të Tij:

“Ejani te Krishti dhe përsosuni në të dhe i mohoni vetes çdo ligësi; dhe në qoftë se do t’i mohoni vetes çdo ligësi dhe ta doni Perëndinë me gjithë fuqinë, mendjen dhe forcën tuaj, atëherë hiri i tij mjafton për ju, se me anë të hirit të tij ju mund të bëheni të përsosur në Krisht; dhe në qoftë se për hir të Perëndisë ju jeni bërë të përsosur në Krisht, ju nuk mund të mohoni në asnjë mënyrë pushtetin e Perëndisë.

Dhe përsëri, në qoftë se ju me anë të hirit të Perëndisë jeni të përkryer në Krisht dhe nuk mohoni pushtetin e tij, atëherë do të shenjtëroheni në Krisht me anë të hirit të Perëndisë, nëpërmjet derdhjes së gjakut të Krishtit, që është në besëlidhjen e Atit për heqjen e mëkateve tuaja, që ju të bëheni të shenjtë, pa njollë” (Moroni 10:32-33).

### Marrja e Hirit gjatë Gjithë Jetës

Përveç nevojës për hir në shpëtimin tuaj të fundit, kjo fuqi aftësuese ju duhet në çdo ditë të jetës. Kur i shkoni pranë Atit tuaj Qiellor me zell, me përlësi dhe butësi, Ai do t’ju lartësojë e do t’ju përforcojë nëpërmjet hirit të Tij (shih Fjalët e Urta 3:34; 1 Pjetri 5:5; DeB 88:78; 106:7-8). Mbështetja mbi hirin e Tij ju krijon mundësinë të përparoni e të zhvilloheni në drejtësi. Vetë Jezusi “nuk e mori plotësinë që në fillim, por vazhdoi nga hiri në hir, derisa mori një plotësi” (DeB 93:13). Hiri ju bën të aftë të ndihmoni në ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë, shërbim të cilin nuk mund ta bëni vetëm me fuqinë dhe mënyrat tuaja (shih Gjoni 15:5; Filipianëve 4:13; Hebrenjve 12:28; Jakobi 4:6-7 [LiM]).

Në rast se ndonjëherë shkurajoheni ose ndiheni tepër i pafuqishëm për të vazhduar të jetoni ungjillin, sillni ndër mend forcën që mund të merrni me anë të fuqisë aftësuese të hirit. Mund të gjeni qetësim dhe sigurim te këto fjalë të Zotit: “Hiri im është i mjaftueshëm për të gjithë njerëzit që përlulen para meje; pasi në qoftë se ata përlulen para meje dhe kanë



## *Homoseksualizëm*

besim tek unë, atëherë unë do të bëj që gjërat e dobëta të bëhen të forta në ta” (Ethëri 12:27).

Referime shtesë: Veprat e Apostujve 15:11; Romakëve 5:2; 2 Nefi 10:24; 11:5

*Shih gjithashtu* Ringjallje; Shlyerja e Jezu Krishtit; Shpëtim

**Homoseksualizëm** (*Shih* Dëlirësi)

**Ilaçe** (*Shih* Fjala e Urtësisë)

**Imoralitet Seksual** (*Shih* Dëlirësi)

**Indaument** (*Shih* Tempuj)

## **Jetë e Përjetshme**

Zoti njoftoi hapur: “Kjo është vepra ime dhe lavdia ime—të bëj të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut” (Moisiu 1:39). Pavdekësi është të jetosh përgjithmonë si qenie e ringjallur. Njëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit gjithkush do ta marrë këtë dhuratë. Jetë e përjetshme, ose ekzaltim, është të trashëgosh një vend në shkallën më të lartë të mbretërisë çelestiale, ku ne do të jetojmë në prani të Perëndisë dhe do të vazhdojmë si familje (shih DeB 131:1-4). Ashtu si pavdekësia, kjo dhuratë bëhet e mundur njëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit. Megjithatë, ajo kërkon “[bindjen tonë] ndaj ligjeve dhe ordinancave të Ungjillit” (Nenet e Besimit 1:3).

Qëndrimi në Shtegun drejt Jetës së Përjetshme

Kur u pagëzuar dhe morët dhuratën e Frymës së Shenjtë, ju hytë në shtegun që të çon drejt jetës së përjetshme. Profeti Nefi mësoi:

“Porta nëpër të cilën ju duhet të hyni është pendimi dhe pagëzimi me anë të ujit; dhe pastaj vjen një heqje e mëkateve tuaja me anë të zjarrit dhe me anë të Frymës së Shenjtë.

Dhe atëherë ju jeni në këtë shteg të ngushtë dhe të ngushtuar që të çon në jetën e përjetshme; po, ju keni hyrë nëpërmjet portës; ju keni bërë sipas urdhërimeve të Atit dhe të Birit; dhe ju keni marrë Frymën e Shenjtë që dëshmon për Atin dhe Birin, deri në plotësimin e premtimit të cilin ai ka bërë, që në qoftë se ju do të hynit nëpërmjet udhës, ju do të merrni” (2 Nefi 31:17-18).

Nefi theksoi se, pasi të kemi hyrë në këtë “shteg të ngushtë dhe të ngushtuar”, duhet të durojmë deri në fund me besim:

“Pasi ju të keni hyrë në këtë shteg të ngushtë dhe të ngushtuar, unë do t’ju pyesja nëse gjithçka është bërë? Vini re, unë ju them juve, Jo; pasi ju nuk keni arritur deri këtu përveçse me anë të fjalës së Krishtit, me besim të patundur në të, duke u mbështetur tërësisht në meritat e atij që është i fuqishëm të shpëtojë.

Kështu që, ju duhet të shkoni përpara me një vendosmëri në Krisht, duke pasur një ndriçim të përkryer të shpresës dhe një dashuri për Perëndinë dhe për gjithë njerëzit. Prandaj, në qoftë se ju do të shkoni përpara, duke u ushqyer me bollëk mbi fjalën e Krishtit dhe të duroni deri në fund, vini re, kështu thotë Ati: Ju do të keni jetën e përjetshme” (2 Nefi 31:19-20).

Tani që ju jeni pagëzuar dhe konfirmuar, shumë përparim drejt jetës së përjetshme nga ana juaj varet nga marrja e ordinancave të tjera të shpëtimit: për burrat, ordinanca e Priftërisë Melkizedeke; për burrat dhe gratë, indaumenti i tempullit dhe vulosja e martesës. Kur i merrni këto ordinanca dhe i mbani besëlidhjet që i shoqërojnë ato, ju e përgatisni veten për të trashëguar shkallën më të lartë të lavdisë celestiale.

## Ju Mund ta Arrini

Ndërsa mendoni thellë mbi përparimin tuaj në “shteg të ngushtë dhe të ngushtuar”, jini të sigurt se mund t’ia arrini jetës së përjetshme. Zoti dëshiron që ju të ktheheni tek Ai dhe kurrë nuk do të kërkojë ndonjë gjë që ju s’mund ta plotësoni.

Të gjitha urdhërimet e Tij janë të llogaritura për ta ngritur më lart lumturinë tuaj. Kur ushtroni besim dhe i shërbeni Atij me gjithë fuqinë, Ai ju jep forcë dhe ju siguron një mënyrë që të bëni gjithçka që ju urdhëron (shih 1 Nefi 3:7). Mbani mend se, kur bëni përpjekjet më të mëdha dhe pendoheni për mëkatet tuaja, Shlyerja e Jezu Krishtit do të vërë në vend dobësinë tuaj dhe padrejtësinë, dëmet dhe dhembjet që përjetoni në këtë jetë: “Ne e dimë se ne shpëtohemi nëpërmjet hirit, pas gjithçkaje që ne mund të bëjmë” (2 Nefi 25:23).

Referime shtesë: Gjoni 3:16; 17:3; 2 Nefi 9:39; Moroni 7:41; DeB 14:7; 50:5

*Shih gjithashtu* Hir; Mbretëri të Lavdisë; Shlyerja e Jezu Krishtit

## **Jezu Krishti**

Më 1 janar 2000, Presidencia e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve nxorën shpalljen që vijon. E titulluar “Krishti i Gjallë”, kjo shpallje sjell dëshmi për Zotin Jezu Krishti dhe përmbledh veçoritë dalluese individuale dhe misionin e Tij hyjnor:

“Ndërsa përkujtojmë lindjen e Jezu Krishtit dy mijë vjet më parë, ne japim dëshminë tonë për vërtetësinë e jetës së Tij të pashoqe dhe virtytit të pafund të sakrificës së Tij madhështore shlyese. Asnjë tjetër nuk ka patur një ndikim kaq të thellë mbi të gjithë njerëzit që kanë jetuar dhe që ende do të jetojnë në tokë.

Ai ishte Jehova i Madh i Dhjatës së Vjetër, Mesia i Dhjatës së Re. Nën drejtimin e të Atit, Ai ishte krijuesi i tokës. ‘Të gjitha gjërat u bënë me anë të tij . . . dhe pa atë nuk u bë asnjë nga ato që u bënë’ (Gjoni 1:3). Edhe pse pa mëkat, Ai u pagëzua për të përmbushur çdo drejtësi. Ai ‘e përshkoi vendin duke bërë mirë’ (Veprat e Apostujve 10:38), por megjithatë u përbuz për këtë. Ungjilli i Tij qe një mesazh paqeje dhe vullneti të mirë. Ai i luti të gjithë të ndiqnin shembullin e Tij. Ai eci rrugëve të Filistisë, duke shëruar të sëmurët, duke u kthyer dritën të verbërve dhe duke ngjallur të vdekurit. Ai

dha mësim për të vërtetat e përjetësisë, realitetin e ekzistencës sonë para lindjes, qëllimin e jetës sonë në tokë dhe potencialin e bijve dhe bijave të Perëndisë në jetën që vjen.

Ai vendosi sakramentin për të na kujtuar sakrificën e Tij madhështore e shlyese. Ai u arrestua dhe u dënua me akuza të rreme, u fajësua për të kënaqur një turmë dhe u dënua të vdiste në kryqin e Kalvarit. Ai dha jetën e Tij për të shlyer mëkatet e gjithë njerëzimit. Ai ishte një dhuratë madhështore e dhënë për të gjithë ata që do të jetonin ndonjëherë në tokë.

Ne dëshmojmë solemnisht se jeta e Tij, e cila është qendra e gjithë historisë njerëzore, as nuk filloi në Betlehem, as nuk mbaroi në Kalvar. Ai ishte i Parëlinduri i Atit, Biri i Vetëmlindur në mish, Shëlbuesi i botës.

Ai u ngrit nga varri dhe 'është fryti i parë i atyre që kanë fjetur' (1 Korintasve 15:20). Si Zot i Ringjallur, Ai vizitoi ata që i kish dashur në jetë. Ai gjithashtu shërbeu midis 'dele[ve] të tjera' (Gjoni 10:16) të Tij në Amerikën e lashtë. Në botën moderne Ai dhe Ati iu shfaqën të riut Jozef Smith, duke nisur periudhën ungjillore të plotësisë së kohërave (shih Efesianëve 1:10) që ish premtuar kohë më parë.

Profeti Jozef Smith shkroi për Krishtin e Gjallë: "Sytë e tij ishin si flakë zjarri; dhe flokët e kokës së Tij ishin të bardhë si dëborë e pastër; fytyra e tij shkëlqente më shumë se ndriçimi i diellit; dhe zëri i tij ishte si tingulli i rrjedhjes së shumë ujërave, madje zëri i Jehovës, duke thënë:

'Unë jam i pari dhe i fundit; unë jam ai që jeton, unë jam ai që u vra; unë jam avokati juaj me Atin' (DeB 110:3-4).

Profeti gjithashtu shpalli: 'Dhe tani, pas shumë dëshmime që janë dhënë për të, kjo është dëshmia, e fundit e të gjithave, që ne japim për të: Se ai jeton!

Sepse ne e pamë atë, madje në të djathtën e Perëndisë; dhe ne e dëgjuam zërin duke dhënë dëshmi se Ai është i Vetëmlinduri i Atit—

Se nëpërmjet tij dhe prej tij, dhe përmes tij, botët janë e u krijuan dhe banorët e tyre janë bij e bija të lindura të Perëndisë' (DeB 76:22-24).

Ne shpallim solemnisht që priftëria dhe Kisha e Tij është rivendosur në tokë—‘ndërtuar mbi themelin e apostujve dhe të profetëve, duke qenë Jezu Krishti vetë guri i qoshes’ (Efesianëve 2:20).

Ne dëshmojmë se një ditë Ai do të kthehet në tokë. ‘Atëherë lavdia e Zotit do të zbulohet dhe çdo qenie do ta shohë’ (Isaia 40:5). Ai do të sundojë si Mbreti i Mbretërve e do të mbretërojë si Zoti i Zotërve dhe çdo gju do të gjunjëzohet e çdo gjuhë do të pohojë me adhurim para Tij. Secili nga ne do të qëndrojë për t’u gjykuar prej Tij për veprat dhe dëshirat e zemrave tona.

Ne dëshmojmë, si Apostujt e tij të shuguruar siç duhet—që Jezusi është Krishti i Gjallë, Biri i pavdekshëm i Perëndisë. Ai është i madhi Mbreti Emanuel, i cili qëndron sot në të djathtë të Atit të Tij. Ai është drita, jeta, dhe shpresa e botës. Udhë e Tij është shtegu që të çon drejt lumturisë në këtë jetë dhe jetës së përjetshme në botën që vjen. I qofshim falë Perëndisë për dhuratën e pashoqe që na ka bërë duke na dhënë Birin e Tij hyjnor” (*Krishti i Gjallë*, numri i artikullit 36299).

*Shih gjithashtu Shlyerja e Jezu Krishtit*

## Jozef Smith

Në pranverën e vitit 1820, Jozef Smithi 14-vjeçar ishte në kërkim të Kishës së vërtetë të Jezu Krishtit, kur lexoi një pjesë në Bibël: “Në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtia, le të kërkojë nga Perëndia, që u jep të gjithëve pa kursim, pa qortuar, dhe atij do t’i jepet” (Jakobi 1:5; shih gjithashtu Joseph Smith—Historia 1:11-12). Duke besuar thjeshtë e pa u luhatur, Jozefi ndoqi këshillën e asaj pjese. I vetëm shkoi tek një korije pemësh, ku u lut që të njihte se me cilën kishë duhej të lidhej. Si përgjigje për lutjen, Perëndia Atë dhe Jezu Krishti iu shfaqën atij. Ndërmjet të tjerash, Ata i thanë se nuk duhej të lidhej me asnjë prej kishave që ekzistonin atëherë. (Shih Joseph Smith—Historia 1:13-20.)

Kur Jozef Smithi dha prova denjësie, atij iu dha një mision hyjnor si profet i Perëndisë. Përmes tij Zoti kreu një

punë të madhe e mahnitëse, që përmbliidhte sjelljen e Librit të Mormonit, rivendosjen e priftërisë, zbulimin e të vërtetave të çmuara të ungjillit, organizimin e Kishës së vërtetë të Jezu Krishtit dhe vendosjen e punës së tempullit. Më 27 qershor 1844, Jozefi dhe i vëllai, Hajrëm, u vranë të sulmuar nga një bandë e armatosur kriminelësh. Dëshmitë e tyre ata i vulosën me gjakun e tyre.

Me qëllim që dëshmia juaj për ungjillin e rivendosur të jetë e plotë, duhet të përmbajë një dëshmi për misionin hyjnor të Jozef Smithit. Fakti i vërtetësisë së Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme qëndron në të vërtetën e Vegimit të Parë dhe të zbulesave të tjera që i dha Zoti Profetit Jozef. Presidenti Xhon Tejlër, Presidenti i tretë i Kishës, shkroi: “Joseph Smith, Profeti dhe Shikuesi i Zotit, ka bërë më shumë, përveç Jezusit vetëm, për shpëtimin e njerëzve në këtë botë, sesa çdo njeri tjetër që jetoi ndonjëherë në të (DeB 135:3).

Referime shtesë: Isaia 29:13-14; 2 Nefi 3:3-15; DeB 5:9-10; 135; Joseph Smith—Historia

*Shih gjithashtu Profetë; Rivendosje e Ungjillit*

**Kafe** (*Shih Fjala e Urtësisë*)

**Këshill në Qiell** (*Shih Plani i Shpëtimit*)

## **Këshilla Disiplinore të Kishës**

Peshkopët dhe presidentët e degëve dhe presidentët e kunjeve, misioneve dhe distrikteve kanë përgjegjësi për të ndihmuar anëtarët të kapërcejnë shkeljet nëpërmjet pendimit. Shkeljet më të rënda, të tilla si: dhunime serioze të ligjit civil, abuzim me bashkëshortin, abuzim me fëmijën, kurorëshkelje, kurvëri, përdhunim dhe incest shpesh kërkojnë disiplinë zyrtare të Kishës. Disiplina zyrtare e Kishës

mund të përfshijë kufizimin e privilegjeve të anëtarësisë ose humbjen e anëtarësisë në Kishë.

Procesi i disiplinës zyrtare fillon kur një udhëheqës kryesues i priftërisë kërkon një këshill disiplinor. Qëllimet e këshillave disiplinore janë për shpëtimin e shpirtave të shkelësve, mbrojtjen e të pafajshmit dhe ruajtjen e pastërtisë, paprekshmërisë dhe emrit të mirë të Kishës.

Disiplina e Kishës është një proces i frymëzuar që ndodh gjatë një periudhe kohe. Nëpërmjet këtij procesi dhe nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit, një anëtar mund të marrë falje të mëkateve, të rifitojë paqen e mendjes dhe të fitojë fuqinë për të shmangur shkelje në të ardhmen. Akti i disiplinës së Kishës nuk mendohet si përfundim i procesit. Ai është menduar për të ndihmuar fëmijët e Atit Qiellor të vazhdojnë përpjekjet e tyre për t'iu kthyer shoqërimin të plotë dhe të gjitha bekimeve të Kishës. Rezultati që dëshirohet është që personi të bëjë çdo lloj ndryshimi që nevojitet për t'u penduar krejtësisht.

*Shih gjithashtu Falje; Pendim*

**Konfirmim** (*Shih Fryma e Shenjtë; Vënie e Duarve*)

**Kontribute** (*Shih Agjërim dhe Oferta Agjërimi; (e) Dhjetë*)

## **Kontroll i Lindjes**

Kur çiftet e martuara janë të aftë fizikisht, ata kanë privilegjin të sigurojnë trupa të vdekshëm për fëmijët shpirtërorë të Atit Qiellor. Ata luajnë rol në planin e madh të lumturisë, i cili u lejon fëmijëve të Perëndisë të marrin trupa fizikë dhe të përjetojnë vdekshmërinë.

Në qoftë se jeni i martuar, ju si bashkëshortë duhet të diskutoni përgjegjësinë tuaj të shenjtë për të sjellë fëmijë në botë dhe për t'i rritur ata në drejtësi. Ndërkohë që veproni kështu, mbani parasysh shenjtërinë dhe domethënien e jetës. Mendoni thellë gëzimin që vjen kur në shtëpi janë fëmijët.

Mbani parasysh bekimet e përvetshme që vijnë kur keni pasardhës të mirë. Me dëshminë për këto parime, ju si bashkëshortë do të jeni të përgatitur të vendosni, me lutje, sa fëmijë të keni dhe kur t'i keni ata. Vendime të tilla janë midis ju të dyve dhe Zotit.

Ndërsa diskutoni këtë çështje të shenjtë, kujtoni që marrëdhëniet seksuale brenda martesës miratohen hyjnisht. Ndërsa një qëllim i këtyre marrëdhënieve është që të sigurojë trupa fizikë për fëmijët e Perëndisë, një tjetër qëllim është për të shprehur dashuri për njëri-tjetrin—për të zotuar burrë e grua së bashku në sinqeritet, besnikëri, interesim dhe qëllim të përbashkët.

## **Kreu-Perëndi**

Neni i parë i besimit bën të ditur: “Ne besojmë në Perëndinë, Atin e Përvetshëm, dhe në Birin e Tij, Jezu Krishtin, dhe në Frymën e Shenjtë.” Këto tre qenie përbëjnë Kreun-Perëndi. Ata kryesojnë mbi këtë botë dhe mbi të gjitha krijimet e tjera të Atit tonë në Qiell.

Doktrina e vërtetë për Kreun-Perëndi humbi në braktisjen që ndoqi shërbesën e Shpëtimtarit në vdekshmëri dhe vdekjen e Apostujve të Tij. Kjo doktrinë filloi të rivendosej atëherë kur Jozef Smithi 14-vjeçar mori Vegimin e tij të Parë (shih Joseph Smith—Historia 1:17). Nga përmbledhja e Profetit mbi Vegimin e Parë dhe nga mësimet e tij të tjera, ne dimë që anëtarët e Kreut-Perëndi janë tre qenie më vete. Ati dhe Biri kanë trupa të vërtetë mishi e kocke dhe Fryma e Shenjtë është person shpirtëror (shih DeB 130:22).

Edhe pse anëtarët e Kreut-Perëndi janë qenie të ndryshme me funksione të veçanta, ata janë një në qëllim e doktrinë. Ata janë plotësisht të bashkuar për ta çuar deri në fund planin hyjnor të Atit Qjellor për shpëtimin.

Referime shtesë: Mateu 3:13-17; Gjoni 14:6-10; 17:6-23; Veprat e Apostujve 7:55-56; 2 Nefi 31:18; Mormoni 7:5-7; DeB 76:20-24

*Shih gjithashtu Fryma e Shenjtë; Jezu Krishti; Perëndia Atë*



## **Krijim**

Nën drejtimin e Atit Qiellor, Jezu Krishti krijoi qiejt dhe tokën (shih Mosia 3:8; Moisiu 2:1). Nga shkrimi i shenjtë i zbuluar nëpërmjet Profetit Jozef Smith, dimë se në punën e Krijimit Zoti organizoi elementet që tashmë ekzistonin (shih Abrahami 3:24). Ai nuk e krijoi botën “nga asgjëja”, siç besojnë disa njerëz.

Shkrimet e Shenjta mësojnë gjithashtu që Adami ishte “[njeriu i parë i] të gjithë njerëzve” (Moisiu 1:34). Perëndia e krijoi Adamin dhe Evën në shëmbëlltyrën e Tij dhe në shëmbëlltyrën e të Vetëmlindurit të Tij (shih Moisiu 2:26-27).

Krijimi është pjesë thelbësore e planit të Atit Qiellor për shpëtimin. Ai i jep secilit prej nesh mundësinë të vijë në tokë, ku marrim trup fizik dhe ushtrojmë lirinë e zgjedhjes sonë. Në Këshillin e Perëndive, para lindjes, u shpall: “Ne do të zbresim, sepse ka hapësirë atje, dhe do të marrim prej materialeve dhe ne do të bëjmë një tokë në të cilën këta mund të banojnë; dhe ne do t’i provojmë me këtë, për të parë nëse ata do t’i bëjnë të gjitha gjërat që Zoti, Perëndia i tyre, do t’i urdhërojë” (Abrahami 3:24-25).

Ju jeni një fëmijë shpirtëror i Perëndisë dhe trupi juaj është krijuar në shëmbëlltyrën e Tij. Për të treguar mirënjohjen tuaj për këto bekime, ju mund të kujdeseni për trupin duke iu bindur Fjalës së Urtësisë dhe urdhërimeve të tjera që lidhen me shëndetin tuaj shpirtëror dhe fizik (shih DeB 89; shih gjithashtu DeB 88:124). Gjithashtu mund të respektoni njerëzit e tjerë si fëmijë të Perëndisë.

Duke qenë një përfitues i të gjitha bukurive të krijimit, ju mund të kujdeseni për tokën dhe të ndihmoni në ruajtjen e saj për brezat e ardhshëm.

Referime shtesë: Zanafilla 1-2; Hebrejve 1:1-2; 1 Nefi 17:36; DeB 38:1-3; 59:16-20; Moisiu 1-3; Abrahami 4-5

*Shih gjithashtu* Jezu Krishti; Perëndia Atë; Plani i Shpëtimit

## **Kryq**

Kryqi përdoret në shumë kisha të krishtere si simbol i vdekjes dhe Ringjalljes së Shpëtimtarit dhe si një shprehje e singertë e besimit. Si anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, ne gjithashtu i kujtojmë me nderim vuajtjet e Shpëtimtarit. Por, për shkak se Shpëtimtari jeton, ne nuk e përdorim simbolin e vdekjes Tij si simbol të besimit tonë.

Shprehja e besimit tuaj duhet të jetë jeta juaj. Kujtoni që, kur u pagëzuar dhe u konfirmuar, besëlidhët që të merrni mbi vete emrin e Jezu Krishtit. Kur shokët tuaj t'ju vëzhgojnë, ata duhet të jenë në gjendje të ndjejnë dashurinë tuaj për Shpëtimtarin dhe për punën e Tij.

Të vetmit anëtarë të Kishës që e vendosin simbolin e kryqit janë kapelanët Shenjtorë të Ditëve të Mëvonshme, që e mbajnë atë mbi uniformat e tyre ushtarake për të treguar se janë kapelanë të krishterë.

*Shih gjithashtu Jezu Krishti; Ringjallje; Shlyerja e Jezu Krishtit*

## **Kryqëzim** (*Shih Kryq; Shlyerja e Jezu Krishtit*)

## **Kthim (sipas besimit)**

“Mendja e kontrolluar nga mishi prodhon vdekje,” shpalli Apostulli Pali, “por mendja e kontrolluar nga Fryma prodhon jetë dhe paqe” (Romakëve 8:6; shih gjithashtu 2 Nefi 9:39). Në gjendjen tonë të rënë ne shpesh luftojmë me tundimin dhe nganjëherë ne i jepemi “dëshirës së mishit dhe ligësisë që është në të” (2 Nefi 2:29; shih gjithashtu “Rënie”, faqe 142-145 në këtë libër). Që të jemi të aftë të marrim bekimin e jetës së përjetshme, ne na duhet të jemi “mendje-kontrolluar nga shpirti” dhe të mposhtim dëshirat tona të padrejta. Kemi nevojë të ndryshojmë. Më saktë, kemi nevojë të *ndryshohemi*, ose të kthehemi, nëpërmjet fuqisë së Shlyerjes së Shpëtimtarit dhe përmes fuqisë së Frymës së Shenjtë. Ky proces quhet kthim.

Kthimi përfshin ndryshim në sjellje, por shkon përtej sjelljes, ai është ndryshim në vetë natyrën tonë. Ai është një ndryshim kaq domethënës, sa që Zoti dhe profetët e Tij i referohen atij si rilindje, ndryshim i zemrës dhe pagëzim nga zjarri. Zoti tha:

“Mos u mrekullo se i gjithë njerëzimi, po, burra dhe gra, të gjitha kombet, fiset, gjuhët dhe popujt duhet të lindin rishtas; po, të lindin nga Perëndia, të ndryshuar nga gjendja e tyre e mishit dhe e rënë në një gjendje drejtësie, duke qenë të shëlbuar nga Perëndia, duke u bërë bijtë dhe bijat e tij;

Dhe kështu ata bëhen krijesa të reja; dhe në qoftë se nuk e bëjnë këtë, ata, në asnjë mënyrë, nuk mund të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë” (Mosia 27:25-26).

### Procesi i Kthimit

Kthimi është një proces, jo një ndodhi. Ju ktheheni si rezultat i përpjekjeve tuaja të drejta për të ndjekur Shpëtimtarin. Këto përpjekje përfshijnë përdorimin e besimit tek Jezu Krishti, pendimin për mëkatin, pagëzimin, marrjen e dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe durimin deri në fund me besim.

Megjithëse kthimi është mrekullues dhe të ndryshon jetën, ai është një mrekulli e heshtur. Vizitat e engjëjve dhe dukuritë mahnitëse nuk sjellin kthim. Madje Alma, i cili pa një engjëll, u kthye vetëm mbasi “[agjëroi] dhe [u lut] për shumë ditë” për një dëshmi të së vërtetës (Alma 5:46). Dhe Pali, i cili e pa Shpëtimtarin e ringjallur, mësoi që “asnjë nuk mund të thotë: ‘Jezusi është Zot’, veçse në Frymën e Shenjtë” (1 Korintasve 12:3).

Meqë kthimi është proces i heshtur e i vazhdueshëm, ju mund të jeni kthyer tani e të mos e kuptoni. Ju mund të jeni si lamanitët të cilët, “për shkak të besimit të tyre në [Krisht], në kohën e kthimit të tyre në besim, u pagëzuan me zjarr dhe me Frymën e Shenjtë dhe ata nuk e dinin” (3 Nefi 9:20). Përpjekjet tuaja të vazhdueshme për të ushtruar besim dhe

për të ndjekur Shpëtimtarin, do t'ju çojnë drejt një kthimi më të madh.

### Tiparet Dalluese të Njerëzve Që Janë Kthyer

Libri i Mormonit siguron përshkrime për njerëz që janë kthyer te Zoti:

*Ata dëshirojnë të bëjnë mirë.* Populli i Mbretit Benjamin shpalli: “[Shpirti i] Zotit të Plotfuqishëm, . . . ka bërë një ndryshim të madh te ne, ose në zemrat tona, që ne nuk kemi më prirje të bëjmë keq, por të bëjmë mirë vazhdimisht” (Mosia 5:2). Alma foli për njerëz të cilët “nuk mund të shikonin mbi mëkatin përveçse me urrejtje të madhe” (Alma 13:12).

*Ata nuk ngrenë krye kundër Zotit.* Mormoni tregoi për një grup lamanitësh të cilët kishin qenë të ligj dhe gjakatarë, por që u “kthyen në besim te Zoti” (Alma 23:6). Këta njerëz e ndryshuan emrin e tyre në Anti-Nefi-Lehitë dhe “u bënë një popull i drejtë; ata ulën armët e rebelimit të tyre dhe nuk luftuan më kundër Perëndisë, as kundër ndonjërit prej vëllezërve të tyre” (Alma 23:7).

*Ata shpërndajnë ungjillin.* Enosi, Alma Plaku, Alma i Riu, bijtë e Mosias, Amuleku dhe Zizromi u përkushtuan në predikimin e ungjillit pasi u kthyen te Zoti (shih Enosi 1:26; Mosia 18:1; Mosia 27:32-37; Alma 10:1-12; 15:12).

*Ata mbushen me dashuri.* Pasi Shpëtimtari i ringjallur vizitoi njerëzit në të dy Amerikat, “i gjithë populli ishte kthyer në besim te Zoti, mbi tërë faqen e dheut, si Nefitë ashtu dhe Lamanitë; dhe nuk pati grindje dhe debate mes tyre dhe të gjithë njerëzit trajtonin me drejtësi njëri-tjetrin . . .

Dhe ndodhi që nuk pati grindje në tokë, për shkak të dashurisë së Perëndisë që jetonte në zemrat e njerëzve.

Dhe nuk pati zili, as luftime, as trazira, as lavirësi, as gënjeshtër, as vrasje, as ndonjë lloj ndyrësie; dhe me siguri nuk mund të kishte një popull më të lumtur mes gjithë njerëzve të krijuar nga dora e Perëndisë.

Nuk kishte as vjedhës, as vrasës, as nuk kishte Lamanitë, as ndonjë lloj tjetër -itësh; por ata ishin të gjithë një, fëmijë të Krishtit dhe trashëgimtarë të mbretërisë së Perëndisë” (4 Nefi 1:2, 15-17).

### Në Përpjekje për Kthim Më të Madh

Ju keni përgjegjësinë kryesore për kthimin personal. Askush nuk mund të kthehet në vend tuaj dhe asnjë nuk mund t’ju detyrojë për t’u kthyer. Sidoqoftë, të tjerët mund t’ju ndihmojnë në procesin e kthimit. Mësoni nga shembujt e drejtë të anëtarëve të familjes, të udhëheqësve dhe mësuesve të Kishës, dhe të burrave e grave në shkrimet e shenjta.

Aftësia juaj për të përjetuar një ndryshim të fuqishëm të zemrës do të rritet ndërsa mundoheni të ndiqni shembullin e përsosur të Shpëtimtarit. Studioni shkrimet e shenjta, lutuni me besim, mbani urdhërimet dhe kërkoni shoqërinë e qëndrueshme të Frymës së Shenjtë. Kur vazhdoni me procesin e kthimit, do të merrni “gëzim . . . jashtëzakonisht të madh”, ashtu si mori populli i Mbretit Beniamin kur Shpirti “[bëri] një ndryshim të madh . . . në zemrat [e tyre]” (shih Mosia 5:2, 4). Do të bëheni të aftë të ndiqni këshillën e Mbretit Beniamin që “të jeni të qëndrueshëm dhe të palëvizur, gjithmonë plot me vepra të mira, që Krishti, Zoti Perëndi i Plotfuqishëm, mund t’ju vulosë ju të tijet, që ju të mund të çoheni në qiell, që ju të mund të keni shpëtim të përjetshëm dhe jetë të përjetshme” (Mosia 5:15).

Referime shtesë: Mateu 18:3; Lluka 22:32; Alma 5:7-14

*Shih gjithashtu* Fryma e Shenjtë; Pagëzim; Shlyerja e Jezu Krishtit; Shpëtim

## Kumar

Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është kundër kumarit, përfshirë këtu lotaritë që organizohen nga qeveritë.

Kumari e ka motivin tek dëshira për të fituar diçka për hiçgjë. Nga ana shpirtërore kjo dëshirë është shkatërruese. Ajo i çon pjesëmarrësit larg nga mësimet e Shpëtimtarit për dashurinë dhe shërbimin dhe drejt egoizmit të kundërshtarit të Tij. Ajo minon virtytin e punës e të nikoqirllëkut dhe dëshirën për të bërë përpjekje të ndershme në gjithçka që bëjmë.

Ata që marrin pjesë në kumar, zbulojnë shpejt mashtrimin tek ideja se ata mund të japin pak ose aspak dhe të marrin në kthim diçka me vlerë. Ata konstatojnë se lënë sasira të mëdha parash, nderin e tyre dhe respektin e anëtarëve të familjes dhe të miqve. Të gënjyer e të dhënë pas saj, ata shpesh luajnë kumar me fondet që duhej t'i përdornin për qëllime të tjera si, p.sh., plotësimi i nevojave minimale të familjeve të tyre. Kumarxhinjtë nganjëherë robërohen kaq shumë e bëhen aq të dëshpëruar në pagimin e borxheve të kumarit, sa që i drejtohen vjedhjes, duke hequr dorë nga emri i tyre i mirë.

Presidencia e Parë na ka nxitur që t'u bashkohemi të tjerëve në kundërshtim të ligjërimit e të sponsorizimit nga qeveria të çdo forme kumari në komunitetet tona.

*Shih gjithashtu Tundim*

**Kunj** (*Shih Administrim i Kishës*)

**Kuorum** (*Shih Priftëri*)

**Kuorum i Dymbëdhjetë Apostujve** (*Shih Administrim i Kishës*)

**Kuorume të të Shtatëdhjetëve** (*Shih Administrim i Kishës*)

**Kurorëshkelje** (*Shih Dëlrirësi*)

**Kurvëri** (*Shih Dëlrirësi*)

**Lagje** (*Shih Administrim i Kishës*)

**Libri i Mormonit** (*Shih Shkrime të Shenjta*)

## Liri e Zgjedhjes

Ati juaj Qiellor ju ka dhënë lirinë e zgjedhjes, aftësinë për të zgjedhur dhe vepruar për vete. Liria e zgjedhjes është thelbësore në planin e shpëtimit. Pa të nuk do të ishit të aftë të mësonit ose të përparonit apo të ndiqnit Shpëtimtarin. Me të jeni “të lirë të [zgjidhni] lirinë dhe jetën e përjetshme, nëpërmjet Ndërmjetësit të madh të të gjithë njerëzve, ose të [zgjidhni] robërinë dhe vdekjen, sipas robërisë dhe fuqisë së djallit” (2 Nefi 2:27).

Ju e kishit fuqinë për të zgjedhur madje përpara se të lindnit. Në Qiell, në Këshillin para lindjes, Ati Qiellor paraqiti planin e Tij, i cili përfshinte parimin e lirisë së zgjedhjes. Luciferi ngriti krye dhe “kërkoj të shkatërronte lirinë e njeriut për të zgjedhur” (Moisiu 4:3). Si rezultat, Luciferit dhe atyre që e ndoqën iu mohua privilegji i marrjes së trupit të vdekshëm. Prania juaj mbi tokë vërtetonte se ju e keni ushtruar lirinë tuaj të zgjedhjes në ndjekje të planit të Atit Qiellor.

Në vdekshmëri ju vazhdoni të keni liri zgjedhjeje. Përdorimi i kësaj dhurate nga ju, kushtëzon lumturinë ose mjerimin tuaj në këtë jetë dhe në jetën që vjen. Ju jeni i lirë të zgjidhni dhe të veproni, por nuk jeni i lirë të zgjidhni pasojat e veprimeve tuaja. Pasojat mund të mos jenë të menjëherëshme, por gjithmonë do të vijnë nga pas. Zgjedhja e së mirës dhe e drejtësisë të udhëheq drejt lumturisë, paqes dhe jetës së përjetshme, ndërsa zgjedhja e mëkatit dhe e ligësisë përfundimisht të udhëheq drejt trishtimit dhe mjerimit.

Ju jeni përgjegjës për vendimet që merrni. Nuk duhet të fajësoni rrethanat tuaja, familjen tuaj ose miqtë tuaj, në rast se zgjidhni të mos u bindeni urdhërimeve të Perëndisë. Ju jeni një fëmijë i Perëndisë, me fuqi të madhe. Keni aftësinë për të zgjedhur drejtësinë dhe lumturinë, pavarësisht nga rrethanat tuaja.

Gjithashtu jeni përgjegjës për zhvillimin e aftësive dhe talenteve që ju ka dhënë Ati Qiellor. Ju jeni përgjegjës ndaj Tij për atë që bëni me aftësitë tuaja dhe se si e përdorni kohën tuaj. Mos e çoni dëm kohën tuaj. Jini i gatshëm të punoni fort. Zgjidhni që të bëni shumë të mira nisur nga vullneti juaj i lirë.

Referime shtesë: Ligji i Përtërirë 11:26-28; 30:15-20; Jozueut 24:14-15; 2 Nefi 2; Helamani 14:30-31; DeB 58:26-28; 101:78

*Shih gjithashtu* Bindje; Plani i Shpëtimit; Tundim

## Luftë

Zoti ka thënë që në ditët e fundit do të ketë “luftëra e ushtrime luftërash dhe i gjithë dheu do të jetë në rrëmujë, dhe zemrat e njerëzve do të mpaken” (DeB 45:26).

Si anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, ne jemi një popull paqësor. Ne ndjekim Shpëtimtarin, i cili është Princi i Paqes. Ne presim me padurim mbretërimin e Tij njëmijëvjeçar, kur luftërat do të mbarojnë dhe paqja do të rivendoset në tokës (shih Isaia 2:4). Megjithatë, ne e pranojmë faktin që në këtë botë udhëheqësit e qeverive ndonjëherë dërgojnë forca ushtarake në luftë për të mbrojtur kombet dhe idealet e tyre.

Shenjtorët e ditëve të mëvonshme në ushtri nuk duhet të ndihen të ndarë më dysh midis atdheut të tyre dhe Perëndisë së tyre. Në Kishë, “ne besojmë në nënshtrimin ndaj mbretërve, presidentëve, sundimtarëve dhe gjykatësve, në bindjen, nderimin dhe mbështetjen e ligjit” (Nenet e Besimit 1:12). Shërbimi ushtarak tregon përkushtim ndaj këtij parimi.

Në qoftë se shenjtorët e ditëve të mëvonshme thirren për të shkuar në betejë, ata mund të shohin nga shembulli i Kapiten Moronit, udhëheqësi i madh ushtarak në Librin e Mormonit. Megjithëse ai ishte një luftëtar i madh, ai “nuk gjente kënaqësi në gjakderdhje” (Alma 48:11). Ai ishte “i vendosur në besimin e Krishtit” dhe arsyeja e tij e vetme për të luftuar ishte “që të mbronte popullin e tij, të drejtat e tij dhe vendin e tij dhe fenë e tij” (Alma 48:13). Në qoftë se



shenjtorëve të ditëve të mëvonshme u duhet të shkojnë në luftë, ata duhet të shkojnë me shpirtin e së vërtetës dhe të drejtësisë, me një dëshirë për të bërë të mirën. Ata duhet të shkojnë me dashuri në zemrat e tyre për të gjithë fëmijët e Perëndisë, përfshirë ata të anës kundërshtare. Pastaj, në qoftë se atyre u kërkohet të derdhin gjakun e dikujt tjetër, veprimi i tyre nuk do të llogaritet si mëkat.

*Shih gjithashtu Paqe; Qeverisje dhe Ligj Civil*

## Lumturi

Duke dëshmuar për “synimet e . . . përjetshme” të Perëndisë, profeti Lehi mësoi: “Njerëzit janë, që ata të mund të kenë gëzim” (2 Nefi 2:15, 25).

Ati Qiellor dëshiron që ne të gjejmë lumturi të vërtetë që zgjat. Lumturia jonë është qëllimi i të gjitha bekimeve që na ka dhënë Ai—mësimet e ungjillit, urdhërimet, ordinancat e priftërisë, lidhjet familjare, profetët, tempujt, bukuritë e krijimit, madje edhe mundësinë për të përjetuar vështirësi. Plani i Tij për shpëtimin quhet shpesh “[plani i] madh [i] lumturisë” (Alma 42:8). Ai dërgoi Birin e Tij të Dashur për të zbatuar Shlyerjen, që kështu të mund të jemi të lumtur në këtë jetë dhe të marrim plotësinë e gëzimit në përjetësi.

Shumë njerëz përpiqen ta gjejnë lumturinë dhe plotësimin e tyre në veprimtari që janë në kundërshtim me urdhërimet e Zotit. Ata, duke mos marrë parasysh planin e Perëndisë për ta, mohojnë të vetmin burim të lumturisë së vërtetë. Ata i jepen djallit, i cili “kërkon që të gjithë njerëzit të jenë të mjeruar sikurse është ai vetë” (2 Nefi 2:27). Në përfundim ata mësojnë të vërtetën që Alma ia paralajmëroi të birit, Koriantonit: “Ligësia kurrë nuk ka qenë lumturi” (Alma 41:10).

Të tjerë kërkojnë vetëm argëtim në jetë. Duke e pasur këtë si qëllimin kryesor, lejojnë kënaqësinë e përkohshme t’ua heqë mendjen nga lumturia që zgjat. Ata ia vjedhin vet-

vetes gëzimet e qëndrueshme që vijnë nga rritja shpirtërore, shërbimi dhe puna e palodhur.

Ndërkohë që kërkonit të jeni i lumtur, mbani mend se udha e vetme drejt lumturisë është të jetosh ungjillin. Ju do të gjeni lumturi të patrazuar dhe të përjetshme, kur përpiqeni t'i mbani urdhërimet, të luteni për fuqi, të pendoheni për mëkatet, të merrni pjesë në veprimtari të shëndetshme dhe të bëni shërbim kuptimplotë. Do mësoni të argëtoheni brenda kufijve të fiksuara prej një Ati të dashur në Qiell.

Lumturia juaj mund të jetë ngjitesë. Kur t'ju shohin të tjerët, mund t'u lindë dëshira për të ditur vendburimin e lumturisë suaj. Atëherë edhe ata mund të përjetojnë lumturinë që vjen duke jetuar ungjillin e Jezu Krishtit.

Referime shtesë: Psalmet 35:9; 2 Nefi 5:27; Mosia 2:41; 3 Nefi 17:18-20; 4 Nefi 1:15-16; DeB 18:10-16

*Shih gjithashtu* Plani i Shpëtimit; Punë Misionare; Shërbim

## Lutje

Ju jeni fëmijë i Perëndisë. Ati juaj Qiellor ju do dhe i njejnëvojat tuaja dhe dëshiron që ju të bashkëbisedoni me Të me anë të lutjes. Lutjuni Atij e askujt tjetër. Zoti Jezu Krishti urdhëroi: "Ju duhet t'i luteni gjithmonë Atit në emrin tim" (3 Nefi 18:19).

Kur e bëni zakon që t'i drejtoheni Perëndisë me lutje, ju do të arrini ta njihni më mirë Atë dhe t'i afroheni gjithnjë e më pranë. Dëshirat tuaja do të bëhen më të ngjashme me të Tijat. Do të jeni në gjendje të siguronit për vete dhe për të tjerët bekime që Ai është gati t'i japë, nëse ju veçse ia kërkonit me besim.

### Parimet e Lutjes

Ati juaj Qiellor është përherë i gatshëm t'i dëgjojë e t'iu përgjigjet lutjeve tuaja. Fuqia e lutjeve tuaja varet nga ju. Ndërsa përpiqeni që ta bëni lutjen pjesë të jetës, kujtoni këto këshilla:

*Bëjini lutjet kuptimplote.* Profeti Mormoni paralajmëroi se, nëse ndokush “nuk lutet me dëshirë të sinqertë të zemrës . . . nuk i sjell ndonjë dobi, pasi Perëndia nuk pranon asnjë të tillë” (Moroni 7:9). Që t’i bëni kuptimplote lutjet, duhet të luteni me sinqeritet dhe “me gjithë fuqinë e zemrës suaj” (Moroni 7:48). Bëni kujdes të shmangni “përsëritje të kota” kur të luteni (shih Mateu 6:7). Mendohuni seriozisht për qëndrimin dhe fjalët që përdorni.

*Përdorni një gjuhë që tregon dashuri, respekt, nderim dhe afërsi.* Përdorimi i këtij parimi ndryshon sipas gjuhës që flisni. Për shembull, kur i drejtoheni Perëndisë, ju duhet të përdorni përemra si në shkrimet e shenjta —*Ti, Ty, Yt, Tënd, e Tua etj.*, në vend të përemrave në numrin shumës: *ju, juve, juaj, tuaj, tuaja etj.* Pavarësisht nga gjuha parimi mbetet i njëjtë: Kur të luteni duhet të përdorni fjalë që përcjellin siç duhet një marrëdhënie të përzemërt e adhuruese. Mund të keni ndonjë vështirësi me mësimin e gjuhës së lutjes, por dalëngadalë do të ndiheni më të qetë në këtë gjë, ndërsa luteni dhe lexoni shkrimet e shenjta.

*Falënderojeni përherë Atin tuaj Qiellor.* Ju duhet “të jetoni çdo ditë me falënderime për mëshirat dhe bekimet e shumta që ai ju jep” (Alma 34:38). Kur gjeni kohë për të kujtuar bekimet tuaja, atëherë do të kuptoni se sa shumë ka bërë për ju Ati Qiellor. Shprehini falënderimet për Të.

*Kërkoni udhëheqjen dhe fuqinë e Atit Qiellor në gjithçka që bëni.* Alma e këshilloi birin e tij Helamani: “Përgjëroju Perëndisë, për gjithë mbështetjen tënde; po, le të jenë të gjitha veprimet e tua në Zotin dhe kudo që të shkosh, le të jetë në Zotin; po, le të jenë të gjitha mendimet e tua të drejtuara te Zoti; po, le të jetë dashuria e zemrës sate e vendosur përgjithnjë te Zoti. Këshillohu me Zotin për të gjitha veprimet e tua dhe ai do të të drejtojë për të mirë; po, kur të biesh në mbrëmje, bjer për Zotin, që ai të mund të të ruajë në gjumin tënd; dhe kur të ngrihesh në mëngjes, le të jetë zemra jote plot falënderime ndaj Perëndisë; dhe në qoftë se i bën këto gjëra, ti do të ngrihesh në ditën e fundit” (Alma 37:36-37; shih gjithashtu Alma 34:17-26).

*Mbani mend nevojat e të tjerëve kur të luteni.* Ofroni lutje “për mirëqenien tuaj dhe gjithashtu për mirëqenien e atyre që janë rreth e përçark jush” (Alma 34:27). Kërkojini Atit tuaj Qiellor t’i bekojë e t’i ngushëllojë ata që kanë nevojë. Kërkojini që të frymëzojë e të fuqizojë Presidentin e Kishës, Autoritetet e tjera të Përgjithshme dhe udhëheqësit tuaj lokalë. Lutuni për mirëqenien e anëtarëve të familjes dhe të miqve. Lutuni për udhëheqësit e qeverisë. Kërkojini Zotit që të frymëzojë dhe të mbrojë misionarët dhe njerëzit që po mësojnë ata.

*Kërkoni udhëheqje nga Fryma e Shenjtë, që kështu të dini se çfarë të përfshini në lutje.* Fryma e Shenjtë mund t’ju mësojë të luteni dhe t’ju udhëheqë në ato që thoni (shih Romakëve 8:26; 2 Nefi 32:8). Ai mund t’ju ndihmojë që të luteni “sipas vullnetit të Perëndisë” (DeB 46:30).

*Kur bëni një kërkesë nëpërmjet lutjes, bëni gjithçka të mundur që të ndihmoni në plotësimin e saj.* Ati Qiellor pret që ju të bëni më tepër sesa thjesht t’i kërkoni bekime. Kur ju keni një vendim të rëndësishëm për të marrë, Ai shpesh do të kërkojë që “ta studiosh . . . në mendjen tënde” para se Ai t’ju japë një përgjigje (shih DeB 9:7-8). Lutjet për udhëheqje do të kenë veçse aq dobi sa ç’janë përpjekjet që bëni për të kapur përshpëritjet e Frymës së Shenjtë. Lutjet për mirëqenie vetjake dhe për mirëqenien e të tjerëve do të jenë të kota, në rast se “nuk ndihmoni nevojtarët dhe të zhveshurit dhe nuk vizitoni të sëmurët dhe të mjeruarit, dhe nuk u jepni nga gjëja juaj, në qoftë se keni, atyre që kanë nevojë” (Alma 34:28).

Në qoftë se ju pret një punë e vështirë, Ati Qiellor kënaqet kur përkuleni në gjuhë e i kërkoni ndihmë dhe pastaj ngriheni në këmbë e shkoni të punoni. Ai do t’ju ndihmojë në të gjitha veprimtaritë e drejta, por rrallë do të bëjë diçka për ju, të cilën mund ta bëni vetë.

## Lutja Vetjake

Në Predikimin e Tij në Mal, Jezu Krishti këshilloi: “Futu në dhomëzën tënde, mbylle derën dhe lutju Atit tënd në

fshehtësi; dhe Ati yt, që shikon në fshehtësi, do të ta shpërblejë publikisht” (Mateu 6:6). Lutja vetjake, private është një pjesë thelbësore e zhvillimit tuaj shpirtëror.

Së paku çdo mëngjes dhe çdo natë, gjeni një vend që ju lejon të jeni të përqendruar. Gjunjzohuni me përlulesi dhe bisedoni ngrohtësisht me Atin Qiellor. Edhe pse nganjëherë mund t’ju nevojitet të luteni në heshtje, bëni hera-herës përpjekje të veçanta që të luteni me zë (shih DeB 19:28; 20:51).

Mbani mend se lutja është bashkëbisedim me dy drejtime. Kur të mbyllni lutjen, prisni dhe dëgjoni me vëmendje. Nganjëherë, Ati Qiellor do t’ju këshillojë, do t’ju udhëheqë ose do t’ju lehtësojë ndërsa jeni të ulur në gjunjë.

Kurrë mos besoni se ju nuk jeni i denjë për t’u lutur. Ky mendim vjen nga Satani, që dëshiron t’ju mbushë mendjen se nuk duhet të luteni (shih 2 Nefi 32:8). Në qoftë se nuk dëshironi të bëni lutje, lutuni gjersa t’ju kthehet dëshira për t’u lutur.

Shpëtimtari na ka urdhëruar: “Lutu gjithmonë që të mund të dalësh fitues; po, që ti të mund të mposhtësh Satanin dhe që ti të mund t’u shpëtosh duarve të shërbëtorëve të Satanit që vërtet përkrahin veprën e tij” (DeB 10:5). Megjithëse ju nuk mund të rrini vazhdimisht në gjunjë, duke paraqitur lutje vetjake e private, mund ta lejoni zemrën të jetë “plot, [e hapur] në lutje tek [Perëndia] vazhdimisht” (Alma 34:27; shih gjithashtu 3 Nefi 20:1). Gjatë çdo dite mund të ruani një ndjenjë të pandryshueshme dashurie për Atin tuaj Qiellor dhe Birin e Tij të Dashur. Mund të shprehni në heshtje mirënjohjen për Atin tuaj dhe t’i kërkonti t’ju japë forcë para përgjegjësive që keni. Në kohë tundimesh ose rreziqesh fizike, mund të kërkonti ndihmën e Tij heshturazi.

## Lutja Familjare

Përveç urdhërimit që të lutemi në vetmi, Shpëtimtari na ka porositur që të lutemi me familjet tona. Ai tha: “Lutjuni Atit në familjet tuaja, gjithnjë në emrin tim, që bashkëshortet tuaja dhe fëmijët tuaj të jenë të bekuar” (3 Nefi 18:21).

Nëse jeni i martuar, bëjeni lutjen familjare një pjesë të qëndrueshme të jetës së familjes suaj. Çdo mëngjes dhe çdo mbrëmje gjunjëzohuni së bashku me përlulje. Jepini rast secilit pjesëtar të familjes që të bëjë lutjen. Bëhuni bashkë në mirënjohjen për bekimet që ju ka dhënë Ati Qiellor. Bëhuni bashkë në besim për t'u lutur fuqimisht për bekimet që ju nevojiten dhe në lutje për të tjerët.

Me anën e lutjes së rregullt familjare, ju dhe anëtarët e familjes do t'i afroheni edhe më pranë Perëndisë dhe njëritjetrit. Fëmijët tuaj do të mësojnë të bashkëbisedojnë me Atin e tyre në Qiell. Ju do të jeni më të përgatitur për t'u shërbyer të tjerëve dhe për të duruar tundimet. Shtëpia juaj do të jetë një vend i fuqisë shpirtërore, një vendstrehim nga ndikimet e liga të botës.

### Lutja Haptas

Nganjëherë mund t'ju kërkohet të bëni lutje haptas, ndoshta në Kishë ose në klasë. Kur t'ju jepet ky rast, mban mend se jeni në bashkëbisedim me Atin Qiellor, jo duke bërë predikim para njerëzve. Mos u merakosni se çfarë mund të mendojnë të tjerët për ato që thoni. Në vend të saj, jepni një lutje të thjeshtë nga zemra.

### Marrja e Përgjigjeve të Lutjes

Shpëtimtari mësoi: "Lypni dhe do t'ju jepet; kërkoni dhe do të gjeni; trokitni dhe do t'ju çelet. Sepse kush lyp merr, kush kërkon gjen dhe do t'i çelet atij që troket" (Mateu 7:7-8). Nefitëve Ai u tha: "Çdo gjë që ju do t'i kërkoni Atit në emrin tim, që është e drejtë, duke besuar se do ta merrni, vini re, ajo do t'ju jepet" (3 Nefi 18:20).

Ati Qiellor i dëgjon lutjet tuaja. Ai mund të mos përgjigjet përherë siç e prisni, por Ai përgjigjet—në kohën e Vet dhe sipas vullnetit të Tij. Ngaqë Ai e di se çfarë është më e mira për ju, nganjëherë mund të përgjigjet "Jo", edhe kur kërkesat janë të sinqerta.

Përgjigjet e lutjeve vijnë në mënyra të shumta. Shpesh vijnë nëpërmjet zërit të qetë e të ulët të Frymës së Shenjtë (shih “Zbulesë”, faqe 192-197). Mund të vijnë në formën e rrethanave të jetës suaj ose nëpërmjet veprimt të atyre që ju ndodhen përreth. Kur vazhdoni t’i afroheni pranë Atit tuaj Qiellor me anën e lutjes, ju do t’i dalloni më me lehtësi përgjigjet e Tij zemërgjera e të mençura mbi kërkesat tuaja. Do të zbuloni se Ai është “një strehë dhe një forcë, një ndihmë gjithnjë e gatshme në fatkeqësi” (Psalmet 46:1).

Referime shtesë: Mateu 6:5-15; Jakobi 1:5-6 [Bibla]; Enosi 1:1-17; Mosia 4:11-12; 3 Nefi 13:6-7; 14:7-8; DeB 19:38; 88:63-65; Joseph Smith—Historia 1:9-19

*Shih gjithashtu* Adhurim; Agjërim dhe Oferta Agjërimi; Besim

## **Lutje Familjare** (*Shih* Lutje)

### **Martesë**

Sot në botë shumë njerëz e heqin nga mendja dhe madje tallen lidhur me martesën dhe familjen. Në mes të zërave të tillë hutues dhe shkatërrimtarë, Presidencia e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve na pajis me zërin e qëndrueshëm të së vërtetës. Ata “solemnisht [shpallin] se martesë midis një burri dhe një gruaje shugurohet nga Perëndia dhe se familja është thelbësore në planin e Krijuesit për destinacionin e përjetshëm të fëmijëve të Tij” (shih “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, faqe 47 në këtë libër).

Gëzimet më të mëdha të jetës gjenden në familje. Marrëdhëniet e fuqishme familjare kërkojnë përpjekje, por një përpjekje e tillë sjell lumturi të madhe në këtë jetë dhe gjatë gjithë përjetësisë. Edhe sikur në të kaluarën të mos keni pasur një jetë të lumtur familjare, ju mund të përpiqeni të keni një martesë të lumtur e të përjetshme dhe marrëdhënie të përzierme me anëtarët e familjes.

## Besëlidhja e Re dhe e Përjetshme e Martesës

Në planin e Atit tonë Qiellor për lumturinë, një burrë dhe një grua mund të vulosen tek njëri-tjetri për këtë kohë e për gjithë përjetësinë. Atyre që janë vulosur në tempull, u sigurohet se marrëdhënia e tyre do të vazhdojë përgjithmonë, nëse ata janë të vërtetë me besëlidhjet e tyre. Ata e dinë se asgjë, madje as vdekja, nuk mund t'i ndajë për një kohë të gjatë.

Besëlidhja e martesës së përjetshme është domosdoshmëri për ekzaltimin. Zoti zbuloi nëpërmjet Jozef Smithit: “Në lavdinë çelestiale ka tre qiej, ose shkallë; Dhe me qëllim që të fitojë më të lartën, një njeri duhet të hyjë në këtë rend të priftërisë [domethënë besëlidhjen e re e të përjetshme të martesës]; Dhe nëse nuk e bën këtë, ai nuk mund ta fitojë atë. Ai mund të hyjë në një tjetër, por është fundi i mbretërisë së tij; ai nuk mund të ketë rritje” (DeB 131:1-4)

Pasi merret ordianca vulosëse dhe bëhen besëlidhjet e shenjta në tempull, çifti duhet të vazhdojë me besnikëri në mënyrë që të marrë bekimet e martesës së përjetshme dhe ekzaltimin. Zoti tha:

“Në qoftë se një burrë martohet me një grua prej fjalës sime, që është ligji im, dhe me anë të besëlidhjes së re dhe të përjetshme dhe ajo iu vuloset me anë të Shpirtit të Shenjtë të premtimit, prej atij që vajoset, të cilit ia kam dhënë këtë fuqi dhe çelësat e kësaj priftërie; . . . dhe në qoftë se [ata e durojnë] besëlidhjen time . . . do të bëhen për ta të gjitha gjërat, çfarëdo që shërbëtori im ka vënë mbi ta, në kohë dhe përmes gjithë përjetësisë; dhe do të jetë plotësisht e vlefshme kur ata të jenë jashtë botës” (DeB 132:19; për një shpjegim mbi Frymën e Shenjtë të Premtimit, shih faqe 57).

## Përgatitja për Martesë

Në rast se jeni beqar, përgatituni me kujdes për martesën. Mbani në mendje që asgjë nuk ia zë vendin martesës në tempull. Përgatituni të martoheni me njeriun e duhur, në vendin e duhur dhe në kohën e duhur. Që tani jetoni me denjësi për atë lloj personi me të cilin shpresoni të martoheni.



Takohuni vetëm me ata që kanë kritere të larta për veten dhe që, gjatë shoqërimit me ta, ju të mund t'i ruani kriteret tuaja të larta. Planifikoni me maturi veprimtari pozitive dhe të dobishme, me qëllim që ju dhe personi që takoni të mos mbe-teni vetëm pa asgjë për të bërë. Qëndroni në zona të sigurta, ku ju mund ta kontrolloni veten me lehtësi. Mos merrni pjesë në bashkëbisedime ose veprimtari që zgjojnë ndjesi seksuale.

Kërkoni një bashkëudhëtar të të njëjtit besim si ju. Kërkoni të gjeni dikë që ju ta nderoni e ta respektoni përherë, dikë që do t'ju plotësojë në jetën tuaj. Para se të martoheni, sigurohuni që keni gjetur dikë të cilit mund t'i jepni gjithë zemrën, gjithë dashurinë, gjithë përkushtimin, gjithë besnikërinë tuaj.

### Këshillë për Ata të Cilët Nuk Martohen

Disa anëtarë të Kishës mbeten beqarë jo për faj të tyre, megjithëse ata dëshirojnë të martohen. Në rast se e shihni veten kështu, jini të sigurtë se “të gjitha gjëra bashkëveprojnë për të mirë për ata që e duan Perëndinë” (Romakëve 8:28). Kur qëndroni i denjë, në një ditë të ardhshme, në këtë jetë ose në tjetrën, do t'ju jepen të gjitha bekimet e një marrëdhënieje të përjetshme familjare. Zoti e ka përsëritur vazhdimisht këtë premtim nëpërmjet profetëve të Tij të ditëve të mëvonshme.

Në rast se jeni beqar dhe dëshironi të martoheni, mos e lëshoni shpresën. Njëkohësisht, mos lejoni që të përhumbni në qëllimin tuaj. Më mirë përfshihuni me zell në veprimtari që ia vlen. Kërkoni të gjeni mënyra shërbimi në farefisn tuaj dhe në komunitetin ku jetoni. Pranojini dhe lartësojini thirrjet e Kishës. Mbajeni veten të pastër edhe fizikisht, edhe shpirtërisht. Vazhdoni të mësoni, të zhvilloheni e të përparoni në jetën vetjake.

### Arritja e një Martese të Lumtur

Në rast se jeni i martuar, kujtoni që miqësia dhe dashuria midis jush si bashkëshortë duhet të jetë marrëdhënia juaj më e çmuar e kësaj toke. Bashkëshorti ose bashkëshortja është i

vetmi person, mbas Zotit, të cilin ju u urdhëruat ta doni me gjithë zemër (shih DeB 42:22).

Mbani mend se martesë, në kuptimin e saj më të vërtetë, është bashkëpunimi midis të barabartëve, ku asnjëri nuk ushtron sundim mbi tjetrin, por ku secili inkurajon, ngushëllon dhe ndihmon tjetrin.

Ngaqë martesë është një marrëdhënie me kaq rëndësi në jetë, ajo kërkon dhe meriton kohë. Mos u jepni më shumë përparësi angazhimeve më pak të rëndësishme. Kaloni kohë duke folur së bashku e duke dëgjuar njëri-tjetrin. Tregoni vëmendje dhe respekt. Shprehni shpesh ndjenja të ëmbla e dashuri.

Merrni vendim që kurrë ndonjëherë nuk do të ketë diçka midis jush si bashkëshortë për t'ju përçarë martesën. Vendosni ta bëni martesën tuaj të triumfojë, pavarësisht nga sfidat që mund të dalin.

Jini besnikë ndaj njëri-tjetrit. Jini besnikë në besëlidhjet e martesës me mendime, fjalë dhe vepra. Kujtoni që Zoti ka thënë: “Duaje bashkëshorten tënde me gjithë zemër dhe do të kapesht pas saj e pas askujt tjetër” (DeB 42:22). Shprehja “askujt tjetër” mëson që asnjë person, veprimtari ose zotërim nuk duhet të marrë ndonjëherë përparësi mbi marrëdhënien tuaj si bashkëshortë.

Qëndroni larg nga çdo gjë që mund t'ju çojë të jeni i pabesë në çfarëdo drejtimi. Pornografia, përfytyrimet e dëmshme dhe flirtet do të gërryejnë forcën tuaj morale dhe do të godasin themelin e martesës suaj.

Punoni së bashku për të administruar gjërat tuaja financiare. Bashkëpunoni për të krijuar dhe për të ndjekur fondin e të ardhurave. Disiplinohuni në shpenzime dhe shmangeni skllavërinë e borxhit. Përdorimi i parasë me mençuri dhe liria nga borxhi ndihmojnë që shtëpia të ketë paqe.

Përqendrojeni jetën tuaj tek ungjilli i Jezu Krishtit. Ndihmoni njëri-tjetrin në mbajtjen e besëlidhjeve që keni bërë. Frekuentoni kishën dhe tempullin së bashku. Studioni bashkë shkrimet e shenjta. Së bashku gjunjëzohuni në lutje në fillim dhe në mbarim të çdo dite që ta falënderoni Atin tuaj Qiellor

për njëri-tjetrin dhe që të bashkoheni në kërkim të bekimeve të Tij në jetën tuaj, për shtëpinë tuaj, për më të dashurit tuaj dhe për dëshirat e drejta. Atëherë Perëndia do t'ju udhëzojë dhe bashkëbisedimet tuaja të përditshme me Të, do të sjellin paqe dhe gëzim që nuk mund të vijnë prej asnjë burimi tjetër. Shoqëria juaj do të ëmbëlsohet nëpër vite; dashuria juaj do të forcohet. Vlerësimi për njëri-tjetrin do të rritet.

Referime shtesë: Zanafilla 1:27-28; 2:18, 21-24; 1 Korintasve 11:11; Efesianëve 5:22-33; Moisiu 2:27-28; 3:18, 21-24

*Shih gjithashtu* Dëllirësi; Divorc; Familje; Tempuj; Unitet

## **Mbledhje e Sakramentit** (*shih* Sakrament; Sakrificë; Shabat)

### **Mbrëmje Familjare në Shtëpi**

Familja është vendi më i rëndësishëm për mësimin e ungjillit. Asnjë organizim tjetër nuk mund të zërë vendin e familjes. Profetët e ditëve të mëvonshme në mënyrë të përsëritur u kanë bërë thirrje prindërve që t'i ushqejnë fëmijët e tyre me dashuri dhe me mësim ungjilli.

Më 1915 Presidenti Jozef F. Smith dhe këshilltarët e tij në Presidencinë e Parë filluan një përpjekje të mbarë Kishës për të forcuar familjen. Ata u bënë thirrje prindërve në Kishë t'i mbledhin fëmijët e tyre një herë në çdo javë për një "Mbrëmje Shtëpie". Familjet duhet të shpenzonin kohë për t'u lutur dhe kënduar së bashku, për të lexuar shkrimet e shenjta, për t'i mësuar ungjillin njëri-tjetrit dhe për të marrë pjesë në aktivitete të tjera që do të ndërtonin unitetin familjar.

Më 1970 Presidenti Jozef Fillding Smith u bashkua me këshilltarët e tij në Presidencinë e Parë për ta caktuar mbrëmjen e së hënës si kohën për mbrëmje familjare në shtëpi. Që prej atij njoftimi, Kisha i ka liruar mbrëmjet e të hënave nga veprimtaritë e Kishës, që familjet ta kenë bashkë këtë kohë.

Profetët e ditëve të mëvonshme vazhdojnë t'i nxisin anëtarët e Kishës që t'i japin përparësinë më të madhe mbrëmjes familjare në shtëpi. Ata kanë premtuar se përkushtimi ynë në

këtë program do të ndihmojë për të mbrojtur familjet tona përkundrejt ligësive të kohës sonë dhe do të na sjellë bollëk gëzimi tani dhe gjatë përjetësive.

Të gjithë anëtarët e Kishës duhet ta bëjnë të hënën një kohë të shenjtë, të ruajtur për mbrëmje familjare në shtëpi. Nëse jeni i martuar, bëni çdo javë mbrëmje familjare në shtëpi si bashkëshortë. Kur të keni fëmijë, përfshijini në mbrëmjen familjare të shtëpisë. Përshtateni programin sipas nevojave dhe interesave të tyre dhe lejojini të bëhen pjesëmarrës. Mbasi fëmijët tuaj të rriten dhe të zhvendosen larg, vazhdoni të mbani si bashkëshortë mbrëmje familjare në shtëpi.

Nëse jeni beqar, merrni parasysh t'iu kërkonit peshkopit ose presidentit tuaj të degës që të organizojë një grup për mbrëmje shtëpie për ju dhe anëtarë të tjerë beqarë të lagjes ose degës suaj. Ai mund të thërrasë një udhëheqës për mbrëmje shtëpie, i cili ka përgjegjësinë për të organizuar programin dhe të kujdeset që mbrëmjet e shtëpisë po mbahen rregullisht.

Në vijim, një program i sugjeruar për mbrëmje familjare në shtëpi:

- Këngë e hapjes
- Lutje e hapjes
- Lexim i shkrimeve të shenjta
- Mësim
- Aktivitet
- Këngë e mbylljes
- Lutje e mbylljes
- Gostitje

Kur të përgatitni mësimet për mbrëmje familjare në shtëpi, mbani mend që t'iu bazoni në shkrimet e shenjta, mësimet e profetëve të ditëve të mëvonshme dhe në përvojat dhe dëshminë vetjake. Ky libër mund t'ju ndihmojë në përzgjedhjen e temave për mësim. Veç kësaj, mund t'ju lindë dëshira t'iu referoheni

## Mbretëri Çelestiale

botimeve të tjera si, për shembull: *Family Home Evening Resource Book* (numri i artikullit 31106), *Parimet e Ungjillit* (31110), *Libri Udhëzues i Familjes* (31180) dhe revistat e Kishës.

*Shih gjithashtu Familje*

## Mbretëri Çelestiale (Shih Mbretëri të Lavdisë)

### Mbretëri të Lavdisë

Nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit të gjithë njerëzit do të ringjallen (shih Alma 11:42-45). Pasi të ringjallemi, ne do të qëndrojmë përpara Zotit për t'u gjykuar (shih Zbulesa 20:12; 3 Nefi 27:14). Secilit do t'i caktohet një vendbanim i përjetshëm në një mbretëri të veçantë të lavdisë. Këtë parim na mësoi Zoti kur tha: “Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa” (Gjoni 14:2).

Ka tre mbretëri të lavdisë: mbretëria çelestiale, mbretëria terestriale dhe mbretëria telestiale. Lavdia që trashëgoni ju do të varet nga sa thellë jeni kthyer në besim, që shprehet me anë të bindjes ndaj urdhërimeve të Zotit. Ajo do të varet nga mënyra me të cilën e keni marrë “dëshminë e Jezusit” (DeB 76:51; shih gjithashtu vargjet 74, 79, 101).

### Mbretëria Çelestiale

Mbretëria çelestiale është më e larta nga të tre mbretëritë e lavdisë. Ata që i takojnë kësaj mbretërie, do të rrojnë përgjithmonë në prani të Perëndisë Atë dhe të Birit të Tij Jezu Krishti. Synimi juaj duhet të jetë ky: të trashëgoni lavdinë çelestiale dhe të ndihmoni që edhe të tjerët ta marrin atë bekim të madh. Një synim i tillë nuk arrihet me një të përpjekur; ai është rezultat i drejtësisë dhe i qëndrueshmërisë në këtë qëllim gjatë gjithë jetës.

Mbretëria çelestiale është vendi i përgatitur për ata që e “morën dëshminë e Jezusit” dhe që u bënë “të përsosur nëpërmjet Jezusit, ndërmjetësit të besëlidhjes së re, i cili e

kreu këtë shlyerje të përsosur nëpërmjet derdhjes së vetë gjakut të tij (DeB 76:51, 69). Që të trashëgojmë këtë dhuratë, duhet të marrim ordinancat e shpëtimit, të mbajmë urdhërimet dhe të pendohemi për mëkatet tona. Për shpjegim të hollësishëm mbi ata që do të trashëgojnë lavdinë çelestiale, shih Doktrina e Besëlidhje 76:50-70, 92-96.

Në janar të vitit 1836, Profeti Jozef Smith mori një zbulësë që ia zhvilloi kuptimin mbi kërkesat për të trashëguar lavdinë çelestiale. Atij iu hapën qiejt dhe pa mbretërinë çelestiale. U mahnit kur pa atje vëllain e tij më të madh, Alvinin, megjithëse Alvini kishte vdekur përpara se të merrte ordinancën e pagëzimit. (Shih DeB 137:1-6.) Atëherë Profetit Jozef i erdhi zëri i Zotit:

“Të gjithë ata që vdiqën pa një dituri të këtij ungjilli, që do ta kishin pranuar atë, nëse do të ishin lejuar të qëndronin, do të jenë trashëgimtarë të mbretërisë çelestiale të Perëndisë;

Gjithashtu ata që do të vdesin që tani e tutje pa dituri për të, të cilët do ta kishin pranuar atë me gjithë zemër, do të jenë trashëgimtarë të asaj mbretërie;

Sepse unë, Zoti, do t’i gjykoj të gjithë njerëzit sipas punëve të tyre, sipas dëshirës së zemrave të tyre” (DeB 137: 7-9).

Duke folur mbi këtë zbulësë, Profeti Jozef tha: “Unë gjithashtu vura re se të gjithë fëmijët që vdesin përpara se të arrinin vitet e përgjegjshmërisë së tyre, shpëtohen në mbretërinë çelestiale të qiellit” (DeB 137:10).

Nga një tjetër zbulësë që iu dha Profetit Jozef, mësojmë se ka tre nivele brenda mbretërisë çelestiale. Që të ekzaltohemi në nivelin më të lartë dhe për të vazhduar marrëdhëniet familjare përjetësisht, ne duhet të hyjmë në “besëlidhjen e re dhe të përjetshme të martesës” dhe t’i jemi të vërtetë asaj besëlidhjeje. Me fjalë të tjera, martesë në tempull përbën një kërkesë për të fituar nivelin më të lartë të lavdisë çelestiale. (Shih DeB 131:1-4.) Të gjithë ata që janë të denjë të hyjnë në besëlidhjen e re e të përjetshme të martesës, do t’u jepet kjo mundësi qoftë në këtë jetë, qoftë në tjetrën.

## Mbretëria Terrestriale

Ata që trashëgojnë lavdinë terestriale, do të “marrin nga prania e Birit, por jo nga plotësia e Atit. Prandaj, ata janë trupa tokësorë e jo trupa çelestialë dhe ndryshojnë në lavdi si hëna ndryshon nga dielli” (DeB 76:77-78). Duke folur në përgjithësi, personat në mbretërinë terestriale do të jenë njerëz të nderuar “të cilët ishin të verbuar nga dredhitë e njerëzve” (DeB 76:75). Ky grup do të përfshijë anëtarë të Kishës të cilët nuk qenë “të guximshëm në dëshminë e Jezusit” (DeB 76:79). Gjithashtu përfshihen ata që mohuan mundësinë për të marrë ungjillin në jetën e vdekshme, por që e morën më vonë në botën e shpirtave pas vdekjes (shih DeB 76:73-74). Për të mësuar më tepër për ata që do të trashëgojnë lavdinë terestriale, shih Doktrina e Besëlidhje 76:71-80, 91, 97.

## Mbretëria Telestiale

Lavdia telestiale do të ruhet për personat që “nuk e pranuan ungjillin e Krishtit, as dëshminë e Jezusit” (DeB 76:82). Këta persona do ta marrin lavdinë e tyre pasi të shpengohen nga burgu shpirtëror, që hera-herës quhet ferr (shih DeB 76:84, 106). Një shpjegim i hollësishëm për ata që do të trashëgojnë lavdinë telestiale, gjendet në Doktrina e Besëlidhje 76:81-90, 98-106, 109-112.

## Mallkimi i Përrjetshëm

Disa njerëz nuk do të jenë të denjë të banojnë në asnjë mbretëri të lavdisë. Ata do të quhen “bijtë e humbjes” dhe do të duhet të “[durojnë] një mbretëri që nuk është një mbretëri lavdie (DeB 76:32; 88:24). Ky do të jetë rangu i “[atyre] që e njohin fuqinë [e Perëndisë] dhe janë bërë pjesëmarrës të saj, dhe lejuan vetë përmes fuqisë së djallit të mposhteshin dhe të mohonin të vërtetën e të kundërshtonin fuqinë [e Perëndisë]” (DeB 76:31; shih gjithashtu vargjet 30, 32-49).

Referime shtesë: 1 Korintasve 15:40-42; DeB 88:20-39; 130:18-19

*Shih gjithashtu* Ferr; Jetë e Përjetshme; Plani i Shpëtimit; Qiell; Shlyerja e Jezu Krishtit

**Mbretëri Telestiale** (*Shih* Mbretëri të Lavdisë)

**Mbretëri Terrestriale** (*Shih* Mbretëri të Lavdisë)

## Mëkat

Kur ne me vullnetin tonë nuk u bindemi urdhërimeve të Perëndisë, ne bëjmë mëkat. Ne gjithashtu bëjmë mëkat kur nuk arrijmë të veprojmë drejt, pavarësisht nëse dimë për të vërtetën (shih Jakobi 4:17 [Bibla]).

Zoti ka thënë se Ai “nuk mund ta [shohë] mëkatin as me shkallën më të vogël të lejimit” (DeB 1:31). Rrjedhoja e mëkatisht është tërheqja e Frymës së Shenjtë dhe, në përjetësi, është pamundësia për të jetuar në prani të Atit tonë Qiellor, sepse “asgjë e papastër nuk mund të jetojë me Perëndinë” (1 Nefi 10:21).

Secili nga ne ka thyer urdhërime ose ka dështuar në veprime sipas njohurisë që kemi për të vërtetën. Apostull Gjoni na mësoi: “Po të themi se jemi pa mëkat, gënjejmë vetveten dhe e vërteta nuk është në ne. Po t’i rrëfejme mëkatet tona, [Jezu Krishti] është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi” (1 Gjoni 1:8-9). Nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit, ne mund të pendohemi dhe të falemi për mëkatet tona.

Referime shtesë: Romakëve 3:23; 6:23; Alma 5:41-42; 11:37; Helamani 5:10-11; DeB 82:1-3; 88:34-35

*Shih gjithashtu* Bindje; Drejtësi; Falje; Mëshirë; Pendim; Shlyerja e Jezu Krishtit; Tundim; Vdekje Shpirtërore

## Mëkati Fillestar

Për arsye të Rënies së Adamit dhe Evës, të gjithë njerëzit jetojnë në gjendje të rënë, të veçuar nga Perëndia dhe të prek-



shëm nga vdekja fizike. Megjithatë, ne nuk fajësohemi për atë që shumë vetë e quajnë “mëkati fillestar”. Me fjalë të tjera, nuk bëhemi përgjegjës për shkeljen e Adamit në Kopshtin e Edenit. Profeti Jozef Smith tha: “Ne besojmë se njerëzit do të ndëshkohen për vetë mëkatet e tyre dhe jo për shkeljen e Adamit” (Nenet e Besimit 1:2).

Me Shlyerjen, Shpëtimtari pagoi çmimin për shkeljen në Kopshtin e Edenit (shih Moisiu 6:53). Ai na dha sigurinë e ringjalljes dhe premtimin që, në bazë të besnikërisë sonë, ne mund të kthehemi për të jetuar në prani të Atit Qiellor përgjithnjë.

*Shih gjithashtu Rënie*

## **Mësim i Shtëpisë** (*Shih Priftëri*)

## **Mësim i Vizitave** (*Shih Shoqatë e Ndihmës*)

## **Mësimdhënie e Ungjillit**

Zoti ka njoftuar: “Unë ju jap urdhërim që ju duhet t’ia mësoni njëri-tjetrit doktrinën e mbretërisë. I mësoni me zell dhe hiri im do të jetë me ju, që ju të udhëzoheni në mënyrë më të përsosur në teori, në parim, në doktrinë, në ligjin e ungjillit, në të gjitha gjërat që lidhen me mbretërinë e Perëndisë, të cilat janë të domosdoshme për ju për t’i kuptuar” (DeB 77-78).

Në dhënien e këtij urdhërimi, Zoti na jep një përgjegjësi të shenjtë. Ai gjithashtu na drejton tek mundësitë e panumërta për shërbim kuptimplotë. Pak përvoja të përjetuara krahasohen me gëzimin që vjen kur ndihmojmë të tjerët të mësojnë dhe të jetojnë ungjillin.

Ky urdhërim për mësimdhënie, ju drejtohet juve, edhe në qoftë se ju nuk keni një thirrje zyrtare si mësues. Ju keni mundësi të jepni mësim duke qenë anëtar i familjes, mësues shtëpie ose mësuese e vizitave dhe duke qenë madje koleg pune, fqinj dhe mik. Nganjëherë ju i mësoni të tjerët nëpër-

mjet fjalëve që keni përgatitur për të thënë. Ndonjëherë ju mund të përfitoni nga çastet e paplanifikuara ku mund të tregoni për të vërteta nga ungjilli. Më shpesh, ju i mësoni të tjerët nëpërmjet shembullit.

T'u Mësosh si Shpëtimtari.

Në përpjekjet tuaja për mësimdhënie të ungjillit, shikoni Jezu Krishtin si shembull. Studioni përmbledhjet e shërbesës së Tij të vdekshme dhe kërkoni mundësi që të mësoni si Ai. Ai tregoi dashuri dhe shqetësim të sinqertë për ata të cilëve u shërbeu. Ai i forconte njerëzit individualisht, duke iu mësuar parimet e ungjillit në një mënyrë që do t'i ndihmonte ata në nevojat e tyre të veçanta. Tek disa Ai zgjoi dëshirën për të kuptuar dhe jetuar ungjillin. Herë pas here Ai u bënte pyetje të cilat do t'i ndihmonin të zbatonin në jetë atë që kishin mësuar. Ai u mësoi të vërtetat shpëtuese të ungjillit, duke ndihmuar dëgjuesit e Tij të kuptonin atë që duhet të dinin, që duhet të bënin dhe që duhet të ishin, në mënyrë që të merrnin dhuratën e jetës së përjetshme.

Ndërsa ndiqni shembullin e Shpëtimtarit, mësimdhënia juaj do të ushqejë dhe do të ngrejë lart të tjerët, do të forcojë besimin e tyre dhe do t'u japë atyre sigurinë për t'u përballur me vështirësitë e jetës. Do t'i nxisë të braktisin mëkatin dhe t'u binden urdhërimeve. Do t'i ndihmojë të vijnë tek Krishti dhe të qëndrojnë në dashurinë e Tij.

Mësimdhënia nëpërmjet Shpirtit

Zoti tha: "Shpirti do t'ju jepet me anë të lutjes së besimit; dhe nëse nuk e merrni Shpirtin, ju s'duhet të jepni mësim" (DeB 42:14). Shpirti, ose Fryma e Shenjtë, është një anëtar i Kreut-Perëndi. Një nga qëllimet e Shpirtit është të "tregojë të vërtetën . . . e të gjitha gjërave" (Moroni 10:4-5). Vetëm nëpërmjet ndikimit të Shpirtit, mësimdhënia e ungjillit mund të jetë ndërtuese dhe frymëzuese.

Privilegji juaj si mësues ungjilli është të jeni mjete nëpërmjet të cilit Fryma e Shenjtë mund të mësojë, të dëshmojë, të ngushëllojë dhe të frymëzojë. Ashtu si mësoi profeti Nefi: “Kur një njeri flet nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, fuqia e Frymës së Shenjtë e çon atë në zemrat e fëmijëve të njerëzve” (2 Nefi 33:1).

Në qoftë se ju përgatiteni shpirtërisht, Fryma e Shenjtë do t’ju ndihmojë që të dini ç’të bëni dhe ç’të thoni në mësimdhënien tuaj. Ju mund të përgatiteni duke u lutur shpesh, duke i studiuar shkrimet e shenjta, duke e jetuar ungjillin dhe duke qenë i përlurur.

### Metodat e Mësimdhënies

Mësimdhënia juaj do të jetë më efikase kur përdorni një shumëllojshmëri metodash të përshtatshme. Për shembull, ju mund të thoni tregime dhe shembuj për t’i mbajtur njerëzit të vëmendshëm dhe për të treguar se si aplikohen në jetën e përditshme parimet e ungjillit. Ju mund të përdorni fotografi dhe objekte për të forcuar kuptimin e të tjerëve për historitë në shkrimet e shenjta dhe për parimet e ungjillit. Nëpërmjet muzikës, ju dhe ata të cilët mësoni mund të ftoni ndikimin e Frymës së Shenjtë dhe mund të shprehni ndjenja që mund të jetë e vështirë për t’i shprehur në tjetër mënyrë. Mund t’u bëni pyetje që nxisin marrjen e mësimi dhe diskutime në një mënyrë të mendueshme e që çojnë në tregimin e përshtatshëm të përvojave vetjake. Me veprimtari të thjeshta, mund t’i ndihmoni ata që po mësojnë, ta përqendrojnë vëmendjen.

Kur mendoni të përdorni një metodë mësimdhënieje të caktuar, bëjini vetes pyetjet e mëposhtme: Kjo metodë a do të ftojë ndikimin e Shpirtit? A përkon me shenjtërinë e parimeve të cilat po u mësoj? A do t’i ngrejë moralisht dhe t’i forcojë ata që i mësoj?

Mbani mend se, duke qenë një mësues ungjilli, ju përfaqësoni Zotin. Sigurohuni që çdo gjë që thoni dhe që bëni, të tregojë nderim dhe të jetë në përputhje me vullnetin e Tij.

Për më shumë sugjerime mbi mësimdhënien e ungjillit, mund t'ju lindë dëshira t'i drejtoheni botimeve: *Teaching, No Greater Call* (36123); *Libri Udhëzues i Mësimdhënies* (34595); dhe "Gospel Teaching and Leadership", seksioni 16 i *Church Handbook of Instructions, Book 2: Priesthood and Auxiliary Leaders* (35903).

Referime shitesë: Mosia 18:19; Alma 1:26; 17:2-3; 31:5; DeB 11:21

## Mëshirë

Ati ynë Qiellor i njej dobësitë dhe mëkatet tona. Ai shfaq mëshirë ndërsa na fal mëkate dhe na ndihmon që të kthehemi për të jetuar në prani të Tij.

Një dhembshuri e tillë mund të duket sikur bie ndesh me ligjin e drejtësisë, i cili kërkon që asgjë e papastër të mos lejohet të jetojë me Perëndinë (shih 1 Nefi 10:21). Por Shlyerja e Jezu Krishtit bëri të mundur që Perëndia "të jetë një Perëndi i përsosur, i drejtë dhe gjithashtu një Perëndi i mëshirshëm" (Alma 42:15).

### Marrja e Mëshirës së Perëndisë

Shpëtimtari i kënaqi kërkesat e drejtësisë kur u vu në vendin tonë dhe vuajti ndëshkimin për mëkatet tona. Për shkak të këtij veprimi vetmohues, Ati me mëshirë mund ta ndalë ndëshkimin tonë dhe të na mirëpresë tek prania e Tij. Që të marrim faljen e Zotit, duhet të pendo kemi me sinqeritet për mëkatet tona. Ashtu siç mësoi Alma, "drejtësia ushtron të gjitha kërkesat e saj dhe gjithashtu mëshira kërkon gjithçka që është e saj; dhe kështu, askush përveç të penduarve të vërtetë, nuk shpëton" (Alma 42:24; shih gjithashtu vargjet 22-23, 25).

Falja e mëkatit nuk është e vetmja dhuratë e mëshirës nga Ati Qiellor dhe Jezu Krishti. Çdo bekim që merrni është vepër e mëshirës, më tepër nga ç'mund të meritoni vetë ndonjëherë. Mormoni mësoi: "Të gjitha gjërat që janë të mira,

vijnë nga Krishti; përndryshe njerëzit do të kishin rënë dhe asgjë e mirë nuk do të mund t'u vinte atyre" (Moroni 7:24). Për shembull, ju bëheni një marrës i mëshirës hyjnore kur Ati Qiellor i dëgjon e u përgjigjet lutjeve tuaja, kur merrni udhëzim nga Fryma e Shenjtë dhe kur shëroheni nga sëmundja nëpërmjet fuqisë së priftërisë. Edhe pse bekime të tilla vijnë si rezultat i bindjes tuaj, ju kurrë nuk do të mund t'i merrnit vetëm me anë të përpjekjeve tuaja. Ato janë dhurata të mëshirshme nga një Atë i përzemërt dhe i dhembshur.

### T'u Shfaqim Mëshirë të Tjerëve

Duke u folur dishepujve të Tij, Shpëtimtari urdhëroi: "Jini të mëshirshëm . . . sikurse edhe Ati juaj është i mëshirshëm" (Lluka 6:36). Ju mund ta ndiqni shembullin mëshirës së Atit tuaj Qiellor në marrëdhëniet me të tjerët. Mundohuni ta çlironi jetën tuaj nga arroganca, krenaria dhe mendjemadhësia. Kërkoni mënyra që të jeni i dhembshur, respektues, falës, bujar dhe i duruar edhe kur jeni i vetëdijshtëm për të metat e të tjerëve. Kur veproni kështu, shembulli juaj do bëjë të tjerët të jenë më të mëshirshëm dhe ju do të pretendoni për më tepër mëshirë nga Perëndia.

Referime shtesë: Mateu 5:7; Lluka 10:25-37; Alma 34:14-16

*Shih gjithashtu* Dashuri Hyjnore; Drejtësi; Falje; Hir

## **Mijëvjeçar**

Mijëvjeçari është një periudhë prej 1000 vjetësh. Kur flasim për "Mijëvjeçarin", e lidhim me 1000 vjetët që pasojnë Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit (shih Zbulesa 20:4; DeB 29:11). Gjatë Mijëvjeçarit "Krishti do të mbretërojë personalisht mbi tokë" (Nenet e Besimit 1:10).

Mijëvjeçari do të jetë një kohë drejtësie dhe paqeje mbi tokë. Zoti ka zbuluar se "në atë ditë armiqësia e njeriut dhe armiqësia e bishave, po, armiqësia e gjithë mishit, do të largohet" (DeB 101:26; shih gjithashtu Isaia 11:6-9). Satani do

të “lidhet që ai të mos ketë vend në zemrat e fëmijëve të njerëzve” (DeB 45:55; shih gjithashtu Zbulesa 20:1-3).

Gjatë Mijëvjeçarit të gjithë njerëzit mbi tokë do të jenë të mirë dhe të drejtë, por shumë vetë nuk do ta kenë marrë plotësinë e ungjillit. Si pasojë, anëtarët e Kishës do të marrin pjesë në punën misionare.

Gjithashtu anëtarët e Kishës do të marrin pjesë në punën e tempullit gjatë Mijëvjeçarit. Shenjtorët do të vazhdojnë të ndërtojnë tempuj dhe të marrin ordiancat në emër të farefisit të tyre të vdekur. Duke u udhëhequr me anë të zbulesës, ata do të përgatisin regjistra për paraardhësit e tyre nga fundi deri në fillim tek Adami dhe Eva.

Drejtesia dhe paqja e plotë do të vazhdojnë deri në fund të 1000 vjetëve, kohë kur Satani “do të zgjidhet për një stinë të vogël, që ai të mund të mbledhë së bashku ushtritë e tij”. Ushtritë e Satanit do të luftojnë kundër armatave të qiellit, të cilat do të udhëhiqen nga Mikaeli ose Adami. Satani dhe ndjekësit e tij do të munden dhe do të dëbohen përgjithmonë. (Shih DeB 88:111-115.)

Referime shtesë: DeB 45:55-59; 101:22-34; 133:25

*Shih gjithashtu Ardhja e Dytë e Jezu Krishtit*

## Mirënjohje

Zoti ka premtuar: “Ai që i pranon të gjitha gjërat me falënderim, do të bëhet i lavdishëm” (DeB 78:19). Mirënjohja është një gjendje ngritëse, madhëruese. Mbase ju mund ta thoni nga përvoja që jeni më të lumtur kur keni mirënjohje në zemër. Nuk mund të jeni i acaruar, në mëri ose shpirtlig kur jeni mirënjohës.

Jini falënderues për bekimet e mrekullueshme që keni vetë. Jini mirënjohës për mundësitë e pallogaritshme që keni. Jini falënderues për prindërit tuaj. Ua bëni të ditur mirënjohjen tuaj. Falënderoni miqtë dhe mësuesit tuaj. Shprehjani vlerësimin cilitdo që ju bën nder ose ju ndihmon në ndonjë mënyrë.

Falenderoni Atin tuaj Qiellor për mirësinë e Tij ndaj jush. Perëndisë mund t'ia shprehni mirënjohjen duke e njohur në gjithçka dorën e Tij, duke e falënderuar për të gjitha ato që ju jep, duke mbajtur urdhërimet e Tij e duke u shërbyer të tjerëve. Falënderojeni për Birin e Tij të Dashur, Jezu Krishtin. Shprehni falënderime për shembullin e madh të Shpëtimtarit, për mësimet e Tij, për shtrirjen pa kufi të dorës së Tij për të ngritur dhe ndihmuar, për Shlyerjen e Tij të pafundme.

Falënderoni Zotin për Kishën e Tij të rivendosur. Falënderojeni për gjithçka që ju ofron ajo. Falënderojeni për miqtë dhe për familjen. Shpirti falënderues le t'i udhëheqë dhe le t'i bekojë të gjitha ditët e netët tuaja. Punoni në drejtim të mirënjohjes. Do të zbuloni se ajo prodhon rezultate të mrekullueshme.

Referime shitesë: Psalmet 100:3-4; Lluca 17:11-19; Mosia 2:19-22; Alma 34:38; DeB 59:7

## **Mirëqenie**

Çdo anëtar i Kishës ka dy përgjegjësi themelore për mirëqenien: të bëhet mbështetës i vetvetes dhe të kujdeset për të varfërit dhe nevojtarët.

Prindërit kanë përgjegjësinë e shenjtë të kujdesen për mirëqenien fizike dhe shpirtërore të fëmijëve të tyre. Ndërsa fëmijët rriten në moshë, atyre u shtohet përgjegjësia për mirëqenien e tyre. Prindërit duhet t'u mësojnë atyre parimet themelore të mirëqenies, duke i ndihmuar ata të mbështeten tek vetja e të sigurojnë në të ardhmen gjërat për familjet e tyre. Prindërit gjithashtu mund t'u japin fëmijëve mundësi që të ndihmojnë në përkujdesjen për të varfërit dhe nevojtarët.

Në qoftë se jeni anëtar i rritur i Kishës, të gjitha këshillat e mëposhtme gjejnë tek ju zbatim të drejtpërdrejtë. Në qoftë se jeni i ri ose e re, shumë nga këto këshilla gjejnë zbatim tek ju gjithashtu, megjithëse ju akoma vareni shumë nga prindërit.

## Duke u Mbështetur tek Vetja

Përgjegjësia për mirëqenien tuaj shoqërore, emocionale, shpirtërore, fizike dhe ekonomike qëndron në radhë të parë mbi ju, së dyti, mbi familjen tuaj dhe së treti, mbi Kishën. Nën frymëzimin e Zotit dhe nëpërmjet përpjekjeve tuaja, ju duhet të siguroni për vete dhe për familjen tuaj nevojat shpirtërore dhe ato të jetës.

Jeni në gjendje të kujdeseni më shumë për veten dhe për familjen atëherë kur mbështeteni tek vetja. Ndoshteni i përgatitur për të përballuar kohë të vështira pa u varur tek të tjerët.

Ju mund ta mbështetni veten: (1) duke përfituar nga mundësitë e edukimit; (2) duke praktikuar parime të shëndosha të të ushqyerit dhe të higjenës; (3) duke u përgatitur dhe duke zënë një punë të përshtatshme; (4) duke ruajtur një rezervë ushqimesh dhe veshjesh në masën që lejon ligji; (5) duke i përdorur me zgjuarsuri burimet tuaja, duke përfshirë pagimin e së dhjetës e të ofertave dhe shmangien e borxheve; dhe (6) duke zhvilluar forcë shpirtërore, emocionale dhe shoqërore.

Në mënyrë që të mbështeteni tek vetja, duhet të jeni i gatshëm të punoni. Zoti na ka urdhëruar të punojmë (shih Zanafilla 3:19; DeB 42:42). Puna e ndershme është burimi themelor i lumturisë, i vlerësimit për veten dhe i përparimit.

Nëse përkohësisht jeni i paaftë për të përballuar nevojat themelore me përpjekjet vetjake ose me ndihmën e anëtarëve të familjes, Kisha mund të jetë në gjendje t'ju ndihmojë. Në këto situata, Kisha shpesh siguron burimet jetike, që t'ju ndihmojë ju dhe familjen tuaj të bëheni përsëri mbështetës të vetes.

## Përkujdesja për të Varfërit dhe Nevojtarët

Zoti gjithmonë i ka urdhëruar njerëzit e Tij të kujdesen për të varfërit dhe nevojtarët. Ai tha: "Ju duhet të vizitoni të varfërit e nevojtarët dhe të administroni në ndihmë të tyre" (DeB 44:6). Ai urdhëroi gjithashtu: "Kujtoni në gjithçka të varfërit dhe nevojtarët, të sëmurët dhe të brengosurit, sepse ai



që nuk i bën këto gjëra, po ai nuk është dishepulli im" (DeB 52:40).

Mund të kujdeseni për të varfërit dhe nevojtarët në shumë mënyra. Një mënyrë e rëndësishme është nëpërmjet agjërimit dhe dhënies së ofertave të agjërimit, të cilat peshkopi ose presidenti i degës i përdor për të ndihmuar anëtarët e lagjes ose degës të cilët vuajnë nga varfëria, sëmundjet ose mundime të tjera. Ju gjithashtu mund të jepni prej kohës suaj dhe të përdorni talentet tuaja. Ju mund t'u shërbeni të pastrehëve, të gjymtuarve, të vejave dhe të tjerëve nga fqinjësia dhe komuniteti juaj.

Përveç dhënies së përkujdesjes në mënyrë lokale dhe individuale për ata në nevojë, Kisha u afrohet në nivel mbarëbotëror njerëzve, pavarësisht nga besimi i tyre fetar, të cilët vuajnë pasojat e katastrofave natyrore, të varfërisë, sëmundjeve dhe krizave të tjera. Kisha siguron burimet më jetike, që të ndihmojë familje dhe individë të marrin veten e të punojnë drejt vetëmbështetjes. Dhurimet për Fondin e Qarkullueshëm Arsimor të Kishës sigurojnë mjetet që shenjtorët e ditëve të mëvonshme në gjendje të pafavorshme të çojnë më tej arsimimin e tyre. Misionarë në shërbim të Kishës japin vullnetarisht kohën dhe burimet e tyre për të luftuar analfabetizmin, për të ndihmuar shëndetësinë dhe për të siguruar trajnim.

Referime shtesë: Jakobi 1:27; Jakobi 2:17-19 [LiM]; DeB 42:31; 104:15-18

*Shih gjithashtu Agjërimit dhe Oferta Agjërimit; Shërbim*

## **Ndërgjegje**

Të gjithë njerëzit lindin me aftësinë për të shquar midis së drejtës dhe së gabuarës. Kjo aftësi, e quajtur ndërgjegje, është manifestim i Dritës së Krishtit (shih Moroni 7:15-19).

Ndërgjegjja juaj është një mbrojtje për t'ju ndihmuar të rriini larg situatave që janë shpirtërisht dëmtoese. Kur u bindeni urdhërimeve dhe merrni vendime të drejta, ju përjetoni paqe të ndërgjegjes.

Kur mëkatoni, ndjeni keqardhje ose faj, pikërisht ashtu siç ndjeni dhimbje fizike kur merrni plagë. Kjo është përgjigjja e natyrshme e ndërgjegjes suaj ndaj mëkatit dhe kjo mund t'ju çojë të pendoheni.

Pendimi dhe falja e ripërtërijnë paqen e ndërgjegjes suaj. Nga ana tjetër, nëse zgjidhni të mos përfillni ndërgjegjen tuaj dhe nuk pendoheni, ndërgjegjja juaj do të humbasë aftësinë, sikur të ishte “damkosur” (1 Timoteut 4:2).

Mësoni të ndiqni ndërgjegjen. Kjo është një pjesë e rëndësishme e ushtrimit të lirisë së zgjedhjes. Sa më shumë e ndiqni ndërgjegjen tuaj, aq më e fortë do të bëhet ajo. Një ndërgjegje e ndjeshme është shenjë e një shpirti të shëndetshëm.

Referime shitesë: Mosia 4:1-3; DeB 84:45-47

*Shih gjithashtu* Bindje; Dritë e Krishtit; Liri e Zgjedhjes; Tundim

## Nderim

Nderimi është respekt dhe dashuri e thellë. Kur ju keni qëndrim nderues kundrejt Perëndisë, ju e nderoni Atë, i shprehni mirënjohjen tuaj dhe i bindeni urdhërimeve të Tij.

Duhet të jeni nderues në sjellje si edhe në qëndrime. Sjellja nderuese përfshin lutjen, studimin e shkrimeve të shenjta, agjërimin dhe pagimin e të dhjetave dhe të ofertave. Ajo përfshin veshjen e rrobave të thjeshta dhe përdorimin e gjuhës së pastër e të moralshme. Thellësia e nderimit që keni duket në zgjedhjen e muzikës e të argëtimit të tjera, në mënyrën si shpreheni për çështje të shenjta dhe në mënyrën si visheni e si veproni kur frekuentoni kishën dhe tempullin. E tregoni nderimin për Zotin atëherë kur u shërbeni njerëzve të tjerë dhe kur i trajtoni me dashamirësi e respekt.

Kur bëheni edhe më nderues, do të vini re një shndërrim të heshtur në jetën tuaj. Zoti do të derdhë Shpirtin e Tij mbi ju më me bollëk. Do të jeni më pak i shqetësuar dhe më pak i hutuar. Do të jeni në gjendje të merrni zbulesë në ndihmë të zgjedhjes së problemeve vetjake dhe familjare.

Në të njëjtën mënyrë që nderimi ju sjell më pranë Perëndisë, po ashtu mungesa e nderimit i shkon për shtat kundërshtarit të Tij. Satani do t'ju tundojë që të ndiqni prirjen e përhapur të botës për më tepër zhurmë, nxitje emocionesh e grindje dhe për më pak vetëpërmbytje e denjësi të heshtur. Ashtu si një komandant që përgatit pushtimin ushtarak, ai do të përpiqet të bllokojë rrugët që ju lidhin juve me Zotin. Ruhuni nga taktikat e tilla dhe mundohuni që të jeni nderues në gjithçka që bëni.

Referime shitesë: Levitiku 26:2; Psalmet 89:5-7; Hebrejve 12:28; DeB 59:21; 63:61-62, 64; 109:21

*Shih gjithashtu* Adhurim; Besim; Lutje; Mirënjohje; Thjeshtësi; Zbulesë

## **Ndershmëri**

Neni i trembëdhjetë i besimit bën të ditur: “Ne besojmë në qenien të ndershëm”. Të jesh i ndershëm do të thotë të jesh kurdoherë i sinqertë, i çiltër dhe pa mashtrim.

Kur jeni i ndershëm në çdo drejtim, ju jeni në gjendje të gëzoni paqe në mendime dhe të ruani respektin për veten. Ju ndërtoni forcën e tiparit moral, e cila ju lejon të jeni në shërbim të Perëndisë dhe të të tjerëve. Ju meritoni besimin në sy të Perëndisë e të atyre që keni përreth.

Nga ana tjetër, në rast se jeni i pandershëm në fjalë ose në mendime, ju cenoni veten dhe shpesh lëndoni edhe të tjerët. Në qoftë se gënjeni, vidhni, jeni hileqar ose nuk përfillni që të punoni aq sa jua kërkon paga, ju e humbni respektin për veten. E humbni udhëheqjen e Frymës së Shenjtë. Ju mund të mësoni se i keni dëmtuar marrëdhëniet me anëtarët familjes e me miqtë dhe se njerëzit nuk ju zënë më besë.

Të jesh i ndershëm kërkon shpesh guxim e sakrificë, sidomos atëherë kur të tjerët përpiqen t'ju bindin që të gjesh arsye në sjelljen e pandershme. Në rast se gjendeni në një situatë të tillë, mbani mend se paqja e qëndrueshme që vjen duke qenë i ndershëm, vlen më shumë se lehtësimi i çastit duke ndjekur turmën.

Referime shitesë: Eksodi 20:16; 2 Nefi 9:34; DeB 97:8

## Nene të Besimit

Nenet e Besimit përvijojnë 13 çështje bazë të besimit mes anëtarëve të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Profeti Jozef Smith në fillim i shkroi ato në një letër drejtuar Xhon Uentuërthit, një botuesi gazete, në përgjigje të kërkesës së z. Uentuërth për të ditur se çfarë besonin anëtarët e Kishës. Më pas ato u nxorën në botimet periodike të Kishës. Tashmë ato konsiderohen si shkrim i shenjtë dhe përmbahen në Perlën me Vlerë të Madhe.

**Ngushëllues** (*Shih Fryma e Shenjtë*)

## Ordinanca

Në Kishë, një ordiancë është një akt i shenjtë e zyrtar që kryhet nëpërmjet autoritetit të priftërisë. Disa ordianca janë thelbësore për ekzaltimin tonë. Këto ordianca quhen ordianca shpëtuese. Ato përfshijnë pagëzimin, konfirmimin, shugurimin e Priftërisë Melkizedeke (për burrat), indau-mentin e tempullit dhe vulosjen e martesës. Në secilën prej këtyre ordiancave ne hyjmë në besëlidhje solemne me Zotin.

Ordiancat e tjera, si vënia e emrit dhe bekimi i fëmijëve, përkushtimi i vajit dhe administrimi i të sëmurëve dhe të pikëlluarve kryhet po ashtu me autoritetin e priftërisë. Megjithëse ato nuk janë themelore në shpëtimin tonë, janë të rëndësishme për lehtësimin, udhëzimin dhe nxitjen tonë.

Ordiancat dhe besëlidhjet na ndihmojnë që të kujtojmë se cilët jemi. Na kujtojnë për detyrën ndaj Perëndisë. Zoti na i ka siguruar me qëllim që të na ndihmojë të vijmë tek Ai dhe të marrim jetë të përjetshme. Kur i nderojmë ato, Ai na forcon.

Mund t'ju jepen shumë raste për të marrë pjesë në ordiancat e priftërisë. Kurdoherë që të keni raste të tilla, bëni gjithçka të mundur që të përgatiteni, qoftë kur kryeni

ordinancën, qoftë kur e merrni atë. Mund të përgatiteni duke u lutur, agjëruar, duke u këshilluar me udhëheqësit e priftërisë e duke studiuar shkrimet e shenjta dhe fjalët e profetëve të ditëve të mëvonshme. Në rast se jeni mbajtës i priftërisë, duhet që përherë të përgatiteni shpirtërisht në kryerjen e një ordinance. Jetoni jetë të pastër, të denjë dhe mundohuni të merrni shoqërimin e pandryshueshëm të Frymës së Shenjtë.

Referime shtesë: DeB 84:19-21; Nenet e Besimit 1:3-5

*Shih gjithashtu* Besëlidhje; Priftëri; Ungjill

## Pagëzim

Libri i Mormonit tregon për një grup njerëzish që mësuan ungjillin dhe u pagëzuan tek një vend i quajtur Mormon. Që nga koha e pagëzimit të tyre, ata e vështronin Mormonin si një vend bukurie, sepse, ndërsa ishin atje, ata “erdhën . . . në njohurinë e Shëlbuesit të tyre” (Mosia 18:30). Të fuqizuar prej dëshmimeve të tyre dhe besëlidhjeve të pagëzimit, ata i qëndruan besnikë Zotit, madje në kohë provash të forta (shih Mosia 23-24).

Ashtu si njerëzit në këtë përmbledhje të Librit të Mormonit, ju mund të gëzoheni kur kujtoni besëlidhjen tuaj të pagëzimit dhe premtimet e Zotit ndaj jush. Ju mund të gjeni forcë në ordinancën e pagëzimit, qoftë nëse u pagëzuat së fundi apo shumë vite më parë.

### Hyrja në Shtegun drejt Jetës së Përjetshme

Pagëzimi është ordinance e parë shpëtuese e ungjillit (shih Nenet e Besimit 1:4). Nëpërmjet pagëzimit dhe konfirmimit nga autoriteti i priftërisë, ju bëheni anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Kur u pagëzuat treguat gatishmërinë tuaj për të ndjekur shembullin e Shpëtimtarit. Ai gjithashtu u pagëzua, madje edhe pse ishte pa mëkat. Ashtu siç i shpjegoi Gjon Pagëzorit, Atij i duhej të pagëzohej, në mënyrë që të “[përmbushte] çdo drejtësi” (shih Mateu 3:13-17).

Gjithkush që kërkon jetë të përjetshme, duhet ta ndjekë shembullin e Shpëtimtarit duke u pagëzuar dhe duke marrë dhuratën e Frymës së Shenjtë. Profeti Nefi tha se Shpëtimtari na paraqiti “portën nëpër të cilën [ne] duhet të [hyjmë]. Pasi porta nëpër të cilën [ne] duhet të [hyjmë] është pendimi dhe pagëzimi me anë të ujit; dhe pastaj vjen një heqje e mëkateve [tona] me anë të zjarrit dhe me anë të Frymës së Shenjtë. Dhe atëherë [ne jemi] në këtë shteg të ngushtë dhe të ngushtuar që të çon në jetën e përjetshme” (2 Nefi 31:17-18). Ne do të marrim jetë të përjetshme nëse durojmë deri në fund, duke mbajtur besëlidhjet tona dhe duke marrë ordinancat e tjera të shpëtimit.

### Pagëzimi në Mënyrën e Zotit

Shpëtimtari ia zbuloi mënyrën e vërtetë të pagëzimit Profetit Jozef Smith, duke bërë të qartë se ordinanca duhet të kryhet nga një që ka autoritetin e priftërisë dhe se ajo duhet bërë me zhytje:

“Personi që thirret nga Perëndia dhe ka autoritet nga Jezu Krishti të pagëzojë, duhet të zbresë në ujë me personin që është paraqitur për pagëzim dhe duhet të thotë duke e thirrur atë me emër: Duke qenë i autorizuar nga Jezu Krishti, unë të pagëzoj në emër të Atit dhe të Birit, dhe të Frymës së Shenjtë. Amen.

Më pas ai duhet ta zhysë atë në ujë dhe ta nxjerrë përsëri nga uji” (DeB 20:73-74).

Zhytja është simbolike për vdekjen e jetës mëkatore të një personi dhe rilindjen e tij drejt një jete shpirtërore, të përku-shtuar në shërbim të Perëndisë dhe të fëmijëve të Tij. Ajo gjithashtu është simbolike për vdekjen dhe ringjalljen. (Shih Romakëve 6:3-6.)

### Fëmijët e Vegjël dhe Pagëzimi

Nga zbulesa e ditëve të mëvonshme, ne dimë se fëmijët e vegjël shëlbohen me anë të mëshirës së Jezu Krishtit. Zoti tha:

“Ata nuk mund të mëkatojnë, sepse fuqi nuk i është dhënë Satanit për t’i tunduar fëmijët e vegjël, derisa ata fillojnë të bëhen të përgjegjshëm para meje” (shih DeB 29:46-47). Ata nuk duhet të pagëzohen derisa të arrijnë moshën e përgjegjësisë, të cilën Zoti ka bërë të njohur që është tetë vjeç (shih DeB 68:27; Përkthimi i Jozef Smithit, Zanafilla 17:11). Cilido që pretendon se fëmijët e vegjël kanë nevojë për pagëzim, “mohon mëshirën e Krishtit dhe përçmon flijimin e tij dhe fuqinë e shëlbimit të tij” (Moroni 8:20; shih gjithashtu vargjet 8-19, 21-24).

### Besëlidhja Juaj e Pagëzimit

Kur u pagëzuat ju hytë në besëlidhje me Perëndinë. Premtuat të merrni mbi vete emrin e Jezu Krishtit, të mbani urdhërimet e Tij dhe t’i shërbeni Atij deri në fund (shih Mosia 18:8-10; DeB 20:37). Ju e përtërinini këtë besëlidhje çdo herë që merrni sakramentin (shih DeB 20:77, 79).

*Marrja mbi Vete e Emrit të Jezu Krishtit.* Kur merrni mbi vete emrin e Jezu Krishtit, ju e shihni veten si të Tijin. Ju e vendosni Atë dhe punën e Tij në radhën e parë të jetës suaj. Ju kërkoni më tepër atë që dëshiron Ai, sesa atë që doni ju ose atë që ju mëson bota për të dashur.

Në Librin e Mormonit, Mbreti Benjamin shpjegon përse është e rëndësishme të marrësh emrin e Shpëtimtarit mbi vete:

“Nuk ka emër tjetër nëpërmjet të cilit të vijë shpëtimi; prandaj unë do të doja që ju të merrni mbi vete emrin e Krishtit, të gjithë ju që keni hyrë në besëlidhje me Perëndinë, se ju do të jeni të bindur deri në fund të jetës suaj.

Dhe do të ndodhë, që cilido që e bën këtë, do të gjendet në krahun e djathtë të Perëndisë, pasi ai do të dijë emrin me të cilin thirret; pasi ai do të thirret me emrin e Krishtit.

Dhe tani do të ndodhë, që kushdo që nuk do të marrë mbi vete emrin e Krishtit duhet të thirret me ndonjë emër tjetër; prandaj ai e gjen veten në krahun e majtë të Perëndisë” (Mosia 5:8-10).

*Mbajtja e Urdhërimeve.* Besëlidhja juaj e pagëzimit është zotim për të ardhur në mbretërinë e Perëndisë, duke u shkëputur nga bota dhe duke qëndruar si dëshmitar i Perëndisë “në të gjitha kohërat dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet” (Mosia 18:9). Përpyekjet tuaja për të qëndruar dëshmitar i Perëndisë përfshijnë çdo gjë që bëni dhe thoni. Mundohuni gjithmonë të kujtoni dhe të mbani urdhërimet e Zotit. Mbajini të pastra mendimet, gjuhën dhe veprimet tuaja. Kur kërkoni argëtime, si: filma, televizion, internet, muzikë, libra, revista dhe gazeta, kini kujdes që të shikoni, të dëgjoni dhe të lexoni vetëm ato gjëra që ndërtojnë. Vishuni thjeshtë. Zgjidhni shokë që ju inkurajojnë në arritjen e synimeve tuaja të përjetshme. Qëndroni larg imoralitetit, pornografisë, kumarit, duhanit, alkoolit dhe narkotikëve të ndaluar. Mbajeni veten të denjë të hyni në tempull.

*Shërbimi ndaj Zotit.* Urdhërimi për t’u shkëputur nga gjërat e botës nuk do të thotë se duhet të izoloheni nga të tjerët. Është pjesë e besëlidhjes së pagëzimit t’i shërbesh Zotit, dhe Atij i shërbeni më së miri atëherë kur u shërbeni të afërmeve tuaj. Kur profeti Alma mësoi për besëlidhjen e pagëzimit, tha se ne duhet të “[jemi] të gatshëm të [mbajmë] barrat e njëri-tjetrit, që ato të mund të jenë të lehta” dhe “të gatshëm të [vajtojmë] me ata që vajtojnë . . . dhe të [ngushëllojmë] ata që kanë nevojë të ngushëllohen” (Mosia 18:8-9). Jini i sjellshëm dhe me respekt ndaj të gjithë njerëzve, duke ndjekur shembullin e Jezu Krishtit në mënyrën me të cilën i trajtoni të tjerët.

### Bekimet e Premtuara të Pagëzimit

Kur i mbani besëlidhjet që keni bërë në pagëzim, Zoti do t’ju bekojë për besnikërinë tuaj. Disa nga bekimet që merrni janë shoqëria e qëndrueshme e Frymës së Shenjtë, heqja e mëkatëve tuaja dhe privilegji për t’u rilindur shpirtërisht.

*Shoqëria e Qëndrueshme e Frymës së Shenjtë.* Pasi u pagëzuat, një a më shumë mbajtës të autorizuar të Priftërisë



Melkizedeke vendosën duart e tyre mbi kokën tuaj dhe ju dhanë dhuratën e Frymës së Shenjtë. Kjo dhuratë ju jep të drejtën për shoqërinë e qëndrueshme të Frymës së Shenjtë sa kohë që jeni i denjë. Shoqëria e qëndrueshme e Shpirtit është një nga bekimet më të mëdha që mund të merrni në vdekshmëri. Shpirti do t'ju udhëzojë në shtigjet e drejtësisë dhe të paqes, duke ju udhëhequr drejt jetës së përvetshme.

*Heqja e Mëkateve.* Ngaqë jeni të pagëzuar, ju mund të merrni falje të mëkateve tuaja. Me fjalë të tjera, mund të faleni nëpërmjet mëshirës së Shpëtimtarit. Me këtë bekim, mund të lejoheni në fund që të jetoni në praninë e Atit Qiellor.

Që të marrësh heqjen e mëkateve tuaja, duhet të ushtrosh besim tek Jezu Krishti, të pendohesh sinqerisht dhe të mundohesh gjithnjë t'i mbash urdhërimet. Profeti Mormoni mësoi: "Fryti i parë i pendimit është pagëzimi; dhe pagëzimi vjen nëpërmjet besimit në plotësimin e urdhërimeve; dhe plotësimi i urdhërimeve sjell heqjen e mëkateve" (Moroni 8:25). Ju e "mbani një heqje të mëkateve tuaja" kur vazhdoni ta përlunni veten para Perëndisë, ta thërrisni Atë përditë në lutje, të mbeteni të patundur në besim dhe t'u shërbeni atyre në nevoja (shih Mosia 4:11-12, 26).

*Të Rilindesh.* Përmes ordinancave të pagëzimit e konfirmimit ju u rilindët për një jetë të re. Shpëtimtari i tha Nikodemit: "Kush nuk ka lindur nga uji dhe nga Fryma, nuk mund të hyjë në mbretërinë e Perëndisë" (Gjoni 3:5). Pikërisht si një fëmijë që me lindjen i hyn një ekzistence të re, ju filluat një jetë të re kur hytë në besëlidhjen e pagëzimit. Mund të rriteni në përshpirtshmëri dhe të bëheni më shumë si Shpëtimtari, me mbajtjen e besëlidhjes suaj të pagëzimit, me marrjen e sakramentit për të përtëritur besëlidhjen tuaj dhe me pendimin për mëkatet tuaja. Apostulli Pali mësoi se ne, atëherë kur jemi të pagëzuar, duhet "të ecim në risinë e jetës" (Romakëve 6:4).

## Durimi Deri në Fund

Tani që jeni pagëzuar dhe keni marrë dhuratën e Frymës së Shenjtë, duhet të vazhdoni në drejtësi, sepse këto ordonanca shënojnë vetëm fillimin e udhëtimit tuaj të kthimit për të banuar me Atin tuaj Qiellor. Profeti Nefi mësoi:

“Pasi ju të keni hyrë në këtë shteg të ngushtë dhe të ngushtuar, unë do t’ju pyesja nëse gjithçka është bërë? Vini re, unë ju them juve, Jo; pasi ju nuk keni arritur deri këtu përveçse me anë të fjalës së Krishtit, me besim të patundur në të, duke u mbështetur tërësisht në meritat e atij që është i fuqishëm të shpëtojë.

Kështu që, ju duhet të shkoni përpara me një vendosmëri në Krisht, duke pasur një ndriçim të përkryer të shpresës dhe një dashuri për Perëndinë dhe për gjithë njerëzit. Prandaj, në qoftë se ju do të shkoni përpara, duke u ushqyer me bollëk mbi fjalën e Krishtit dhe të duroni deri në fund, vini re, kështu thotë Ati: Ju do të keni jetën e përvetshme” (2 Nefi 31:19-20).

Referime shtesë: Veprat e Apostujve 2:37-38; 2 Nefi 31:4-13; Alma 7:14-16; 3 Nefi 11:18-41; 27:13-22; DeB 39:5-6, 10; 76:50-53

*Shih gjithashtu* Besim; Bindje; Fryma e Shenjtë; Pendim; Priftëri; Sakrament

## Paqe

Shumë njerëz mendojnë se paqja është mungesë lufte. Por ne mund të ndjejmë paqe madje edhe në kohë lufte dhe mund të na mungojë paqja kur lufta nuk duket gjëkund. Thjesht mungesa e mosmarrëveshjeve, nuk mjafton për të na sjellë paqe në zemër. Paqja vjen me anë të ungjillit—nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit, shërbesës së Frymës së Shenjtë dhe nëpërmjet drejtësisë vetjake, pendimit të sinqertë dhe shërbimit me zell.

Kur madje bota rreth jush është në mes të trazirës, ju mund të merrni bekimin e paqes së brendshme. Ky bekim do

t'ju vazhdojë ndërsa qëndroni i vërtetë në dëshminë për ungjillin dhe ndërsa e kujtoni që Ati Qiellor dhe Jezu Krishti ju duan dhe ju mbrojnë.

Përveçse ndjeni vetë paqe, mund të keni një ndikim për paqen në familje, në komunitet dhe në botë. Ju punoni për paqen atëherë kur i mbani urdhërimet, shërbeni, përkujdeseni për anëtarët e familjes e për fqinjët dhe shpërndani ungjillin. Ju punoni për paqen kurdoherë që ndihmoni në lehtësimin e vuajtjes së një tjetri.

Fjalët e Shpëtimtarit që vijojnë më pas, na mësojnë se si mund ta përjetojmë paqen që sjell ungjilli:

“Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë, që Ati do ta dërgojë në emrin tim, do t’ju mësojë çdo gjë dhe do t’ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë.

Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë po jua jap, po jo si e jep bota; zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë” (Gjoni 14:26-27).

“Mos kini frikë të bëni mirë, bijtë e mi, sepse çfarë të mbillni, atë edhe do të korrni; prandaj, në qoftë se mbillni mirësi, ju gjithashtu do të korrni mirësi për shpërblimin tuaj.

Prandaj, mos ki frikë, tufë e vogël; bëni mirë; le të bashkohen toka e ferri kundër jush, sepse, nëse ju ndërtohemi mbi shkëmbin tim, ato s’mund të triumfojnë.

Vini re, unë nuk ju dënoj; shkoni në rrugët tuaja dhe mos mëkatoni më; kryeni me maturi punën që ju kam urdhëruar.

Shihni tek unë në çdo mendim; mos dyshoni, mos kini frikë.

Vini re plagët që tejshpuan ijën time dhe gjithashtu shenjat e gozhdëve në duart dhe këmbët e mia; jini besnikë, zbatoni urdhërimet e mia dhe ju do të trashëgoni mbretërinë e qiellit” (DeB 6:33-37).

“Jua kam thënë këto gjëra, që ta keni paqen në mua; në botë do të keni mundime, por merrni zemër, unë e munda botën!” (Gjoni 16:33).

Ndërsa e kujtoni Shpëtimtarin dhe i shkoni pas, ju me të vërtetë mund të merrni zemër. Ju mund të përjetoni paqe

të vërtetë e të qëndrueshme në të gjitha kohërat. Ju mund të gjeni shpresë në fjalët e para të Shpëtimtarit pas Ringjalljes drejtuar dishepujve të Tij: “Paqja me ju!” (Gjoni 20:19).

Referime shtesë: DeB 59:23

*Shih gjithashtu* Dashuri; Dashuri Hyjnore; Fryma e Shenjtë; Jezu Krishti; Luftë; Shërbim; Shpresë

## Parajsë

Në shkrimet e shenjta fjala *parajsë* përdoret në dy mënyra të ndryshme. Së pari, ajo përcakton një vend paqeje dhe lumturie në botën e shpirtave të pas vdekjes, të ruajtur për ata që janë pagëzuar dhe që kanë mbetur besnikë (shih Alma 40:12; Moroni 10:34). Ata që ndodhen në burgun shpirtëror, kanë mundësi të mësojnë ungjillin e Jezu Krishtit, të pendohen për mëkatet dhe të marrin ordinancat e pagëzimit e të konfirmimit nëpërmjet punës që bëjmë ne në tempuj (shih DeB 138:30-35). Kur i plotësojnë këto, ata mund të hyjnë në parajsë.

Një përdorim i dytë i fjalës *parajsë* gjendet në përmbledhjen e Llukës për Kryqëzimin e Shpëtimtarit. Kur Jezusi ishte në kryq, një vjedhës i cili gjithashtu po kryqëzohej, tha: “Zot, kujtohu për mua kur të vish në mbretërinë tënde” (Lluka 23:42). Sipas Lluka 23:43, Zoti iu përgjigj: “Në të vërtetë po të them: sot do të jesh me mua në parajsë”. Profeti Jozef Smith shpjegoi se ky është një keqpërkthim; Zoti faktikisht tha se vjedhësi do të ishte me Të në botën e shpirtave.

Fjala *parajsë* gjendet po ashtu në 2 Korintasve 12:4, ku me sa duket lidhet me mbretërinë çelestiale. Në nenin e dhjetë të besimit, fjala “të parajsës” përshkruan lavdinë e tokës në Mijëvjeçar.

*Shih gjithashtu* Plani i Shpëtimit; Ringjallje; Vdekje Fizike

## Parashugurim

Në botën e shpirtave para lindjes, Perëndia emëroi shpirta të caktuar, me qëllim që të përmbushnin misionet të

veçanta gjatë jetës së tyre të vdekshme. Kjo quhet parashugurim.

Parashugurimi nuk është garanci që individët do të marrin thirrje ose përgjegjësi të caktuara. Mundësi të tilla vijnë në këtë jetë si rezultat i ushtrimit të drejtë të lirisë së zgjedhjes, pikërisht ashtu siç erdhi parashugurimi si një rezultat i drejtësisë në ekzistencën para lindjes.

Jezu Krishti u parashugurua për të zbatuar Shlyerjen, duke u bërë “[Qengji], që ishte vrarë që nga krijimi i botës” (Zbulesa 13:8; shih gjithashtu 1 Pjetri 1:19-21). Shkrimet e shenjta na tregojnë për të tjerë që u parashuguruan. Profeti Abraham mësoi për parashugurimin e tij atëherë kur mori një vegim në të cilin pa “shumë fisnikë dhe të mëdhenj” ndërmjet shpirtave në botën e shpirtave para lindjes. Ai tha: “Perëndia pa se këta shpirta ishin të mirë dhe qëndroi në mes tyre dhe ai tha: Këta unë do t’i bëj sunduesit e mi; sepse ai qëndroi mes atyre që ishin shpirta dhe pa se ata ishin të mirë; dhe ai më tha: Abraham, ti je një prej tyre; ti u zgjodhe përpara se të lindesh” (Abrahami 3:22-23). Zoti i tregoi Jeremias: “Para se unë të të formoja në barkun e nënës sate, të kam njohur; para se ti të dilje nga barku i saj, të kam shenjtëruar dhe të kam caktuar profet të kombeve” (Jeremia 1:5). Gjon Pagëzori u parashugurua të përgatisë popullin për shërbesën e Shpëtimtarit në vdekshmëri (shih Isaia 40:3; Lluka 1:13-17; 1 Nefi 10:7-10).

Doktrina e parashugurimit zbatohet tek të gjithë anëtarët e Kishës, jo vetëm tek Shpëtimtari dhe profetët e Tij. Përpara krijimit të tokës, grave besnike iu dhanë përgjegjësi të caktuara dhe burrat besnikë u parashuguruan në detyra të caktuara priftërie. Edhe pse nuk e kujtoni atë kohë, sigurisht që ju pranuat të plotësoni detyra të rëndësishme në shërbim të Atit tuaj. Kur jepni prova që jeni i denjë, do t’ju jepen mundësi për të përmbushur funksionet që morët atëherë.

Referime shtesë: Alma 13:1-9; DeB 138:53-56

*Shih gjithashtu Liri e Zgjedhjes; Plani i Shpëtimimit*

## Pendim

Pendimi është një nga parimet e para të ungjillit (shih Nenet e Besimit 1:4). Ai është thelbësor për lumturinë tuaj në këtë jetë dhe gjatë gjithë përjetësisë. Pendimi është shumë më tepër sesa thjesht të pranosh gabimet. Është një ndryshim i mendjes dhe i zemrës që ju jep një pamje të re për Perëndinë, për veten dhe për botën. Ai përfshin largimin nga mëkati dhe kthimin tek Perëndia për falje. Është i motivuar nga dashuria për Perëndinë dhe dëshira e sinqertë për t’iu bindur urdhëri-meve të Tij.

### Nevoja për Pendim

Zoti ka deklaruar që “asgjë e papastër nuk mund të trashëgojë mbretërinë e qiellit” (Alma 11:37). Mëkatet tuaja ju bëjnë të papastër—të padenjë për tu kthyer dhe për të jetuar në prani të Atit tuaj Qiellor. Ato gjithashtu i sjellin shpirtit tuaj dhembje në këtë jetë.

Nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit, Ati Qiellor ka siguruar të vetmen mënyrë që juve t’ju falen mëkatet (shih “Falje”, faqe 45-47). Jezu Krishti vuajti ndëshkimin për mëkatet tuaja, që ju të mund të faleni në qoftë se pendoheni sinqerisht. Kur pendoheni dhe mbështeteni tek hiri i Tij shpëtuës, ju do të pastroheni nga mëkatet. Ai deklaroi:

“Unë të urdhëroj të pendohesh—pendohu, përndryshe unë të godas me shufrën e gojës sime dhe me zemërimin tim, dhe me indinjatën time, dhe vuajtjet e tua do të jenë të ashpra—sa të ashpra ti s’e di, sa therëse ti s’e di, po, sa të vështira për t’u duruar ti s’e di.

Pasi vër re, unë, Perëndia, i kam vuajtur këto gjëra për të gjithë, që ata të mos vuajnë nëse do të pendohen;

Por nëse nuk do të pendohen, ata duhet të vuajnë po aq sa unë;

Vuajtje që më bëri mua, madje Perëndi, më i madhi i të gjithëve, të dridhem për shkak të dhembjes e të më dalë gjak

## *Pendim*

nga çdo por dhe të vuaj si në trup e në shpirt—dhe të dëshiroj që të mos e pi kupën e hidhur e të mpakem—

Megjithatë, lavdi i qoftë Atit, dhe unë mora pjesë e i mbarova përgatitjet e mia për fëmijët e njerëzve” (DeB 19:15-19).

### Rreziku nga Shtyrja e Pendimit

Mos i përligjini mëkatet tuaja apo ta lini pendimin për më vonë. Amuleku na këshilloi: “Kjo jetë është koha për njerëzit që të përgatiten të takohen me Perëndinë; po, vini re, dita e kësaj jete është dita për njerëzit që të kryejnë punët e tyre. . . . Ju lutem shumë që të mos e shtyni ditën e pendimit tuaj deri në fund; pasi pas kësaj dite të jetës që na është dhënë për t’u përgatitur për përjetësi, vini re, në qoftë se ne nuk e përdorim më mirë kohën tonë ndërsa jemi në këtë jetë, atëherë vjen nata e errësirës, gjatë së cilës nuk mund të kryhet asnjë punë” (Alma 34:32-33).

### Pjesët Përbërëse të Pendimit

Pendimi është një proces i dhimbshëm, por na prin drejt faljes dhe paqes së qëndrueshme. Nëpërmjet profetit Isaia, Zoti tha: “Edhe sikur mëkatet tuaja të ishin të kuqe flakë, do të bëhen të bardha si bora, edhe sikur të ishin të kuqe të purpur, do të bëhen si leshi” (Isaia 1:18). Në këtë periudhë ungjillore Zoti ka premtuar: “Ai që është penduar për mëkatet e tij, po ai falet dhe unë, Zoti, nuk i kujtoj më ato” (DeB 58:42). Pendimi përfshin pjesët përbërëse të mëposhtme:

*Besimi tek Ati Qiellor dhe tek Jezu Krishti.* Fuqia e mëkatit është shumë e madhe. Për t’u çliruar nga ai, ju duhet t’i drejtoheni Atit tuaj Qiellor dhe të luteni me besim. Satani mund të mundohet t’ju bindë që nuk jeni i denjë për t’u lutur—që Ati Qiellor është aq i pakënaqur me ju, saqë Ai nuk do t’i dëgjojë kurrë lutjet tuaja. Kjo është gënjeshtëri. Ati juaj Qiellor është gjithmonë i gatshëm t’ju ndihmojë, në qoftë se do të

shkoni tek Ai me zemër të penduar. Ai e ka fuqinë për t'ju shëruar dhe për t'ju ndihmuar të triumfoni mbi mëkatin.

Pendimi është vepër e besimit tek Jezu Krishti—një pranim i fuqisë së Shlyerjes së Tij. Mbani mend që ju mund të merrni falje vetëm sipas kushteve të Tij. Ndërsa e pranoni me mirënjohje Shlyerjen e Tij dhe fuqinë e Tij për t'ju pastruar nga mëkati, ju jeni në gjendje të “ushtroni besimin tuaj në pendim” (Alma 34:17).

*Trishtimi për Mëkatin.* Në mënyrë që të faleni, duhet që në radhë të parë të pranoni brenda vetes se keni mëkatuar. Në qoftë se po përpiqeni të jetoni ungjillin, një pranim i tillë do t'ju çojë tek “trishtimi sipas Perëndisë,” i cili “sjell pendim për shpëtim” (2 Korintasve 7:10). Trishtimi sipas Perëndisë nuk vjen për shkak të pasojave të natyrshme të mëkatis ose nga frika e dënimit; më saktë, ai vjen nga dijenia se ju keni fyer Atin tuaj Qiellor dhe Shpëtimtarin tuaj. Kur përjetoni trishtimin sipas Perëndisë, ju keni një dëshirë të sinqertë për të ndryshuar dhe një gatishmëri për t'iu nënshtruar çdo kërkesë të nevojshme për t'u penduar.

*Rrëfimi.* “Kush i fsheh shkeljet e tij nuk do të ketë mbarësi; por ai që i rrëfen dhe i braktis ato, ka për të fituar mëshirën” (Fjalët e Urta 28:13). Për marrjen e faljes është thelbësore gatishmëria për t'ia zbuluar plotësisht Atit tuaj Qiellor gjithçka që keni bërë. Gjunjëzohuni para Tij në lutje të përlulur, duke i pranuar mëkatet tuaja. Rrëfeni turpin dhe fajin tuaj dhe pastaj lutuni për ndihmë.

Mëkatet e mëdha si thyerja e ligjit të dëlirësisë, mund të rrezikojnë anëtarësinë tuaj në Kishë. Prandaj, ju duhet t'ia rrëfeni këto mëkate edhe Zotit, edhe përfaqësuesve të Tij në Kishë. Kjo bëhet nën kujdesin e peshkopit ose presidentit tuaj të degës e ndofta edhe të presidentit të kunjtit ose të misionit, të cilët shërbejnë si rojtarë dhe gjykatës në Kishë. Ndërsa vetëm Zoti mund të falë mëkatet, këta udhëheqës të priftërisë luajnë një rol vendimtar në procesin e pendimit. Ata do ta mbajnë rrëfimin tuaj të fshehtë dhe do t'ju ndihmojnë gjatë



gjithë procesit të pendimit. Jini plotësisht i ndershëm me ta. Në qoftë se ju rrëfeni pjesërisht, duke përmendur vetëm mëkatet më të vogla, ju nuk do të jeni në gjendje të ndreqni një shkëlje më serioze të pazbuluar. Sa më shpejt që ta nisni këtë proces, aq më shpejt do të gjeni paqen dhe gëzimin që vijnë me anën e mrekullisë së faljes.

*Braktisja e Mëkatit.* Edhe pse rrëfimi është pjesë përbërëse thelbësore e pendimit, ai nuk mjafton. Zoti ka thënë: “Në këtë mënyrë ju mund të dini nëse një njeri pendohet për mëkatet e tij—vini re, ai do t’i rrëfejë ato e do t’i braktisë ato” (DeB 58:43).

Vazhdoni të mbani vendosmërinë e paepur e të përherëshme që kurrë nuk do ta përsërisni shkëljen. Kur e mbani këtë zotim, nuk do ta përjetoni kurrë më dhimbjen e atij mëkati.

Ikni menjëherë nga çdo rrethanë e rrezikshme. Në rast se disa rrethana ju bëjnë që të mëkatoni ose mund t’ju bëjnë të mëkatoni, largohuni. Nuk mund të rrini në tundime dhe të prisni që të fitoni mbi mëkatin.

*Ndreqja e Dëmeve.* Aq sa të jetë e mundur, ju duhet të dëmshpërbleni gjithçka që u dëmtua nga veprimet tuaja, qoftë kjo prona e dikujt ose fama e mirë e dikujt. Gatishmëria për ndreqjen e dëmeve i tregon Zotit që ju do të bëni gjithçka të mundur për t’u penduar.

*Të Jetuarit me Drejtësi.* Nuk mjafton thjesht të përpiqesh të kundërshtosh ligësinë ose të boshatisësh jetën nga mëkati. Duhet ta mbushni jetën me drejtësi dhe të merreni me veprimtari që sjellin fuqi shpirtërore. Zhytuni në leximin e shkrimeve të shenjta. Lutuni përditë në mënyrë që Zoti t’ju japë fuqi përtej asaj vetjake. Nganjëherë edhe agjëroni për bekime të veçanta.

Bindja e plotë e sjell të plotë fuqinë e ungjillit në jetën tuaj, përfshirë rritjen e fuqisë për të mposhtur dobësitë. Kjo bindje përmban veprime të cilat në fillim mund të mos i keni

quajtur si pjesë të pendimit, siç janë frekuentimi i mbledhjeve, pagimi i së dhjetës, shërbimi dhe falja e të tjerëve. Zoti premtoi: “Ai që pendohet dhe i bën urdhërimet e Zotit, do të falet (DeB 1:32).

Referime shitesë: Lluca 15:11-32; 2 Nefi 9:19-24; Mosia 4:1-3, 10-13; 26:30-31; DeB 18:10-16

*Shih gjithashtu* Besim; Falje; Këshilla Disiplinore të Kishës; Mëkat; Pagëzim; Plani i Shpëtimit; Shlyerja e Jezu Krishtit; Tundim

## Perëndia Atë

Perëndia Atë është Qenia Më e Lartë në të cilin besojmë dhe që e adhurojmë. Ai është Krijuesi, Sunduesi dhe Ruajtësi më i skajshëm i gjithçkaje. Ai është i përkryer, ka gjithë fuqinë dhe di gjithçka. “Ka trup prej mishi e kockash, po aq të prekshëm sa edhe të një njeriu” (DeB 130:22).

Ati ynë Qiellor është një Perëndi me gjykim dhe forcë, me njohuri dhe fuqi, por është gjithashtu Perëndi me mëshirë, dashamirësi dhe dashuri hyjnore të përsosur. Megjithëse ne “nuk e [dimë] kuptimin e të gjitha gjërave”, mund të gjejmë paqe tek dija e sigurt se Ai na do (shih 1 Nefi 11:17).

### Ati i Shpirtrave Tanë

Një nga pyetjet më të mëdha në jetë është “Kush jam unë?” Një këngë fort e dashur e Fillores ndihmon madje fëmijët e vegjël që t’i përgjigjen kësaj pyetjeje. Ne këndojmë: “Fëmij’ i Per’ndis’ jam, këtu ai më çoi”. Dija që ne jemi fëmijët e Perëndisë, siguron forcë, qetësim dhe shpresë.

Ju jeni me plot kuptimin fëmijë i Perëndisë, i krijuar në jetën para lindjes. Duke qenë fëmija i Tij, mund të jeni i sigurt se keni aftësi hyjnore e të përrjetshme dhe se Ai do t’ju ndihmojë gjatë përpjekjeve tuaja të sinqerta për të arritur nivelin e asaj aftësie.

## Krijuesi Më i Lartë

Ati Qiellor është Krijuesi Më i Lartë. Nëpërmjet Jezu Krishtit, Ai krijoi qiellin e tokën dhe gjithçka në to (shih Moisiu 2:1). Alma tha: “Të gjitha gjërat tregojnë se ka një Perëndi; po, madje edhe toka e të gjitha gjërat që gjenden mbi faqe të saj, po, edhe lëvizja e saj, po, dhe gjithashtu të gjithë planetët të cilët lëvizin në mënyrën e tyre të rregullt, dëshmojnë se ka një Krijues Suprem” (Alma 30:44).

Kohë pas kohe meditoni mbi bukuritë e krijimit: pemë, lule, kafshë, male, valë oqeani, një fëmijë i porsalindur. Gjени kohë për ta ngulitur vështrimin në qiell, atje ku vargjet e yjeve e të planetëve janë provë për “Perëndinë duke lëvizur në madhësinë dhe fuqinë e tij” (shih DeB 88:41-47).

## Autori i Planit të Shpëtimit

Ati ynë në Qiell dëshiron që të rrojmë me Të përjetësisht. Puna dhe lavdia e Tij është që “të [bëjë] të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut” (Moisiu 1:39). Për ta bërë të mundur këtë gjë, Ai përgatiti planin e shpëtimit. Dërgoi Birin e Tij të Dashur, Jezu Krishtin, që të zgjidhte rripat e vdekjes dhe të shlyente mëkatet e botës: “Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme” (Gjoni 3:16). Kjo sakrificë është shprehja më e madhe e dashurisë së Atit tonë ndaj nesh.

## Në Njohje të Perëndisë Atë

Duke qenë fëmijë të Perëndisë, kemi një marrëdhënie të veçantë me Të, e cila na radhit veçmas krijimeve të tjera. Kërkoni ta njihni Atin tuaj në Qiell. Ai ju do dhe ju ka dhënë mundësinë e çmueshme që t’i afroheni pranë kur luteni. Lutjet tuaja, të ofruara me përlulesi e sinqeritet, dëgjohen dhe marrin përgjigje.

Gjithashtu ju mund të arrini ta njihni Atin tuaj duke mësuar për Birin e Tij të Dashur e duke zbatuar ungjillin në

jetë. Shpëtimtari i mësoi dishepujt e Tij: “Po të më kishit njohur, do të kishit njohur edhe Atin tim . . . Kush më ka parë mua, ka parë Atin” (Gjoni 14:7, 9).

I afroheni pranë Perëndisë Atë ndërsa studioni shkrimet e shenjta dhe fjalët e profetëve të ditëve të mëvonshme dhe kur bëni shërbime. Kur ndiqni vullnetin e Perëndisë dhe jetoni siç dëshiron Ai, bëheni më i ngjashëm me Të dhe Birin e Tij. Ju përgatiteni për t’u kthyer tek jeta në prani të Tyre.

Referime shitesë: Gjoni 14:6, 21-24; 17:3; Mosia 4:9; DeB 132:22-24; Nenet e Besimit 1:1

*Shih gjithashtu* Kreu-Perëndi; Krijim; Plani i Shpëtimit

## **Perla me Vlerë të Madhe** (*Shih* Shkrime të Shenjta)

### **Përrulësi**

Të jesh i përrulur do të thotë të pranosh me mirënjohje varësinë tënde nga Zoti—të kuptosh se ke nevojë të vazhdueshme për përkrahjen e Tij. Përrulësia është një mënyrë pranimi që talentet dhe zotësitë tuaja janë dhurata nga Perëndia. Nuk është shenjë dobësie, druajtjeje ose frike, është një tregues që ju e dini se ku qëndron forca juaj e vërtetë. Mund të jesh edhe i përrulur, edhe i patrembur. Mund të jesh edhe i përrulur, edhe guximtar.

Jezu Krishti është shembulli ynë më i madh i përrulësisë. Gjatë shërbesës së Tij në vdekshmëri, Ai pranoi përherë se fuqia e Tij erdhi për arsye të varësisë së Tij nga Ati i Tij. Ai tha: “Unë s’mund të bëj asgjë nga vetja ime . . . Nuk kërkoj vullnetin tim, por vullnetin e Atit që më ka dërguar” (Gjoni 5:30).

Zoti do t’ju forcojë kur përruleni përpara Tij. Jakobi mësoi: “Perëndia u kundërvihet mendjemëdhenjve dhe u jep hir të përrulurve . . . Përruluni përpara Zotit, dhe ai do t’ju lartësojë” (Jakobi 4:6, 10).

## *Peshkop*

Referime shtesë: Mateu 18:4; 23:12; 26:39; Lluka 22:42; 1 Pjetri 5:5-6; Mosia 4:11-12; 15:6-7; Alma 5:27-28; Helamani 3:33-35; Ethëri 12:27; DeB 12:8; 67:10; 112:10; 136:32-33

**Peshkop** (*Shih* Administrim i Kishës)

**Pije të Nxehta** (*Shih* Fjala e Urtësisë)

**Plak** (*Shih* Priftëri; Priftëri Melkizedeke)

## **Plani i Shpëtimit**

Në ekzistencën para lindjes, Ati Qiellor përgatiti një plan që të na jepte mundësinë të bëheshim si Ai dhe të merrnim plotësinë e gëzimit. Shkrimet e shenjta e përmendin këtë plan si “plani i shpëtimit” (Alma 24:14; Moisiu 6:62), “[plani i madh i lumturisë]” (Alma 42:8), “[plani i] . . . shëlbimit” (Jakobi 6:8 [LiM]; Alma 12:30) dhe “plani i mëshirës” (Alma 42:15).

Plani i shpëtimit është plotësia e ungjillit. Ai përfshin Krijimin, Rënien, Shlyerjen e Jezu Krishtit dhe të gjitha ligjet, ordincat dhe doktrinën e ungjillit. Liria e zgjedhjes morale, aftësia për të zgjedhur e vepruar për vete, është gjithashtu në thelb të planit të Atit Qiellor. Për shkak të këtij plani ne mund të bëhemi të përkryer me anë të Shlyerjes, të marrim plotësinë e gëzimit dhe të jetojmë përgjithnjë në prani të Perëndisë. Marrëdhëniet tona familjare mund të zgjasin gjatë gjithë përjetësisë.

Ju jeni një pjesëmarrës në planin e Atit Qiellor dhe përvoja juaj e përditshme mund të ndahet në tre pjesë kryesore: jeta para lindjes, jeta në tokë dhe jeta pas vdekjes. Kur arrini të kuptoni planin, ju gjeni përgjigjet për pyetjet që shumë vetë i bëjnë: Nga erdhëm? Përse jemi këtu? Ku shkojmë pas kësaj jete?

## **Jeta Para Lindjes**

Para se të lindeshit në tokë, jetuat në prani të Atit tuaj Qiellor si një nga fëmijët e Tij shpirtërorë. Në këtë ekzistencë

para lindjes, ju ishit i pranishëm në një këshill bashkë me fëmijët e tjerë shpirtërorë të Atit Qiellor. Në atë këshill Ati Qiellor paraqiti planin e Tij të madh të lumturisë (shih Abrahami 3:22-26).

Në harmoni me planin e lumturisë, Jezu Krishti i para lindjes, Biri i Atit i Parë lindur në shpirt, lidhi besë të ishte Shpëtimtari (shih Moisiu 4:2; Abrahami 3:27). Ata që ndoqën Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin, u lejuan që të vinin në tokë për të përjetuar jetën e vdekshme dhe të përparonin në drejtim të jetës së përjetshme. Luciferi, një bir tjetër shpirtëror i Perëndisë, ngriti krye ndaj planit dhe “kërkoi të shkatërronte lirinë e njeriut për të zgjedhur” (Moisiu 4:3). Ai u bë Satani dhe ai e pasuesit e tij u dëbuan nga qielli dhe iu mohuan privilegji për të marrë trup fizik dhe për të përjetuar jetën e vdekshme (shih Moisiu 4:4; Abrahami 3:27-28).

Gjatë gjithë jetës së para lindjes ju formuat tërësinë e veçorive dalluese individuale dhe rritët aftësitë tuaja shpirtërore. Të bekuar me dhuratën e lirisë për të zgjedhur, ju morët vendime të rëndësishme, si vendimi për të ndjekur planin e Atit Qiellor. Këto vendime ndikuan në jetën tuaj atëherë dhe tani. Ju rritët aftësinë për të mësuar e kuptuar dhe mësuar ta doni të vërtetën, dhe u përgatitët të vini në tokë, ku mund të vazhdonit drejt përparimit.

## Jeta e Vdekshme

Tani po përjetoni jetën e vdekshme. Shpirti juaj është bashkuar me trupin, duke ju dhënë mundësi që të rriteni e të zhvilloheni në drejtime që nuk ishin të mundura në jetën tuaj para lindjes. Kjo pjesë e ekzistencës sonë është kohë mësimi, në të cilën ju mund të provoni vetveten, të zgjidhni për të ardhur drejt Krishtit dhe të përgatiteni për ta merituar jetën e përjetshme. Është gjithashtu koha kur mund të ndihmoni të tjerët të gjejnë të vërtetën dhe të fitojnë dëshminë për planin e shpëtimit.

## Jeta pas Vdekjes

Kur vdisni, shpirti juaj do të hyjë në botën e shpirtave dhe do të presë ringjalljen. Në kohën e ringjalljes, shpirti dhe trupi juaj do të ribashkohen dhe ju do të gjykojeni e do të merreni në një nga mbretëritë e lavdisë. Lavdia që do të trashëgoni varet nga thellësia e kthimit tuaj në besim dhe bindja ndaj urdhërimeve të Zotit (shih “Mbretëri të Lavdisë”, faqe 90-93). Ajo do të varet nga mënyra me të cilën e keni “[marrë] dëshminë e Jezusit” (DeB 76:51; shih gjithashtu vargjet 74, 79, 101).

## Bekimet nga Njohja e Planit

Dëshmia për planin e shpëtimit mund t’ju japë shpresën dhe pikësynimin kur ndesheni me sfidat e jetës. Mund të gjeni rishtas siguri tek dituria që ju jeni fëmijë i Perëndisë dhe që keni jetuar në prani të Tij para se të lindeshit në tokë. Mund të gjeni kuptimin e jetës së tanishme, duke ditur se veprimet tuaja gjatë vdekshmërisë ndikojnë fatin e përjetshëm. Duke pasur këtë dije, vendimet e rëndësishme mund t’i bazoni mbi të vërtetat e përjetshme më tepër se në rrethanat e ndryshueshme të jetës. Ju mund t’i përmirësoni vazhdimisht marrëdhëniet tuaja me anëtarët e familjes, të gëzuar me premtimin që familja juaj mund të jetë e përjetshme. Mund të gjeni gëzim tek dëshmia që keni për Shlyerjen dhe për urdhërimet, ordinancat, besëlidhjet dhe doktrinën e Zotit, duke ditur se “ai që bën veprat e drejtësisë, duhet ta marrë shpërblimin e tij, madje paqe në këtë botë dhe jetë të përjetshme në botën që vjen” (DeB 59:23).

Referime shtesë: 2 Nefi 2:5-30; 10:23-25; Alma 12:24-37; 22:12-14; 42; Moisiu 6:47-62

*Shih gjithashtu Ferr; Jezu Krishti; Krijim; Liri e Zgjedhjes; Mbretëri të Lavdisë; Parajsë; Perëndia Atë; Qiell; Rënie; Ringjallje; Shlyerja e Jezu Krishtit; Ungjill; Vdekje Fizike; Vdekje Shpirtërore*

## Pornografi

Pornografi është çdo informacion që paraqet ose përshkruan trupin njerëzor ose sjelljen gjinore në mënyrën që zgjon ndjesi seksuale. Ajo shpërndahet nëpërmjet shumë mjeteve të komunikimit, përfshirë revistat, librat, televizionin, filmat, muzikën dhe internetin. Ajo është aq dëmтуese për shpirtin sa janë duhani, alkooli dhe drogat për trupin. Përdorimi në çfarëdolloj mënyre i informacionit pornografik është dhunim i urdhërimit të Perëndisë: “Mos bëj shkelje kurore, . . . as mos bëj diçka të ngjashme” (DeB 59:6). Ajo mund të çojë në mëkate të tjera serioze. Anëtarët e Kishës duhet ta shmangin pornografinë e çfarëdo forme dhe duhet ta kundërshtojnë prodhimin, shpërndarjen dhe përdorimin e saj.

Pornografia të kap në një varësi tragjike. Ashtu siç ndodh kur jepesh pas gjërave të tjera, ajo i çon njerëzit të bëjnë prova dhe të kërkojnë për nxitje më të fuqishme. Nëse bëni prova me të dhe ia lejon vetes të rri i kapur në lakun e saj, ajo do t’ju shkatërrojë, duke ju zvetënuar mendjen, zemrën dhe shpirtin. Ajo do t’ju grabisë respektin për veten dhe ndjesinë e bukurisë së jetës. Ajo do t’ju rrënojë dhe t’ju çojë në mendime të liga dhe ndofta në sjellje abuzuese. Do t’ju shkaktojë dëme të tmerrshme në marrëdhëniet familjare.

Për shkak se pornografia bëhet prirje dhe për shkak të dëmit që mundet të shkaktojë në trup e në shpirt, shërbëtorët e Zotit na kanë paralajmëruar në mënyrë të përsëritur që ta shmangim. Në qoftë se jeni kapur në lakun e pornografisë, ndaluni menjëherë dhe kërkonin ndihmë. Nëpërmjet pendimit ju mund të merrni falje dhe të gjeni shpresën tek ungjilli. Shkoni tek peshkopi ose presidenti i degës për këshillë se si ta kapërceni problemin tuaj dhe kërkonin shërimin me anë të Shlyerjes së Jezu Krishtit. Kërkojini Zotit që t’ju japë forcë ta kapërceni këtë varësi të tmerrshme.

Referime shtesë: Mateu 5:27-28; Romakëve 6:12; Alma 39:9; DeB 42:23

*Shih gjithashtu Dëlrësi; Tundim*



**Presidenci e Parë** (*Shih* Administrim i Kishës; Profetë)

**Prift** (*Shih* Administrim i Kishës; Priftëri; Priftëri Aarone)

## **Priftëri**

Priftëria është fuqia dhe autoriteti i përjetshëm i Perëndisë. Me anë të priftërisë Perëndia krijoi dhe qeveris qiejtë dhe tokën. Nëpërmjet kësaj fuqie Ai shëlbbon dhe ekzalton Fëmijët e Tij, duke përbushur "[pavdekësinë] dhe [jetën] e përjetshme [të] njeriut" (Moisiu 1:39).

Autoriteti i Priftërisë u Jepet Njerëzve në Tokë

Perëndia u jep autoritetin e priftërisë anëtarëve meshkuj të denjë të Kishës, që ata të mund të veprojnë në emrin e Tij për shpëtimin e fëmijëve të Tij. Mbajtësit e priftërisë mund të autorizohen që të predikojnë ungjillin, të administrojnë ordincat e shpëtimit dhe të qeverisin mbretërinë e Perëndisë në tokë.

Anëtarët meshkuj të Kishës mund të fillojnë shërbimin e tyre priftëror kur të arrijnë moshën 12 vjeç. Ata fillojnë me marrjen e Priftërisë Aarone dhe më vonë mund të cilësohen të gatshëm për t'iu dhënë Priftëria Melkizedeke. Në faza të tjera të jetës së tyre dhe atëherë kur përgatiten që të marrin përgjegjësi të ndryshme, ata mbajnë detyra të ndryshme në priftëri, si p.sh., dhjak, mësues ose prift në Priftërinë Aarone dhe plak ose prift i lartë në Priftërinë Melkizedeke. (Për të dhëna të veçanta lidhur me Priftërinë Aarone dhe Melkizedeke, shih faqet 130-133.)

Me qëllim që një anëtar mashkull i Kishës të mbajë priftërinë, duhet që një mbajtës i autorizuar i priftërisë t'ia japë atë dhe ta shugurojë në një detyrë të asaj priftërie (shih Hebrenjve 5:4; DeB 42:11; Nenet e Besimit 1:5).

Megjithëse autoriteti i priftërisë u jepet vetëm anëtarëve të denjë meshkuj të Kishës, bekimet e priftërisë vlejnë për të gjithë, burra, gra dhe fëmijë. Të gjithë kemi dobi nga ndikimi

i udhëheqjes së drejtë të priftërisë dhe të gjithë kemi privilegjin të marrim ordinancat shpëtuese të priftërisë.

### Priftëria dhe Familja

Më e rëndësishmja në ushtrimin e priftërisë është ushtrimi i saj në familje. Secili bashkëshort dhe baba në Kishë duhet të mundohet të jetë i denjë që të mbajë Priftërinë Melkizedeke. Duke e pasur të shoqen si bashkëpunëtore të barabartë, ai kryeson me drejtësi e dashuri, duke shërbyer si udhëheqës shpirtëror i familjes. Ai i prin familjes në lutje të rregullta, në studimin e shkrimeve të shenjta dhe në mbremjen familjare në shtëpi. Punon bashkë me të shoqen për mësimin e fëmijëve dhe i ndihmon të përgatiten për marrjen e ordinancave të shpëtimit (shih DeB 68:25-28). Ai u jep bekime priftërie për orientim, për shërim dhe për ngushëllim.

Shumë anëtarë nuk kanë në shtëpitë e tyre mbajtës besnikë të Priftërisë Melkizedeke. Mirëpo, nëpërmjet shërbimit të mësuesve të shtëpisë dhe udhëheqësve të priftërisë, të gjithë anëtarët e Kishës mund të gëzojnë bekimet e fuqisë së priftërisë në jetën e tyre.

### Kuorumet e Priftërisë

Një kuorum i priftërisë është një grup i organizuar i vëllezërve në Kishë që mbajnë të njëjtën detyrë priftërie. Pikësnyimet parësore të kuorumeve janë: t'u shërbejnë të tjerëve, të ndërtojnë bashkimin dhe vëllazërinë dhe të udhëzojnë njëri-tjetrin në doktrina, parime dhe në detyra.

Gjenden kuorume në të gjitha nivelet e organizimit të Kishës. Presidenti i Kishës dhe këshilltarët e tij formojnë Kuorumin e Presidencisë së Parë. Dymbëdhjetë Apostujt formojnë po ashtu një kuorum. Të Shtatëdhjetët, qoftë si Autoritete të Përgjithshme, qoftë si Autoritete Zone, organizohen si kuorume. Çdo president i kunjit kryeson mbi një kuorum të priftërinjve të lartë, të përbërë nga të gjithë priftërinjtë e lartë të kunjit. Secila lagje ose degë, si rregull, ka kuorume.

rume të pleqve, të priftërinjve, të mësuesve dhe të dhjakëve. Edhe priftërinjtë e lartë në lagje organizohen, duke shërbyer në grupet e priftërinjve të lartë.

### Mësimi i Shtëpisë

Që në kohën kur mbajtësit e priftërisë shugurohen në detyrën e mësuesit, u jepet mundësia dhe përgjegjësia për të shërbyer si mësues shtëpie. Në këtë mënyrë ata punojnë në drejtim të plotësimit të detyrës së tyre që të "[vëzhgojnë] mbi kishën gjithmonë dhe të [jenë] me ta e t'i [forcojnë] ata" (DeB 20:53).

Mësuesit e shtëpisë kanë detyrën e shenjtë që të jenë burimi i parë i ndihmës së individëve dhe të familjeve. Ata i vizitojnë anëtarët që u caktohen, të paktën një herë në muaj. Në shërbimin dhe në vizitën që u bëjnë anëtarëve, ata përkrahin prindërit në përgjegjësitë e tyre, i mësojnë ungjillin çdo anëtar i familjes, forcojnë miqësinë dhe i ndihmojnë anëtarët të përgatiten për të marrë ordinancat e tempullit e të jetojnë të denjë për bekimet e ungjillit.

Udhëheqësit në lagje dhe në degë sigurojnë që çdo familje ose individi t'i caktohen mësues shtëpie. Ata bashkë me mësuesit e shtëpisë ndjekin ecurinë dhe ndihmojnë në plotësimin e nevojave shpirtërore dhe jetësore të secilit anëtar.

### Çelësat e Priftërisë

Ushtrimi i autoritetit të priftërisë në Kishë, qeveriset nga ata që mbajnë çelësat e priftërisë (shih DeB 65:2; 124:123). Ata që mbajnë çelësat e priftërisë, kanë të drejtë të kryesojnë dhe të drejtojnë Kishën brenda zonës ku vepron autoriteti. Për shembull, një peshkop mban çelësat e priftërisë që i japin mundësi të kryesojë në lagjen e tij. Si pasojë, kur një fëmijë i asaj dege përgatitet për t'u pagëzuar, personi që e pagëzon duhet të marrë leje nga peshkopi.

Jezu Krishti mban të gjitha çelësat e priftërisë. Ai u ka dhënë Apostujve të Tij çelësat që janë të nevojshëm për qeve-

risjen e Kishës së Tij. Vetëm Apostulli më i vjetër, Presidenti i Kishës, mund t'i përdorë (ose të autorizojë një person tjetër) këta çelësa për qeverisjen e mbarë Kishës (shih DeB 43:1-4; 81:2; 132:7).

Presidenti i Kishës u jep pjesë të çelësave të priftërisë udhëheqësve të tjerë të priftërisë, që ata të kryesojnë në sferën ku kanë përgjegjësinë. Çelësat e priftërisë u jepen presidentëve të tempujve, të misioneve, të kunjeve dhe të distrikteve; peshkopëve, presidentëve të degëve; presidentëve të kuorumeve. Personi që shërben në njërin nga këto pozita, mban çelësa vetëm deri atëherë kur çlirohet. Këshilltarët nuk marrin çelësa, por ata marrin autoritet dhe përgjegjësi me marrjen e thirrjes dhe prej funksionit.

#### Ushtrimi i Priftërisë me Drejtësi

Në rast se jeni mbajtës priftërie, mbani mend që priftëria duhet të përbëjë një pjesë tuajën në çdo kohë dhe në çdo rrethanë. Ajo nuk është si mantel të cilin mund ta vishni e ta hiqni sipas dëshirës. Cilido shugurim në një pozitë të priftërisë është një thirrje për të shërbyer gjithë jetës, me premtimin që Zoti do t'ju aftësojë që të bëni punën e tij, sipas besnikërisë suaj.

Në mënyrë që ta merrni dhe ta ushtroni fuqinë e priftërisë, duhet të jeni i denjë. Fjalët që thoni dhe sjellja juaj e përditshme ndikojnë aftësinë tuaj për shërbim. Sjellja juaj para njerëzve duhet të jetë e paqortueshme. Akoma më shumë rëndësi ka sjellja juaj kur nuk ju shohin. Nëpërmjet Profetit Jozef Smith, Zoti bëri të ditur se "të drejtat e priftërisë lidhen në mënyrë të pandashme me fuqitë e qiellit dhe se fuqitë e qiellit nuk mund të kontrollohen, as përdoren, vetëm mbi bazën e parimeve të drejtësisë" (DeB 121:36). Ai paralajmëroi mbajtësit e priftërisë:

"Kur përpiqemi t'i mbulojmë mëkatet tona ose të kënaqim krenarinë tonë, ambicien tone të kotë ose të ushtrojmë kontroll apo sundim, apo detyrim mbi shpirtrat e fëmijëve të njerëzve, në çfarëdo shkalle padrejtësie, vini re, qiejtë tërhiqen; Shpirti i

Zotit hidhërohet; dhe kur ai tërhiqet, Amen priftërisë ose autoritetit të atij njeriu. Vini re, përpara se ta kuptojë, ai lihet i vetëm” (DeB 121:37-38).

Në priftëri ju nuk mund të vazhdoni të ruani ndonjë fuqi ose ndikim, përveçse “nëpërmjet bindjes, nëpërmjet durimit, nëpërmjet mirësjelljes e zemërbutësisë dhe nëpërmjet dashurisë së pashtirur; nëpërmjet mirësisë dhe diturisë së pastër, të cilat do ta zgjerojnë shumë shpirtin, pa hipokrizi dhe pa mashtrim”. Në qoftë se “u nxite nga Fryma e Shenjtë” për të qortuar dikë, shfaqni më pas “rritje të dashurisë ndaj atij që e ke qortuar, që ai të mos të të vlerësojë si armikun e tij; që ai të mund ta dijë se besnikëria jote është më e fortë se zinxhirët e vdekjes” (DeB 121:41-43).

Kur e ushtroni priftërinë me drejtësi e me dashuri, do të gjeni gëzimin e shërbimit si mjet në duart e Zotit. Ai tha:

“Brendësia jote duhet të jetë plot dashuri hyjnore ndaj gjithë njerëzve e ndaj familjes së besimit dhe virtyti duhet t’i stolisë mendimet e tua pa pushim; atëherë do të forcohet vetbesimi yt në prani të Perëndisë; dhe doktrina e priftërisë do të pikojë mbi shpirtin tënd sikurse vesat nga qiejt.

Fryma e Shenjtë do të jetë shoqëruesi yt i vazhdueshëm dhe skeptri yt një skeptër i pandryshueshëm i drejtësisë dhe së vërtetës; dhe sundimi yt do të jetë një sundim i përjetshëm dhe, pa mënyra detyruese, ai do të rrjedhë tek ty përherë e përgjithmonë” (DeB 121:45-46).

Referime shtesë: Gjoni 15:16; Veprat e Apostujve 8:14-20; Jakobi 5:14-15 [Bibla]; DeB 13; 20; 84; 107; Joseph Smith—Historia 1:68-73

*Shih gjithashtu* Administrim i Kishës; Ordinanca; Priftëri Aarone; Priftëri Melkizedeke; Rivendosje e Ungjillit

## **Priftëri Aarone**

Ndërsa Profeti Jozef Smith përkthente Librin e Mormonit, gjeti që përmendej pagëzimi për heqjen e mëkateve. Më 15 maj 1829 ai dhe shkruesi i tij, Oliver Kaudëri, shkuan në pyll për t’iu drejtuar Zotit lidhur me pagëzimin. Ndërkohë që luteshin,

“një lajmëtar nga qielli zbriti mbi një re drite”. Ky lajmëtar ishte Gjon Pagëzori, profeti i cili kishte pagëzuar Jezu Krishtin shekuj më parë. Gjon Pagëzori, tashmë një qenie e ringjallur, vuri duart e tij mbi Jozefin dhe Oliverin dhe i dha secilit Priftërinë Aarone, e cila qe hequr nga toka gjatë Braktisjes së Madhe. Me këtë autoritet, Jozefi dhe Oliveri u bënë të aftë të pagëzonin njëri-tjetrin. (Shih Joseph Smith—Historia 1:68-72.)

Sot në Kishë, anëtarë të denjë meshkuj mund të marrin Priftërinë Aarone duke filluar nga mosha 12 vjeç. Atyre u jepen shumë mundësi për të marrë pjesë në ordianca të shenjta priftërore dhe për të shërbyer. Kur i kryejnë detyrat e tyre me denjësi, ata veprojnë në emrin e Zotit për t’i ndihmuar të tjerët të marrin bekimet e ungjillit.

Detyrat e Priftërisë Aarone janë: peshkop, prift, mësues dhe dhjak. Me autorizimin e udhëheqësit kryesues të priftërisë (zakonisht të peshkopit ose presidentit të degës), dhjakët shpërndajnë sakramentin. Ata ndihmojnë peshkopin ose presidentin e degës të vigjëlojë mbi anëtarët e Kishës, duke bërë shërbime dhe duke ndihmuar në çështje të jetës materiale si mbledhja e ofertave të agjërimit. Mësuesit mund kryejnë të gjitha detyrat e dhjakëve dhe gjithashtu u jepen mundësi të tjera për të shërbyer. Ata përgatisin bukën dhe ujin e sakramentit dhe shërbejnë si mësues të shtëpisë. Priftërinjtë mund kryejnë të gjitha detyrat e dhjakëve dhe të mësuesve. Me autorizimin e udhëheqësit kryesues të priftërisë, ata gjithashtu mund të bekojnë sakramentin, të pagëzojnë dhe të shu-gurojnë të tjerë në detyrat e priftit, të mësuesit dhe të dhjakut.

Priftëria Aarone është “një shtesë e më të madhes ose Priftërisë Melkizedeke” (DeB 107:14). Shpesh quhet priftëria përgatitore. Ndërkohë që një mbajtës i priftërisë shërben në Priftërinë Aarone, ai përgatitet që të marrë Priftërinë Melkizedeke, të marrë bekimet e tempullit, të shërbejë në një mision kohëplotë, të jetë bashkëshort dhe baba i dashur dhe që të vazhdojë gjithë jetës në shërbim të Zotit.

*Shih gjithashtu Priftëri; Priftëri Melkizedeke*

## **Priftëri Melkizedeke**

“Ka, në kishë, dy priftëri, domethënë, Priftëria Melkizedeke dhe Aarone” (DeB 107:1). Priftëria Melkizedeke, e cila është “sipas Urdhrit të Birit të Perëndisë” (DeB 107:3), është më e larta nga këto. Ajo “mban të drejtën e kryesimit dhe ka fuqi e autoritet mbi gjithë detyrat në kishë” (DeB 107:8). Ajo mban gjithashtu “çelësat e të gjitha bekimeve shpirtërore të kishës” (DeB 107:18). Është quajtur sipas një prifti të lartë të madh që jetoi gjatë kohës së profetit Abraham (shih DeB 107:2-4; shih gjithashtu Alma 13:14-19).

Nëpërmjet autoritetit të Priftërisë Melkizedeke, udhëheqësit e Kishës udhëzojnë Kishën dhe drejtojnë predikimin e ungjillit në mbarë botën. Në ordinancat e Priftërisë Melkizedeke “fuqia e perëndishmërisë manifestohet” (DeB 84:20).

Kjo priftëri më e lartë iu dha Adamit dhe ka qenë në tokë në çdo kohë që Zoti ka zbuluar ungjillin e Tij. Ajo u mor nga toka gjatë Braktisjes së madhe, por u rivendos në maj të vitit 1829, kur Apostujt Pjetri, Jakobi dhe Gjoni ia dhanë Jozef Smithit dhe Oliver Kaudërit.

Detyrat e Priftërisë Melkizedeke janë: Apostull, i Shtatëdhjetë, patriark, prift i lartë dhe plak. Presidenti i Priftërisë së Lartë është Presidenti i Kishës (shih DeB 107:64-66).

Burrat në Kishë duhet të jenë mbajtës të denjë të Priftërisë Melkizedeke, në mënyrë që të marrin indaumentin e tempullit dhe të vulosen tek familjet e tyre për përjetësi. Ata kanë autoritet të administrojnë të sëmuret dhe t’u japin bekime të veçanta anëtarëve të familjes dhe të tjerëve. Me lejen e udhëheqësit kryesues të priftërisë, ata mund të japin dhuratën e Frymës së Shenjtë dhe të shugurojnë burra të tjerë të denjë në detyrat e Priftërive Aarone dhe Melkizedeke.

Kur një burrë merr Priftërinë Melkizedeke, hyn në betimin dhe besëlidhjen e priftërisë. Ai lidh besën që të jetë besnik, të lartësojë thirrjen e tij, “[t’u vërë] veshin me zell fjalëve të jetës së përjetshme” dhe “[të jetojë] me çdo fjalë që del

nga goja e Perëndisë”. Ata që e mbajnë këtë besëlidhje do të shenjtërohen me anë të Shpirtit dhe do të marrin “gjithçka që Ati . . . ka”. (Shih DeB 84:33-44.)

*Shih gjithashtu Priftëri; Priftëri Aarone*

**Profeci** (*Shih Dhurata Shpirtërore; Zbulesë*)

## Profetë

Duke qenë anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, jemi të bekuar me udhëheqjen nga profetë të gjallë—njerëz të frymëzuar të thirrur për të folur për Zotin, pikërisht si Moisiu, Isaia, Pjetri, Pali, Nefi, Mormoni dhe profetë të tjerë të shkrimeve të shenjta. Ne e mbështesim Presidentin e Kishës si profetin, shikuesin dhe zbuluesin tonë—i vetmi njeri në tokë që merr zbulesë për të udhëhequr të gjithë Kishën. Po kështu ne i mbështesim këshilltarët në Presidencinë e Parë dhe anëtarët e Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve si profetë, shikues dhe zbulues.

Ashtu si profetët e lashtë, profetët e sotëm dëshmojnë për Jezu Krishtin dhe mësojnë ungjillin e Tij. Ata bëjnë të njohur vullnetin dhe cilësitë e vërteta personale të Perëndisë. Ata flasin me guxim dhe qartë, duke e dënuar mëkatin e duke na paralajmëruar për pasojat e tij. Nganjëherë ata mund të frymëzohen që të profetizojnë për ngjarje të ardhshme, që kjo të na vlejë.

Ju mund t’u besoni gjithmonë profetëve të gjallë. Mësimet e tyre pasqyrojnë vullnetin e Zotit, i cili ka bërë të ditur: “Atë që unë, Zoti, kam thënë, e jam thënë dhe nuk justifikohem; dhe ndonëse qiejt dhe toka do të kalojnë, fjala ime nuk do të kalojë, por do të përmbushet e gjitha, qoftë nëpërmjet zërit tim apo nëpërmjet zërit të shërbëtorëve të mi është njësoj” (DeB 1:38).

Siguria juaj më e madhe gjendet në ndjekjen e përpiktë të fjalës së Zotit që jepet nëpërmjet profetëve të Tij, veçanërisht të Presidentit të tanishëm të Kishës. Zoti paralajmëron se ata që nuk marrin parasysh fjalët e profetëve të gjallë, do të bien



(shih DeB 1:14-16). Ai i premtun bekime të mëdha atyre që ndjekin Presidentin e Kishës:

“Ju duhet t’u vini veshin fjalëve dhe urdhërimeve të tij, që ai do t’ua japë ashtu siç i merr ato, duke ecur gjithë shenjtëri përpara meje;

Sepse fjalën e tij duhet ta merrni si nga goja ime, plot durim e besim.

Pasi duke i bërë këto gjëra, portat e ferrit nuk do të hapen kundër jush; po, dhe Zoti Perëndi do t’i shpërndajë fuqitë e errësirës përpara jush dhe do të bëjë që qiejt të dridhen për të mirën tuaj dhe për lavdinë e emrit të tij” (DeB 21:4-6).

Referime shtesë: 2 Kronikave 20:20; Amosi 3:7; Efesianëve 2:19-20; 1 Nefi 22:1-2; Mosia 13:33-35; DeB 107:91-92; Nenet e Besimit 1:6

## **Punë Misionare**

Kur ne i përjetojmë bekimet e jetës me ungjillin, dëshirojmë në mënyrë të natyrshme t’ua japim edhe të tjerëve ato bekime. Zoti foli për gëzimin që hyn në jetën tonë kur shpërndajmë ungjillin e tij:

“Nëse është që ju duhet të punoni gjithë ditët tuaja për t’u shpallur pendim këtyre njerëzve dhe sillni qoftë edhe një shpirt tek unë, sa i madh do të jetë gëzimi juaj me të në mbretërinë e Atit tim!

Dhe tani, nëse gëzimi juaj do të jetë i madh me një shpirt që keni sjellë tek unë në mbretërinë e Atit tim, sa i madh do të jetë gëzimi juaj nëse do të më sillni shumë shpirtra!” (DeB 18:15-16).

Detyra e Secilit Anëtar si Misionar

Zoti ka njoftuar hapur se puna misionare është përgjegjësi për të gjithë Shenjtorët e Ditëve të Mëvonshme (shih DeB 88:81). Duke qenë anëtar i Kishës së Zotit, ju mundeni që, me anë të mirësisë së jetës suaj dhe të forcës së dëshmisë, të ndihmoni për përgatitjen e anëtarëve të familjes,

të miqve e të të njohurve të tjerë që keni, që të takohen me misionarët kohëplotë.

Mesazhi më i fuqishëm misionar që mund të dërgoni ju, është shembulli vetjak i jetës së lumtur që jetoni si shenjtor i ditëve të mëvonshme. Mbani mend se njerëzit nuk bashkohen me Kishën vetëm për shkak të parimeve që mësojnë. Bashkohen sepse ndjejnë diçka që fillon të kënaqë nevojat e tyre shpirtërore. Në rast se jeni i sigurtë në miqësinë me ta, ata do të jenë në gjendje të ndiejnë shpirtin e dëshmisë dhe të lumturisë suaj.

Përveç qëndrimit me shembullin e mirë, mund të “[jeni] gjithnjë gati për [t’u] përgjigjur . . . kujt do që ju kërkon shpjegime për shpresën që është në ju” (1 Pjetri 3:15). Mund të luteni për mundësi që t’u tregoni të tjerëve për ungjillin e rivendosur. Pastaj rritni në gatishmëri, sepse shumë njerëz kanë etje për të vërtetën.

### Shërbimi në Mision Kohëplotë

Pas Ringjalljes, Zoti i urdhëroi dishepujt e Tij që të “[shkonin] . . . dhe [të bënin] dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë” (Mateu 28:19). Për të plotësuar këtë urdhërim, të rinjtë e aftë në Kishë kanë detyrën që të përgatiten shpirtërisht, fizikisht dhe nga ana e zotërimit emocional, për të shërbyer si misionarë kohëplotë. Të rejat beqare dhe çiftet e rritura gjithashtu kanë mundësi të shërbejnë misione kohëplotë. Nëse keni dëshirë të shërbeni në mision kohëplotë, flisni me peshkopin ose me presidentin e degës suaj.

### Shërbesa ndaj Anëtarëve të Rinj të Kishës

Puna misionare përfshin ndihmën dhe përkrahjen e atyre që i bashkohen Kishës. Kur mendoni thellë për këtë përgjegjësi, sillni ndër mend që anëtarët e rinj përballen me sprova në kohën që i bashkohen Kishës. Zotimet e reja që kanë marrë kërkojnë shpesh që ata të lënë mënjane zakone të vjetra dhe

të lënë miq e shoqëri të vjetra. Veç kësaj, Kisha parashtroi një rrugë jete që mund t'u duket e ndryshme dhe kërkuese.

Secilit anëtar të ri të Kishës i nevojiten tre gjëra: një shok, një përgjegjësi dhe ushqim "nga fjala e mirë e Perëndisë" (Moroni 6:4). Ju mund të jeni pjesë e përpjekjes për sigurimin e kësaj ndihme. Mund të jeni gjithnjë mik. Edhe sikur të mos jeni në detyrën e atij që jep zyrtarisht thirrje në Kishë, mund të punoni përkrah anëtarëve të rinj si një veprim shërbimi. Mund të kërkoni edhe raste për të folur me anëtarët e rinj për fjalën e Perëndisë.

Referime shtesë: Marku 16:15; Alma 26:1-16; DeB 4; 60:2; 84:88; 123:12

## **Punë për Historinë e Familjes dhe Gjenealogji**

Më 3 prill 1836 profeti Elia erdhi tek Jozef Smithi dhe Oliver Kaudëri në Tempullin e Kërtlendit. Ai u dha atyre fuqinë vulosëse të priftërisë, duke e bërë të mundur vulosjen e familjeve përgjatë brezave. Me dhënien e kësaj fuqie ai plotësoi profecinë se Zoti do ta dërgonte atë "për t'i kthyer zemrat e etërve tek fëmijët dhe të fëmijëve tek etërit" (shih DeB 110:14-16; shih gjithashtu Malakia 4:5-6).

Nëpërmjet punës për historinë e familjes ju mund të bëheni pjesëmarrës në plotësimin e vazhdueshëm të kësaj profecie. Mund të mësoni mbi paraardhësit tuaj dhe ta shtoni dashurinë për ta. Mund të frymëzoheni prej historive të guximit e të besimit të tyre. Mund t'ua përcillni atë trashëgimi fëmijëve tuaj.

Këto janë bekime të qëndrueshme që vijnë nga puna për historinë e familjes, por ato nuk janë arsytet parësore në përpjekjen e madhe të Kishës për të mbledhur regjistrime gjenealogjike. Të gjitha përpjekjet e Kishës për historinë e familjes drejtohen nga kërkesa për të formuar një "lidhje bashkëngjitëse . . . midis etërve dhe fëmijëve" (DeB 128:18). Kjo lidhje bashkëngjitëse formohet me anë të fuqisë së priftërisë, nëpërmjet ordinancave të shenjta të tempullit që i marrim në emër të paraardhësve tanë.

## Shëlbimi i të Vdekurve

Shumë fëmijë të Atit Qiellor kanë vdekur pa patur mundësi të marrin plotësinë e ungjillit. Me mëshirën dhe dashurinë e Tij të pafundme, Zoti ka përgatitur një mënyrë që ata të fitojnë dëshmi për ungjillin dhe të marrin ordinancat shpëtuese të priftërisë.

Në botën e shpirtave ungjilli u “[predikohet] atyre që [kanë] vdekur në mëkatet e tyre, pa një dituri të së vërtetës ose të shkëljes, duke mohuar profetët. Këtyre [u mësohet] besim në Perëndinë, pendim nga mëkati, pagëzimi mëkëmbës për heqjen e mëkateve, dhurata e Frymës së Shenjtë me anë të vënies së duarve, dhe të gjitha parimet e tjera të ungjillit të cilat [janë] të nevojshme për ta për t’i ditur, me qëllim që të [cilësohen] se mund të [gjykohen] sipas njerëzve në mish, por të [jetojnë] sipas Perëndisë në shpirt” (DeB 138:32-34).

Shumë vetë në botën e shpirtave e përqafojnë ungjillin. Megjithatë, ata s’mund të marrin ordinancat e priftërisë për vete, sepse nuk kanë trup fizik. Në tempujt e shenjtë ne kemi privilegjin të marrim ordinancat në emër të tyre. Këto ordinanca përfshijnë pagëzimin, konfirmimin, shugurimin e Priftërisë Melkizedeke (për burrat), indaumentin, vulosjen e martesës dhe vulosjen e fëmijëve tek prindërit. Zoti ia zbuloi këtë punë Profetit Jozef Smith, duke rivendosur një praktikë që u ishte zbuluar shpejt të krishterëve, pak mbas Ringjalljes së Jezu Krishtit (shih 1 Korintasve 15:29).

Kur merrni ordinancat e priftërisë në emër të atyre që kanë vdekur, ju bëheni për ta një shpëtimtar mbi Malin Zion (shih Abdia 1:21). Mundimi juaj i afrohet shpirtit të sakrificës shlyese të Shpëtimtarit—ju kryeni për të tjerët një punë të cilën ata s’mund ta bëjnë për veten.

## Përgjegjësitë Tuaja në Punën për Historinë e Familjes

Në punën për historinë e familjes keni tre përgjegjësi themelore:

1. Të merrni ordinancat e tempullit për vete dhe të ndihmoni anëtarët më të afërm të familjes që t'i marrin ato.
2. Të mbani një rekomandim tempulli të kohës së tanishme dhe të vizitoni tempullin aq shpesh sa t'jua lejojnë rrethanat.
3. Të grumbulloni informacion për historinë e familjes, që kështu të arrini të ndihmoni paraardhësit tuaj t'i marrin bekimet e tempullit.

Mund të merrni pjesë në punën e tempullit dhe të historisë së familjes, në një farë mase së paku, pavarësisht se ku jetoni ose si janë rrethanat tuaja. Ndonëse mundet që të mos jeni të aftë të bëni gjithçka, ju mund të bëni diçka. Idetë që vijnë mund t'ju ndihmojnë t'ia filloni:

- Regjistroni detaje të rëndësishme mbi vetë jetën tuaj. Regjistroni datëlindjen dhe vendlindjen tuaj dhe datat e pagëzimit e të konfirmimit tuaj. Mbani ditar vetjak për të regjistruar momentet më të rëndësishme të jetës suaj, duke përfshirë përvoja personale që do të forcojnë besimin e fëmijëve tuaj dhe brezave të tjerë të ardhshëm.
- Mësoni mbi paraardhësit tuaj. Filloni me regjistrimin e informacionit që keni në kujtesë dhe nga burimet që mund t'i keni në shtëpi. Regjistroni informacionin jetik që e mbani mend mirë ose që mund ta gjeni, mbi vëllezërit e motrat, prindërit, xhaxhallarët e dajallarët, hallat e tezet, gjyshërit e stërgjyshërit. Aty ku ka mundësi, merrni kopje certifikatash ose dokumentesh të tjera që e përmbajnë atë informacion. Ndërsa grumbulloni më shumë informacione, mund t'ju lindë dëshira për të kërkuar në terrene të tjera, si për shembull regjistrat publikë. Lagjja apo dega lokale mund të ketë një këshillues për historinë e familjes, i cili mund t'ju ndihmojë. Gjithashtu mund t'ju lindë dëshira të

vizitoni në internet faqen zyrtare të Kishës për historinë e familjes, [www.familysearch.org](http://www.familysearch.org).

- Ndërsa përcaktoni paraardhësit tuaj, përdorni tabelat e prejardhjes familjare dhe formularët e grupeve familjare për të regjistruar informacionin që gjeni. Këto formularë gjenden si fleta dhe gjithashtu si programe kompjuterike të prodhuara nga Kisha, si për shembull, Personal Ancestral File.

Kur ta keni mbledhur informacionin e nevojshëm mbi paraardhësit tuaj që kanë vdekur pa marrë ungjillin, sigurohuni që të kryhet puna e tempullit për ta. Edhe sikur të mos jetoni aq pranë një tempulli, që ju dhe anëtarët e familjes suaj të jeni në gjendje të bëni punën e ordinancave, ju mund t’i paraqisni emrat e paraardhësve tek një tempull, që të tjerët të kenë mundësi për të bërë punën për ta. Mund t’ju jepet mundësia që të vizitoni një qendër të afërt të historisë së familjes ose që të konsultoheni me një këshillues për histori të familjes në degë ose lagje për të parë se si të veproni.

Profeti Jozef Smith shpalli se ekzistojnë “parime në lidhje me të vdekurit dhe të gjallët, të cilat nuk duhet të kalohen me lehtësi, përse i përket shpëtimit tonë. Sepse shpëtimi i tyre është i nevojshëm dhe thelbësor për shpëtimin tonë, sikurse . . . ata pa ne nuk mund të bëhen të përsosur—as ne nuk mundemi, pa të vdekurit tanë, të bëhemi të përsosur” (DeB 128:15). Nëpërmjet pjesëmarrjes suaj në punën e historisë së familjes, ju dhe paraardhësit tuaj përparoni drejt shpëtimit.

*Shih gjithashtu Tempuj*

## Qenie

Termi *qenie* përdoret në dy mënyra në shkrimet e shenjta. Së pari, shpirti që bashkohet me një trup fizik, qoftë në vdekshmëri, qoftë mbas ringjalljes, quhet qenie (shih DeB 88:15-16).

Së dyti, shpirtirat tanë nganjëherë janë quajtur qenie (shih Alma 40:15-18; Abrahami 3:23).

*Shih gjithashtu* Plani i Shpëtimit; Ringjallje; Shpirt

**Qeveri** (*Shih* Qeverisje dhe Ligj Civil)

## Qeverisje dhe Ligj Civil

Seksioni 134 i Doktrinës e Besëlidhjeve përvijon “[besimin e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme] lidhur me qeveritë dhe ligjet tokësore në përgjithësi” (DeB 134, kreu i seksionit). Seksioni mëson parimet që vijnë:

Ne besojmë se qeveritë u krijuan nga Perëndia për përfitim të njeriut; dhe se ai i mban njerëzit përgjegjës për veprimet e tyre në lidhje me to, si në përgatitjen e ligjeve, edhe në administrimin e tyre, për të mirën dhe sigurinë e shoqërisë . . .

Ne besojmë se të gjithë njerëzit janë të detyruar të mbështesin dhe të përkrahin qeveritë përkatëse, në të cilat qëndrojnë, ndërsa mbrohen në të drejtat e tyre të natyrshme dhe të patjetërsueshme me anë të ligjeve të qeverive të tilla; dhe që kryengritja dhe rebelimi janë të padobishme për çdo qytetar të mbrojtur në këtë mënyrë dhe duhet të ndëshkohen në përputhje me to; dhe që gjithë qeveritë kanë të drejtë të nxjerrin ligje të tilla që, sipas gjykimit të tyre, janë llogaritur më të mirat për të garantuar interesin publik; në të njëjtën kohë, megjithatë, duke e mbajtur të shenjtë lirinë e ndërgjegjes.

Ne besojmë se çdo njeri duhet të nderohet në detyrën e tij, sundimtarët dhe gjykatësit si të tillët, duke qenë të vendosur për mbrojtjen e të pafajshmëve dhe ndëshkimin e fajtorëve; dhe që të gjithë njerëzit iu detyrohen ligjeve respekt dhe nderim, pasi pa to, paqja dhe harmonia do të zëvendësohen nga anarkia dhe terrori; ligjeve njerëzore duke qenë të krijuara për qëllimin e veçantë të rregullimit të interresave tona si individë dhe si kombe, midis një njeriu dhe një

tjetri; dhe ligjeve hyjnore të dhëna nga qielli, duke dhënë rregulla për çështje shpirtërore, për besimin dhe adhurimin, për të dyja njeriu duhet t'i përgjigjet Krijuesit të tij" (DeB 134:6).

Një element kyç i ndarjes së kishës nga shteti është përgjegjësia e qeverisë për të garantuar lirinë fetare. Profetët e ditëve të mëvonshme e përkrahin këtë parim, siç shpallet në nenin e njëmbëdhjetë të besimit: "Ne shpallim privilegjin e adhurimit të Perëndisë të Plotfuqishëm në përputhje me zërin e ndërgjegjes sonë dhe u lejojmë të gjithë njerëzve të njëjtin privilegj, që ata duhet të adhurojnë si, ku dhe çfarë të zgjedhin". Në përputhje me ndarjen e kishës nga shteti, Kisha nuk vë firmë për asnjë parti ose kandidat politik. Ajo nuk lejon përdorimin e ndërtesave dhe pajisjeve për qëllime politike. Kisha nuk merr pjesë në politikat qeveritare, veç kur është në shqyrtim një çështje morali, në të cilin rast Kisha shpesh do të flasë hapur.

Edhe pse Kisha mbetet politikisht asnjëansore, udhëheqësit e Kishës inkurajojnë anëtarë të veçantë të përfshihen si qytetarë. Si Shenjtorë të Ditëve të Mëvonshme, ju duhet të kuptoni vendin dhe pozitën tuaj në shtetin ku jetoni. Mësoni mbi historinë, trashëgiminë dhe ligjet e vendit. Nëse keni mundësi të votoni dhe të merrni pjesë në punë qeveritare, angazhohuni aktivisht në mbështetje dhe mbrojtje të parimeve të së vërtetës, drejtësisë dhe lirisë.

Referime shtesë: DeB 98:10; Nenet e Besimit 1:12

## Qiell

Në shkrimet e shenjta fjala *qiell* përdoret në dy mënyra themelore. Së pari, ajo lidhet me vendin kur jeton Perëndia, vend që është shtëpia bazë e besnikëve (shih Mosia 2:41). Së dyti, lidhet me hapësirën rreth tokës (shih Zanafilla 1:1).

Referime shtesë: Psalmet 11:4; Mateu 6:9; 1 Nefi 1:8; Mosia 3:8; DeB 20:17

*Shih gjithashtu Mbretëri të Lavdisë*



## Rënie

Në Kopshtin e Edenit Perëndia urdhëroi: “Nga çdo pemë e këtij kopshti ti mund të hash lirisht, por nga pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes, ti nuk do të hash prej saj, megjithatë, ti mund të zgjedhësh vetë, sepse të është dhënë ty; por, kujto që unë ta ndaloj atë, sepse në ditën do të hash prej saj, ti me siguri do të vdesësh” (Moisiu 3:16-17). Ngaqë Adami dhe Eva shkelën këtë urdhërim dhe morën prej frutit të pemës së njohurisë të së mirës dhe së keqes, ata u dëbuan nga prania e Zotit (shih DeB 29:40-41). Me fjalë të tjera, ata përjetuan vdekjen shpirtërore. Gjithashtu ata u bënë të vdekshëm—të prekshëm nga vdekja fizike. Kjo vdekje shpirtësore dhe fizike quhet Rënie.

### Gjendja Jonë e Rënë

Duke qenë pasardhës të Adamit dhe të Evës, ne trashëgojmë një gjendje të rënë gjatë vdekshmërisë (shih Alma 42:5-9, 14). Jemi të shkëputur nga prania e Zotit dhe i nënshtrohemi vdekjes fizike. Gjithashtu caktohem në një sistem kundërshtues, në të cilin provohemi me anë të vështirësive të jetës dhe tundimeve të kundërshtarit (shih 2 Nefi 2:11-14; DeB 29:39; Moisiu 6:48-49).

Në këtë gjendje të rënë ne kemi kontradiktë brenda vetes. Ne jemi fëmijët shpirtërorë të Perëndisë, me mundësinë që të jemi “pjesëtarë të natyrës hyjnore” (2 Pjetri 1:4). Megjithatë, “jemi të padenjë para [Perëndisë]; për shkak të rënies, natyra jonë është bërë e ligë vazhdimisht” (Ethëri 3:2). Na nevojitet të mundohemi vazhdimisht që të mposhtim ndjenjat dhe dëshirat e padrejta.

Duke përsëritur fjalët e një engjëlli, Mbreti Benjamin tha: “Njeriu i natyrshëm është një armik ndaj Perëndisë dhe ka qenë që nga rënia e Adamit”. Mbreti Benjamin paralajmëroi që në këtë gjendje të natyrshme, ose të rënë, çdo njeri do të jetë armik ndaj Perëndisë përgjithmonë, “nëse ai nuk dëgjon thirrjet e Frymës së Shenjtë dhe nuk zhvesh njeriun e natyr-

shëm dhe nuk bëhet një shenjtor nëpërmjet shlyerjes së Krishtit Zot, dhe nuk bëhet si një fëmijë, i nënshtruar, i bindur, i përlur, i duruar, plot me dashuri, i gatshëm t'u nënshtrohet të gjitha gjërave që Zoti i sheh të përshtatshme të shkaktojë mbi të, madje sikurse një fëmijë i nënshtrohet atit të tij" (Mosia 3:19).

### Dobitë e Rënies

Rënia është një pjesë thelbësore e planit të shpëtimit të Atit Qiellor (shih 2 Nefi 2:15-16; 9:6). Ajo ka një drejtim të dyfishtë—zbritës, por megjithatë avancues. Veç fillimit të vdekjes fizike dhe shpirtërore ajo na dha mundësinë të lindemi mbi tokë dhe të mësojmë e të përparojmë. Nëpërmjet ushtrimit të drejtë të lirisë sonë për të zgjedhur dhe pendimit të sinqertë kur mëkatojmë, ne mund të vijmë tek Krishti dhe, nëpërmjet Shlyerjes së Tij, të përgatitemi për të marrë dhuratën e jetës së përjetshme. Profeti Lehi mësoi:

"Nëse Adami nuk do të kishte shkelur, ai nuk do të kishte rënë, por ai do të kishte qëndruar në kopshtin e Edenit. Dhe të gjitha gjërat që ishin krijuar, do të kishin qëndruar në të njëjtën gjendje që ato ishin pasi u krijuan; dhe ato do të kishin qëndruar përgjithmonë dhe nuk do të kishin fund.

Dhe [Adami dhe Eva] nuk do të kishin pasur fëmijë; prandaj ata do të kishin qëndruar në një gjendje pafajësie, pa patur gëzim, pasi ata nuk njihnin mjerim; duke mos bërë të mirë, pasi ata nuk njihnin mëkat.

Por, vini re, të gjitha gjërat janë bërë në diturinë e atij që i di të gjitha gjërat.

Adami ra që njerëzit të mund të jenë; dhe njerëzit janë, që ata të mund të kenë gëzim.

Dhe Mesia vjen në plotësinë e kohës, që ai të mund të shëlbojë fëmijët e njerëzve nga rënia" (2 Nefi 2:22-26; shih gjithashtu vargjet 19-21, 27).

Adami dhe Eva shprehën mirënjohjen e tyre për bekimet që erdhën si rezultat i Rënies.

Adami lëvdoi Perëndinë e u ndie plot dhe filloi të profetizonte lidhur me të gjitha familjet e tokës, duke thënë se i bekuar ishte emri i Perëndisë. Ai tha se sytë e tij qenë hapur për shkak të shkeljes së tij—që në këtë jetë ai do të kishte gëzim dhe që në mish përsëri do të shihte Perëndinë.

Eva, bashkëshortja e tij, i dëgjoi të gjitha këto gjëra dhe u gëzua, duke thënë se, po të mos ishte për shkeljen e tyre, nuk do të kishin pasur kurrë pasardhës dhe nuk do të kishin njohur kurrë të mirën e të ligën dhe gëzimin për shëlbimin e tyre, dhe jetën e përjetshme që Perëndia u jep gjithë të bindurve (shih Moisiu 5:10-11).

### Shëlbimi nga Rënia

Për arsye të natyrës sonë të rënë e të vdekshme dhe të mëkateve vetjake, shpresa jonë e vetme është tek Jezu Krishti dhe plani i shëlbimit.

Nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit gjithkush do të shëlbohet nga ndikimet e Rënies. Ne do të ringjallemi dhe do të sillemi në praninë e Zotit që të gjykohe mi (shih 2 Nefi 2:5-10; Alma 11:42-45; Helamani 14:15-17).

Veç shëlbimit tonë prej efekteve të përgjithshme të Rënies, Shpëtimtari mund të na shëlbojë nga mëkatet vetjake. Në gjendjen tonë të rënë ne mëkatojmë dhe e mbajmë veten larg nga Zoti, duke sjellë mbi vete vdekjen shpirtërore. Siç tha Apostulli Pali, “të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë” (Romakëve 3:23). Në qoftë se rrimë në mëkatet tona, nuk mund të banojmë në prani të Perëndisë, sepse “asgjë e papastër nuk mund të banojë . . . në prani të tij” (Moisiu 6:57). Për fat të mirë, Shlyerja “përmbush kushtin e pendimit” (Helamani 14:18), duke na bërë të mundur të marrim falje për mëkatet tona dhe të banojmë në prani të Perëndisë përgjithmonë. Alma mësoi: “Njeriut iu dha një interval kohe, gjatë të cilit ai mund të pendohej; prandaj kjo jetë u bë një gjendje e përkohshme prove; një kohë për t’u përgatitur që të takojmë Perëndinë; një kohë për t’u përga-

titur për atë gjendje pa mbarim, për të cilën folëm ne, e cila është pas ringjalljes së të vdekurve” (Alma 12:24).

Mirënjohje për Sakrificën Shlyese të Shpëtimtarit

Tamam ashtu siç nuk duam vërtet ushqim derisa të kemi uri, ne nuk do të dëshirojmë tamam shpëtim të përjetshëm, deri kur të pranojmë që kemi nevojë për Shpëtimtar. Ky pranim vjen kur e zhvillojmë kuptimin për Rënien. Siç mësoi profeti Lehi, “i tërë njerëzimi ishte në një gjendje të humbur dhe të rënë dhe gjithmonë do të ishte ashtu, nëse nuk do të mbështetej në këtë Shëlbues” (1 Nefi 10:6).

Referime shitesë: Zanafilla 3; Mormoni 9:12-14; Moisiu 4

*Shih gjithashtu* Liri e Zgjedhjes; Mëkat; Mëkat Fillestar; Plani i Shpëtimtarit; Shlyerja e Jezu Krishtit

**Rilindur (i)** (*Shih* Kthim; Pagëzim; Shpëtim)

## Ringjallje

Për arsye të Rënies së Adamit dhe Evës, i nënshtrohemi vdekjes fizike, e cila është ndarja e shpirtit nga trupi. Nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit, të gjithë njerëzit do të ringjallen—të shpëtuar nga vdekja fizike (shih 1 Korintasve 15:22). Ringjallja është ribashkimi i shpirtit me trupin në një gjendje të përkryer e të pavdekshme, që nuk i nënshtrohet më sëmundjeve ose vdekjes (shih Alma 11:42-45).

Shpëtimtari ishte njeriu i parë që do të ringjallej në këtë tokë. Dhjata e Re përmban disa përmbledhje që dëshmojnë se Ai u ngrit nga varri (shih Mateu 28:1-8; Marku 16:1-14; Lluka 24:1-48; Gjoni 20:1-29; 1 Korintasve 15:1-8; 2 Pjetri 1:16-17).

Kur Zoti i ringjallur iu shfaq Apostujve të Tij, i ndihmoi ata të kuptonin se Ai kishte trup prej mishi e kocke. Ai tha: “Shikoni duart e mia dhe këmbët e mia, sepse unë jam. Më prekni dhe shikoni, sepse një frymë nuk ka mish e eshtra,

si po shihni se unë kam!" (Lluka 24:39). Ai gjithashtu iu shfaq ne fitëve pas Ringjalljes së Tij (shih 3 Nefi 11:10-17).

Në kohën e ringjalljes, ne do të "[gjykohe] sipas veprave [tona] . . . Ne do të sillemi që të qëndrojmë para Perëndisë, duke ditur madje siç dimë tani dhe duke pasur një kujtesë të mirë të të gjithë fajit tonë" (Alma 11:41, 43). Lavdia e përjetshme që marrim do të varet nga besnikëria jonë. Edhe pse të gjithë do të ringjallen, vetëm ata që kanë ardhur te Krishti dhe kanë marrë nga plotësia e ungjillit të Tij, do të trashëgojnë ekzaltimin në mbretërinë çelestiale.

Kuptimi dhe dëshmia për ringjalljen mund t'ju japin shpresë dhe pamje për të ardhmen atëherë kur përjetoni sfidat, sprovat dhe fitoret e jetës. Mund të gjeni lehtësim tek siguria se Shpëtimtari jeton dhe se nëpërmjet Shlyerjes së Tij, "ai këput rripat e vdekjes, që varri të mos ketë fitore dhe thumbi i vdekjes të gjëllitet në shpresat e lavdisë" (Alma 22:14).

Referime shtesë: Isaia 25:8; 26:19; Gjoni 5:25-29; 11:25-26; 1 Korintasve 15; Enosi 1:27; Alma 40:23-26; 41; Mormoni 9:12-14; DeB 88:15-16; 93:33-34; Moisiu 1:39

*Shih gjithashtu* Mbretëri të Lavdisë; Plani i Shpëtimit; Qenie; Shlyerja e Jezu Krishtit; Shpëtim; Vdekje Fizike

## **Rivendosje e Ungjillit**

Kur Jezu Krishti ishte në tokë, Ai themeloi Kishën e Tij mes pasuesve të Tij. Pas Kryqëzimit të Tij dhe vdekjes së Apostujve të Tij, ungjilli në formën e tij të plotë u mor nga toka për shkak të përhapjes së gjerë të braktisjes (shih "Braktisje", faqe 26-27). Shumë burra e gra e kërkuan plotësinë e së vërtetës së ungjillit gjatë shekujve të Braktisjes së Madhe, por nuk qenë në gjendje ta gjenin. Megjithëse shumë vetë predikuan sinqerisht për Shpëtimtarin dhe për mësimet e Tij, asnjë nuk pati të vërtetën e plotë ose autoritetin e priftërisë nga Perëndia.

Braktisja e Madhe ishte kohë e errësirës shpirtërore, por tani ne jetojmë në kohën kur mund të marrim nga "drita e ungjillit të lavdisë së Krishtit" (2 Korintasve 4:4; shih gjitha-

shtu DeB 45:28). Plotësia e ungjillit është rivendosur dhe Kisha e Jezu Krishtit është përsëri mbi tokë. Asnjë organizim tjetër nuk mund të krahasohet me të. Ajo nuk është pasojë e reformave, nga burra e gra të qëllimit të mirë që bëjnë gjithçka që munden që të sjellin ndryshim. Ajo është rivendosja e Kishës që u themelua nga Jezu Krishti. Është puna e Atit Qiellor dhe e Birit të Tij të Dashur.

Duke qenë anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, ju mund të merrni bekime që i kanë munguar tokës për gati 2000 vjet. Nëpërmjet ordinancave të pagëzimit dhe të konfirmimit ju mund të merrni heqjen e mëkateve dhe të gëzoni privilegjin e shoqërisë së vazhdueshme të Frymës së Shenjtë. Mund të jetoni ungjillin sipas plotësisë dhe thjeshtësisë së tij. Mund të fitoni kuptim për natyrën e Kreut-Perëndi, Shlyerjen e Jezu Krishtit, qëllimin e jetës në tokë dhe të vërtetën e jetës pas vdekjes. Ju keni privilegjin të udhëhiqeni nga profetë të gjallë, që na mësojnë vullnetin e Perëndisë në kohën tonë. Ordinancat e tempullit ju krijojnë mundësi që të merrni udhëzim dhe paqe, të përgatiteni për jetë të përjetshme, të vuloseni me familjen për në përjetësi dhe sigurojnë ordinanca shpëtuese për stërgjyshërit tuaj të vdekur.

## Ngjarje të Shquara të Rivendosjes

Paraqitja e shkurtër që vijon përmbledh disa nga ngjarjet e rëndësishme në rivendosjen e ungjillit dhe në themelimin e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, për të cilën Zoti ka njoftuar hapur se është “[e vetmja] kishë [e] vërtetë dhe [e] gjallë mbi faqen e tërë dheut” (DeB 1:30).

*Fillim pranvere, 1820.* Në kërkim të Kishës së vërtetë të Jezu Krishtit, Jozef Smithi 14-vjeçar u lut në një korije pranë shtëpisë së tij në Palmira të Nju Jorkut. Duke iu përgjigjur lutjes së tij të përulur, Ati Qiellor dhe Jezu Krishti e vizituan dhe i thanë që ai nuk duhej të bashkohej me asnjë kishë të asaj kohe mbi tokë. (Shih

Joseph Smith—Historia 1:11-19). Në Kishë e përmendim këtë përjetim si Vegimi i Parë i Jozef Smithit.

21-22 shtator 1823. Jozef Smithi u vizitua nga një engjell i quajtur Moroni. Moroni profetizoi për ngjarjet në ardhje e sipër dhe i tregoi Jozefit për Librin e Mormonit, të shkruar në fletë ari. Engjëlli e lejoi Jozefin t'i shihte fletët e arta, të cilat ishin groposur në kodrën e afërt Kumorah. (Shih Joseph Smith—Historia 1:27-53.)

22 shtator 1827. Jozef Smithi i mori fletët e arta nga Moroni tek kodra Kumorah, pasi ishte takuar me Moronin në çdo 22 shtator të katër viteve të mëparshme. (Shih Joseph Smith—Historia 1:53, 59).

15 maj 1829. Pasi kishin lexuar mbi pagëzimin për heqjen e mëkateve, ndërsa punonin me përkthimin e fletëve të arta, Jozef Smithi dhe shkruesi i tij, Oliver Kaudëri, shkuan në një vend të veçuar që t'i kërkonin Zotit përta i përkiste asaj çështjeje. Atje, në brigjet e lumit Saskuihena, pranë Harmonisë në Pensilvani, ata morën përgjigjen e lutjes së tyre. Gjon Pagëzori, qenie e ringjallur, erdhi tek ata si “një lajmëtar nga qielli . . . mbi një re drite”. Ai u dha atyre Priftërinë Aarone. Pastaj, duke iu bindur udhëzimeve të tij, Jozefi dhe Oliveri pagëzuan njëri-tjetrin dhe shuguruan njëri-tjetrin në Priftërinë Aarone. (Shih Joseph Smith—Historia 1:68-72; shih gjithashtu DeB 13.)

Maj 1829. Apostujt e lashtësisë Pjetri, Jakobi dhe Gjoni u dhanë Priftërinë Melkizedeke Jozef Smithit dhe Oliver Kaudërit. (Shih DeB 128:20.)

Qershor 1829. I drejtuar “me anë të dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë” (DeB 135:3), Profeti Jozef Smith përfundoi përkthimin e Librit të Mormonit.

26 mars 1830. Kopjet e para të shtypura të Librit të Mormonit ishin të gatshme për përdorim në Palmira të Nju Jorkut.

6 prill 1830. U formua Kisha, në Feiet Taunship, Nju Jork, duke filluar me gjashtë anëtarë.

27 mars 1836. U dedikua Tempulli i Kërtlëndit, tempulli i parë i ndërtuar në këtë periudhë ungjillore. Profeti Jozef Smith dha lutjen dedikuese, e cila iu dha me anë të zbulësës. (Shih DeB 109.)

3 prill 1836. Shpëtimtari iu shfaqet Jozef Smithit dhe Oliver Kaudërit në Tempullin e Kërtlëndit. U shfaqën gjithashtu Moisiu, Eliasi dhe Elia dhe u dhanë çelësat e priftërisë Jozefit dhe Oliverit. Elia solli çelësat e fuqisë së vulosjes, e cila bën të mundur që familjet të vulosen së bashku përgjithnjë. (Shih DeB 110.)

### Fati i Paracaktuar i Kishës

Profeti Daniel i Dhjatës së Vjetër profetizoi që Perëndia do të “nxjerrë një mbretëri” që “nuk do të shkatërrohet kurrë” dhe do të “ekzistojë përjetë” (Danieli 2:44). Duke bërë këtë profeci, ai foli për Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, mbretërinë e Perëndisë në tokë sot. Që nga dita që Kisha u formua me gjashtë anëtarë, ajo është rritur e ka lulëzuar dhe do të vazhdojë të përparojë derisa të ketë “[mbushur] tërë tokën” (Danieli 2:35; shih gjithashtu DeB 65:2). Me qindra mijëra njerëz pagëzohen çdo vit. Libri i Mormonit po përkthehet në shumë gjuhë. Po ndërtohen tempuj kudo në botë. Duke pasur Jezu Krishtin në krye të Kishës, profetët e gjallë do të udhëheqin përparimin e Kishës derisa toka të jetë e përgatitur për Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit.

Profeti Jozef Smith foli për bekimet e Rivendosjes: “Tani, çfarë dëgjojmë në ungjillin që kemi marrë? Një zë kënaqësie!



## Sakrament

Një zë mëshire nga qielli; dhe një zë të vërtete nga toka; lajme të gëzuara për të vdekurit; një zë gëzimi për të gjallët dhe të vdekurit; lajme të gëzuara të gëzimit të madh" (DeB 128:19).

Referime shtesë: Isaia 2:1-3; 29:13-14; Veprat e Apostujve 3:19-21; Zbulesa 14:6-7; 2 Nefi 3:3-15; DeB 128:19-21; 133:36-39, 57-58; Joseph Smith—Historia

*Shih gjithashtu* Ardhja e Dytë e Jezu Krishtit; Braktisje; Jozef Smith; Zbulesë

## Sakrament

Një natë para Kryqëzimit të Tij, Jezu Krishti u takua me Apostujt e Tij dhe themeloi ordinancën e sakramentit. "Pastaj mori bukën, falënderoi, e theu dhe ua dha atyre duke thënë: 'Ky është trupi im, që është dhënë për ju; bëni këtë në përkujtimin tim'. Po kështu, pas darkës, mori kupën duke thënë: 'Kjo kupë është besëlidhja e re në gjakun tim, që është derdhur për ju'" (Lluka 22:19-20). Mbas Ringjalljes së Tij Ai themeloi sakramentin mes ne fitëve (shih 3 Nefi 18:1-11).

Sot ne marrim nga buka dhe uji në kujtim të sakrificës shlyese të Jezu Krishtit. Kjo ordinancë është një pjesë themelore e adhurimit tonë dhe e zhvillimit tonë shpirtëror. Sa më shumë të thellohemi duke menduar për kuptimin e saj, aq më e shenjtë bëhet ajo për ne.

## Kujtimi për Shpëtimtarin dhe Shlyerjen e Tij

Sakramenti jua bën të mundur ta kujtoni me mirënjohje jetën, shërbesën dhe shlyerjen e Birit të Perëndisë.

Me bukën e thyer ju kujtoni trupin e Tij. Mund të mendoni për vuajtjen e Tij fizike—veçanërisht vuajtjen e Tij në kryq. Mund të mendoni që, nëpërmjet mëshirës dhe hirit të Tij, të gjithë njerëzit do të ringjallen dhe do t'u jepet mundësia për jetë të përzetshme me Perëndinë.

Me një gotë të vogël me ujë, ju mund të kujtoni që Shpëtimtari derdhi gjakun e Tij në një vuajtje dhe ankth shpirt-

tëror shumë të madh, duke filluar në Kopshtin e Gjetsemanit. Atje Ai tha: “Shpirti im është thellësisht i trishtuar, deri në vdekje” (Mateu 26:38). Duke iu nënshtuar vullnetit të Atit, Ai vuajti më shumë nga ç’mund të kuptojmë ne: “Gjaku [doli] nga çdo pór, kaq e madhe [ishte] dhembja e tij për ligësinë dhe neveritë e popullit të tij” (Mosia 3:7). Mund të kujtoni që, nëpërmjet derdhjes së gjakut të Tij, Jezu Krishti ju shpëtoi juve dhe të gjithë njerëzit e tjerë nga ajo që shkrimet e quajnë “[faji] origjinal” i shkeljes së Adamit (Moisiu 6:54). Mund të kujtoni që Ai gjithashtu vuajti për mëkatet, hidhërimet dhe dhimbjet e të gjithë fëmijëve të Atit Qiellor, duke bërë të mundur heqjen e mëkateve për ata që pendohen dhe jetojnë ungjillin (shih 2 Nefi 9:21-23).

Rinovimi i Besëlidhjeve dhe Bekimet e Premtuara.

Kur merrni sakramentin, ju i dëshmoni Perëndisë që kujtimi për Birin e Tij do të shtrihet përtej kohës së shkurtër së asaj ordinance të shenjtë. Ju premtoni se do ta kujtoni Atë gjithmonë. Ju dëshmoni që jeni i gatshëm të merrni mbi vete emrin e Jezu Krishtit dhe që do të mbani urdhërimet e Tij. Në marrjen e sakramentit dhe në bërjen e këtyre zotimeve, ju rinovoni besëlidhjet tuaja të pagëzimit (shih Mosia 18:8-10; DeB 20:37).

Ju merrni bekime të mëdha kur mbani besëlidhjet e pagëzimit. Ndërsa ju e rinovoni atë, Zoti rinovon heqjen e premtuar të mëkateve tuaja. I pastruar nga mëkati, ju jeni i aftë “të [keni] gjithmonë Shpirtin e tij me [ju]” (DeB 20:77). Shoqëria e qëndrueshme e Shpirtit është një nga dhuratat më të mëdha që ju mund të merrni në vdekshmëri. Shpirti do t’ju udhëheqë në shtigjet e drejtësisë dhe të paqes, duke ju drejtuar drejt jetës së përjetshme me Atin tonë Qiellor dhe Jezu Krishtin.

Marrja me Denjësi

Në përgatitje për sakramentin çdo javë, ju duhet të kaloni kohë duke shqyrtuar jetën tuaj dhe duke u penduar

## Sakrificë

për mëkatet tuaja. Ju nuk duhet të jeni i përkryer që të merrni sakramentin, por duhet të keni një shpirt përulësie dhe pendimi në zemrën tuaj. Çdo javë ju duhet të përgatiteni për atë ordinancë të shenjtë me një zemër të thyer dhe shpirt të penduar (shih 3 Nefi 9:20).

Në qoftë se ju e trajtoni sakramentin me nderimin dhe solemnitetin që i përket, ai bëhet një mundësi e përjavshme për të analizuar veten, për t'u penduar dhe për t'u përku-shtuar rishtas—një burim force dhe një kujtim i vazhdue-shëm i Shlyerjes së Shpëtimtarit.

Referime shtesë: 1 Korintasve 11:23-29; Moroni 4-5; DeB 20:75-79; 27:2

*Shih gjithashtu* Besëlidhje; Shlyerja e Jezu Krishtit

## Sakrificë

Të sakrifikosh do të thotë të heqësh dorë nga diçka të cilën e çmojmë, për hir të diçkaje me më shumë vlerë. Si shenjtore të ditëve të mëvonshme, ne kemi mundësinë të sakrifikojmë gjëra të botës për Zotin dhe për mbretërinë e Tij. Anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme duhet të jenë të gatshëm të bëjnë çdo sakrificë që u kërkohet nga Zoti. Në qoftë se nuk do të na kërkohet të sakrifikonim, ne asnjëherë nuk do të mund të zhvillonim besimin e nevojshëm për shpëtimin e përjetshëm.

Shlyerja e Jezu Krishtit është sakrifica e madhe dhe e përjetshme në qendër të ungjillit (shih Alma 34:8-16). Përpara se Shpëtimtari të kryente Shlyerjen, populli i Tij i besëlidhjes sakrifikonte kafshë si simbol për sakrificën e Tij. Kjo praktikë i ndihmonte ata të shikonin përpara tek Shlyerja (shih Moisiu 5:4-8). Urdhërimi për të ofruar sakrifica kafshësh mbaroi me vdekjen e Jezu Krishit. Në Kishë sot marrim sakramentin në kujtim të sakrificës shlyese të Shpëtimtarit.

Përveç kujtimit të sakrificës shlyese të Jezu Krishtit, ne duhet të ofrojmë sakrificën tonë: një zemër të thyer dhe një shpirt të penduar. Shpëtimtari tha: “Ju nuk do të më ofroni më derdhje gjaku; po, flijimet tuaja dhe olokaustet tuaja do të

marrin fund . . . Dhe ju do të më ofroni për fli një zemër të thyer dhe një shpirt të penduar. Dhe kushdo që vjen tek unë me një zemër të thyer dhe një shpirt të penduar, atë do ta pagëztoj me zjarr dhe me Frymën e Shenjtë” (3 Nefi 9:19-20).

Të kesh një zemër të thyer dhe një shpirt të penduar, do të thotë të jesh i përlulur dhe perceptues ndaj vullnetit të Perëndisë dhe këshillës së atyre që Ai ka thirrur të udhëheqin Kishën e Tij. Gjithashtu do të thotë të ndjesh një keqardhje të thellë për mëkatet dhe një dëshirë të sinqertë për t’u penduar. Profeti Lehi theksoi rëndësinë ofrimit të kësaj sakrifice: “Vër re, ai ofron veten si sakrificë për mëkatin, për t’iu përgjigjur kërkesave të ligjit, për të gjithë ata që kanë një zemër të thyer dhe një shpirt të penduar; dhe për askënd tjetër nuk mund të plotësohen kërkesat e ligjit” (2 Nefi 2:7). Në qoftë se ne nuk ofrojmë sakrificën e zemrës së thyer dhe të shpirtit të penduar, ne nuk mund të marrim plotësisht bekimet që vijnë nga Shlyerja.

Në qoftë se ju jeni të gatshëm të sakrifikoni ashtu siç ka urdhëruar Zoti, ju do të pranoheni prej Tij. Ai na mësoi: “Të gjithë . . . mes atyre që e dinë se zemrat e tyre janë të pastra dhe të thyera dhe shpirtat e tyre të penduar, dhe janë të gatshëm t’i ruajnë besëlidhjet e tyre me anë të sakrificës—po, çdo sakrificë që unë, Zoti, do të urdhëroj—ata pranohen nga unë” (DeB 97:8). Me perspektivë të përjetshme, ju mund të shihni se, që të heqësh dorë nga gjërat e botës, nuk është aspak një sakrificë. Bekimet që ju merrni, janë më të mëdha se çdo gjë nga e cila mund të hiqni ndonjëherë dorë.

Referime shitesë: Mateu 19:16-22; DeB 59:8

*Shih gjithashtu* Dashuri; Pendim; Sakrament; Shërbim; Shlyerja e Jezu Krishtit

## Satani

Satani, gjithashtu i quajtur kundërshtari ose djalli, është armiku i drejtësisë dhe i atyre që përpiqen të ndjekin Perëndinë. Ai është një bir shpirtëror i Perëndisë i cili njëherë ishte një engjëll “në autoritet në praninë e Perëndisë” (DeB

76:25; shih gjithashtu Isaia 14:12; DeB 76:26-27). Por në Këshillin e paralindjes, në Qiell, Luciferi, siç quhej atëherë Satani, ngriti krye kundër Atit Qiellor dhe planit të shpëtimit. Në këtë rebelim kundër Perëndisë, Satani “kërkoi të shkatërronte lirinë e njeriut për të zgjedhur” (Moisiu 4:3). Ai tha: “Unë . . . do ta shëlboj gjithë njerëzimin, që asnjë shpirt të mos humbasë, dhe sigurisht do ta bëj atë; si rrjedhim, ma jep mua lavdinë tënde” (Moisiu 4:1).

Satani bindi “një [të tretën] e ushtrive të qiellit” të largoheshin nga Ati (DeB 29:36). Si rezultat i këtij rebelimi, Satani dhe ndjekësit e tij u përjashtuan nga prania e Perëndisë dhe iu mohua bekimi për të marrë një trup fizik (shih Zbulesa 12:9). Atyre iu mohua gjithashtu mundësia për të marrë ndonjë trashëgimi në një nga mbretëritë e lavdisë.

Ati Qiellor i lejon Satanin dhe pasuesit e Satanit të na tundojnë si pjesë e përvojës sonë në vdekshmëri (shih 2 Nefi 2:11-14; DeB 29:39). Meqenëse Satani “kërkon që të gjithë njerëzit të jenë të mjeruar sikurse është ai vetë” (2 Nefi 2:27), ai dhe ndjekësit e tij përpiqen të na çojnë larg drejtësisë. Ai e përqendron energjinë e tij më të madhe për të kundërshtuar pikëpamjet më të rëndësishme të planit të Atit Qiellor për lumturinë. Për shembull, ai kërkon të hedhë mosbesim tek autoriteti i Shpëtimtarit dhe i priftërisë, të hedhë dyshim tek fuqia e Shlyerjes, të sajojë zbulesë të rreme, të na heqë mendjen nga e vërteta dhe të hedhë poshtë përgjegjësinë e individit. Ai përpiqet ta minojë familjen me anë të çoroditjes së roleve gjinore, të nxitjes së marrëdhënieve seksuale jashtë martesë, përqeshjes së martesës dhe duke i dekurajuar të rriturit e martuar të lindin fëmijë, të cilët ata do t’i kishin rritur me drejtësi, po t’i lindnin.

Ju nuk duhet t’i dorëzoheni tundimeve të Satanit. Ju keni brenda vetes fuqinë për të zgjedhur të mirën mbi të keqen dhe ju gjithmonë mund të kërkonti ndihmën e Zotit nëpërmjet lutjes. (Shih “Tundim”, faqe 183-185.)

Referime shitesë: Isaia 14:12-17; 1 Nefi 15:23-24; 2 Nefi 2:16-18; Moroni 7:12; DeB 10:5; 29:36-40, 46-47; 76:25-29

*Shih gjithashtu* Liri e Zgjedhjes; Mëkat; Tundim

## Sion

Doktrina e Besëlidhje përmban shumë fragmente në të cilat Zoti i urdhëron shenjtorët të “[kërkojnë të fillojnë e të ngrenë] kauzën e Sionit (DeB 6:6; shih gjithashtu DeB 11:6; 12:6; 14:6).

Fjala *Sion* ka kuptime të ndryshme në shkrimet e shenjta. Përkufizimi më i përgjithshëm i kësaj fjale është “të kulluarit në zemër”(DeB 97:21). *Sion* përdoret shpesh në këtë mënyrë për t’iu referuar popullit të Zotit ose Kishës dhe kunjeve të saj (shih DeB 82:14).

Në fillimet e kësaj periudhe ungjillore, udhëheqësit e Kishës i këshilluan anëtarët të ndërtonin Sionin duke emigruar tek një vendndodhje kryesore. Sot udhëheqësit tanë na këshillojnë ta ndërtojmë Sionin kudo që jetojmë. Anëtarëve të Kishës u kërkohet të qëndrojnë në vendlindjet e tyre dhe të ndihmojnë për ta ngritur Kishën atje. Shumë tempuj po ndërtohen, që kështu shenjtorët e ditëve të mëvonshme kudo në botë mund të marrin bekimet e tempullit.

Fjala *Sion* mund t’i referohet edhe një vendndodhjeje gjeografike të caktuar, si vijon:

- Qytetit të Enokut (shih Moisiu 7:18-21).
- Qytetit të lashtë të Jeruzalemit (shih 2 Samueli 5:6-7; 1 Mbretërve 8:1; 2 Mbretërve 9:28).
- Jeruzalemit të Ri, që do të ndërtohet në Xhekson Kaunti, Mizuri (shih DeB 45:66-67; 57:1-3; Nenet e Besimit 1:10).

Referime shtesë: Isaia 2:2-3; 1 Nefi 13:37; DeB 35:24; 39:13; 45:68-71; 59:3-4; 64:41-43; 90:36-37; 97:18-28; 101:16-18; 105:5; 115:5-6; 136:31

**Smith, Jozef i Riu** (*Shih* Jozef Smith)

## Shabát

Shabati është dita e Zotit, e veçuar çdo javë për pushim dhe adhurim. Në kohërat e Dhjatës së Vjetër, njerëzit e besëlidhjes së Perëndisë e mbajtën ditën e Shabatit në ditën e shtatë të javës, sepse Perëndia pushoi ditën e shtatë kur Ai krijoi tokën. Zoti e theksoi rëndësinë e respektimit të Shabatit në Dhjetë Urdhërimet:

“Mbaje mend ditën e shtunë për ta shenjtëruar.

Do të punosh gjashtë ditë dhe në ato do të bësh të gjithë punën tënde;

Por dita e shtatë është e shtuna, e shenjtë për Zotin, Perëndinë tënd; nuk do të bësh në atë ditë asnjë punë, as ti, as biri yt, as bija jote, as shërbëtori yt, as shërbëtorja jote, as kafshët e tua, as i huaji që ndodhet brenda portave të tua;

Sepse në gjashtë ditë Zoti krijoi qiejt dhe tokën, detin dhe gjithçka që është në to, dhe ditën e shtunë ai pushoi; prandaj Zoti e ka bekuar ditën e shabatit dhe e ka shenjtëruar atë” (Eksodi 20:8-11).

Mbas ringjalljes së Jezu Krishtit, e cila ndodhi ditën e parë të javës, dishepujt e Zotit filluan ta respektonin Shabatin në ditën e parë të javës, të dielën (shih Veprat e Apostujve 20:7).

Në ditët e mëvonshme Zoti na ka urdhëruar të vazhdojmë ta respektojmë Shabatin. Ai na ka premtuar që, në qoftë se ne i bindemi këtij urdhërimi, ne do të marrim “[plotësinë] e tokës”. (shih DeB 59:16-20).

Për shkak se Shabati është një ditë e shenjtë, duhet të rezervohet për veprimtari të denja dhe të shenjta. Heqja dorë nga puna dhe argëtimi nuk është e mjaftueshme. Në fakt, në qoftë se ne thjesht rrimë kot, pa bërë asgjë ditën e Shabatit, ne nuk arrijmë ta mbajmë këtë ditë të shenjtë. Në një zbulesë të dhënë Jozef Smithit më 1831, Zoti urdhëroi: “Që të mund ta ruash veten më tepër të panjollë nga bota, duhet të shkosh në shtëpinë e lutjes dhe t’i ofrosh sakramentet e tua në ditën time të shenjtë; sepse në të vërtetë kjo është një ditë e caktuar për ty që të prehesh nga punët e tua dhe t’i drejtosh lutje

Më të Lartit” (DeB 59:9-10). Në harmoni me këtë zbulësë, ne frekuentojmë mbledhjen e sakramentit çdo javë. Veprimtaritë e tjera në ditën e Shabatit mund të përfshijnë lutje, mendim të thelluar, studim të shkrimeve të shenja dhe të mësimëve të profetëve të ditëve të mëvonshme, shkrimin e letrave për anëtarë të familjes dhe për shokët, lexim të materialeve të shëndosha, vizita tek të sëmurët dhe të pikëlluarit dhe pjesëmarrje në mbledhje të tjera të Kishës.

Referime shtesë: Eksodi 31:16-17; Mosia 18:23; DeB 59:11-14; 68:29

Shih gjithashtu Adhurim; Nderim; Sakrament

## Shenja

Shenjat janë ngjarje ose përvoja që shfaqin qartë fuqinë e Perëndisë. Shpesh ato janë të mbinatyrshme. Ato paraqesin dhe lajmërojnë ngjarje të mëdha, si lindjen e Shpëtimtarit, vdekjen dhe Ardhjen e Tij të Dytë. Ato na kujtojnë për besëlidhjet që Zoti ka bërë me ne. Shenjat gjithashtu mund të dëshmojnë për një thirrje hyjnore ose të tregojnë mosmiratimin e Zotit.

Disa njerëz pretendojnë se ata do të besonin në Perëndi ose në punën e Tij, në qoftë se ata do të mund të merrnin një shenjë. Por Zoti ka thënë: “Besimi nuk vjen me anë të shenjave, por shenjat i ndjekin ata që besojnë” (DeB 63:9). Shenja të tilla u jepen atyre që janë besnikë dhe të bindur, për t’i forcuar ata në besimin e tyre.

Referime shtesë: Mateu 12:38-39; Marku 13:22-27; Lluca 2:8-17; Alma 30:43-52; Helamani 14; 3 Nefi 1:13-21; 8:2-25; Ethëri 12:6; DeB 63:7-12

Shih gjithashtu Ardhja e Dytë e Jezu Krishtit; Besim; Bindje

## Shërbim

Dishepujt e vërtetë të Jezu Krishtit kanë dëshirë t’u shërbejnë njerëzve përreth. Shpëtimtari tha: “Prej kësaj do t’ju



njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin” (Gjoni 13:35).

Kur u pagëzuat, ju lidhët besën që të merrnit mbi vete emrin e Jezu Krishtit. Profeti Alma ia shpjegoi këtë besëlidhje një grupi të kthyerish të rinj në besim që donin të pagëzohehin. Ai vuri re që dëshira e tyre për “të [hyrë] në grigjën e Perëndisë” përfshinte gatishmërinë për të dhënë një shërbim kuptimplotë—për “të [mbajtur] barrat e njëri-tjetrit, që ato të mund të jenë të lehta”, për “të [vajtuar] me ata që vajtojnë” dhe për “të [ngushëlluar] ata që kanë nevojë të ngushëllohen” (Mosia 18:8-9).

Ndërsa përpiqeni t’u shërbeni të tjerëve, shikojeni Shpëtimtarin si shembull. Megjithëse erdhi në tokë si Biri i Perëndisë, Ai me përlësi u shërbeu të gjithë njerëzve rrotull Tij. Ai shpalli: “Unë jam midis jush porsia ai që shërben” (Lluka 22:27).

Shpëtimtari përdori një shëmbëlltyrë për të na mësuar rëndësinë e shërbimit. Në këtë shëmbëlltyrë, Ai rikthehet në tokë në lavdinë e Tij dhe ndan të drejtët nga të këqijtë. Të drejtëve Ai u thotë: “Ejani, të bekuar të Atit tim; merrni në trashëgim mbretërinë që u bë gati për ju që nga krijimi i botës. Sepse pata uri dhe më dhatë për të ngrënë, pata etje dhe më dhatë për të pirë; isha i huaj dhe më pritët, isha i zhveshur dhe më veshët, isha i sëmure dhe ju më vizitonit, isha në burg dhe erdhët tek unë” (Mateu 25:34-36).

Të drejtët, që janë të paqartë nga kjo shpallje, pyesin: “Zot, kur të pamë të uritur dhe të dhamë për të ngrënë; ose të etur dhe të dhamë për të pirë? Dhe kur të pamë të huaj dhe të pritëm ose të zhveshur dhe të veshëm? Dhe kur të pamë të lënguar ose në burg dhe erdhëm te ti?” (Mateu 25:37-39).

Pastaj Zoti u përgjigjet: “Në të vërtetë po ju them: sa herë ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre vëllezërve të mi më të vegjël, këtë ma bëtë mua” (Mateu 25:40).

Shpëtimtari ju fton të jepni nga vetja për t’u shërbyer të tjerëve. Mundësitë tuaja për ta bërë këtë gjë janë pa fund. Çdo ditë, kërkoni mundësi për të gëzuar zemra, për të thënë

fjalë të mira, për të bërë për të tjerët punë që ata nuk mund t'i bëjnë vetë, për të folur për ungjillin. Jini i gatshëm për të dëgjuar pëshpëritjet e Shpirtit, të cilat ju nxisin që të shërbeni. Ju do të shikoni që çelësi i vërtetë i lumturisë është të punosh për lumturinë e të tjerëve.

Referime shtesë: Mateu 22:35-40; 25:41-46; Lluca 10:25-37; Galatasve 5:13-14; Mosia 2:17

*Shih gjithashtu* Dashuri; Dashuri Hyjnore

## **Shkrime të Shenjta**

Kur njerëz të shenjtë të Perëndisë shkruajnë ose flasin nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, fjalët e tyre “do të [jenë] shkrim i shenjtë, do të [jenë] vullneti i Zotit, do të [jenë] mendja e Zotit, do të [jenë] fjala e Zotit, do të [jenë] zëri i Zotit dhe fuqia e Perëndisë për shpëtim” (DeB 68:4). Shkrimet e shenjta zyrtare dhe të miratuara nga autoritetet e Kishës, që shpesh quhen veprat standarde, janë: Bibla, Libri i Mormonit, Doktrina e Besëlidhje dhe Perla me Vlerë të Madhe. Këto libra të shkri-meve të shenjta janë përshkruar në faqet 161-163.

Rëndësia e Studimit të Përditshëm të Shkrimeve të Shenjta.

Qëllimi kryesor i shkrimeve të shenjta është të dëshmojnë për Krishtin, për të na ndihmuar të arrijmë tek Ai dhe të marrim jetën e përjetshme (shih Gjoni 5:39; 20:31; 1 Nefi 6:4; Mosia 13:33-35). Profeti Mormoni dëshmoi:

“Kushdo që ka dëshirë mund të mbështetet në fjalën e Perëndisë, që është e shpejtë dhe e fuqishme, e cila do t'i ndajë copë-copë të gjitha dinakëritë dhe kurthet dhe mashtrimet e djallit, dhe do të udhëheqë njeriun e Krishtit në një udhë të ngushtë dhe të ngushtuar nëpër atë humnerë të përhershme mjerimi, që është përgatitur të përpijë të këqijtë—

Dhe të vendosin shpirtrat e tyre, po, shpirtrat e tyre të pavdekshëm, në krahun e djathtë të Perëndisë, në mbretërinë e qiellit, që të ulen me Abrahamin dhe Isakun dhe Jakobin,

dhe me të gjithë etërit tanë të shenjtë, për të mos dalë kurrë më” (Helamani 3:29-30).

Profetët e ditëve të mëvonshme na këshillojnë të studiojmë shkrimet e shenjta çdo ditë, si individualisht, ashtu edhe me familjet tona. Ata na nxisin ne, ashtu siç i nxiti Nefi vëllezërit e tij, t’i përshtasim shkrimet me veten tonë, duke gjetur mënyra me të cilat përmbledhjet e shenjta të kohërave të vjetra ne t’i zbatojmë në jetën tonë sot (shih 1 Nefi 19:23-24). Ata na këshillojnë ne të “[hetojmë] shkrimet” (Gjoni 5:39) dhe të “[ushqehemi] me bollëk me fjalët e Krishtit” (2 Nefi 32:3).

Ju do të përfitoni shumë nga ndjekja e kësaj këshille. Studimi ditor dhe kuptimplotë i shkrimeve të shenjta ju ndihmon të jeni i ndjeshëm ndaj pëshpëritjeve të Frymës së Shenjtë. Ai ju forcon besimin, ju përforcon kundra tundimit dhe ju ndihmon të vini pranë Atit Qiellor dhe Birit të Tij të Dashur.

Zhvilloni një plan për studim vetjak të shkrimeve të shenjta. Merrni parasysh që të vini mënjane çdo ditë një sasi kohe të caktuar për të studiuar shkrimet e shenjta. Gjatë asaj kohe lexoni me kujdes, duke qenë të vëmendshëm ndaj nxitjeve të Shpirtit. Kërkojini Atit tuaj Qiellor t’ju ndihmojë që të dini se çfarë do Ai që ju të mësoni dhe të bëni.

Vazhdoni të lexoni shkrimet e shenjta, veçanërisht Librin e Mormonit, gjatë gjithë jetës suaj. Ju do të rizbuloni thesaret e shkrimeve të shenjta vazhdimisht, duke gjetur tek ato kuptime dhe zbatime të reja ndërsa i studioni në stade të ndryshme të jetës suaj.

Në qoftë se jeni i martuar, vini mënjane çdo ditë një kohë për të lexuar shkrimet e shenjta si familje. Kjo përpjekje mund të jetë e vështirë, por do të sjellë rezultate të përjetshme dhe të mrekullueshme. Nën drejtimin e Shpirtit, planifikoni lexime nga shkrimet e shenjta që do të përmbushin nevojat e familjes suaj. Mos kini frikë t’u lexoni shkrimet e shenjta fëmijëve të vegjël. Gjuha e atyre anave të shenjta ka fuqi të prekë edhe ata që janë shumë të rinj.

## Bibla

Bibla është e ndarë në dy pjesë: Dhjata e Vjetër dhe Dhjata e Re. Dhjata e Vjetër është një anal i shenjtë i marrëdhënieve të Perëndisë me popullin e tij të besëlidhjes, në Tokën e Shenjtë. Përfshin mësimet e profetëve si Moisiu, Jozueu, Isaia, Jeremia dhe Danieli. Dhjata e Re dokumenton lindjen, shërbesën në vdekshmëri dhe Shlyerjen e Shpëtimtarit. Ajo mbaron me shërbesën e dishepujve të Shpëtimtarit.

Për shkak se Bibla është përkthyer shumë herë, është shtypur në versione të ndryshme. Për gjuhën shqipe, përkthimi i Biblës nisur nga Diodati i Ri (versioni i vitit 1991), është pranuar si shkrim i shenjtë nga Kisha.

Në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, ne e nderojmë thellësisht Biblën dhe mësimet e saj të shenjta. Ne mund të marrim forcë dhe ngushëllim nga tregimet biblike për marrëdhëniet e Perëndisë me njerëzit e Tij.

## Libri i Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit

Libri i Mormonit erdhi në këtë periudhë ungjillore me anë të vullnetit të Perëndisë. Është një anal i marrëdhënieve të Perëndisë me njerëzit që jetonin në kohërat e lashta në kontinentet amerikane. Profetët e Zotit gdhendën analet në fletë ari. Zoti shpalli se Libri i Mormonit përmban “[plotësinë e] ungjillit të Jezu Krishtit” (DeB 20:9; shih gjithashtu DeB 42:12).

Më 22 shtator 1827, një engjell i quajtur Moroni—profeti i fundit i Librit të Mormonit—ia dorëzoi këto anale Profetit Jozef Smith. Me anë të dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë, Profeti Jozef e përktheu analin në gjuhën angleze. Që nga ajo kohë, Libri i Mormonit është përkthyer në shumë gjuhë të tjera.

Qëllimi kryesor i Librit të Mormonit është që t’i bindë të gjithë njerëzit se “Jezusi është Krishti, Perëndia i Amshuar, që ua shfaqti veten të gjitha kombeve” (faqja titulluese e Librit të Mormonit). Ai mëson se të gjithë njerëzit “duhet të vijnë tek ai ose ata nuk mund të shpëtohen” (1 Nefi 13:40). Jozef Smithi tha që Libri i Mormonit është “guri kyç i besimit tonë

dhe se një njeri do t'i afrohet më shumë Perëndisë duke iu bindur porosive të tij, se nga ndonjë libër tjetër" (hyrje tek Libri i Mormonit).

Libri i Mormonit është një dëshmi tjetër për të vërtetat që mësohen në Bibël. Gjithashtu ai rivendos të vërteta "të qarta dhe të çmueshme" që kanë humbur nga Bibla përmes gabimeve në përkthim ose janë "hequr" në përpjekje "që të mund të shtrembërojnë udhët e drejta të Zotit" (shih 1 Nefi 13:24-27, 38-41). Bibla dhe Libri i Mormonit "do të rriten së bashku në ngatërrimin e doktrinave të rreme dhe për dhënien fund të grindjeve dhe për vendosjen e paqes" (2 Nefi 3:12).

Nga fundi i Librit të Mormonit, profeti Moroni na mëson se si mund ta dimë që libri është i vërtetë: "Kur ju t'i merrni këto gjëra, unë do t'ju këshilloja që të pyesni Perëndinë, Atin e Amshuar, në emrin e Krishtit, në qoftë se këto gjëra nuk janë të vërteta; dhe në qoftë se ju do të kërkoni me një zemër të sinqertë, me qëllim të vërtetë duke pasur besim në Krisht, ai do t'ju tregojë të vërtetën, nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë" (Moroni 10:4; shih gjithashtu vargjet 3 dhe 5).

## Doktrina e Besëlidhje

Doktrina e Besëlidhje përmban zbulesa që iu dhanë Profetit Jozef Smith. Gjithashtu përmban disa zbulesa që iu dhanë profetëve të tjerë të ditëve të mëvonshme. Ky libër shkrimesh të shenjta është i veçantë, sepse nuk është përkthim i dokumentave të lashtë. Është një përmbledhje zbulësash nga Zoti të dhëna profetëve të Tij të zgjedhur në ditët e mëvonshme.

Profeti Jozef Smith tha që Doktrina e Besëlidhje është "themeli i Kishës në këto ditë të fundit dhe një përfitim për botën, duke treguar që çelësat e mistereve të mbretërisë së Shpëtimtarit tonë përsëri i janë besuar njeriut" (kreu i seksionit në DeB 70).

Perla me Vlerë të Madhe.

Perla me Vlerë të Madhe përmban librin e Moisiut, librin e Abrahamit, përkthimin e frymëzuar të kapitullit 24 të Mateut nga Jozef Smithi dhe disa shkrime të Profetit Jozef.

Libri i Moisiut është një pjesëz e përkthimit të frymëzuar të Biblës nga Jozef Smithi. Ai është një dokument më i plotë i shkrimeve të Moisiut në fillim të librit të Zanafillës në Dhjatën e Vjetër. Përmban shumë doktrina dhe mësimë që humbën nga Bibla dhe jep informacion shtesë për planin e shpëtimit, krijimin e tokës dhe marrëdhëniet e Zotit me Adamin dhe Enokun.

Libri i Abrahamit është një përkthim i anave të lashta të shkruara në papiruse që u vunë në pronësi të Kishës më 1835. Profeti Jozef Smith i përktheu këto anave me anë të zbulesës. Ky libër përmban të vërteta mbi Këshillin e paralindjes në Qiell, mbi krijimin e tokës, natyrën e Perëndisë dhe priftërinë.

Joseph Smith—Mateu shton njohurinë tonë mbi mësimet e Shpëtimtarit për Ardhjen e Tij të Dytë.

Shkrimet e Jozef Smithit në Perlën me Vlerë të Madhe përfshijnë:

- Joseph Smith—Historia, e cila është një pjesëz e historisë së Kishës shkruar nga Profeti. Është një tregim i ngjarjeve që sollën rivendosjen e Kishës, duke përfshirë Vegimin e Parë, vizitat e Moronit tek Profeti Jozef Smith, marrjen e fletëve të arta dhe rivendosjen e Priftërisë Aarone.
- Nenet e Besimit, të cilat Profeti Jozef Smith i shkroi si formulime themelore të besimit dhe të doktrinës.

Referime shtesë: Romakëve 15:4; 2 Timoteut 3:15-17; 2 Nefi 25:26; Alma 17:2-3; 3 Nefi 23:1-5; DeB 18:33-36; Nenet e Besimit 1:8

*Shih gjithashtu Profetë; Rivendosje e Ungjillit; Zbulesë*

## **Shlyerja e Jezu Krishtit**

Fjala *shlyhet* do të thotë të lahet borxhi ose që diçka të mos merret më parasysh. Përmes Shlyerjes së Jezu Krishtit ne mund të pajtohemi me Atin tonë Qiellor (shih Romakëve 5:10-11; 2 Nefi 25:23; Jakobi 4:11). Në fund ne mund të rrojmë në prani të Tij përgjithmonë, duke u “bërë të përsosur nëpërmjet Jezusit” (shih DeB 76:62, 69).

Jezu Krishti “u përgatit nga krijimi i botës të shëlbojë popullin [e Tij]” (Ethëri 3:14). Në botën e shpirttrave para lindjes, Ati Qiellor paraqiti planin e përjetshëm të shpëtimit, i cili kërkonte një Shlyerje të pafundme dhe të përjetshme. Jezusi i paralindjes, atëherë i njohur si Jehova, shpalli me përlësi se do të bënte vullnetin e Atit në plotësimin e planit (shih Moisiu 4:2). Kështu Ai u shugurua për ta zbatuar Shlyerjen—të vinte në tokë, të vuante ndëshkimin për mëkatet tona, të vdiste në kryq dhe të ringjallej. Ai u bë “[Qengji], që ishte vvarë që nga krijimi i botës” (Zbulesa 13:8, shih gjithashtu 1 Pjetri 1:19-20; Moisiu 7:47).

Shlyerja është shprehja më e lartë e dashurisë së Atit tonë Qiellor për ne (shih Gjoni 3:16). Ajo gjithashtu është shprehja më e lartë e dashurisë së Shpëtimtarit për Atin dhe për ne (shih Gjoni 14:28-31; 15:9-13; 1 Gjoni 3:16; DeB 34:3; 138:1-4).

### **Nevoja që Kemi për Shlyerjen**

Duke qenë pasardhës të Adamit dhe Evës, të gjithë njerëzit trashëgojnë efektet e Rënies. Ne të gjithë e provojmë vdekjen shpirtërore, të ndahesh nga prania e Perëndisë, dhe të gjithë i nënshtrohemi vdekjes së përkohshme, e cila është vdekja e trupit fizik (shih Alma 42:6-9; DeB 29:41-42).

Në gjendjen tonë të rënë ne u nënshtrohemi kundërshtive dhe tundimeve. Kur ne i jepemi tundimit, e largojmë veten nga Perëndia dhe privohemi nga lavdia e Tij (shih Romakëve 3:23).

Drejtësia hyjnore e kërkon që efektet e Rënies të mbesin dhe që ne të ndëshkohemi për keqbërjet tona. Pa Shlyerjen,

vdekja shpirtërore dhe e përkohshme do të vendoste një pengesë të pakalueshme midis nesh dhe Perëndisë. Ngaqë ne nuk mund ta shpëtojmë veten tonë nga Rënia apo nga mëkatet tona, do të ndaheshim përgjithmonë nga Ati ynë Qiellor, sepse “asgjë e papastër nuk mund të banojë . . . në prani të tij” (Moisiu 6:57).

E vetmja mënyrë që të shpëtohemi është të na shpëtojë tjetërkush. Kemi nevojën e dikujt që mundet t’i kënaqë kërkesat e drejtësisë—të vihet në vendin tonë për të marrë barrën e Rënies dhe të paguajë çmimin për mëkatet tona. Jezu Krishti përherë ka qenë i vetmi njeri i aftë për të bërë një sakrificë të tillë.

### Jezu Krishti, Shpresa Jonë e Vetme

Që para Krijimit të tokës, Shpëtimtari ka qenë shpresa jonë e vetme për “paqe në këtë botë dhe jetë të përjetshme në botën që vjen” (DeB 59:23).

Vetëm Ai e kishte fuqinë për të lënë jetën dhe për ta marrë përsëri. Nga nëna e Tij e vdekshme, Maria, Ai trashëgoi aftësinë për të vdekur. Nga Ati i Tij i pavdekshëm Ai trashëgoi fuqinë për të kapërcyer vdekjen. Ai shpalli: “Sikurse Ati ka jetë në vetvete, kështu ia ka dhënë dhe Birit të ketë jetë në vetvete” (Gjoni 5:26).

Vetëm Ai mund të na shëlbonte nga mëkatet tona. Këtë fuqi Atij ia dha Perëndia Atë (shih Helamani 5:11). Shpëtimtari ishte i aftë ta merrte këtë fuqi dhe të zbatonte Shlyerjen, për shkak se e mbajti Vetën të lirë nga mëkati. “Ai vuajti tundime, por nuk ua vuri veshin atyre” (DeB 20:22). Pasi jetoi një jetë të përsosur, të pamëkat, Ai ishte i lirë nga kërkesat e drejtësisë. Ngaqë Ai kishte fuqinë e shëlbimit dhe ngaqë nuk i kishte asnjë borxh drejtësisë, Ai mund ta paguante borxhin për ata që pendohen. Ai mund t’i kërkojë Atit të vështrojë vuajtjet dhe vdekjen e Tij—vuajtjet dhe vdekjen e Atij i cili nuk mëkatoi, me të cilin Ati është plotësisht i kënaqur. Ai mund t’i kërkojë Atit të vështrojë gjakun që derdhi Ai—gjakun e Birit, të cilin Ati e dha që të mund të për-



lëvdohej Vetë. Ai mund t'i kërkojë Atit që t'i kursejë ata që besojnë në emër të Tij, me qëllim që ata të mund të vijnë te Ai dhe të kenë jetë të përjetshme. (Shih DeB 45:4-5.)

Me të vërtetë, “nuk do të ketë asnjë emër tjetër të dhënë, as ndonjë mënyrë tjetër nëpërmjet së cilës shpëtimi mund të vijë te fëmijët e njerëzve, vetëm në dhe nëpërmjet emrit të Krishtit, Zotit të Plotfuqishëm” (Mosia 3:17).

### Sakrifica Shlyese

Sakrifica shlyese e Jezusit ndodhi në Kopshtin e Gjetsemanit dhe në kryqin e Kalvarit. Në Gjetseman Ai iu nënshtrua vullnetit të Atit dhe filloi të merrte mbi Vete mëkatet e të gjithë njerëzve. Ai ka zbuluar diçka nga ajo që Ai përjetoi ndërsa paguante çmimin për mëkatet tona:

“Unë Perëndia i kam vuajtur këto gjëra për të gjithë, që ata të mos vuajnë nëse do të pendohen;

Por nëse nuk do të pendohen, ata duhet të vuajnë po aq sa unë;

Vuajtje që më bëri mua, madje Perëndi, më i madhi i të gjithëve, të dridhem për shkak të dhembjes e të më dalë gjak nga çdo pór dhe të vuaj si në trup e në shpirt—dhe të dëshiroj që të mos e pi kupën e hidhur e të mpakem—

Megjithatë, lavdi i qoftë Atit dhe unë mora pjesë e i mbarova përgatitjet e mia për fëmijët e njerëzve” (DeB 19:16-19; shih gjithashtu Lluca 22:44; Mosia 3:7).

Shpëtimtari vazhdoi të vuante për mëkatet tona në kohën kur e lejoi Vetën të kryqëzohej—“ngritur mbi kryqin dhe . . . vrarë për mëkatet e botës” (1 Nefi 11:33).

Në kryq Ai lejoi Vetën të vdiste. Trupi i Tij u shtri pastaj në një varr derisa Ai u ringjall dhe u bë “fryti i parë i atyre që kanë fjetur” (1 Korintasve 15:20). Përmes vdekjes dhe Ringjalljes së Tij Ai e kapërceu vdekjen fizike për të gjithë ne. Ai më vonë tha:

“Unë erdha në botë për të bërë vullnetin e Atit tim, sepse Ati im më dërgoi.

Dhe, Ati im më dërgoi që të mund të ngrihesha në kryq; dhe pasi u ngrita në kryq, që të tërheq të gjithë njerëzit tek unë, që ashtu si unë u ngrita nga njerëzit, ashtu dhe njerëzit të ngrihen nga Ati, që të qëndrojnë para meje për t'u gjykuar për veprat e tyre, qofshin ato të mira ose qofshin ato të liga—

Dhe për këtë shkak unë jam ngritur; prandaj, sipas fuqisë së Atit, unë do t'i tërheq të gjithë njerëzit tek unë, që ata të gjykohen sipas veprave të tyre.

Dhe do të ndodhë që kushdo që pendohet dhe pagëzohet në emrin tim, do të mbushet; dhe në qoftë se duron deri në fund, vini re, atë do ta konsideroj të pafajshëm para Atit tim, në atë ditë kur do të qëndroj të gjykoj botën" (3 Nefi 27:13-16).

### Shëlbimi i Përgjithshëm nga Rënia

Nëpërmjet Shlyerjes, Jezu Krishti shëlbbon të gjithë njerëzit nga efektet e Rënies. Të gjithë njerëzit që kanë jetuar ndonjëherë mbi tokë dhe që do të jetojnë mbi tokë, do të ringjallen dhe do të sillen përsëri në prani të Perëndisë për t'u gjykuar (shih 2 Nefi 2:5-10; Helamani 14:15-17). Nëpërmjet dhuratës së mëshirës dhe hirit shëlbues të Shpëtimtarit, ne të gjithë do të marrim dhuratën e pavdekësisë dhe do të jetojmë përherë në trupa të ringjallur të lëvduar.

### Shpëtimi nga Mëkatet Tona

Megjithëse ne shëlbohemi pa kushte nga efektet e përgjithshme të Rënies, ne jemi përgjegjës për mëkatet vetjake. Por mund të falemi dhe të pastrohemi nga njolla e mëkatit, në rast se "[përdorim] gjakun shlyes të Krishtit" (Mosia 4:2). Ne duhet të ushtrojmë besim tek Jezu Krishti, të pendohemi, të pagëzohemi për heqjen e mëkateve dhe të marrim dhuratën e Frymës së Shenjtë. Alma këshilloi:

"Ju duhet të pendoheni dhe të lindni përsëri; pasi Shpirti thotë, në qoftë se ju nuk lindni përsëri, ju nuk mund të trashëgoni mbretërinë e qiellit; prandaj ejani dhe pagëzohuni në pendim, që ju të mund të laheni nga mëkatet tuaja, që ju të

mund të keni besim në Qengjin e Perëndisë, i cili merr mëkatet e botës, i cili është i fuqishëm të shpëtojë dhe të pas-trojë nga çdo padrejtësi” (Alma 7:14).

### Dhurata e Jetës së Përjetshme

Shpëtimtari ka shpallur se jeta e përjetshme është “më e madhja nga të gjitha dhuratat e Perëndisë” (DeB 14:7). Të fitosh jetë të përjetshme, është të bëhesh i denjë të banosh në prani të Perëndisë, duke trashëguar një vend në shkallën më të lartë të mbretërisë çelestiale. Kjo dhuratë është në dispozicion vetëm nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit. Mormoni tha: “Për çfarë duhet të keni shpresë? Vini re, unë ju them juve se duhet të keni shpresë nëpërmjet shlyerjes së Krishtit dhe fuqisë së ringjalljes së tij, që të ngriheni në jetën e përjetshme dhe kjo për shkak të besimit tuaj në të, sipas premtimit” (Moroni 7:41).

Për të marrë këtë dhuratë ne duhet t’u bindemi disa kushteve. Ne duhet të ushtrojmë besim te Jezu Krishti, të pendo kemi për mëkatet tona dhe të durojmë besnikërisht deri në fund. Ne duhet të marrim ordinancat e shpëtimit: pagëzimin, dhuratën e Frymës së Shenjtë, shugurimin e Priftërisë Melkizedeke (për burrat) dhe indaumentin e tempullit dhe vulosjen e martesës. Me marrjen e këtyre ordinancave dhe mbajtjen e besëlidhjeve shoqëruese, ne vijmë te Krishti dhe në përfundim marrim dhuratën e jetës së përjetshme (shih Nenet e Besimit 1:3).

Në drejtësi dhe mëshirë të pakufishme, Zoti u jep gjithashtu jetë të përjetshme “të [gjithëve] që vdiqën pa një njohuri të këtij ungjilli, që do ta kishin pranuar atë, nëse do të ishin lejuar të qëndronin” më gjatë dhe “të gjithë [fëmijëve] që vdesin përpara se të arrinin vitet e përgjegjshmërisë së tyre” (DeB 137:7,10).

Shpëtimtari na fton të gjithëve të marrim jetë të përjetshme: “Ai u dërgon gjithë njerëzve një ftesë, pasi krahët e mëshirës janë shtrirë drejt tyre dhe ai thotë: Pendohuni dhe unë do t’ju pranoj. Po, ai thotë: Ejani tek unë dhe ju do të hani

nga fruti i pemës së jetës; po, ju do të hani dhe do të pini lirisht nga buka dhe nga ujërat e jetës” (Alma 5:33-34).

### Të Gjesh Paqe dhe Shërim nëpërmjet Shlyerjes

Bekimet e Shlyerjes së Shpëtimtarit shtrihen gjatë gjithë përjetësisë, por ato vijnë gjithashtu në këtë jetë. Kur vini te Krishti, ju do të njihni gëzimin e qenies i pastër para Zotit. Do të jeni në gjendje të përsëritni fjalët e Almës, i cili, pas shumë mëkatesh e rebelimesh, përjetoi procesin e dhimbshëm, por shërues të pendimit. Pasi ishte falur, ai dëshmoi:

“Nuk munda t’i kujtoj më dhembjet e mia; po, nuk isha më i ngacmuar nga kujtimi i mëkateve të mia.

Dhe oh, çfarë gëzimi dhe çfarë drite të mrekullueshme pashë; po, shpirti im më ishte mbushur me një gëzim po aq të madh, sa kishte qenë dhembja ime!

. . . Nuk mund të ketë asgjë aq therëse dhe aq të hidhur, sa ishin dhembjet e mia . . . Nga ana tjetër, nuk mund të ketë asgjë kaq të mrekullueshme dhe kaq të ëmbël, sa ishte gëzimi im” (Alma 36:19-21).

Veç ofrimit të shëlbimit nga dhembjet e mëkatit, Shpëtimtari ofron paqe në kohë provash. Si pjesë të Shlyerjes së Tij, Jezusi mori mbi Vete dhembjet, sëmundjet dhe pafuqishmëritë e të gjithë njerëzve (shih Alma 7:11-12). Ai i kupton vuajtjet tuaja, ngaqë i ka përjetuar ato. Me këtë të kuptuar të përsosur Ai e di se si t’ju ndihmojë. “Gjithë merakun tuaj hidheni mbi të, sepse ai merakoset për ju” (1 Pjetri 5:7).

Përmes besimit dhe drejtësisë suaj dhe nëpërmjet sakrificës së Tij shlyese, të gjitha padrejtësitë, dëmtimet dhe dhembjet e kësaj jete mund të zhdëmtohen dhe të vihen në vend plotësisht. Bekimet e mohuara në këtë jetë do të jepen në përjetësi. Dhe, megjithëse Ai mund të mos i lehtësojë të gjitha vuajtjet tuaja tani, Ai do t’ju bekojë me ngushëllim e arsytim dhe me forcë për të “[duruar] barrat [tuaja] me lehtësi” (Mosia 24:15).

“Ejani tek unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar”, tha Shpëtimtari, “dhe unë do t’ju jap çlodhje” (Mateu 11:28).

Në një rast tjetër Ai premtoi përsëri paqen e Tij, duke thënë: "Në botë do të kenë mundime, por merrni zemër, unë e munda botën!" (Gjoni 16:33). Këto janë premtimet e Shlyerjes, në këtë jetë dhe gjatë gjithë përjetësisë.

Referime shitesë: Isaia 49:13-16; 53; Mateu 26-28; Marku 14-16; Lluca 22-24; Gjoni 10:14-15; 11:25-26; 14:6; 15:13; 19-20; 1 Korintasve 15:20-22; Hebrejve 4:14-16; 1 Gjoni 1:7; 1 Nefi 10:6; 2 Nefi 2:1-10; 9; 25:23-26; Jakobi 4:12 [LiM]; Mosia 3:1-19; Alma 22:14; 34:5-18; 42; Helamani 5:9-12; 14:13-19; 3 Nefi 9:14-22; 27:13-22; Mormoni 9:10-14; Ethëri 12:27, 41; Moroni 8:5-26; 10:32-33; DeB 18:10-12; 19:15-24; 20:17-34; 45:3-5; 76:40-43; Moisiu 1:39

*Shih gjithashtu* Besim; Drejtësi; Falje; Jetë e Përvetshme; Mbretëri të Lavdisë; Mëshirë; Ordinanca; Pagëzim; Pendim; Perëndia Atë; Plani i Shpëtimit; Rënie; Ringjallje; Shpëtim; Ungjill; Vdekje Fizike; Vdekje Shpirtërore

## **Shoqatë e Ndihmës**

Shoqata e Ndihmës u themelua nga Profeti Jozef Smith më 17 mars 1842, në Navú, Illinoi. Në ditët e themelimit të saj Shoqata e Ndihmës kishte dy qëllime kryesore: për të siguruar ndihmë për të varfërit dhe nevojtarët dhe për të shpëtuar shpirta. Kjo organizatë vazhdon sot, duke qëndruar e vërtetë ndaj atyre parimeve udhëzuese fillestare. Në të gjithë botën, motrat në Shoqatën e Ndihmës punojnë me mbajtësit e priftërisë për të kryer misionin e Kishës. Ato mbështesin njëra-tjetrën ndërsa:

- Rrisin dëshmitë e tyre për Jezu Krishtin nëpërmjet lutjes dhe studimit të shkrimeve të shenja.
- Kërkojnë forcë shpirtërore duke ndjekur nxitjet e Frymës së Shenjtë.
- Ia përkushtojnë veten forcimit të martesës, familjeve dhe shtëpive.
- Gjejnë fisnikëri në qënien nënë dhe gëzim në qënien grua.

- Gjejnë kënaqësi në shërbim dhe në vepra të mira.
- E duan jetën dhe të mësuarin.
- Qëndrojnë për të vërtetën dhe drejtësinë.
- Mbështesin priftërinë si autoriteti i Perëndisë mbi tokë.
- Gëzohen në bekimet e tempullit.
- Kuptojnë qëllimin e tyre hyjnor dhe përpiqen për të marrë ekzaltimin.

Në qoftë se jeni në Shoqatën e Ndhmës, një mënyrë që ju mund të kontribuoni në misionin e organizatës, është të pranoni një detyrë për të shërbyer si një mësuese e vizitave. Ndërsa i vizitoni e u shërbeni motrave që ju janë caktuar, gjeni kohë që t'u mësoni ungjillin dhe që të forconi miqësinë. Përveç shërbimit ndaj individëve, ju mund të luani një rol të rëndësishëm në forcimin e familjeve.

Udhëheqësit në lagje dhe në degë sigurohen që mësueset e vizitave t'u caktohen të gjitha motrave që janë 18 vjeç e sipër. Udhëheqësit e Priftërisë dhe të Shoqatës së Ndhmës ndjekin ecurinë me mësueset e vizitave për të ndihmuar në plotësimin e nevojave shpirtërore dhe jetësore të çdo motre.

Duke qenë një motër në Shoqatën e Ndhmës, ju jeni anëtare e një bashkimi mbarëbotëror midis motrave, të bashkuara në përkushtimin ndaj Jezu Krishtit. Ju u bashkoheni bijave të tjera të Perëndisë si grua me besim, virtyt, largpamësi dhe dashuri hyjnore, me njohurinë e sigurt që jeta juaj ka kuptim, qëllim dhe drejtim. Nëpërmjet pjesëmarrjes suaj në Shoqatën e Ndhmës, keni mundësi të gëzoni solidaritetin dhe shoqërinë si motra, të jepni shërbim kuptimplotë, të tregoni dëshminë e talentet tuaja dhe të rriteni shpirtërisht.

## Shpëtim

Në bashkëbisedimet tuaja me të krishterë të tjerë, nganjëherë mund t'ju jetë bërë pyetja: "A je shpëtuar?" Ata që bëjnë këtë pyetje, zakonisht i referohen rrëfimit të sinqertë, ose

deklarimit, që ju e keni pranuar Jezu Krishtin si Zotin dhe Shpëtimtarin tuaj personal. Kur bëjnë këtë pyetje, ata tregojnë besimin e tyre tek fjalët në vijim, të shkruara nga Apostull Pali:

“Po të rrëfesh me gojën tënde Zotin Jezus, dhe po të besosh në zemrën tënde se Perëndia e ngjalli prej së vdekurish, do të shpëtohesh. Sepse me zemër, njeriu beson në drejtësi dhe me gojë bëhet rrëfim për shpëtim” (Romakëve 10:9-10).

### Përgjigjja e Pyetjes “A Je Shpëtuar?”

Tek Romakëve 10:9-10, fjalët *i shpëtuar* dhe *shpëtim* tregojnë një marrëdhënie besëlidhjeje me Jezu Krishtin. Me anë të kësaj marrëdhënie besëlidhjeje, ne na sigurohet shpëtimi nga pasojat e përjetshme të mëkatit, në qoftë se ne jemi të bindur. Çdo shenjtor i ditëve të mëvonshme besnik shpëtohet sipas këtij kuptimi. Ne jemi të kthyer në besim në ungjillin e rivendosur. Nëpërmjet ordinancës së pagëzimit ne kemi hyrë në një marrëdhënie besëlidhjeje me Shpëtimtarin, duke e marrë emrin e Tij mbi vete. Ne rinovojmë besëlidhjen tonë të pagëzimit duke marrë sakramentin.

### Kuptime të Ndryshme të Fjalës *Shpëtim*

Në doktrinën e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, fjalët *i shpëtuar* dhe *shpëtim* kanë disa kuptime. Sipas këtyre kuptimeve, përgjigjja juaj ndaj pyetjes “A je shpëtuar?” do të jetë “Po” ose “Po, por me kushte”. Shpjegimet e mëposhtme konturojnë gjashtë kuptime të ndryshme të fjalës *shpëtim*.

*Shpëtim nga Vdekja Fizike.* Të gjithë njerëzit do të vdesin. Por nëpërmjet Shlyerjes dhe Ringjalljes së Jezu Krishtit, të gjithë njerëzit do të ringjallen—të shpëtuar nga vdekja fizike. Pali dëshmoi: “Ashtu sikur të gjithë vdesin në Adamin, kështu të gjithë do të ngjallen në Krishtin” (1 Korintasve 15:22).

*Shpëtim nga Mëkati.* Që të pastroheni nga mëkati nëpërmjet Shlyerjes së Shpëtimtarit, ju duhet të ushtroni besim në Jezu Krishtin, të pendoheni, të pagëzoheni dhe të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë (shih Veprat e Apostujve 2:37-38). Në qoftë se jeni pagëzuar dhe keni marrë Frymën e Shenjtë nëpërmjet autoritetit të duhur të priftërisë, ju tashmë jeni shpëtuar nga mëkati me kusht. Ju nuk do të shpëtoheni plotësisht nga mëkati, derisa ju të mbaroni jetën mbi tokë, duke duruar me besnikëri deri në fund.

Mbani parasysh që ju nuk mund të shpëtoheni *në mëkate*; ju nuk mund të merrni shpëtim pa kushte thjesht duke shpallur besimin tuaj tek Krishti me kuptimin që, në një mënyrë të pashmangshme, ju do të bëni mëkate gjatë gjithë pjesës së jetës që ju mbetet (shih Alma 11:36-37). Nëpërmjet hirit të Perëndisë, ju mund të shpëtoheni *nga mëkatet* (shih Helamani 5:10-11). Për të marrë këtë bekim, ju duhet të ushtroni besim tek Jezu Krishti, të përpiqeni të mbani urdhërimet, të braktisni mëkatin dhe të rinovoni pendimin dhe pastrimin tuaj nëpërmjet ordinancës së sakramentit.

*Të Rilindesh.* Ndonjëherë mund t'ju pyesin nëse jeni rilindur. Parimi i rilindjes shpirtërore paraqitet shpesh në shkrimet e shenjta. Dhjata e Re përmban mësimin e Jezusit që ne duhet të "[rilindemi]" dhe që në qoftë se ne nuk kemi "lindur nga uji dhe nga Fryma, nuk mund të [hyjmë] në mbretërinë e Perëndisë" (Gjoni 3:3, 5). Ky mësim pohohet në Librin e Mormonit: "I gjithë njerëzimi, po, burra dhe gra, të gjitha kombet, fiset, gjuhët dhe popujt duhet të lindin rishtas; po, të lindin nga Perëndia, të ndryshuar nga gjendja e tyre e mishit dhe e rënë në një gjendje drejtësie, duke qenë të shëlbuar nga Perëndia, duke u bërë bijtë dhe bijat e tij; Dhe kështu ata bëhen krijesa të reja; dhe në qoftë se nuk e bëjnë këtë, ata, në asnjë mënyrë, nuk mund të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë" (Mosia 27:25-26).

Kjo rilindje është një proces që ndodh mbasi të pagëzoheni dhe të marrim dhuratën e Frymës së Shenjtë. Ajo vjen si rezultat i gatishmërisë sonë "të hyjmë në një besëlidhje me



Perëndinë tonë, që të bëjmë vullnetin e tij dhe të jemi të bindur ndaj urdhërimeve të tij, në të gjitha gjërat që ai do të na urdhërojë ne për të gjithë pjesën tjetër të ditëve tona” (Mosia 5:5). Atëherë “zemrat [tona] janë ndryshuar nëpërmjet besimit në emrin e tij; prandaj [ne kemi] lindur prej tij” (Mosia 5:7). Në qoftë se jeni pagëzuar dhe keni marrë dhuratën e Frymës së Shenjtë, me besëlidhjen e marrjes mbi vete të emrit të Jezu Krishtit, ju mund të thoni se jeni rilindur. Dhe ju mund ta rinovoni atë rilindje çdo ditë Shabati kur merrni sakramentin.

*Shpëtim nga Padituria.* Shumë njerëz jetojnë në një gjendje errësire, pa e njohur dritën e ungjillit të rivendosur. Ata “mbahen larg nga e vërteta vetëm ngaqë nuk dinë se ku ta gjejnë atë” (DeB 123:12). Duke qenë anëtar i Kishës së Zotit, ju jeni i shpëtuar nga kjo gjendje. Ju keni një dituri për Perëndinë Atë, Jezu Krishtin, qëllimin e jetës, planin e shpëtimit dhe potencialit tuaj të përjetshëm. Ju mund të jetoni si dishepull i Shpëtimtarit, i cili njoftoi hapur: “Unë jam drita e botës; kush më ndjek nuk do të ecë në errësirë, por do të ketë dritën e jetës” (Gjoni 8:12).

*Shpëtim nga Vdekja e Dytë.* Shkrimet e shenjta hera-herës flasin për shpëtimin nga vdekja e dytë. Vdekja e dytë është vdekja shpirtërore përfundimtare—qenia i përjashtuar nga drejtësia dhe mohimi nga një vend në ndonjë prej mbretërive të lavdisë (shih Alma 12:32; DeB 88:24). Kjo vdekje e dytë nuk do të ndodhë para Gjykimit Përfundimtar dhe do t’i ndodhë shumë pak vetëve (shih DeB 76:31-37). Gati çdo njeriu që ka jetuar ndonjëherë mbi tokë, i sigurohet shpëtim nga vdekja e dytë (shih DeB 76:40-45).

*Jetë e Përjetshme ose Ekzaltim.* Në shkrimet e shenjta, fjalët *i shpëtuar* dhe *shpëtim* shpesh i referohen jetës së përjetshme ose ekzaltimit (shih Abrahami 2:11). Jetë e përjetshme është të njohësh Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin dhe të jetosh me Ta përgjithmonë—të trashëgosh një vend në shkallën më të lartë të

mbretërisë çelestiale (shih Gjoni 17:3; DeB 131:1-4; 132:21-24). Për të marrë këtë dhuratë të madhe, ne duhet të bëjmë më shumë sesa vetëm të pendohemi për mëkatet tona e të pagëzohemi dhe të konfirmohemi nëpërmjet autoritetit të duhur të priftërisë. Burrat duhet të marrin Priftërinë Melkizedeke dhe të gjithë anëtarët e Kishës duhet të bëjnë dhe t'i mbajnë besëlidhjet e shenjta në tempull, duke përfshirë martesën e përjetshme.

Në qoftë se ne e përdorim fjalën *shpëtim* për të nënkuptuar jetën e përjetshme, në vdekshmëri, asnjë nga ne nuk mund të thotë se kemi shpëtuar. Ajo dhuratë e lavdishme mund të vijë vetëm mbas Gjykimit Përfundimtar.

Referime shtesë: Mateu 10:22; Marku 16:16; Efesianëve 2:8-10; Jakobi 2:14-18; 2 Nefi 25:23, 26; Mosia 5:8-15; 3 Nefi 9:21-22; Moroni 10:32-33; Nenet e Besimit 1:3

*Shih gjithashtu* Hir; Jetë e Përjetshme; Mbretëri të Lavdisë; Pagëzim; Plani i Shpëtimit; Shlyerja e Jezu Krishtit

## Shpëtuar (i) *(Shih Shpëtim)*

### Shpirt

Ju jeni fëmijë shpirtëror i Atit Qiellor dhe ju ekzistonit si shpirt para se të lindeshit në tokë. Gjatë jetës suaj në tokë, shpirti juaj qëndron brenda trupit tuaj fizik, i cili u lind nga prindër të vdekshëm.

Nga shkrimet e shenjta ne mësojmë mbi natyrën e shpirtave. Ne mësojmë se “gjithë shpirti është materie, por është më i pastër e më i përpunuar dhe mund të dallohet vetëm me anë të syve më të pastër” (DeB 131:7). Ne lexojmë që “[shpirti i njeriut është] në ngjashmërinë e vetes së tij, po ashtu sikurse shpirti i bishës dhe i çdo krijese tjetër që Perëndia ka krijuar” (DeB 77:2; shih gjithashtu Ethëri 3:7-16).

Shkrimet e shenjta gjithashtu na mësojnë se në kohën e vdekjes fizike, shpirti nuk vdes. Ai ndahet nga trupi dhe

jeton në botën e shpitrave të pas vdekshmërisë. Në kohën e ringjalljes shpirti ribashkohet me trupin, “për të mos u ndarë kurrë më; kështu i tëri duke u bërë shpirtëror dhe i pavdekshëm” (Alma 11:45).

Referime shtesë: Romakëve 8:16-17; 2 Nefi 9:10-13; DeB 93:29, 33

*Shih gjithashtu* Plani i Shpëtimit; Qenie; Ringjallje

## **Shpirti i së Vërtetës** (*Shih* Fryma e Shenjtë)

## **Shpirti i Zotit** (*Shih* Fryma e Shenjtë; Drita e Krishtit)

## **Shpresë**

Fjala *shpresë* nganjëherë nuk kuptohet siç duhet. Në gjuhën tonë përditshme kjo fjalë të lë përshtypjen e pasigurisë. Për shembull, ne mund të themi që shpresojmë të ndryshojë moti apo që të na vijë një mik për vizitë. Në gjuhën e ungjillit, sidoqoftë, fjala *shpresë* është e sigurt, e patundur dhe vepruese. Profetët thonë të kesh “shpresë të vendosur” (Alma 34:41) dhe “shpresë të gjallë” (1 Pjetri 1:3). Profeti Moroni mësoi: “Kushdo që beson në Perëndi, mund të shpresojë me siguri për një botë më të mirë, po, madje për një vend në krahun e djathtë të Perëndisë, shpresë e cila vjen nga besimi dhe shërben si një spirancë për shpirtat e njerëzve, që do t’i bëjë ata të sigurtë dhe të vendosur, gjithmonë plot me vepra të mira, duke qenë të udhëhequr për të lavdëruar Perëndinë” (Ethëri 12:4).

Kur kemi shpresë, u besojmë premtimeve të Perëndisë. Kemi një siguri të heshtur që po të bëjmë “veprat e drejtësisë”, ne “duhet ta [marrim] shpërblimin [tonë], madje paqe në këtë botë dhe jetë të përjetshme në botën që vjen” (DeB 59:23). Mormoni mësonte se një shpresë e tillë vjen vetëm nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit: “Për çfarë duhet të keni shpresë? Vini re, unë ju them juve se duhet të keni shpresë nëpërmjet shlyerjes së Krishtit dhe fuqisë së ringjalljes së tij, që të ngri-

heni në jetën e përjetshme dhe kjo për shkak të besimit tuaj në të, sipas premtimit” (Moroni 7:41).

Kur përpiqeni të jetoni ungjillin, ju rritet aftësia që “të keni mbushulli në shpresë, me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë” (Romakëve 15:13). Shpresa juaj rritet ndërsa i luteni dhe kërkoni faljen e Perëndisë. Në Librin e Mormonit, një misionar i quajtur Aaron i dha siguri një mbreti lamanit: “Në qoftë se ti do të pendohesh për të gjitha mëkatet e tua dhe do të përulesh para Perëndisë dhe të thërrasësh emrin e tij në besim, duke besuar se do të marrësh, atëherë do të marrësh shpresën që dëshiron” (Alma 22:16). Edhe ju fitoni shpresë ndërsa studioni shkrimet e shenjta dhe i ndiqni mësimet e tyre. Apostulli Pali mësoi: “Të gjitha gjërat që u shkruan në të kaluarën u shkruan për mësimin tonë, që me anë të këmbënguljes dhe të ngushëllimit të Shkrimeve, të kemi shpresë” (Romakëve 15:4).

Parimi i shpresës shtrihet deri tek përjetësitë, por edhe ju krijon mbështetje përmes sfidave të përditshme të jetës. “Lum ai”, thotë Autori i psalmit, “që ka Perëndinë e Jakobit si ndihmë, shpresa e të cilit është tek Zoti, Perëndia i tij” (Psalmet 146:5). Me anën e shpresës ju mund të gjeni gëzim në jetë. Ju mund të “keni durim dhe të duroni . . . pikëllime, me shpresë, të vendosur se një ditë do të mund të pushoni nga të gjitha pikëllimet tuaja” (Alma 34:41). Ju mund të “shkoni përpara me një vendosmëri në Krisht, duke pasur një ndriçim të përkryer të shpresës dhe një dashuri për Perëndinë dhe për gjithë njerëzit. Prandaj, në qoftë se ju do të shkoni përpara, duke u ushqyer me bollëk mbi fjalën e Krishtit dhe të duroni deri në fund, vini re, kështu thotë Ati: Ju do të keni jetën e përjetshme” (2 Nefi 31:20).

Referime shtesë: Vajtimet 3:25-26; 1 Korintasve 15:19-22; 1 Pjetri 3:15; 1 Gjoni 3:2-3; Jakobi 4:4-6 [LiM]; Alma 13:28-29; 27:28; Ethëri 12:32; Moroni 8:26; 9:25; 10:22

*Shih gjithashtu* Besim; Dashuri Hyjnore; Fatkeqësi; Shlyerja e Jezu Krishtit

## **Shpuarit (të) e Trupit**

Profetët e ditëve të mëvonshme e shkurajojnë me forcë të shpuarit e trupit, përveçse për qëllime mjekimi. Nëse vajzat ose gratë dëshirojnë të shpojnë veshët, inkurajohen që të mbajnë vetëm një palë vathë të thjeshta.

Ata të cilët zgjedhin shpërfilljen e kësaj këshille, tregojnë mungesë respekti për veten dhe për Perëndinë. Një ditë do të ndjejnë keqardhje për vendimin e tyre.

Apostulli Pali mësoi për kuptimin e trupave tanë dhe për rrezikun e ndotjes së tyre qëllimisht: “A nuk e dini ju se jeni tempulli i Perëndisë dhe se Fryma e Perëndisë banon në ju? Në qoftë se dikush e prish tempullin e Perëndisë, Perëndia do ta prishë atë, sepse tempulli i Perëndisë, i cili jeni ju, është i shenjtë” (1 Korintasve 3:16-17).

*Shih gjithashtu* Tatuazh; Thjeshtësi

### **Shtatëdhjetë (i)** (*Shih* Administrim i Kishës)

### **Shtatëdhjetë (i) Autoritet Zone** (*Shih* Administrim i Kishës)

## **Tatuazh**

Profetët e ditëve të mëvonshme e shkurajojnë fuqimisht bërjen e tatuazheve në trup. Ata që e shpërfillin këtë këshillë tregojnë mungesë respekti për veten e tyre dhe për Perëndinë. Apostulli Pali na mësoi për domethënien e trupave tanë dhe rrezikun e fëlliqjes së tyre me qëllim: “A nuk e dini ju se jeni tempulli i Perëndisë dhe se Fryma e Perëndisë banon në ju? Në qoftë se dikush e prish tempullin e Perëndisë, Perëndia do ta prishë atë, sepse tempulli i Perëndisë, i cili jeni ju, është i shenjtë” (1 Korintasve 3:16-17).

Në qoftë se keni një tatuazh, ju mbani një kujtim të vazhdueshëm të një gabimi që keni bërë. Ju mund të merrni parasysh ta hiqni.

*Shih gjithashtu* (të) Shpuarit e Trupit

## Tempuj

Tempujt janë shtëpitë e Zotit në kuptimin e plotë të fjalës. Ato janë vende të shenjta për adhurim ku Zoti mund t'i vizitojë. Vetëm shtëpia mund të krahasohet me tempullin përse i përket shenjtërisë.

Gjatë gjithë kohërave Zoti e ka urdhëruar popullin e Tij të ndërtojë tempuj. Sot Kisha po i bindet thirrjes së Zotit për të ndërtuar tempuj në mbarë botën, duke i bërë më të arritshme bekimet e tempullit për një numër shumë të madh të fëmijëve të Atit tonë Qiellor.

### Ordinancat për të Gjallët

Qëllimi parësor i tempujve është të sigurojë ordinancat e nevojshme për ekzaltimin tonë në mbretërinë çelestiale. Ordinancat e tempullit çojnë drejt bekimeve më të mëdha të arritshme me anë të Shlyerjes së Jezu Krishtit. Çdo gjë që bëjmë në kishë—mbledhjet tona dhe veprimtaritë, përpjekjet tona misionare, mësimet që japim dhe himnet që këndojmë—duhet të na drejtojnë nga Shpëtimtari dhe tek puna që bëjmë në tempujt e shenjtë.

Njëra ordinancë që ne marrim në tempull është indaumenti. Fjala *indaument* do të thotë “dhuratë” dhe indaumenti i tempullit me të vërtetë është një dhuratë nga Perëndia. Kjo ordinancë përbëhet nga një seri udhëzimesh dhe përfshin besëlidhje që bëjmë për të jetuar me drejtësi dhe për të përmbushur kërkesat e ungjillit. Indaumenti na ndihmon të përqendrohemi tek Shpëtimtari, tek roli i Tij në planin e Atit tonë Qiellor dhe tek zotimi ynë për ta ndjekur Atë.

Një ordinancë tjetër e tempullit është martesë çelestiale, në të cilën burri dhe gruaja vulosen tek njëri-tjetri për të gjithë përjetësinë. Një vulosje e bërë në tempull vazhdon përgjithmonë, në qoftë se burri dhe gruaja janë besnikë ndaj besëlidhjeve që bëjnë.

Fëmijët e lindur nga prindër të cilët janë vulosur në tempull, lindin në besëlidhje. Ata fëmijë bëhen vetvetiu pjesë e

një familjeje të përjetshme. Fëmijët të cilët nuk janë lindur në besëlidhje, gjithashtu mund të bëhen pjesë e një familjeje të përjetshme, pasi prindërit e tyre nga gjaku ose ata birësues të jenë vulosur me njëri-tjetrin. Ordinanca e vulosjes së fëmijëve me prindërit bëhet në tempull.

Në qoftë se ju keni marrë ordianca tempulli, kujtojini gjithmonë besëlidhjet që keni bërë. Rikthehuni në tempull sa më shpesh që të mundeni. Në qoftë se jeni baba ose nënë, u mësoni fëmijëve domethënien e tempullit. I ndihmoni ata të përgatiten për të qenë të denjë të hyjnë në tempull.

Në qoftë se nuk keni marrë akoma ordianca të tempullit, filloni të përgatiteni tani. Aq sa e lejojnë rrethanat, frekuentoni tempullin për të marrë pjesë në pagëzime dhe konfirmime për të vdekurit.

### Ordinancat për të Vdekurit

Njerëz të cilët kanë vdekur pa ordianca thelbësore të ungjillit, mund t'i marrin këto ordianca me anë të punës që bëhet në tempull. Ju mund ta bëni këtë punë për paraardhësit tuaj dhe për të tjerë që kanë vdekur. Duke u vënë në vend të tyre, ju mund të pagëzoheni dhe të konfirmoheni, të merrni indaumentin dhe të merrni pjesë në vulosjet e burrit me gruan dhe të fëmijëve tek prindërit.

Në mënyrë aktive duhet të kërkoni për dokumenta të paraardhësve tuaj të vdekur, që kështu puna e tempullit të mund të bëhet për ta.

Për më shumë informacion për punën në tempull për të vdekurit dhe punën e historisë familjare, shih "Punë për Historinë e Familjes dhe Gjenealogji", faqe 136-139.

### Denjësia për të Hyrë në Tempull

Për të hyrë në tempull, ju duhet të jeni i denjë. Ju e vërtetoni denjësinë tuaj në dy intervista—njërën me një anëtar të këshillit të peshkopit ose të presidentit tuaj të degës dhe një tjetër me një anëtar të presidencisë së kunjit ose me preside-

ntin e misionit tuaj. Udhëheqësit tuaj të priftërisë do t'i mbajnë këto intervista si gjëra private dhe të besuara. Në secilën nga intervistat, udhëheqësi i priftërisë do t'ju pyesë mbi sjelljen dhe denjësinë tuaj vetjake. Do të pyeteni mbi dëshminë tuaj për Atin Qiellor dhe Shlyerjen e Jezu Krishtit dhe do të pyeteni nëse i mbështetni udhëheqësit e përgjithshëm dhe lokalë të Kishës. Do t'ju kërkohet pohim se ju jeni i pastër moralisht dhe se e zbatoni Fjalën e Urtësisë, se paguani të dhjetën e plotë, se jetoni në harmoni me mësimet e Kishës dhe nuk mbani ndonjë lidhje ose simpati me grupe braktisëse.

Në qoftë se ju jepni përgjigje të pranueshme për pyetjet në intervista dhe në qoftë se ju dhe udhëheqësit tuaj të priftërisë janë të bindur që ju jeni i denjë që të hyni në tempull, ju do të merrni një rekomandim tempulli. Ju dhe udhëheqësit tuaj të priftërisë do të firmosni rekomandimin, i cili do t'ju lejojë të hyni në tempull për dy vitet e ardhshme, nëse do të qëndroni i denjë.

Intervistat për rekomandimin e tempullit ofrojnë një mundësi shumë të mirë që të shqyrtoni denjësinë tuaj dhe modelin e jetës suaj. Në qoftë se në jetën tuaj ka diçka të gabuar, planifikoni që të takoheni me peshkopin ose presidentin tuaj të degës shumë më përpara intervistës suaj për rekomandim tempulli. Ai do të jetë në gjendje t'ju ndihmojë që të përgatiteni për të qenë i denjë për rekomandimin e tempullit.

### Veshjet e Tempullit

Kur të shkoni në tempull, ju duhet të vishni veshjet tuaja më të mira, ashtu siç bëni kur shkoni në kishë. Kur jeni brenda në tempull, ju i ndërroni rrobat tuaja dhe vishni rrobat e bardha të tempullit. Ky ndërrim rrobash bëhet në një dhomë veshjeje, ku ju përdorni një dollap me çelës dhe një vend të mbyllur e më vete për t'u veshur. Në tempull thjeshtësia mbahet me kujdes të madh.

Kur i vini rrobat në dollapin me çelës, ju mund t'i lini mbrapa të gjitha shpërqendrimit tuaja për gjërat e botës. Të veshur me të bardha mund të ndjeni njëjtësi dhe një ndjenjë



barazie me të tjerët në tempull, sepse përreth të gjithë janë të veshur njëllëj.

### Veshja e Veshjeve të Brendshme të Tempullit

Mbasi keni marrë indaumentin, ju keni bekimin të vishni veshjet e brendshme të tempullit gjatë gjithë jetës suaj. Ju keni detyrimin t'i vishni ato sipas udhëzimeve të dhëna në indaument. Mbani mend që bekimet të cilat janë të lidhura me këtë privilegj të shenjtë, varen nga denjësia juaj dhe nga besnikëria juaj në mbajtjen e besëlidhjeve të tempullit.

Veshjet e brendshme të tempullit sigurojnë një kujtues të vazhdueshëm të besëlidhjeve që ju keni bërë në tempull. Ju duhet t'i trajtoni ato përherë me respekt. Nuk duhet t'i shfaqni ato para atyre që nuk e kuptojnë domethënien e tyre dhe nuk duhet t'u bëni ndryshime për t'i përshtatur me moda të ndryshme veshjeje. Kur i vishni ato siç duhet, ato sigurojnë mbrojtje kundra tundimit dhe ligësisë. Veshja e veshjeve të brendshme të tempullit është një shfaqje e jashtme e zotimit të brendshëm për të ndjekur Shpëtimtarin.

### Bekimet nga Frekuentimi i Tempullit

Përveçse është një vend ku bëhen ordianca të shenjta të priftërisë, tempulli është një vend paqeje dhe i marrjes së zbulesës. Kur ju jeni të trazuar ose kur mbi kokën tuaj rëndojnë vendime kritike, ju mund t'i merrni shqetësimet tuaja në tempull. Atje ju mund të merrni udhëheqje shpirtërore.

Ndonjëherë mund të ndiheni sikur s'mund të mendoni qartë, ngaqë mendja juaj është shumë e ngarkuar me probleme dhe me shumë gjëra që kërkojnë vëmendje. Në tempull ndikimi i këtyre shpërqendrimeve mund të ndalojë, gjendja e turbullt dhe pasiguria mund të zhduken dhe ju mund të kuptoni gjëra që s'i keni kuptuar më parë. Ju mund të gjeni mënyra të reja për t'u marrë me sfidat që ju dalin përballë.

Zoti do t'ju bekojë teksa i kushtoni vëmendje punës së ordinancave të shenjta në tempull. Dhe bekimet që Ai do t'ju japë nuk do të kufizohen vetëm për kohën që jeni në tempull. Ai do t'ju bekojë në të gjitha aspektet e jetës suaj. Puna juaj në tempull do t'ju forcojë dhe do t'ju pastrojë shpirtërisht.

Referime shtesë: Isaia 2:1-3; DeB 88:119; 109-110; 124:39-41

*Shih gjithashtu* Besëlidhje; Martesë; Ordinanca; Plani i Shpëtimit; Punë për Historinë e Familjes dhe Gjenealogji

## Tundim

Ashtu siç profetizoi Apostulli Pali, ditët e fundit janë “kohë të vështira” (2 Timoteut 3:1). Ndikimi i armikut është joshës dhe i përhapur gjerësisht. Por ju mund ta mundni Satanin dhe t'i mposhtni tundimet e tij. Ati Qiellor ju ka dhënë dhuratën e lirisë së zgjedhjes—fuqinë për të zgjedhur të mirën në vend të së keqes. Ju mund “të përuleni para Zotit dhe të thërrisni në emrin e tij të shenjtë dhe të jeni vigjilentë, dhe të luteni vazhdimisht, që ju të mos tundoheni mbi atë që mund të duroni” (Alma 13:28). Kur u bindeni urdhërimeve me dëshirë, Ati juaj Qiellor do t'ju forcojë që t'i qëndroni tundimit.

Këshillat e mëposhtme do t'ju ndihmojnë që ta mposhtni tundimin:

*Përqendrojeni jetën tuaj mbi Shpëtimtarin.* Profeti Helamani i këshilloi fëmijët e tij: “Mbani mend, mbani mend se është mbi shkëmbin e Shëlbuesit tonë që është Krishti, biri i Perëndisë, që ju duhet të ndërtoni themelin tuaj; që kur djalli të çojë erërat e tij të fuqishme, po shigjetat e tij në shtjellë të erës, po, kur i gjithë breshëri i tij dhe furtuna e tij e fuqishme do të lëshohen mbi ju, nuk do të ketë fuqi mbi ju, që t'ju tërheqë në humnerën e mjerimit dhe të vuajtjes së pafund, për shkak të shkëmbit mbi të cilin jeni ndërtuar, që është një bazë e sigurt, një bazë mbi të cilën në qoftë se njerëzit ndërtojnë, nuk mund të bien” (Helamani 5:12).

*Lutuni për forcë.* Kur Shpëtimtari i ringjallur erdhi tek nefitet, ai mësoi turmën: “Ju duhet të mbani sytë hapur dhe

të luteni gjithnjë, që të mos bini në tundim; pasi Satani dëshiron t'ju ketë ju, që t'ju kalojë në shoshë, sikurse grurin. Prandaj, ju duhet t'i luteni gjithmonë Atit në emrin tim" (3 Nefi 18-19). Në ditët e mëvonshme Ai ka dhënë një këshillë të ngjashme: "Lutu gjithmonë që të mund të dalësh fitues; po, që ti të mund të mposhtësh Satanin dhe që ti të mund t'u shpëtosh duarve të shërbëtorëve të Satanit që vërtet përkrahin veprën e tij" (DeB 10:5).

*Studioni shkrimet e shenjta çdo ditë.* Kur i studioni të vërtetat e ungjillit dhe i zbatoni në jetë, Zoti do t'ju bekojë me forcë për t'i rezistuar tundimit. Nefi mësoi: "Të gjithë që do të dëgjonin fjalën e Perëndisë dhe do të mbaheshin fort në të, ata nuk do të mbaronin kurrë; as tundimet dhe shigjetat e flakta të kundërshtarit nuk do të mund t'i mposhtnin ata në verbëri, që t'i çojnë ata në shkatërrim" (1 Nefi 15:24; shih gjithashtu Helamani 3:29-30).

*Mbusheni jetën tuaj me mirësi.* Ju keni kaq gjëra të mira për të zgjedhur, sa që nuk keni nevojë të bëni atë që është e keqe. Kur e mbushni jetën tuaj me mirësi, nuk lini vend për ndonjë gjë tjetër.

*Shmangiuni vendeve dhe rrethanave tunduese.* Ju nuk mund t'i shmangni komplet tundimet, por mund të shmangni vendet ose rrethanat ku ka shumë të ngjarë të tundoheni. Ju gjithashtu mund të shmangni materiale të papërshtatshme në revista, libra, televizor, filma, muzikë dhe në internet.

*Mundohuni të ndikoni për mirë tek të tjerët.* Vetëm pak para se të vuante në Kopshtin e Gjetsemanit, Shpëtimtari u lut për dishepujt e Tij: "[Ata] nuk janë prej botës, ashtu si edhe unë nuk jam prej botës. Unë nuk kërkoj që ti t'i heqësh nga bota, por që ti t'i mbrosh nga i ligu. Ata nuk janë nga bota, sikurse unë nuk jam nga bota. Shenjtëroji në të vërtetën tënde; fjala jote është e vërteta. Sikurse ti më ke dërguar mua në botë, po ashtu unë i kam dërguar ata në botë" (Gjoni 17:14-18). Duke qenë dishepull i Jezu Krishtit në ditët e mëvonshme, ju mund

të jeni në botë por jo “nga bota”. Përveç shmangies së tundimeve tuaja, ju mund të ndikoni që të tjerët të jetojnë jetë të mirë dhe të shëndetshme. Ju mund të jeni një shembull drejtësie, të jeni mik i mirë, të merrni pjesë në shërbime komuniteti dhe kur duhet, ngrijeni zërin në mbrojtje të vlerave morale.

*Kurrë mos ngurroni në vendimet për të përballuar tundimin.* Mundohuni të ndiqni shembullin e Shpëtimtarit, i cili “vuajti tundime, por nuk ia vuri veshin atyre” (DeB 20:22). Kur Satani e tundoi Jezusin në shkretëtirë, Zoti asnjëherë nuk u lëkund. Përgjigjja e Tij ishte e shpejtë dhe e vendosur: “Largohu prej meje, Satana” (Lluka 4:8). Me anë të mendimeve, të fjalëve dhe të veprimeve të drejta, ju mund t’u përgjigjeni tundimeve të kundërshtarit me të njëjtën bindje. “Kundërshtoni djallin dhe ai do të largohet nga ju! Afrohuni te Perëndia dhe ai do t’ju afrohet juve” (Jakobi 4:7-8 [Bibla]).

Referime shtesë: Romakëve 12:21; Efesianëve 6:11-17; Jakobi 1:12; DeB 23:1; 31:12; Moisiu 1:12-22

*Shih gjithashtu* Agjërim dhe Oferta Agjërimi; Drita e Krishtit; Fryma e Shenjtë; Liri e Gjydhjes; Ndërgjegje; Pendim; Satani

## Thjeshtësi

Thjeshtësia është mbajtja e një qëndrimi të përvulur dhe të hijshëm në veshje, në zbulim, në gjuhë dhe në sjellje. Kur jeni i thjeshtë, nuk do të kërkonit të tërhiqni vëmendje të tepruar mbi ju. Në vend të kësaj, ju kërkonit të “përlëvdoni Perëndinë . . . në trupin tuaj dhe në frymën tuaj” (1 Korintasve 6:20; shih gjithashtu vargun 19).

Nëse nuk jeni i sigurt se veshja ose zbulimi juaj është i thjeshtë, i bëni vetes pyetjen: “A do të ndihesha rehat me paraqitjen time, po të isha në prani të Zotit?” Të njëjtën pyetje mund t’i bënit vetes lidhur me gjuhën dhe sjelljen: “Do t’i thoja këto fjalë ose do të merresha me këto veprimtari, po të

ishte i pranishëm Zotit?" Përgjigjet e ndershme të këtyre pyetjeve mund t'ju prijnë që të bëni ndryshime të rëndësishme në jetën tuaj. Të dhënat në vijim do t'ju ndihmojnë në përpjekjet tuaja për thjeshtësi.

### Veshja dhe Zbukurimi

Profetët gjithnjë na kanë këshilluar të vishemi thjesht. Kjo këshillë bazohet tek e vërteta se trupi njerëzor është krijimi i shenjtë i Perëndisë. Nderojeni trupin si dhuratë nga Perëndia. Nëpërmjet veshjes dhe paraqitjes suaj, mund t'i tregoni Zotit se e dini se sa i çmuar është trupi që keni.

Veshja juaj shpreh se kush jeni ju. Ajo dërgon mesazhe përreth jush dhe ndikon në mënyrën me të cilën veproni ju dhe të tjerët. Kur jeni të zbukuruar mirë e të veshur thjesht, kjo mund të jetë ftesë për shoqërinë e Shpirtit dhe mund të ushtrojë ndikim për mirë mbi ata përreth.

Në qendër të urdhërimit për të qenë të thjeshtë, është kuptimi i drejtë i fuqisë së krijimit të jetës, i aftësisë për të sjellë fëmijë në këtë botë. Kjo fuqi duhet të përdoret vetëm midis bashkëshortit dhe bashkëshortes. Veshjet e hapura dhe seksualisht nxitëse, që përfshijnë pantallona dhe funde të shkurtëra, veshje të ngushta dhe bluza që nuk e mbulojnë barkun, mund të nxisin dëshira dhe veprime që dhunojnë ligjin e Zotit për dëlirësinë.

Pëveç mënjanimi të veshjeve të hapura, duhet të shmangni kalimin në modele extreme të veshjes, paraqitjes dhe prerjes së flokëve. Në veshje, në zbukurim dhe në modele përherë qëndroni i saktë dhe i pastër, asnjëherë i çrregullt ose i shkujdesur në mënyrë të pavend. Mos u shëmtoni me tatuazhe apo me të shpuara në trup. Në rast se jeni grua dhe dëshironi të shponi veshët, mbani veçse një palë vathë të thjeshtë.

Mbani norma të larta thjeshtësie për të gjitha rastet. Mos i zvogëlioni normat tuaja që të tërhiqni vëmendjen mbi trupin tuaj ose që të merrni miratimin e të tjerëve. Dishepujt e vërtetë të Jezu Krishtit i mbajnë kriteret e Zotit pavarësisht nga stili i kohës ose presioni i të tjerëve.

## Gjuha dhe Sjellja

Ashtu si veshja dhe zbukurimi, edhe gjuha dhe sjellja janë shprehje të cilësisë suaj morale. Fjalët dhe veprimet tuaja mund të kenë ndikim të thellë tek ju dhe tek të tjerët. Shprehuni me anë të gjuhës së pastër, të padyshimtë e lartësuese dhe me veprime që u sjellin lumturi atyre përreth. Përpjekjet tuaja që të jeni i thjeshtë në fjalë e në vepra, çojnë drejt rritjes së udhëheqjes dhe ngushëllimit nga Fryma e Shenjtë.

Largoni gjuhën e ndyrë dhe të shkujdesur, përdorimin e emrit të Zotit pa respekt, të cilat janë aq të rëndomta në botë. I bëni qëndresë tundimit për t'u përfshirë në sjellje jo të matura ose të papërshtatshme. Natyra e një gjuhe dhe sjelljeje të tillë me mungesë respekti dëmton aftësinë për të marrë nxitjet e qeta të Frymës së Shenjtë.

Referime shtesë: DeB 42:40-41; Nenet e Besimit 1:13

*Shih gjithashtu Dëlirësi; Përdhosje; Tatuazh; (të) Shpuarit e Trupit*

## Ungjill

Ungjilli është plani i Atit Qiellor për lumturi. Doktrina qendrore e ungjillit është Shlyerja e Jezu Krishtit.

Profeti Jozef Smith tha: “Parimet dhe ordinancat e para të Ungjillit janë: së pari, Besimi në Zotin Jezu Krisht; së dyti, Pendimi; së treti, Pagëzimi me anë të zhytjes për heqjen e mëkateve; së katërti, Vënia e duarve për dhuratën e Frymës së Shenjtë” (Nenet e Besimit 1:4). Në formën e tij të plotë, ungjilli përfshin të gjitha doktrinat, parimet, ligjet, ordinancat dhe besëlidhjet e domosdoshme që ne të ekzaltohemi në mbretërinë çelestiale. Shpëtimtari ka premtuar që, nëse durojmë deri në fund, duke e jetuar ungjillin me besnikëri, Ai do të na quajë të pafajshëm përpara Atit në Gjykimin Përfundimtar (shih 3 Nefi 27:16).

Plotësia e ungjillit është predikuar në të gjitha kohërat kur fëmijët e Perëndisë kanë qenë të përgatitur për ta pranuar. Në ditët e mëvonshme, ose periudha ungjillore e plotësisë së

kohëve, ungjilli është rivendosur nëpërmjet Profetit Jozef Smith.

Referime shtesë: Romakëve 1:16-17; 3 Nefi 27:13-22; DeB 11:24; 39:5-6

*Shih gjithashtu* Besim; Fryma e Shenjtë; Jezu Krishti; Pagëzim; Pendim; Plani i Shpëtimit; Rivendosje e Ungjillit; Shlyerja e Jezu Krishtit

## Unitet

Pak para se Shpëtimtari të kryente Shlyerjen, Ai u lut për dishepujt e Tij, të cilët Ai i kishte dërguar në botë për të mësuar ungjillin. Ai u lut edhe për ata që do të besonin në Të prej fjalëve të dishepujve të Tij. Ai u lut për unitet: “Që të gjithë të jenë një, ashtu si ti, o Atë, je në mua dhe unë në ty; edhe ata të jenë një në ne, që bota të besojë se ti më ke dërguar” (Gjoni 17:21).

Nga kjo lutje ne mësojmë se si na bashkon ungjilli me Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin dhe me njëri-tjetrin. Kur e jetojmë ungjillin, duke marrë ordinancat e shpëtimit dhe duke mbajtur besëlidhjet tona, natyra jonë ndryshon. Shlyerja e Shpëtimtarit na shenjtëron ne dhe ne mund të jetojmë në unitet, duke shijuar paqen në këtë jetë dhe duke u përgatitur të jetojmë me Atin dhe Birin e Tij përgjithmonë.

Zoti ka thënë: “Nëse nuk jeni një, nuk jeni të mitë” (DeB 38:27). Ju mund të përpiqeni ta mbani dhe ta përkrahni këtë kriter të unitetit, në familje dhe në Kishë. Në qoftë se jeni i martuar, ju dhe bashkëshortja mund të jeni të bashkuar në qëllim dhe në veprim. Mund t’i lejoni cilësitë tuaja të veçanta të plotësojnë njëra-tjetrën teksa i përballoni së bashku sfidat dhe forcoheni në dashuri e mirëkuptim. Gjithashtu mund të bashkoheni me anëtarë të tjerë të familjes dhe me anëtarë të Kishës nëpërmjet shërbimit së bashku, mësimi të njëri-tjetrit dhe inkurajimit të njëri-tjetrit. Mund të bëheni një me Presidentin e Kishës dhe me udhëheqës të tjerë të Kishës kur studioni fjalën e tyre dhe ndiqni këshillën e tyre.

Në një kohë që Kisha rritet anëmbanë botës, të gjithë shenjtorët e ditëve të mëvonshme mund të qëndrojnë të bashkuar.

Zemrat tona mund të jenë “të thurura në bashkim dhe në dashuri kundrejt njëri-tjetrit” (Mosia 18:21). Ne e vlerësojmë larminë kulturore dhe ndryshimet mes individëve, por ne gjithashtu përpiqemi për “[unitetin e] besimit” që vjen kur ndjekim udhëheqës të frymëzuar dhe kur mbajmë mend se jemi të gjithë fëmijë të të njëjtit Atë (shih Efesianëve 4:3-6, 11-13).

*Shih gjithashtu* Bindje; Dashuri; Martesë; Sion; Shërbim

**Varësi** (*Shih* Fjala e Urtësisë; Kumar; Pornografi)

## Vdekje Fizike

Vdekja fizike është ndarja e shpirtit nga trupi i vdekshëm. Rënia e Adamit solli vdekje fizike në botë (shih Moisiu 6:48).

Vdekja është pjesë thelbësore e Planit të Atit Qiellor për shpëtimin (shih 2 Nefi 9:6). Në mënyrë që të bëhemi si Ati ynë i Amshuar, duhet të përjetojmë vdekjen dhe më vonë të marrim trupa të ringjallur të përsosur.

Kur trupi fizik vdes, shpirti vazhdon të jetojë. Në botën e shpirtave, shpirtat e të drejtëve “pranohen në një gjendje lumturie që quhet parajsë, një gjendje e pushimit, një gjendje e paqes, ku ata do të prehen nga të gjitha trazirat e tyre dhe nga të gjitha vuajtjet dhe brengat” (Alma 40:12). Një vend i quajtur burg shpirtëror u rezervohet “atyre që [kanë] vdekur në mëkatet e tyre, pa një dituri të së vërtetës ose të shkeljes, duke i mohuar profetët” (DeB 138:32). Shpirtave në burg “[u mësohet] besim në Perëndinë, pendim nga mëkati, pagëzimi mëkëmbës për heqjen e mëkateve, dhurata e Frymës së Shenjtë me anë të vënies së duarve, dhe të gjitha parimet e tjera të ungjillit të cilat janë të nevojshme për ta për t’i ditur” (DeB 138:33-34). Nëse ata pranojnë parimet e ungjillit, pendohen për mëkatet e tyre dhe pranojnë ordinancat e kryera në tempuj në emër të tyre, ata do të mirëprehen në parajsë.



Për shkak të Shlyerjes dhe Ringjalljes së Jezu Krishtit, vdekja fizike është veçse e përkohshme: “Ashtu sikur të gjithë vdesin në Adamin, kështu të gjithë do të ngjallen në Krishtin” (1 Korintasve 15:22). Çdo njeri do të ringjallet, domethënë çdo shpirt individ do të ribashkohet me trupin e tij ose të saj—“[të rikthyer] në formën e tyre të përshtatshme dhe të përkryer” dhe të paprekshëm më nga vdekja (Alma 40:23; shih gjithashtu Alma 11:44-45).

Mbase ju e keni përjetuar dhimbjen që vjen me vdekjen e një anëtari të familjes ose një miku. Është e natyrshme të ndjesh trishtim në të tilla kohë. Në fakt, vajtimi është një nga shprehjet më të thella të dashurisë. Zoti tha: “Jeto së bashku në dashuri, kështu që ti duhet të vajtosh për humbjen e atyre që vdesin” (DeB 42:45). E vetmja mënyrë për t’i hequr vdekjes trishtimin është t’i heqësh jetës dashurinë.

Madje atëherë kur vajtoni për vdekjen e të dashurve, ju mund të merrni ngushëllim në premtimin e ringjalljes dhe në sigurinë që familjet mund të jenë bashkë përgjithmonë. Ju mund “[të shihni] arsyen e madhe të pikëllimit dhe gjithashtu të gëzimit—pikëllim për shkak të vdekjes dhe shkatërrimit mes njerëzve dhe gëzim për shkak të dritës jetëdhënëse të Krishtit” (Alma 28:14; shih gjithashtu vargjet 9-13).

Veç marrjes së ngushëllimit kur vdesin njerëz të dashur, mund të jeni në paqe duke ditur se në përfundim ju do të vdisni. Ndërsa jetoni ungjillin, mund të kujtoni premtimin e Zotit: “Ata që vdesin në mua, nuk do ta shijojnë vdekjen, sepse ajo do të jetë e ëmbël për ta” (DeB 42:46).

Referime shtesë: Isaia 25:8; 1 Korintasve 15:51-58; 2 Nefi 9:6-15; Mosia 16:6-8

*Shih gjithashtu* Parajsë; Plani i Shpëtimit; Ringjallje; Shlyerja e Jezu Krishtit

## Vdekje Shpirtërore

Vdekja shpirtërore është shkëputja nga Perëndia. Shkrimet e shenjta mësojnë për dy burime të vdekjes shpirtërore. Burimi i parë është Rënia dhe i dyti është mosbindja jonë.

Profeti në Librin e Mormonit, Samueli, mësoi: “I gjithë njerëzimi, që nga rënia e Adamit, pasi u përjashtua nga prania e Zotit, u konsiderua i vdekur, si për gjërat tokësore, ashtu dhe për gjërat shpirtërore” (Helaman 14:16). Gjatë jetës sonë në tokë, ne shkëputemi nga prania e Perëndisë. Nëpërmjet Shlyerjes, Jezu Krishti shëlbbon secilin nga kjo vdekje shpirtërore. Samueli dëshmoi që Ringjallja e Shpëtimtarit “shëlbbon gjithë njerëzimin nga vdekja e parë—nga vdekja shpirtërore . . . Vini re, ringjallja e Krishtit shëlbbon njerëzimin, po, madje gjithë njerëzimin dhe e sjell përsëri në praninë e Zotit” (Helamani 14:16-17). Profeti Lehi mësoi se për shkak të Shlyerjes “të gjithë njerëzit do të vijnë te Perëndia; prandaj, ata qëndrojnë në praninë e tij për t’u gjykuar prej tij sipas së vërtetës dhe shenjtërisë që janë në të” (2 Nefi 2:10).

Vdekje shpirtërore e mëtejshme vjen si rezultat i mosbindjes sonë. Mëkatet tona na bëjnë të papastër dhe të paaftë për të banuar në praninë e Perëndisë (shih Romakëve 3:23; Alma 12:12-16, 32; Helamani 14:18; Moisiu 6:57). Nëpërmjet Shlyerjes, Jezu Krishti ofron shëlbim nga kjo vdekje shpirtërore, por vetëm kur ushtrojmë besim në Të, kur pendohemi për mëkatet tona dhe u bindemi parimeve dhe ordinancave të ungjillit (shih Alma 13:27-30; Helamani 14:19; Nenet e Besimit 1:3).

Referime shitesë: 1 Nefi 15:33-35; Alma 40:26; 42:23

*Shih gjithashtu* Besim; Bindje; Mëkat; Pendim; Rënie; Shlyerja e Jezu Krishtit

## Vënie e Duarve

Vënia e duarve është praktikë e zbuluar nga Zoti për kryerjen e shumë ordinancave të priftërisë, si konfirmimi,

shugurimi, veçimi i anëtarëve për të shërbyer në thirrje, administrimi i të sëmurëve dhe dhënia e bekimeve të tjera priftërore (shih DeB 42:44; Nenet e Besimit 1:4-5). Ata që kanë autoritetin e duhur të priftërisë, vendosin duart e tyre mbi kokën e personit që merr ordinancën. Në këtë mënyrë ata shërbejnë si mjet me të cilin Zoti bekon fëmijët e Tij (shih DeB 36:2).

Kjo praktikë është përdorur përherë nga mbajtësit e priftërisë. Adami shuguroi pasardhësit e tij të drejtë meshkuj nëpërmjet vënies së duarve (shih DeB 107:40-50). Kur Jakobi shqiptoi bekimet mbi Efraimin dhe Manasin, ai u vuri duart mbi kokë (shih Zanafilla 48:14-19). Alma “shuguroi priftërinj dhe pleq, nëpërmjet vënies së duarve të tij, sipas urdhrit të Perëndisë” (Alma 6:1). Apostujt Pjetri dhe Gjoni dhanë dhuratën e Frymës së Shenjtë nëpërmjet vendosjes së duarve (shih Veprat e Apostujve 8:14-17). Në këtë periudhë ungjillore, Gjon Pagëzori u akordoi Priftërinë Aarone Jozef Smithit dhe Oliver Kaudërit me anë të vënies së duarve (shih Joseph Smith—Historia 1:68-69).

Referime shtesë: Numrat 27:18-23; Veprat e Apostujve 19:1-6; 1 Timoteut 4:14; DeB 33:15; 35:6

*Shih gjithashtu Fryma e Shenjtë; Priftëri*

## **Vepra Standarde** (*Shih Shkrime të Shenjta*)

## **Veshje të Brendshme** (*Shih Tempuj*)

## **Zbulesë**

Zbulesa është njoftim nga Perëndia për fëmijët e Tij. Ky udhëzim vjen nëpërmjet mënyrave të ndryshme, sipas nevojave dhe rrethanave të personave, të familjeve dhe të Kishës në tërësi.

Kur Zoti i zbulon vullnetin e Tij Kishës, Ai flet nëpërmjet profetit të Tij. Shkrimet e shenjta përmbajnë shumë zbulesa—fjalën e Zotit me anë të profetëve të lashtë dhe të ditëve të

mëvonshme. Sot Zoti vazhdon ta udhëheqë Kishën duke ua zbuluar vullnetin e tij shërbëtorëve të zgjedhur.

Profetët nuk janë të vetmit njerëz që mund të marrin zbulesë. Sipas besnikërisë suaj ju mund të merrni zbulesë që t'ju ndihmojë në raste nevoje, në përgjegjësi dhe në pyetje të veçanta dhe t'ju ndihmojë të forconi dëshminë tuaj.

Përgatitja për të Marrë Zbulesë nëpërmjet Frymës së Shenjtë

Shkrimet e shenjta tregojnë lloje të ndryshme zbuluese, si: vegime, ëndërra dhe vizita nga engjëjt. Nëpërmjet mënyrave të tilla njoftimi, Zoti ka rivendosur ungjillin e Tij në ditët e mëvonshme dhe ka zbuluar të vërteta që lidhen me doktrina të tilla si ekzistenca para lindjes, shëlbimi i të vdekurve dhe tre mbretëritë e lavdisë. Megjithatë, shumica e zbulësive tek udhëheqësit dhe anëtarët e Kishës vjen nëpërmjet pëshpëritjeve të Frymës së Shenjtë.

Nxitjet e heshtura shpirtërore mund të mos duken aq të bujshme sa vizitat engjëjllore, por ato janë më të fuqishme e më të qëndrueshme dhe më jetëndryshuese. Dëshmia nga Fryma e Shenjtë lë një përshtypje në shpirt, e cila është më kuptimplote se çfarëdoqoftë që mund të shihni ose të dëgjoni. Përmes zbulësive të tilla, ju do të merrni forcë të qëndrueshme që t'i qëndroni besnik ungjillit dhe t'i ndihmoni të tjerët të bëjnë njëllë.

Këshillat në vazhdim do t'ju ndihmojë të përgatiteni që të merrni nxitje nga Fryma e Shenjtë:

*Lutuni për udhëheqje.* Zoti tha: “Lypni dhe do t’ju jepet; kërkonti dhe do të gjeni; trokitni dhe do t’ju çelet. Sepse kush lyp merr, kush kërkon gjen dhe do t’i çelet atij që troket” (Mateu 7:7-8). Që ju të gjeni dhe të merrni, duhet të përpiqeni dhe të kërkonti. Nëse nuk trokisni—duke iu lutur Atit Qiellor për udhëheqje—dera e zbulësës nuk do t’ju hapet. Por, nëse i afroheni Atit tuaj me lutje të përrulur, ju përfundimisht mund “të [merrni] zbulesë pas zbulësive, dituri pas diturie, që të mund të [dini] misteret dhe gjërat paqësore—ato që sjellin gëzim, ato që sjellin jetë të përjetshme” (DeB 42:61).

*Jini nderues.* Nderimi është respekt dhe dashuri e thellë. Kur jeni nderues dhe i qetë, ju e ftoni zbulesën. Edhe kur çdo gjë rreth jush është në trazirë, ju mund të mbani qëndrim adhurues dhe të jeni i përgatitur për të marrë udhëheqje nga Zoti.

*Jini i përlur.* Përlësia lidhet ngushtë me nderimin. Kur jeni i përlur, ju pranoni që vareni nga Zoti. Profeti Mormoni mësoi: “Për shkak të bindjes dhe të përlësisë në zemër, vjen vizitimi i Frymës së Shenjtë, Ngushëllues i cili mbush me shpresë dhe dashuri të pastër” (Moroni 8:26).

*Mbani urdhërimet.* Kur mbani urdhërimet, jeni i përgatitur që t’i merrni, t’i njihni dhe t’i ndiqni nxitjet e Frymës së Shenjtë. Zoti premtoi: “Atij që i mban urdhërimet e mia, unë do t’i jap misteret e mbretërisë sime dhe ato do të jenë në të një burim uji të gjallë, duke gufuar në jetë të përvetshme” (DeB 63:23).

*Merrni sakramentin me denjësi.* Lutja e Sakramentit na mëson si të marrim shoqërinë e vazhdueshme të Shpirtit të Shenjtë. Kur merrni sakramentin, i dëshmoni Perëndisë se jeni i gatshëm të merrni mbi vete emrin e Birit të Tij dhe që do ta kujtoni Atë përherë e do t’i mbani urdhërimet e Tij. Ati Qiellor premton se, kur i mbani këto besëlidhje, do të keni përherë me vete Shpirtin. (Shih DeB 20:77, 79.)

*Studioni përditë shkrimet e shenjta.* Ndërsa studioni me zell shkrimet e shenjta, mund të mësoni prej shembujve të burrave e grave, jeta e të cilëve ishte bekuar kur kishin ndjekur vullnetin e Zotit të shfaqur me zbulesë. Gjithashtu bëheni më i gatshëm të merrni nga Fryma e Shenjtë në jetën vetjake. Ndërsa lexoni dhe mendoni thellë, mund të merrni zbulesë se si zbatohet tek ju një pjesë e caktuar e shkrimit të shenjtë ose për diçka tjetër të cilën Zoti ka dëshirë t’ju njoftojë. Për arsye se shkrimet e shenjta mund t’ju ndihmojnë që të merrni zbulesë për vete, ju duhet t’i studioni shkrimet e shenjta për çdo ditë.

*Shpenzoni kohë për të menduar thellë.* Kur kaloni kohë duke menduar thellë për të vërtetat e ungjillit, ju ia hapni mendjen dhe zemrën ndikimit udhëheqës të Frymës së Shenjtë (shih 1 Nefi 11:1; DeB 76:19; 138:1-11). Mendimi i thelluar ju

shkëput vëmendjen nga gjërat e vogla të botës dhe ju sjell më pranë Shpirtit.

*Kur kërkoni udhëzime të përcaktuara, shqyrtojeni çështjen në mendje.* Nganjëherë kumtimi i Zotit do të vijë vetëm pasi ta keni shqyrtuar në mendje çështjen. Zoti ia shpjegoi këtë mënyrë veprimi Oliver Kaudërit, i cili shërbeu si shkruer i Jozef Smithit për një pjesë të madhe të përkthimit të Librit të Mormonit. Nëpërmjet Profetit Jozef Smith, Zoti i foli Oliver Kaudërit, ku i shpjegoi përse Oliveri nuk kishte qenë në gjendje të përkthente Librin e Mormonit, edhe pse i ishte dhënë dhurata për të përkthyer: “Vër re, ti nuk ke kuptuar; ke menduar se do të ta jap atë, kur ti nuk e more mundimin as për të më pyetur. Por, vër re, unë të them se ti duhet ta studiosh atë tërësisht në mendjen tënde; më pas ti duhet të më pyesësh nëse është e drejtë dhe, nëse është e drejtë, unë do të bëj që krahërori yt do të digjet përbrenda; si rrjedhim, do ta ndjesh që është e drejtë” (DeB 9:7-8).

*Kërkoni me durim vullnetin e Perëndisë.* Perëndia e zbulon Vetën “në vetë kohën e tij dhe në vetë mënyrën e tij, dhe sipas vetë vullnetit të tij (shih DeB 88:63-68). Ka të ngjarë që zbulesa do t’ju vijë “rresht pas rreshti, parim pas parimi, pak këtu dhe pak atje” (2 Nefi 28:30; shih gjithashtu Isaia 28:10; DeB 98:12). Mos u orvatni të detyroni gjërat shpirtërore. Zbulesa nuk vjen me atë mënyrë. Kini durim dhe mirëbesim në kohëmatjen e Zotit.

Njohja e Nxitjeve të Frymës së Shenjtë

Të ndodhur në mes të zhurmave të shumta dhe të shumë atyre që përcjellin lajme sot në botë, ju duhet të mësoni të njihni pëshpëritjet e Frymës së Shenjtë. Në vijim jepen disa nga mënyrat kryesore me të cilat Fryma e Shenjtë na kumton diçka:

*Ai i flet mendjes dhe zemrës me zë të qetë dhe të ulët.* Zoti na mësoi: “Unë do të të them në mendjen tënde dhe në zemrën tënde, me anë të Frymës së Shenjtë, që do të vijë mbi ty dhe

që do të banojë në zemrën tënde. Tani, vër re, ky është shpirti i zbulesës” (DeB 8:2-3). Nganjëherë Fryma e Shenjtë do t’ju ndihmojë që të kuptoni një të vërtetë nga ungjilli ose do t’ju japë një nxitje që “duket se e ka pushtuar mendjen [tuaj] dhe ndikon në ndjenjat [tuaja]” (DeB 128:1). Megjithëse një zbulesë e tillë mund t’ju lërë përshtypje të fuqishme, pothuajse gjithnjë ajo vjen pa zhurmë, “si një shushuritje e ëmbël” (shih 1 Mbretërve 19:9-12; Helamani 5:30; DeB 85:6).

*Ai na jep nxitje nëpërmjet ndjenjave.* Edhe pse shpesh e përshkruajmë si zë njoftimin nga Shpirti, ky zë është më shumë ajo që ndjejmë, sesa ajo që dëgjojmë. Gjithashtu, kur flasim mbi “dëgjimin” e pëshpëritjeve të Frymës së Shenjtë, ne shpesh e përshkruajmë nxitjen shpirtërore me fjalët: “Unë kisha një ndjenjë . . .”. Këshilla e Zotit për Oliver Kaudërin në seksionin 9 të Doktrina e Besëlidhje, e cila shtjellohet tek faqja 195, këtë parim mëson. Megjithatë, kjo këshillë nganjëherë nuk kuptohet drejt. Pasi lexojnë atë pjesë, disa anëtarë të Kishës hyjnë në shqetësim, duke drujtur se nuk kanë marrë kurrë një nxitje nga Fryma e Shenjtë, ngaqë nuk e kanë ndjerë kurrë krahërorin e tyre të ndezur. Vini re fjalët e fundit të Zotit në Doktrina e Besëlidhje 9:8: “Si rrjedhim, do ta ndjesh që është e drejtë”. Ndezja që përshkruhet në këtë pjesë të shkrimit të shenjtë, kupton një ndjenjë lehtësimi dhe kthjelltësie, jo medoemos ndjesinë e nxehtësisë. Kur vazhdoni të kërkoni e të ndiqni vullnetin e Zotit në jetë, do të arrini të njihni mënyrën e ndikimit të Frymës së Shenjtë mbi vetë ju.

*Ai sjell paqe.* Fryma e Shenjtë quhet shpesh Ngushëlluesi (shih Gjoni 14:26; DeB 39:6). Ndërsa ju zbulon vullnetin e Zotit, Fryma e Shenjtë do t’i “flasë paqe mendjes tënde” (DeB 6:23). Paqja që jep Ai, nuk mund të falsifikohet nga ndikimet ose mësimet e rreme të kësaj bote. Ajo është paqja që premtoi Shpëtimtari kur i siguroi dishepujt e Tij se do t’u dërgonte Ngushëlluesin: “Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë po jua jap, po jo si e jep bota; zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë” (Gjoni 14:27).

Referime shtesë: Amosi 3:7; Mateu 16:13-18; 1 Korintasve 2:9-14; 12:3; Zbulesa 19:10; Alma 5:43-48; 17:2-3; DeB 76:5-10; 121:26-33; Nenet e Besimit 1:7, 9

*Shih gjithashtu* Besim; Dhurata Shpirtërore; Fryma e Shenjtë; Lutje; Nderim; Shkrime të Shenjta

## **Zbulesë Personale** (*Shih Zbulesë*)



*Mëso nga unë dhe dëgjoji fjalët e mia;  
ec në butësinë e Shpirtit tim  
dhe ti do të kesh paqe në mua.*

*Doktrina e Besëlidhje 19:23*

KISHA E  
JEZU KRISHTIT  
E SHENJTORËVE TË  
DITËVE TË MËVONSHME

ALBANIAN

